



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 5 prill 2023
Nr. ref.:AGJ 2152/23

AKTGJYKIM

në

rastet nr. KO100/22 dhe KO101/22

parashtrues

të kërkesës KO100/22, Abelard Tahiri dhe 10 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës;
të kërkesës KO101/22, Arben Gashi dhe 10 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Ligjit Nr.08/L-136 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar
Enver Peci, gjyqtar

Parashtruesit e kërkesave

- Kërkesa KO100/22 është dorëzuar nga Abelard Tahiri, Elmi Reçica, Ganimete Musliu, Enver Hoxhaj, Ferat Shala, Blerta Deliu-Kodra, Bekim Haxhiu, Floretë Zejnullahu, Isak Shabani, Rashit Qalaj dhe Hajdar Beqa, deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kuvendi), të grupit parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës (në tekstin e mëtejme: PDK), të cilët i përfaqëson Faton Fetahu, avokat.

2. Kërkesa KO101/22 është dorëzuar nga Arben Gashi, Armend Zemaj, Avdullah Hoti, Agim Veliu, Rrezarta Krasniqi, Besian Mustafa, Hykmete Bajrami, Vlora Dumoshi, Valentina Bunjaku, Anton Quni dhe Marigona Geci, po ashtu deputetë të Kuvendit, të grupit parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës (në tekstin e mëtejme: LDK), të cilët i përfaqëson deputeti Armend Zemaj (në tekstin e mëtejme të referuar bashkërisht si parashtruesit e kërkesës/kërkesave).

Ligji i kontestuar

3. Parashtruesit e kërkesës në rastin KO100/22, e kontestojnë kushtetutshmërinë e neneve 13, 16, 18 dhe 20 të Ligjit nr.08/L-136 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji i kontestuar), miratuar me Vendimin e Kuvendit [nr.08-V-309] të 23 qershorit 2022. Ndërsa, parashtruesit e kërkesës në rastin KO101/22, e kontestojnë kushtetutshmërinë e Ligjit të Kontestuar në tërësinë e tij.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes së kërkesave është vlerësimi i kushtetutshmërisë së dispozitave të Ligjit të kontestuar, për të cilat parashtruesit e kërkesave pretendojnë se nuk janë në përputhshmëri me nenet: 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit], 16 [Epërsia e Kushtetutës], 24 [Barazia para Ligjit], 32 [E Drejta për Mjete Efektive], 45 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes], 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave], 109 [Prokurori i Shtetit] dhe 110 [Këshilli Prokurorial i Kosovës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).
5. Përveç kësaj, parashtruesit e kërkesave kërkojnë nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata), të vendosë masë të përkohshme, për të pezulluar *ex lege* hyrjen në fuqi dhe zbatimin e Ligjit të kontestuar, deri në vendosjen përfundimtare për kërkesat nga Gjykata.

Baza juridike

6. Kërkesat bazohen në paragrafin 5 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] dhe paragrafin 2 të nenit 116 [Efekti i Vendimeve] të Kushtetutës, në nenet 22 (Procedimi i kërkesës), 27 (Masat e përkohshme), 42 (Saktësimi i kërkesës) dhe 43 (Afatet) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji), dhe rregullat 32 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) dhe 74 (Kërkesa në pajtim me nenin 113.5 të Kushtetutës dhe neneve 42 dhe 43 të Ligjit) të Rregullores së punës së Gjykatës, nr.01/2018 (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

7. Më 1 korrik 2022, parashtruesit e kërkesave i dorëzuan kërkesat në Gjykatë.
8. Më 4 korrik 2022, Kryetarja e Gjykatës, përmes Vendimit [Nr.GJR.KSH KO100/22], për rastin KO100/22, caktoi gjyqtarin Bajram Ljatifi gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga: Selvete Gërxhaliu-Krasniqi (kryesuese), Safet Hoxha dhe Nexhmi Rexhepi (anëtarë). Po të njëjtën ditë, Kryetarja, për rastin KO101/22, përmes Vendimit [Nr.GJR.KSH KO101/22], caktoi gjyqtarin Radomir Laban, gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga: Selvete Gërxhaliu-Krasniqi (kryesuese), Safet Hoxha dhe Nexhmi Rexhepi (anëtarë).

9. Më 4 korrik 2022, Kryetarja, në pajtim me paragrafin (1) të rregullit 40 (Bashkimi dhe ndarja e kërkesave) të Rregullores së punës, përmes Urdhrit [KO100/22 dhe KO101/22], urdhëroi bashkimin e kërkesës KO101/22 me kërkesën KO100/22. Bazuar në paragrafin (3) të rregullit të lartcekur, për kërkesat e bashkuara, gjyqtari raportues dhe përbërja e Kolegjit shqyrtues mbetet në përbërje të njëjtë, siç është përcaktuar për kërkesën e parë, përkatësisht atë KO100/22.
10. Në të njëjtën datë, Gjykata njoftoi për regjistrimin e kërkesave fillimisht: (i) Presidenten e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Presidentja); (ii) Kryetarin e Kuvendit, të cilit iu kërkua që të njoftojë deputetët se mund të dorëzojnë komentet e tyre në lidhje me kërkesat e parashtruesve të kërkesave, nëse kanë, deri më 18 korrik 2022; si dhe (iii) Sekretarin e Përgjithshëm të Kuvendit, me sqarimin që bazuar në paragrafin 2 të nenit 43 të Ligjit, *“në rast kur ligji apo vendimi i miratuar nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës kontestohet sipas nenit 113, paragrafi 5 i Kushtetutës, ligji apo vendimi i tillë mund t’i dërgohet Presidentit të Republikës së Kosovës për shpallje në pajtim me modalitetet e përcaktuara në vendimin final të Gjykatës Kushtetuese për rastin e kontestuar”*. Gjykata, bazuar në dispozitën e lartcekur të Ligjit dhe praktikën e saj gjyqësore, rikujtoi se kjo dispozitë nënkupton që Ligji i kontestuar, nuk mund të dekretohet, të hyjë në fuqi, ose të prodhojë efekte ligjore deri në vendimin final të Gjykatës, lidhur me çështjen e ngritur pranë saj.
11. Më 5 korrik 2022, Gjykata, njoftoi për regjistrimin e kërkesave dhe Urdhrin për bashkim të tyre: (i) parashtruesit e kërkesave; (ii) Kryeministrin e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kryeministri); (iii) Institucionin e Avokatit të Popullit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Avokati i Popullit); (iv) Ministrinë e Drejtësisë së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Ministria e Drejtësisë); dhe (v) Këshillin Prokurorial të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: KPK ose Këshilli). Po të njëjtën datë, përkitazi me vendimin për bashkim të kërkesave, Gjykata njoftoi: (i) Presidenten; (ii) Kryetarin e Kuvendit; dhe (iii) Sekretarin e Përgjithshëm të Kuvendit, të cilët ishin njoftuar paraprakisht për regjistrimin e kërkesave, përkatësisht më 4 korrik 2022.
12. Në të njëjtën datë, Gjykata, gjithashtu i njoftoi palët e interesuara rreth afateve përkatëse për dorëzimin e komenteve në lidhje me kërkesat. Më saktësisht: (i) për Presidenten dhe Kryetarin e Kuvendit, të cilët i pranuan njoftimet për regjistrimin e kërkesave më 4 korrik 2022, ky afat përfundonte më 18 korrik 2022; ndërsa (ii) për Kryeministrin, Avokatin e Popullit, Ministrinë e Drejtësisë dhe KPK-në, të cilët i pranuan njoftimet më 5 korrik 2022, afati përfundonte më 19 korrik 2022.
13. Më 13 korrik 2022, Oda e Avokatëve të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Oda e Avokatëve), iu drejtua Gjykatës me kërkesë për përfshirjen e saj si palë e interesuar në procedurë, për të dhënë komente përkitazi me Ligjin e kontestuar.
14. Më 14 korrik 2022, Kuvendi ia dorëzoi Gjykatës të gjithë dokumentacionin relevant përkitazi me Ligjin e kontestuar.
15. Më 15 korrik 2022, KPK i dorëzoi komentet e saj përkitazi me Ligjin e kontestuar.
16. Më 19 korrik 2022, Ministria e Drejtësisë gjithashtu i dorëzoi komentet e saj përkitazi me Ligjin e kontestuar.
17. Më 25 korrik 2022, Gjykata njoftoi Odën e Avokatëve për miratimin e kërkesës së saj për përfshirje në procedurë në cilësinë e palës së interesuar, të cilës iu kërkua që komentet e tyre t’i dorëzonin në Gjykatë deri më 9 gusht 2022.

18. Më 25 korrik 2022, Gjykata pranoi një kërkesë nga Avokati i Popullit, nëpërmjet së cilës ky institucion kërkoi shtyrjen e afatit për dorëzimin e komenteve në lidhje me Ligjin e kontestuar.
19. Më 29 korrik 2022, Gjykata e miratoi kërkesën e Avokatit të Popullit për shtyrjen e afatit për dorëzimin e komenteve në lidhje me Ligjin e kontestuar. Po atë ditë, Avokati i Popullit dorëzoi në Gjykatë komentet e tij në lidhje me Ligjin e kontestuar.
20. Më 9 gusht 2022, Oda e Avokatëve dorëzoi komentet në lidhje me Ligjin e kontestuar.
21. Më 15 gusht 2022, Gjykata, nga një kopje të komenteve të KPK-së, Ministrisë së Drejtësisë, Odës së Avokatëve dhe të Avokatit të Popullit, ia dërgoi parashtruesve të kërkesave, Kryetarit të Kuvendit, Sekretarit të Kuvendit, Avokatit të Popullit, Ministrisë së Drejtësisë, KPK-së dhe Odës së Avokatëve, të cilëve u përcaktoi afat për të dorëzuar përgjigje ndaj komenteve deri më 29 gusht 2022. Po të njëjtën datë, Gjykata nga një kopje të komenteve të lartcekura ia dërgoi edhe Presidentes dhe Kryeministrit.
22. Më 29 gusht 2022, Avokati i Popullit dorëzoi përgjigje ndaj komenteve të dorëzuara nga KPK, Ministria e Drejtësisë dhe Oda e Avokatëve.
23. Po të njëjtën datë, Ministria e Drejtësisë dorëzoi përgjigje ndaj komenteve të KPK-së, Avokatit të Popullit dhe Odës së Avokatëve.
24. Më 5 shtator 2022, Gjykata i njoftoi parashtruesit e kërkesave lidhur me komentet e pranuar nga Avokati i Popullit, KPK dhe Ministria e Drejtësisë.
25. Më 28 shtator 2022, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues lidhur me pranueshmërinë e kërkesave dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës pranueshmërinë e kërkesave dhe shqyrtimin e tyre në merita.
26. Më 16 dhjetor 2022, gjyqtari Enver Peci dha betimin para Presidentes, me ç'rast filloi mandati i tij në Gjykatë.
27. Më 24 mars 2023, Gjykata njëzëri konstatoi që (i) kërkesa është e pranueshme; dhe (ii) pika 1.3.2 e paragrafit 1 të nenit 6 dhe neni 8, përkatësisht neni 10/A të Ligjit të kontestuar nuk janë në përputhshmëri me paragrafin 1 të nenit 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit], paragrafin 10 të nenit 65 [Kompetencat e Kuvendit] dhe nenin 132 [Roli dhe Kompetencat e Avokatit të Popullit] të Kushtetutës; (iii) paragrafi 2/a i nenit 13 të Ligjit të kontestuar nuk është në përputhshmëri me paragrafin 1 të nenit 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit] dhe paragrafin 1 të nenit 110 [Këshilli Prokurorial i Kosovës] të Kushtetutës; (iv) paragrafi 5 i nenit 16 të Ligjit të kontestuar nuk është në përputhshmëri me paragrafin 1 të nenit 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës; (v) neni 18, përkatësisht 23/A i Ligjit të kontestuar nuk është në përputhshmëri me nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike] dhe nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës; dhe (vi) paragrafi 3 i nenit 11 dhe neni 20 i Ligjit të kontestuar nuk janë në përputhshmëri me paragrafin 1 të nenit 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit], nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike], nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] dhe paragrafin 1 të nenit 110 [Këshilli Prokurorial i Kosovës] të Kushtetutës.

Përmbledhja e fakteve

28. Bazuar në shkresat e lëndës, iniciativës për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.08/L-156 për KPK-në (në tekstin e mëtejme: Ligji bazik), i kishte paraprirë procesi i Rishikimit Funkcional të Sektorit të Sundimit të Ligjit, që ka rezultuar në Strategjinë

për Sundimin e Ligjit 2021-2026, ku synohej “ngritja e llogaridhënies së sistemit gjyqësor dhe prokurorial”, ndër të tjera, përmes “zbatimit të masave të parapara, duke filluar me ndryshime ligjore në përbërjen e KGJK-së dhe KPK-së”.

29. Më 26 tetor 2021, Ministria e Drejtësisë, pasi kishte hartuar projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit bazik, iu drejtua Komisionit të Venecias, për të marrë opinion përkatës, nëse projektligji në fjalë ishte hartuar konform standardeve evropiane dhe ndërkombëtare.
30. Më 18 dhe 19 nëntor 2021, përfaqësuesit e Komisionit të Venecias vizituan Republikën e Kosovës dhe takuan autoritetet relevante për të marrë informacionet e duhura përkitazi me projektligjin e hartuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Qeveria).
31. Më 13 dhjetor 2021, Komisioni i Venecias, publikoi [Opinionin nr. 1063/2021, CDL-AD\(2021\)051](#) të miratuar në seancën plenare të 129-të (në tekstin e mëtejme: Opinioni i parë), mbi draft amendamentet e projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit bazik.
32. Pas Opinionit të parë të Komisionit të Venecias, në shkurt 2022, Qeveria hartoi dhe miratoi draftin e dytë të projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit bazik.
33. Më 25 shkurt 2022, Qeveria kërkoi një Opinion të dytë nga Komisioni i Venecias, për tu siguruar nëse drafti final i projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit bazik, kishte adresuar vërejtjet dhe rekomandimet e Opinionit të parë.
34. Më 9 mars 2022, Qeveria, nëpërmjet Vendimit [nr.02/67], miratoi projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit bazik.
35. Më 11 mars 2022, Qeveria në pajtim me Vendimin e lartcekur të 9 marsit 2022, projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit bazik ia përcolli Kuvendit për lexim të parë dhe miratim sipas përcaktimeve të Rregullores së punës së Kuvendit.
36. Më 23 mars 2022, Komisioni i Venecias, publikoi [Opinionin nr. 1080/2022, CDL-AD\(2022\)006, të miratuar](#) në seancën plenare të 130-të (në tekstin e mëtejme: Opinioni i dytë), përkitazi me draftin final të projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit bazik.
37. Më 5 prill 2022, Komisioni FunkSIONAL për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit (në tekstin e mëtejme: Komisioni funksional), Opinioni e dytë të Komisionit të Venecias ua shpërndau të gjithë deputetëve të Kuvendit.
38. Më 14 prill 2022, Kuvendi, pas procedurës së leximit të parë, në prezencë të shtatëdhjetë e nëntë (79) deputetëve, me gjashtëdhjetë e tre (63) vota për dhe gjashtëmbëdhjetë (16) kundër, e miratoi në parim, projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit bazik, përkatësisht Ligjin e kontestuar.
39. Në të njëjtën datë, Kuvendi e ngarkoi Komisionin funksional, Komisionin për Buxhet dhe Financa, Komisionin për Integrim Evropian dhe Komisionin për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim (në tekstin e mëtejme: Komisionet e përhershme), që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit, të shqyrtojnë projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit bazik dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportin me rekomandime.

40. Në po të njëjtën datë, Komisioni funksional, miratoi raportin e tij përkitazi me projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit bazik, duke i propozuar trembëdhjetë (13) amendamente në projektligjin në fjalë.
41. Më 17 maj 2022, Komisioni funksional, shqyrtoi projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit bazik dhe po të njëjtën datë raportin me amendamente ia procedoi komisioneve të përhershme për shqyrtim të mëtejme.
42. Më 25 dhe 26 maj 2022, Komisionet e përhershme, shqyrtuan raportin e Komisionit funksional, përkitazi me amendamentet e propozuara. Megjithatë, sipas shkresave të lëndës, Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim nuk e kishte shqyrtuar projektligjin me amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional, brenda afatit të përcaktuar me paragrafin 8 të nenit 57 (Shqyrtimi i projektligjit në komisione) të Rregullores së Kuvendit.
43. Më 31 maj 2022, raporti përfundimtar i Komisionit funksional, së bashku me amendamentet e propozuara iu shpërnda të gjithë deputetëve të Kuvendit, me rekomandimin që ky projektligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit bazik, bashkë me amendamentet e propozuara të miratohet, pasi zbatimi i tij nuk kërkon kosto shtesë buxhetore.
44. Kuvendi, pasi pranoi raportin final nga Komisioni funksional, njoftoi dhe ftoi deputetët për seancën plenare të radhës, ku ndër të tjera, si pikë e rendit të ditës ishte edhe shqyrtimi i dytë i projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit bazik.
45. Më 23 qershor 2022, Kuvendi, pas leximit të dytë, me gjashtëdhjetë (60) vota për, asnjë kundër dhe një (1) abstenim, e miratoi Ligjin e kontestuar.

Pretendimet e parashtruesve të kërkesës KO100/22

46. Parashtruesit e kësaj kërkesë pretendojnë se nenet 13, 16, 18 dhe 20 të Ligjit të kontestuar nuk janë në përputhshmëri me nenet: 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit], 24 [Barazia para Ligjit], 32 [E Drejta për Mjete Efektive], 45 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes], 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave], 109 [Prokurori i Shtetit] dhe 110 [Këshilli Prokurorial i Kosovës] të Kushtetutës.
47. Në vijim, Gjykata do të përmbledhë pretendimet e parashtruesve të kërkesës KO100/22 lidhur me mospërputhshmërinë e neneve të lartcekura të Ligjit të kontestuar me nenet e lartcekura të Kushtetutës, përkatësisht pretendimet për mospërputhshmërinë e: (I) nenit 13 të Ligjit të kontestuar me nenet 4, 54 109 dhe 110 të Kushtetutës; (II) nenit 16 të Ligjit të kontestuar me nenet 24 dhe 54 të Kushtetutës; (III) nenit 18 të Ligjit të kontestuar me nenin 31, 32 dhe 54 të Kushtetutës; dhe (IV) nenit 20 të Ligjit të kontestuar me nenet 32, 45 dhe 54 të Kushtetutës.

(I) Pretendimet për mospërputhshmërinë e nenit 13 të Ligjit të kontestuar me nenet 4, 54, 109 dhe 110 të Kushtetutës

48. Në vijim, Gjykata do të përmbledhë pretendimet e parashtruesve të kërkesës KO100/22 lidhur me mospërputhshmërinë e nenit 13 të Ligjit të kontestuar me: (i) nenin 110 të Kushtetutës; dhe (iii) nenet 109 dhe 4 të Kushtetutës; dhe (iii) nenin 54 të Kushtetutës.

(i) *pretendimet për mospërputhshmërinë e nenit 13 të Ligjit të kontestuar me nenin 110 të Kushtetutës*

49. Parashtruesit e kësaj kërkesë, ndër të tjera, theksojnë se paragrafi 4 i nenit 110 të Kushtetutës, përcakton që *“Përbërja e Këshillit Prokurorial të Kosovës, si dhe dispozitat për emërimin, shkarkimin, mandatin, strukturën organizative dhe rregullat e procedurës, rregullohen me ligj”*. Sipas tyre, ky fakt ka mjaftuar që Qeveria të propozojë dhe Kuvendi të miratojë Ligjin e kontestuar, i cili përveç tjerash, ndryshon përbërjen e KPK-së dhe numrin e anëtarëve të tij, nga trembëdhjetë (13), sa ishte deri më tani në shtatë (7) sosh. Ndërkaq, sipas parashtruesit të kërkesës, arsytimi i vetëm i këtij ndryshimi substancial të numrit të anëtarëve të KPK-së, në koncept-dokumentin që i ka paraprirë atij ndryshimi, është përmbledhur në një fjali të vetme dhe të shkurtër, përkatësisht *“për qëllime të efikasitetit të punës së KPK-së”*.
50. Parashtruesit e kësaj kërkesë, tutje pretendojnë se neni 13 i Ligjit të kontestuar, në mënyrë tërësisht të pabazuar prekë dy segmente kyçe të organizimit dhe pavarësisë së punës dhe vendimmarrjes së KPK-së, duke theksuar se në njërën anë, kuorumi i vendosur prej pesë (5) anëtarësh nga shtatë (7) sosh, paraqet një *“kusht shumë të lartë ligjor”*, në bazë të të cilit, roli i anëtarëve jo-prokurorë, *“jo vetëm që është i rëndësishëm, por paraqet në mënyrë të drejtpërdrejtë përgjegjësi vendimtare për vendimmarrje, e cila për pasojë e bën të pakalueshëm çfarëdo vendimi të rëndësishëm në KPK, pa të paktën një votë të anëtarit jo-prokurorë, gjë e cila, në thelb, paraqet goditje të drejtpërdrejtë të garancioneve kushtetuese të mishëruara në parimet kushtetuese të KPK-së, siç janë pavarësia dhe paanshmëria”*. Nga ana tjetër, parashtruesit e kërkesës theksojnë se përveç kushtit të domosdoshëm të kuorumit prej pesë (5) anëtarësh, Ligji i kontestuar përcakton shumicën e kualifikuar të vendimmarrjes, sipas të cilës, kërkohen jo më pak se pesë (5) vota nga përbërja e plotë e KPK-së, dy (2) prej të cilave, duhet të jenë nga radhët e anëtarëve jo-prokurorë për votimet e rëndësishme, siç është: (i) pozita e Kryeprokurorit të Shtetit dhe Kryeprokurorëve të Prokurorive përkatëse; (ii) miratimi i akteve nënligjore që rregullojnë emërimin e kryeprokurorëve; si dhe (iii) emërimi, transferimi, disiplinimi dhe ngritja në detyrë e prokurorëve, *“përbën ndërhyrje të drejtpërdrejtë dhe cenim të pavarësisë së punës së KPK-së nga ana e anëtarëve jo-prokurorë, dy (2) prej të cilëve zgjedhën me shumicë të thjeshtë nga Kuvendi, ndërsa anëtari i tretë caktohet(delegohet) mbi bazën e emërimit dhe jo të zgjedhjes nga ana e Avokatit të popullit”*.
51. Për rrjedhojë, parashtruesit e kësaj kërkesë theksojnë se amendamenti i nëntë (9), i cili kishte për qëllim zbatimin e njëres prej vërejtjeve dhe rekomandimeve kryesore të Opinionit të parë dhe të Opinionit të dytë të Komisionit të Venecias, nuk ka adresuar çështjen e shkeljes së standardit ndërkombëtar të moscenimit të pavarësisë së KPK-së nga ndikimi politik dhe i jashtëm. Në këtë kontest, parashtruesit e kërkesës pretendojnë se mënyra e përcaktimit të vendimmarrjes së kualifikuar dhe e *“votimit të dyfishtë”* nga njëra anë, dhe përcaktimit se në rast të dështimit të kësaj mënyre të votimit, të zbatohet procedura që kërkon votimin me shumicën prej 2/3-ve të të gjithë anëtarëve të KPK-së, në mbledhjen vijuese, pas dështimit të përmbushjes së kriterit të parë *“...në thelb, paraqet minim të punës dhe vendimmarrjes së KPK-së, duke bërë që si në rastin e parë, ashtu edhe në rastin e dytë, vota e anëtarit të jashtëm jo-prokurorë, të jetë shumëfish më e fuqishme, se sa e anëtarit prokurorë dhe për rrjedhojë, jo e barabartë me të”*. Si rezultat i kësaj, parashtruesit e kësaj kërkesë, pretendojnë se një strukturë e tillë e KPK-së, me këtë mënyrë të kuorumit të pjesëmarrjes, të kuorumit të vendimmarrjes, të votimit me shumicë të kualifikuar dhe votimit me shumicë të dyfishtë, përbën shkelje të drejtpërdrejtë të garancioneve kushtetuese të mishëruara në nenin 110 të Kushtetutës.

52. Parashtruesit e kësaj kërkesë, tutje pohojnë se, Ligji i kontestuar e ka zbritur numrin e anëtarëve prokurorë dhe nuk e ka zbritur numrin e anëtarëve jo-prokurorë, që ishte tre (3) anëtarë me Ligjin bazik dhe po ashtu tre (3) anëtarë jo-prokurorë me Ligjin e kontestuar. Për më tepër, parashtruesit e kërkesës, theksojnë që çështja e kuorumit dhe e vendimmarrjes: “...*asnjëherë nuk janë bllokuar më parë për shkak të vonesave të zgjedhjes së anëtarëve jo-prokurorë, ndërsa me Ligjin e kontestuar, politika merr rol vendimtar në KPK, sepse sipas përbërjes aktuale, kuorumi për vendimmarrje është propozuar të jetë 5 (pesë) vota, të cilat vota do t’i kenë ndikimet si në vijim: e para, ka të bëjë me faktin se nëse anëtarët jo-prokurorë nuk propozohen dhe zgjedhën me kohë do të bllokohej plotësisht puna dhe funksioni i KPK-së; dhe e dyta, që anëtarët jo-prokurorë të marrin rol vendimtar në çdo vendim të KPK-së, gjë e cila, sipas tyre do t’a politizonte skajshmërisht jo vetëm punën e KPK-së, por edhe propozimin e kandidatëve të ardhshëm për prokurorë ose udhëheqës të prokurorive. Praktikisht, sipas parashtruesve të kësaj kërkesë, KPK-ja, shndërrohet në instrument të politikës, i varur e i anshëm*”. Për pasojë, sipas parashtruesve të kërkesës, fuqizimi i anëtarëve jo-prokurorë deri në nivel të votës së kualifikuar dhe të shumicës së dyfishtë, bën që KPK të nënshtrohet dhe t’i cenohet pavarësia kushtetuese dhe institucionale, sepse, kërkesa për shumicë të kualifikuar, efektivisht, i siguron “*të drejtë vetoje*” anëtarëve jo-prokurorë. Kjo, sipas parashtruesve të kërkesës, vërteton edhe më shumë faktin se qëllimi i Ligjit të kontestuar, është që të shkarkohen disa anëtarë të caktuar të KPK-së me qëllim që të krijohet mundësia që pushteti të ndikojë në zgjedhjen e Kryeprokurorit të ri të Shtetit.
53. Parashtruesit e kësaj kërkesë, tutje theksojnë se, edhe pushtetet e pavarura mund t’i nënshtrohen kontrollit reciprok, që në këtë rast sigurohet me prezencën e anëtarëve jo-prokurorë në KPK. Megjithatë, sipas tyre, ky kontroll asnjëherë nuk mund të rezultojë me mbivendosje të pushtetit kontrollues ndaj pushtetit të pavarur. Sipas tyre: “*Kërkesa për shumicë të kualifikuar e ka këtë rezultat. Anëtarët jo-prokurorë, me të drejtën efektive të vetos, mbivendosin anëtarët prokurorë të KPK-së, dhe atë me bllokim të vendimmarrjes*”.
- (ii) *pretendimet për mospërputhshmërinë e nenit 13 të Ligjit të kontestuar me nenet 109 dhe 4 të Kushtetutës*
54. Përkitazi me pretendimet për mospërputhshmërinë e nenit 13 të Ligjit të kontestuar me nenet 109 dhe 4 të Kushtetutës, parashtruesit e kësaj kërkesë theksojnë se neni 110 i Kushtetutës, nuk mund të zbatohet dhe interpretohet i ndarë nga nenet 109 dhe 4 të Kushtetutës, e madje as nga neni 108 [Këshilli Gjyqësor i Kosovës] i Kushtetutës, kur bëhet fjalë për zbatimin e parimeve kushtetuese të pavarësisë dhe paanshmërisë, përkitazi me të cilat KPK ka përgjegjësi kushtetuese mbi bazën e parimit të ndarjes së pushteteve dhe kontrollit e balancimit në mes tyre. Parashtruesit e kërkesës theksojnë se “*pushteti gjyqësor është unik, i pavarur dhe ushtrohet nga gjykatat*”, dhe se ky parim është i zbatueshëm përshtatshmërisht edhe në raport me Prokurorin e Shtetit dhe KPK-në, për aq sa funksionet dhe përgjegjësitë prokuroriale janë të pavarura dhe të paanshme dhe hyjnë në kuadër të kapitullit VII, përkatësisht “Sistemi i Drejtësisë” të Kushtetutës, dhe si të tilla, janë të ndara dhe të pavarura nga pushteti ekzekutiv dhe legjislativ.
55. Një qëndrim i tillë juridik, sipas parashtruesve të kësaj kërkesë, është i bazuar dhe i mishëruar në sistemin e vlerave kushtetuese të cilat i promovon Kushtetuta, e të cilat argumentohen edhe me jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese, e cila me rastin e vlerësimit të kushtetutshmërisë së neneve të caktuara të Ligjit nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përmes Aktgjykimit në rastin KO203/19, në paragrafët 101 dhe 102, shprehimisht përcakton që Kushtetuta e Kosovës ka pasur për qëllim që sistemit prokurorial, përkatësisht KPK dhe Prokurorit të Shtetit, t’i sigurojë pavarësi të njëjtë

për të ushtruar funksionet e saj, po aq sa edhe sistemit gjyqësor. Tutje theksohet se paragrafët e këtij Aktgjykimi, në mënyrë të qartë argumentojnë faktin e trajtimit të barabartë që Kushtetuta i ka garantuar sistemit gjyqësor dhe prokurorial, të cilat së bashku ndërtojnë sistemin e drejtësisë si një pushtet i ndarë nga pushteti ekzekutiv dhe legjislativ, e mbi të gjitha, i pavarur, i paanshëm, unik dhe apolitik.

(iii) pretendimet për mospërputhshmërinë e nenit 13 të Ligjit të kontestuar me nenin 54 të Kushtetutës

56. Në lidhje me këtë pretendim, parashtruesit e kësaj kërkesë argumentojnë se Ligji i kontestuar në mënyrë arbitrare ndërpret mandatin e anëtarëve aktual të KPK-së, dhe krijon mekanizëm bllokues të vendimmarrjes institucionale për çështjet e rëndësishme të KPK-së, si dhe duke zbatuar shumicën e kualifikuar, cenon garancionet kushtetuese të së drejtës në *“mbrojtje gjyqësore të prokurorëve”*, si dhe legjitimon standardin e dyfishtë të shkarkimit të anëtarëve të KPK-së, pa iu siguruar të njëjtëve mbrojtje të barabartë gjyqësore.

(II) Pretendimet për mospërputhshmërinë e nenit 16 të Ligjit të kontestuar me nenet 24, 32 dhe 54 të Kushtetutës

57. Parashtruesit e kësaj kërkesë, në lidhje me këtë pretendim, ndër të tjera, theksojnë, se *“përmes nenit 16 të Ligjit të kontestuar, është riformuluar në tërësi neni 19 i Ligjit bazik”*, duke mos u njohur të drejtën e ankesës kundër shkarkimit anëtarëve jo-prokurorë, ashtu siç e njëjta dispozitë ua njeh këtë të drejtë anëtarëve prokurorë.
58. Në këtë kontekst, sipas parashtruesve të kësaj kërkesë: *“...duke përligjur privimin e anëtarëve jo prokurorë nga e drejta për mjete juridike nga neni 32 i Kushtetutës, sipas të cilit, “secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij në mënyrën e përcaktuar me ligj”*, në mënyrë të pakontestueshme cenohet edhe pavarësia e punës së tyre, sepse një përcaktim i tillë përmes Ligjit të kontestuar: *“...do të mundësojë nënshtrimin e të njëjtëve (jo-prokurorëve), ndaj presioneve të jashtme (politike apo konkretisht nga mazhoranca parlamentare) që i zgjedh ata, por edhe ndaj anëtarëve prokurorë të KPK-së”*.
59. Sa më sipër, parashtruesit e kësaj kërkesë theksojnë, se fakti i mosnjohjes nga Ligji i kontestuar i të drejtës së ankesës ndaj vendimit për shkarkim nga ana e Kuvendit, për dy anëtarët jo-prokurorë dhe të një anëtari jo-prokuror të shkarkuar me vendim nga Avokati i Popullit, konfirmon pretendimet e kësaj kërkesë, se nëpërmjet paragrafit 5 të nenit 19 të Ligjit bazik siç është ndryshuar me nenin 16 të Ligjit të kontestuar: *“...përligjet trajtimi i pabarabartë mes anëtarëve të këshillit, detyrat, përgjegjësitë dhe funksionet e të cilëve janë të njëjta (në kuadrin e fushëveprimit të KPK-së), andaj në këtë mënyrë, cenohen edhe garancionet kushtetuese të përcaktuara në nenin 24 (Barazia para ligjit) dhe neni 54 (Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave), të Kushtetutës (...)*”.

(III) Pretendimet për mospërputhshmërinë e nenit 18 të Ligjit të kontestuar me nenet 31, 32 dhe 54 të Kushtetutës

60. Në lidhje me pretendimet për mospërputhshmërinë e nenit 18 të Ligjit të kontestuar me nenet 31, 32 dhe 54 të Kushtetutës respektivisht, parashtruesit e kësaj kërkesë, ndër të tjera, theksojnë se nëpërmjet nenit të ri 23A, cenohet parimi i sigurisë juridike në ndërlidhje me nenet 32 dhe 54 të Kushtetutës, pasi që, nga njëra anë prokurorëve u njihet e drejta për të paraqitur ankesë drejtpërdrejtë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme) kundër vendimeve të

KPK-së, në lidhje me shkarkimin, vlerësimin e performancës së prokurorëve dhe disiplinën e prokurorëve, që për pasojë kanë uljen në detyrë të prokurorëve, edhe pse procedura ndaj vendimeve disiplinore, në mënyrë të plotë dhe të qartë është e trajtuar dhe e rregulluar në Ligjin në fuqi nr. 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve (në tekstin e mëtejme: Ligji për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve), ku sipas nenit 15 (Ankesa ndaj vendimeve disiplinore) të tij, shprehimisht përcaktohet si në vijim: *“1. Palët kanë të drejtë të ankohen ndaj vendimeve disiplinore të Këshillit, drejtpërdrejt në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimit të vendimit. Gjykatat tjera në Kosovë, nuk kanë kompetencë të shqyrtojnë dhe të vendosin lidhur me procedurën disiplinore ndaj gjyqtareve dhe prokurorëve. 2. Ankesa ndaj vendimit të Këshillit ka efekt suspensiv dhe ndalon implementimin e atij vendimi, derisa të shqyrtohet ankesa. [...], 5. Gjykata Supreme, në një trup gjykues të përberë nga tre anëtarë, të zgjedhur nga Kryetari i Gjykatës Supreme, brenda tridhjetë (30) ditëve, shqyrton dhe vendos lidhur me ankesën. Në rast se Kryetari i Gjykatës Supreme është subjekt i vendimit të Këshillit, atëherë zgjedhjen e anëtareve e bën gjyqtari me i moshuar i Gjykatës Supreme”.*

61. Në këtë kontekst, parashtruesit e kësaj kërkesë pretendojnë se neni 18 i Ligjit të kontestuar vendosë procedurë paralele të ankimimit për prokurorë, që të njëjtit të mund të kundërshtojnë vendimet e KPK-së në Gjykatën Supreme, pos tjerash edhe ndaj vendimeve disiplinore të KPK-së. Një zgjidhje e tillë ligjore, sipas tyre, jo vetëm që krijon pasiguri juridike për prokurorët në pikëpamje të procedurës paralele, që mund ta ndjekin në rastet e kundërshtimeve të vendimeve disiplinore të KPK-së, por edhe në pikëpamje të afatit nëntëdhjetë (90) ditor brenda të cilit duhet të vendosë Gjykata Supreme, krahas afatit paralel të përcaktuar në paragrafin 5 të nenit 15 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.
62. Nga ana tjetër, parashtruesit e kësaj kërkesë, theksojnë se paragrafi 6 i nenit 109 të Kushtetutës, shprehimisht përcakton që: *“6. Prokuroret mund të shkarkohen nga funksioni për shkak të dënimit për një vepër të rëndë penale ose për mosrespektimin e rëndë të detyrave”.* Si rezultat, neni 18 i Ligjit të kontestuar, jo vetëm që cenon parimin e sigurisë juridike, por edhe shkel garancionet kushtetuese nga neni 31 të Kushtetutës, sepse krijon dy procedura të ndryshme/paralele dhe dy afate të ndryshme, përkritazi me vendosjen për të njëjtat çështje, përkatësisht ankesave ndaj vendimeve disiplinore dhe/ose atyre që ndërlidhen me shkarkimin.

(IV) Pretendimet për mospërputhshmërinë e nenit 20 të Ligjit të kontestuar me nenet 32, 45 dhe 54 të Kushtetutës

63. Në vijim, Gjykata do të përmbledhë pretendimet e parashtruesve të kësaj kërkesë lidhur me mospërputhshmërinë e nenit 20 të Ligjit të kontestuar me nenet 32, 45, dhe 54 të Kushtetutës, përkatësisht pretendimet për mospërputhshmërinë e nenit 20 të Ligjit të kontestuar me: (i) nenin 32 dhe 54 të Kushtetutës; dhe (ii) nenin 45 të Kushtetutës.
(i) pretendimet për mospërputhshmërinë e nenit 20 të Ligjit të kontestuar me nenet 32 dhe 54 të Kushtetutës
64. Parashtruesit e kësaj kërkesë, përkritazi me këtë pretendim, ndër të tjera, theksojnë se neni 20 i Ligjit të kontestuar, e ndërpreu mandatin e anëtarëve aktualë të KPK-së, duke e ndërlidhur këtë ndërprerje me momentin e: (i) zgjedhjes së dy anëtarëve jo-prokurorë që do t'i zgjedhë Kuvendi dhe një anëtar jo-prokuror që do ta zgjedh Avokati i Popullit, si dhe (ii) hedhjes së shortit për dy (2) anëtarë nga anëtarët aktualë nga prokuroritë themelore, si dhe një (1) anëtar nga Prokuroria e Apelit ose Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës. Andaj, në këtë kontekst, parashtruesit e kërkesës argumentojnë

se: “Ndërprerja e mandatit në mënyrë arbitrare dhe të parakohshme për anëtarët e KPK-së është e pa bazë, për faktin se tejkalohen kriteret e aplikueshme ligjore nga neni 13 i Ligjit në fuqi, sipas të cilit, përfundimi i mandatit të anëtarëve aktual mund të ndodhë për këto shkaqe; vdekja; humbja e zotësisë për veprim; dështimi i vazhduar për të marrë pjesë ne veprimtaritë e KPK-së me gjatë se 3 (tre) muaj pa arsye të vërtetuar; pushimin e statusit mbi të cilin bazohet emërimi; skadimin e mandatit dhe dorëheqjen, duke e njoftuar paraprakisht KPK-në”.

65. Tutje, parashtruesit e kësaj kërkesë, theksojnë se, në rekomandimet e Opinionit të parë të Komisionit të Venecias, shprehimisht është theksuar se: “Zëvendësimi i anëtarëve aktual me anëtarë të rinj mund të justifikohet jashtëzakonisht vetëm nëse shpie në një përmirësim të madh të sistemit aktual, (në veçanti, depolitizimin e tij)”. Në këtë kontekst, parashtruesit e kërkesës, pretendojnë se: “Përfundimi i mandatit të anëtarëve të KPK-së, mund të bëhet në mënyrë të natyrshme apo nëse plotësohet ndonjëri nga kriteret e lartcekura dhe kjo ndërprerje arbitrare e mandatit është në kundërshtim edhe me jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese, e cila, ne rastet KO29/12 dhe KO48/12 për çështjen e mandatit të mbajtësve të pozitive kushtetuese, përkatësisht sipas paragrafit 268 theksohet se “mandati është i pacenueshëm për të siguruar respektim të parimit të ndarjes së pushteteve dhe për ta ruajtur sigurinë në rendin juridik dhe kushtetues”. Në bazë të këtij Aktgjykimi, shkurtimi i mandatit pakëson të drejtat dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës”. Sipas parashtruesve të kërkesës, kjo mënyrë e ndërprerjes së mandatit është edhe në kundërshtim edhe me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: KEDNJ) dhe praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: GJEDNJ), por edhe me nenin 25 të Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike.
66. Parashtruesit e kësaj kërkesë, tutje argumentojnë se, me nenin 20 të Ligjit të kontestuar: “...paracaktohet qëllimi që, përmes një ligji special të ndryshohet një përbërje e caktuar e KPK-së, dhe atë para një vendimi madhor - zgjedhjes së Kryeprokurorit të ri të Shtetit”. Sipas tyre, kjo është arsyeja se përse, në mënyrë jo-kushtetuese, po u ndërpritet mandati para kohe anëtarëve aktualë. Ky ligj, sipas tyre, ka si qëllim një rezultat të caktuar, përkatësisht ndikimin në zgjedhjen e Kryeprokurorit të Shtetit. Në këtë kontest, parashtruesit e kërkesës, i referohen nenit 1.9 të Kushtetutës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, i cili ndalon ligje të tilla, të cilat quhen *Bill of Attainder*, përkatësisht ligje që synojnë rezultate të paragjykuara, duke përjashtuar edhe kontrollin gjyqësor. Për këtë çështje, parashtruesit e kërkesës i referohen vendimit të Gjykatës Supreme Amerikane, përkatësisht *Chevron Oil v. Huson, 404 U.S. 97* dhe një vendimi të Gjykatës Kushtetuese të Çekisë, për mos-zbatim retroaktiv të ligjeve të reja jashtë fushës penale.
67. Për më tepër, parashtruesit e kësaj kërkesë pretendojnë se, përfundimi i mandatit me pamundësi për ushtrimin e mjeteve juridike është në kundërshtim me nenin 32 të Kushtetutës. Nga ana tjetër, sipas tyre Parimet Themelore të Kombeve të Bashkuara për Pavarësinë e Gjyqësorit, sa i përket çështjes së mandatit, shprehimisht përcaktojnë: “Sa i përket çështjes së mandatit, sipas Parimeve Themelore të OKB-së për Pavarësinë e Gjyqësorit, gjyqtarëve duhet t’u garantohen kohëzgjatja e mandatit deri në arritjen e moshës së pensionimit, ose deri në skadimin e kohëzgjatjes së paracaktuar të mandatit”. Ky parim ndërkombëtar do të duhej të vlejë për të gjithë anëtarët prokurorë dhe jo-prokurorë që e kanë fituar këtë mandat. Përveç kësaj, “Parimet Bangalore” dhe masat për zbatimin e tyre, shprehimisht përcaktojnë, ndër të tjera, se: “...tutje, pika 49 përcakton se siguria e kohëzgjatjes së mandatit dhe pamundësia e largimit nga detyra janë elemente kyçe të pavarësisë së gjyqtarëve. Sipas pikës 50, rekomandohet që mandati i përhershëm mund të shkëputet vetëm për shkak të shkeljeve serioze të natyrës disiplinore apo penale, të qartësuara me ligj, apo kur gjyqtari nuk mund të

kryej funksionet gjyqësore". Po ashtu edhe Rekomandimi i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës CM/Rec (2010) 12, ndër të tjera, në pikën 49, përcakton që: *"Siguria e kohëzgjatjes së mandatit dhe pamundësia e largimit nga detyra janë elemente kyçe të pavarësisë së gjyqtarëve"*. Parashtruesit e kërkesës gjithashtu u referohen parimeve themelore për pavarësinë e gjyqësorit të miratuara nga Kongresi Shtatë i Kombeve të Bashkuara për Parandalimin e Krimit dhe Trajtimin e Shkelësve, mbajtur në Milano, nga 26 gushti deri në 6 shtator 1985 dhe miratuar me rezolutat 40/32 të Asamblesë së Përgjithshme të 29 nëntorit 1985 dhe 40/146, të 13 dhjetorit 1985, të cilat, ndër të tjera, theksojnë se: *"Pavarësia e gjyqësorit garantohej nga shteti dhe sanksionohet në Kushtetutën ose ligjin e vendit. Është detyrë e të gjitha institucioneve qeveritare dhe të tjera të respektojnë pavarësinë e gjyqësorit"*.

68. Tutje, parashtruesit e kësaj kërkesë, në mbështetje të pretendimeve lidhur me ndërprerjen e mandatit të anëtarëve aktualë të KPK-së, i referohen rasteve të GJEDNJ-së, *Baka kundër Hungarisë*, nr. 20261/12, ku Gjykata Evropiane, kishte konstatuar shkelje të nenit 6.1 (E drejta e qasjes në gjykatë) të KEDNJ-së dhe *Grzeda kundër Polonisë*, nr. 43572/18, ku Gjykata Evropiane gjithashtu konstatoi shkelje të nenit 6 dhe nenit 13 (E drejta për zgjidhje efektive) të KEDNJ-së, për shkak të përfundimit të parakohshëm të mandatit të gjyqtarit. Parashtruesit e kërkesës, po ashtu i referohen Opinioni nr. 81 1/2015 të Komisionit të Venecias për projekt ndryshimet e Ligjit për prokurorë të Gjeorgjisë, për pjesën e statusit të anëtarëve të Këshillit Prokurorial, ku Opinioni, ndër të tjera, kishte potencuar: *"...se nuk duhet të jetë lehtë largimi i një anëtari të Këshillit nga pozita e tij/saj. Ndërsa heqja e hershme duhet të jetë gjithmonë e mundur në rastet e sjelljes së keqe, të rëndë ose papajtueshmërisë, vendime të tilla duhet gjithmonë të bazohen në baza specifike të renditura në projektligj, dhe duhet të konfirmohet nga vetë shumica e anëtarëve të Këshillit"*. Në fund, parashtruesit e kërkesës theksojnë se ndërprerja e mandatit me short, nuk e siguron barazinë gjinore dhe përfshirjen etnike edhe të komuniteteve të nën përfaqësuar, aq më pak pasi ligji parasheh votimin e fshehtë.

(ii) pretendimet për mospërputhshmërinë e nenit 20 të Ligjit të kontestuar me nenin 45 të Kushtetutës

69. Parashtruesit e kësaj kërkesë, për më tepër konsiderojnë, se ndërprerja e mandatit nëpërmjet nenit 20 të Ligjit të kontestuar, ka për pasojë edhe shkeljen e të drejtës për të zgjedhur edhe për t'u zgjedhur, siç është e garantuar me nenin 45 të Kushtetutës, sepse anëtarët e KPK-së janë zgjedhur në pozitën nga të cilat do të shkarkohen sipas këtij ligji. Kjo e drejtë shkelet kur ndryshohen kushtet sipas të cilave anëtarët kanë zgjedhur dhe janë zgjedhur para përfundimit të mandatit për të cilin është ushtruar kjo e drejtë. Parashtruesit e kërkesës gjithashtu theksojnë se: *"Vlerësimet politike apo perceptimet e Qeverisë për punën dhe imazhin e KPK-së, nuk mund të shndërrohen në norma ligjore dhe tju ndërpritet, pa bazë mandati shumicës së anëtarëve prokurorë aktual të KPK-së (përfshirë edhe anëtarit jo-prokurorë aktual), sepse kjo do të përbënte një praktikë tepër të rrezikshme për pavarësinë kushtetuese, institucionale dhe funksionale të KPK-së, pasi do të shërbente çdo qeverie dhe shumicë të re parlamentare, ndërhyrjen në strukturën, përbërjen dhe vendimmarrjen e këtij institucioni, sipas vlerësimit dhe perceptimit të saj për KPK-në"*.

Pretendimet e parashtruesve të kërkesës KO101/22

70. Parashtruesit e kërkesës në rastin KO101/22, pretendojnë se Ligji i kontestuar, në tërësinë e tij, nuk është në përputhshmëri me nenet: 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit], 16 [Epërsia e Kushtetues], 24 [Barazia para Ligjit], 109 [Prokurori i Shtetit] dhe 110 [Këshilli Prokurorial i Kosovës] të Kushtetutës.

71. Në këtë kontekst, parashtruesit e kësaj kërkesë, paraqesin pretendime specifike lidhur me nenet 6, 13 dhe 20 të Ligjit të kontestuar, ndër të tjera, duke theksuar se: (i) përbërja e re e anëtarëve të KPK-së, nuk garanton përfaqësim të mjaftueshëm të prokuroreve brenda sistemit në KPK; (ii) zgjedhja e një (1) anëtari të KPK-së nga Avokati i Popullit është në kundërshtim me autorizimet kushtetuese që i ka Avokati i Popullit; (iii) zgjedhja e dy (2) anëtareve jo-prokurorë me shumicë të thjeshtë të votave në Kuvend, rrit rrezikun që anëtarët e KPK-së të emëruar nga Kuvendi, të jenë persona, që potencialisht përfaqësojnë politikatat e shumicës në Kuvend dhe jo persona me autoritet dhe integritet që marrin besimin gjithëpërfshirës të përfaqësuesve të popullit për të ushtruar i pavarur detyrat e tij kushtetuese dhe ligjore; (iv) e drejta e "*shumicës speciale apo e drejta e vetos*" së anëtareve jo-prokurorë në procese të rëndësishme në KPK, e cenon pavarësinë, profesionalitetin dhe paanshmërinë e këtij institucioni plotësisht të pavarur në kryerjen e funksioneve të tij kushtetuese dhe ligjore; dhe (v) shorti për ndërprerjen e mandatit të anëtarëve aktualë është kundërkushtetues.
72. Në përgjithësi, parashtruesit e kësaj kërkesë pretendojnë se, Qeveria dhe shumica parlamentare, e proceduan projektligjin përkatës në mënyrë arbitrare në Kuvend, "*pa e përfunduar punën e vet Komisioni i Venecias*", sepse më 15 mars 2022, projektligji është shqyrtuar dhe miratuar në parim nga Komisioni funksional, gjersa Komisioni i Venecias, po organizonte dëgjim publik më 18 mars 2022 për këtë temë. Sipas parashtruesve të kësaj kërkesë, komentet finale, përkatësisht Opinioni i dytë i Komisionit të Venecias, i është dorëzuar Qeverisë më 23 mars 2022, kurse deputetëve të Kuvendit më 5 prill 2022, ndërsa projektligji përkatës është miratuar në lexim të parë më 14 prill. Parashtruesit e kësaj kërkesë, tutje theksojnë se lidhur me projektligjin, në cilësinë e grupit parlamentar kanë paraqitur shqetësimet e tyre edhe në Komisionin funksional, pastaj edhe në seancë plenare, duke tërhequr vëmendjen se dispozitat e projektligjit, mund të jenë kundërkushtetuese, por që shumica parlamentare nuk i ka marrë fare parasysh vërejtjet e tyre.
73. Në vijim, Gjykata do të përmbledhë pretendimet e parashtruesve të kërkesës në rastin KO101/22 lidhur me mospërputhshmërinë e neneve të lartcekura të Ligjit të kontestuar me nenet e lartcekura të Kushtetutës, përkatësisht pretendimet për mospërputhshmërinë e: (I) nenit 6 të Ligjit të kontestuar me nenet 4, 16 dhe 110 të Kushtetutës; (II) nenit 13 të Ligjit të kontestuar me nenet 4 dhe 110 të Kushtetutës; dhe (III) nenit 20 të Ligjit të kontestuar me nenet 4 dhe 110 të Kushtetutës.

(I) Pretendimet për mospërputhshmërinë e nenit 6 të Ligjit të kontestuar me nenet 4, 16 dhe 110 të Kushtetutës

74. Parashtruesit e kësaj kërkesë pretendojnë se neni 6 i Ligjit të kontestuar nuk është në përputhshmëri me nenin 4 të Kushtetutës, si dhe nenin 110 të Kushtetutës, pasi që përbërja aktuale e KPK-së, institucion që administron gjithë sistemin prokurorial të Kosovës, ka numër minimalisht më të madh sesa anëtarët jo-prokurorë, pra katër (4) me tre (3).
75. Tutje, parashtruesit e kësaj kërkesë theksojnë se me Ligjin bazik, përbërja e KPK-së, kishte trembëdhjetë (13) anëtarë, prej të cilëve dhjetë (10) ishin anëtarë prokurorë, që i përfaqësonin të gjitha nivelet e prokurorisë së shtetit dhe asnjëherë më parë nuk ishte konsideruar si problem përfaqësimi në numër të madh i KPK-së, nga anëtarët prokurorë, andaj sipas vlerësimit të tyre: "*Problemet në sistemin prokurorial të Kosovës, nuk e kanë gjenezën tek mënyra e përfaqësimit të deritanishme të këtij institucioni, por tek ndërhyrjet, përfshirë edhe atë politike në punën e këtij institucioni.*" Prandaj, të njëjtit pretendojnë se: "*Përbërja e re, i hapë rrugë, që çdo herë mazhoranca parlamentare, përmes, anëtarëve jo-prokurorë, të ndërhyjë në procese të rëndësishme në administrimin e prokurorisë së shtetit*". Tutje, parashtruesit e

kërkesës vërejnë se me dispozitat e Ligjit të kontestuar, përbërja e KPK-së, në raport me anëtarët jo-prokurorë është vetëm me një (1) anëtar më tepër. Pra, tre (3) anëtarë prokurorë që përzgjedhen nga kolegët e tyre brenda sistemit prokurorial dhe tre (3) anëtarë që zgjedhen jashtë sistemit prokurorial. Sipas tyre: *“Pjesëmarrja e Kryeprokurorit të Shtetit në mënyrë ex-officio nuk paraqet apo nuk konsiderohet ndonjë shumicë dhe i njëjti nuk zgjedhet nga koleget e tyre në mënyrë të drejtpërdrejtë, por e merr këtë detyrë sipas detyrës zyrtare”*.

76. Prandaj, në këtë kontekst, parashtruesit e kësaj kërkesë pretendojnë se kjo përbërje e re e KPK-së, e përcaktuar me Ligjin e kontestuar: *“...jo që nuk e garanton pavarësinë institucionale të KPK-së, përkundrazi e minon këtë pavarësi, duke e rrezikuar kështu proceset e administrimit dhe të avancimit në sistemin prokurorial të Kosovës, sepse procesi i kontrollit të integritetit, i performancës, i disiplinimit të prokurorëve, do të kryhet nga një trup, që në gjysmën e përbërjes së saj do të përbehet nga anëtarët jo-prokurorë”*.

77. Në vijim, Gjykata do të përmbledhë pretendimet e parashtruesve të kësaj kërkesë lidhur me mospërputhshmërinë e nenit 6 të Ligjit të kontestuar me nenet 4, 16 dhe 110 të Kushtetutës, përkatësisht pretendimet që ndërlidhen me: (i) zgjedhjen e një (1) anëtari të KPK-ës nga Avokati i Popullit; dhe (ii) zgjedhja e dy (2) anëtarëve jo-prokurorë nga Kuvendi.

(i) zgjedhja e anëtarit jo-prokuror nga Avokati i Popullit

78. Përkitazi me këtë, parashtruesit e kësaj kërkesë, pretendojnë se dispozitat e Ligjit të kontestuar, që përcaktojnë zgjedhjen e një anëtari jo-prokuror në KPK nga Avokati i Popullit, janë në kundërshtim me autorizimet kushtetuese dhe ligjore përkitazi me Avokatin e Popullit, sepse as me Kushtetutë dhe as me Ligjin nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (në tekstin e mëtejshëm: Ligji për Avokatin e Popullit), sipas tyre: *“Ky institucion nuk është autorizuar që të ketë të drejtën e emërimeve, si kjo, e një anëtari në Këshillin Prokurorial të Kosovës”*. Në këtë kuptim, sipas tyre, dhënia e kompetencave shtesë, i këtij institucioni përmes Ligjit të kontestuar, është në kundërshtim me Kushtetutën, akt i cili: *“...ia ka përcaktuar kompetencat e këtij institucioni dhe asnjë organ tjetër, në këtë rast as Kuvendi i Kosovës, nuk mund t'i jep kompetenca tjera, përtej atyre të përcaktuara me Kushtetutë, sepse ashtu siç e përcakton neni i mëposhtëm [neni 16] i Kushtetutës, i tërë pushteti qeverisës buron nga Kushtetuta”*.

79. Për më tepër, parashtruesit e kësaj kërkesë, gjithashtu theksojnë se natyra e fushëveprimit që ka Avokati i Popullit: *“...bie në konflikt të interesit në disa rrafshje, duke marrë parasysh rolin e tij në raport me mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut dhe rolin e tij të përcaktuar me ligj, në disa procese brenda sistemit prokurorial të shtetit tonë”*. Sipas tyre, i vetmi institucion nga ku mund të burojnë, pra të emërohen personat në pozitat e institucioneve të pavarura kushtetuese, janë nga procedurat e brendshme konkurruese të institucioneve përkatëse dhe nga Kuvendi, si organ, përfaqësues i popullit të Kosovës.

80. Në këtë kontekst, parashtruesit e kësaj kërkesë, pohojnë se Gjykata Kushtetuese nuk duhet: *“...të lejojë këtë precedent të emërimit të tillë, sepse kjo do t'i hapte rrugë, që secila shumicë parlamentare në të ardhmen, me ligje, që nxjerrën me shumicë të thjeshtë, mund të zgjedh përfaqësues të një institucioni tjetër të pavarur kushtetues, duke rrezikuar kështu rendin juridik dhe kushtetues, të epërsisë së institucioneve dhe duke nënvlerësuar rolin kushtetues të Kuvendit të Republikës, si organ përfaqësues i popullit të Kosovës dhe si organ nga ku burojnë (zgjedhën) krerët dhe anëtarët e institucioneve tjera kushtetuese”*.

81. Parashtruesit e kësaj kërkesë, gjithashtu theksojnë se “burimi i autorizimeve shtetërore, mund të bartet në vijë vertikale, në rastin konkret nga Kuvendi, por asesi në vijë horizontale, sepse e njëjta, është kundërkushtetuese dhe e prish balancën dhe ndarjen e pushteteve”. Sipas kësaj logjike, sipas parashtruesve të kërkesës, edhe Auditori i Përgjithshëm, edhe Guvernatori i Bankës Qendrore, mund të marrin autorizime me ligje të tjera, jashtë mandatit të tyre kushtetues dhe ligjor nga ku i ushtrojnë autorizimet publike, për emërimë në institucione përkatëse të karakterit kushtetues e për rrjedhojë, këto do të krijonin pasiguri juridike, si dhe do të ndikonin në pavarësinë dhe autoritetin e institucioneve të pavarura.
82. Sa më sipër, parashtruesit e kësaj kërkesë, vlerësojnë se mënyra e përzgjedhjes, e emërimit, e shkarkimit të anëtarit të KPK-së, nuk është e njëjtë me zgjedhjen e një anëtari jo-prokuror, që emërohet nga Avokati i Popullit, prandaj, kjo bie ndesh me parimin e “barazisë para ligjit” sepse për të njëjtën pozitë, në të njëjtin institucion, përcaktohen masa rënduese, respektivisht favorizuese, për disa anëtarë në raport me anëtarët e tjerë. Thënë këtë parashtruesit e kërkesës, vlerësojnë se përbërja e re e anëtarëve të KPK-së nuk garanton përfaqësim të mjaftueshëm të prokurorëve brenda sistemit të KPK-së.

(ii) zgjedhja e dy (2) anëtarëve jo-prokurorë nga Kuvendi

83. Përkitazi me zgjedhjen e dy (2) anëtarëve jo-prokurorë, parashtruesit e kësaj kërkesë, pretendojnë se dispozitat e Ligjit të kontestuar që përcaktojnë zgjedhjen e 2 (dy) anëtarëve jo-prokurorë me shumicë të thjeshtë të votave në Kuvend, “...rrisin rrezikun që anëtarët e KPK-së të emëruar nga Kuvendi, të jenë persona, që potencialisht përfaqësojnë politikën e shumicës në Kuvend dhe jo persona me autoritet dhe integritet që marrin besimin gjithëpërfshirës të përfaqësuesve të popullit”. Sipas parashtruesve të kërkesës, në mënyrën se si është përcaktuar zgjedhja e dy (2) anëtarëve jo-prokurorë nga Kuvendi, lehtësisht këta anëtarë mund të emërohen me vetëm tridhjetë e një (31) vota të deputetëve, që si përfaqësim është minimal për emërimin e personave në këtë institucion të rëndësishëm kushtetues.
84. Në këtë kontekst, parashtruesit e kësaj kërkesë vlerësojnë se zgjedhja e këtyre anëtarëve të KPK-së, duhet të bëhet me ligj, dhe me votat e së paku gjashtëdhjetë e një (61) deputetëve ose me dy të tretat (2/3) e deputetëve që votojnë në procedurën e zgjedhjes së tyre nga Kuvendi. Kjo, sipas parashtruesve të kërkesës do të ishte një garanci për emërimin e personaliteteve me reputacion dhe me integritet profesional, ashtu siç e meriton ky institucion i rëndësishëm kushtetues që përfshin një shtyllë të rëndësishme të sistemit të drejtësisë. Pra, parashtruesit e kësaj kërkesë, vlerësojnë se votimi me shumicë të thjeshtë, përkatësisht nga shumica e deputetëve që janë të pranishëm dhe që votojnë, cenon pavarësinë dhe integritetin e këtij organi të pavarur kushtetues, duke i dhënë kështu secilës shumicë parlamentare mundësi të madhe për ndikim dhe kontroll politik mbi anëtarët jo-prokurorë në KPK.

(II) Pretendimet për mospërputhshmërinë e nenit 13 të Ligjit të kontestuar me nenet 4, 16 dhe 110 të Kushtetutës

85. Në vlerësimin e parashtruesve të kësaj kërkesë, e drejta e “shumicës speciale ose e drejta e vetos” për anëtarët jo-prokurorë është kundërkushtetuese dhe si e tillë i bllokoi proceset kryesore vendimmarrëse në KPK dhe i jep fuqi vendimmarrëse anëtarëve jo-prokurorë që zgjedhen nga Kuvendi me shumicë të thjeshtë, respektivisht nga shumica parlamentare. Përveç kësaj, parashtruesit në fjalë, ndër të tjera, pretendojnë se “e drejta e vetos” së dy (2) anëtarëve jo-prokurorë, në procese të rëndësishme brenda KPK-së, i bën të pabarabartë me anëtarët prokurorë, të këtij institucioni. Tutje, theksojnë parashtruesit e kërkesës, se duke marrë parasysh faktin se tre (3) anëtarët jo-prokurorë

zgjedhen nga Kuvendi, me shumicë të thjeshtë dhe Avokati i Popullit, përmes vendimmarrjes së tij, cenohet pavarësia e këtij institucioni dhe i pamundësohet të njëjtit që t'i ushtrojë i pavarur kompetencat kushtetuese, ashtu siç e përcakton Kushtetuta, përkatësisht, “KPK siguron që Prokurori i Shtetit të jetë i pavarur, profesional, i paanshëm dhe pasqyron natyrën shumetnike të Kosovës dhe parimet e barazisë gjinore”.

(III) Pretendimet për mospërputhshmërinë e nenit 20 të Ligjit të kontestuar me nenet 4, 16 dhe 110 të Kushtetutës

86. Parashtruesit e kësaj kërkesë, në lidhje me këtë pretendim theksojnë se: “Ndërprerja arbitrare e mandatit përmes shortit të anëtarëve të një organi kushtetues, bie ndesh me Kushtetutën e vendit, sepse në një institucion të pavarur kushtetues, anëtarëve të tij, nuk mundet t'i ndërpritet mandati i fituar pa u përmbushur kushtet që kërkohen me ligjin me të cilin janë zgjedhur”. Sipas parashtruesve të kërkesës, nisur në premisën se secili person që emërohet në një pozitë, krijon marrëdhënie pune dhe duke marrë parasysh që kushtet dhe kriteret e emërimit dhe të përfundimit të marrëdhënies së punës dhe/ose shkarkimit janë të përcaktuara me ligj, çdo ndryshim ligjor, lidhur me kushtet e reja të përcaktuara me ligj, duhet të fillojë të zbatohet nga momenti kur përfundojnë të drejtat dhe obligimet e anëtarëve të emëruar, sipas kriterëve të cilat kanë qenë të vlefshme në momentin e krijimit të marrëdhënies së punës. Në këtë kontekst, parashtruesit e kësaj kërkesë, vlerësojnë se vetëm në këtë mënyrë mbrohet parimi i sigurisë juridike, si parim bazë i drejtësisë kushtetuese. Sipas parashtruesve të kërkesës: “...as Kushtetuta, e as ligji nuk njeh kriter që marrëdhënia e punës të krijohet sipas shortit, prandaj, as përfundimi i saj, nuk bëhet mbi bazën e shortit”.
87. Në fund, parashtruesit e kësaj kërkesë, nga Gjykata kërkojnë: (i) të deklarojë kërkesën e pranueshme për shqyrtim në merita; (ii) të shpallë Ligjin e kontestuar në mospërputhshmëri me nenin 4, 16, 24, 109 dhe 110 të Kushtetutës; dhe (iii) të shpallë të pavlefshëm, në tërësinë e tij Ligjin e kontestuar.

(IV) Pretendimet përkitazi me kërkesën për masë të përkohshme

88. Përkitazi me vendosjen e masës së përkohshme, parashtruesit e kësaj kërkesë pretendojnë se: (i) mosvënja e masës së përkohshme, në këtë rast do të kishte pasoja të paparashikueshme, sepse do të fillonte ndërprerja e mandatit të anëtarëve aktualë dhe emërimi i anëtarëve të rinj të KPK-së, përmes Ligjit të kontestuar, prandaj duke marrë parasysh kompetencat që i ka ky institucion, përkatësisht dhe ndër të tjera, që të rekrutojë, propozojë, avancojë, transferojë e dispiunojë prokurorët në mënyrën e rregulluar me ligj, do të ndikonte drejtpërdrejtë në krijimin e të drejtave dhe obligimeve ndërmjet KPK-së dhe personave të tjerë fizikë; (ii) procesi i përzgjedhjes së Kryeprokurorit të Shtetit nga ana e KPK-së është në procedurë të vlerësimit në Gjykatën Kushtetuese dhe varësisht nga ky epilog, varet nëse do të ketë nevojë për proces të ri të emërimit, prandaj, çdo ndryshim në KPK, pa u vendosur për meritat e kërkesës për Ligjin e kontestuar, do ta dëmtonte rëndë tërë sistemin e prokurorisë së shtetit; (iii) ndërprerja e marrëdhënies së punës së anëtarëve aktual dhe krijimi i marrëdhënies së re të punës për anëtarët e rinj të KPK-së, sipas Ligjit të kontestuar, pa u vendosur për meritat e kërkesës, do të kishte pasoja të pariparueshme, sepse do të cenonte të drejtat dhe liritë themelore të tyre të garantuara me Kushtetutë.

Komentet e dorëzuara nga KPK më 15 korrik 2022

89. Më 15 korrik 2022, KPK, në cilësinë e palës së afektuar me Ligjin e kontestuar, i dorëzoi në Gjykatë komentet e saj. KPK, përmes këtyre komenteve, gjithashtu njoftoi Gjykatën se në lidhje me këtë çështje, më 28 qershor 2022, ka parashtruar kërkesë pranë Avokatit

të Popullit, nëpërmjet së cilës i ka kërkuar që në cilësinë e palës së autorizuar, të dërgojë Ligjin e kontestuar në Gjykatën Kushtetuese për vlerësim të kushtetutshmërisë së tij.

90. Në vijim, Gjykata do të përmbledhë komentet e KPK-së përkitazi me pretendimet e parashtruesve të kërkesave dhe Ligjin e kontestuar, duke përfshirë ato që ndërlidhen me: (i) pavarësinë e KPK-së sipas Kushtetutës; (ii) përbërjen dhe procedurën e zgjedhjes së anëtarëve të KPK-së; (iii) mënyrën e zgjedhjes dhe votimit të anëtarëve jo-prokurorë të KPK-së nga Kuvendi dhe Avokati i Popullit, respektivisht; (iv) kuorumin dhe vendimmarrjen; (v) përfundimin e mandatit të anëtarëve aktualë të KPK-së; (vi) avancimin e prokurorëve pas përfundimit të mandatit të tyre në KPK; dhe (vii) mbrojtjen gjyqësore të anëtarëve jo-prokurorë të KPK-së.

(i) *pavarësia e KPK-së sipas Kushtetutës*

91. Në lidhje me pavarësinë e KPK-së sipas Kushtetutës, KPK pretendon se është institucion i pavarur kushtetues dhe në këtë aspekt, i referohet paragrafit 5 të nenit 4 të Kushtetutës, i cili përcakton: *"Pushteti gjyqësor është unik, i pavarur dhe ushtrohet nga gjykatat"*, në kuadër të të cilit paragraf, sipas KPK-së, bie dhe KPK dhe për faktin se kësisoj e ka përcaktuar edhe Gjykata Kushtetuese me Aktgjykimin KO203/19, me parashtrues Avokati i Popullit. Duke iu referuar në veçanti paragrafëve 101 dhe 102 të këtij Aktgjykimi, KPK thekson se: *"Megjithatë, sa i përket Kushtetutës së Kosovës, megjithëse Kushtetuta në mënyrë specifike parasheh që pushteti gjyqësor ushtrohet nga gjykatat, sistemi prokurorial i Kosovës është përfshirë në Kapitullin VII [Sistemi i Drejtësisë] të Kushtetutës së bashku me sistemin gjyqësor, ku në mënyrë specifike është përcaktuar se Prokuroria e Shtetit është institucion i pavarur me autoritet dhe përgjegjësi për ndjekjen penale ndërsa KPK, sipas nenit 110 të Kushtetutës, është mandatar që të sigurojë, mes tjerash, pavarësinë e Prokurorit të Shtetit, ngjashëm sikurse është mandatuar Këshilli Gjyqësor për të siguruar pavarësinë e gjykatave"* dhe *"Gjykata vlerëson se Kushtetuta e Kosovës ka pasur për qëllim që sistemit prokurorial t'i sigurojë pavarësinë e njëjtë për të ushtruar funksionet e saj po aq sa edhe sistemit gjyqësor. Andaj, Gjykata, për qëllime të pavarësisë së tyre institucionale që ndërlidhet me Ligjin e kontestuar, do të trajtojë sistemin gjyqësor dhe sistemin prokurorial së bashku, në raport me pushtetin legjislativ që ushtrohet nga Kuvendi dhe pushtetin ekzekutiv që ushtrohet nga Qeveria"*.
92. Në këtë kontekst, KPK pretendon se *"ndërmarrja e veprimeve të njëanshme nga Ministria e Drejtësisë për ta ndryshuar Ligjin nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, pa filluar edhe me ndryshimet e tjera në ligjet bazike të sistemit të drejtësisë ashtu siç është paraparë me Strategjinë e Sundimit të Ligjit ka qenë tendencë për të ndërhyrë në pavarësinë e institucionit tonë"*.

(ii) *përbërja dhe procedura e zgjedhjes së anëtarëve të KPK-së*

93. KPK, tutje pretendon se neni 6 i Ligjit të kontestuar bie ndesh me nenin 4 të Kushtetutës, sepse nëpërmjet këtij neni, ndryshohet thelbësisht përbërja e KPK-së nga përbërja që e kishte paraprakisht me Ligjin bazik, si dhe nga përbërja që ka Këshilli Gjyqësor i Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: KGJK), që në përbërjen e tij ka dhjetë (10) gjyqtarë, dhe ku vetëm tre (3) prej anëtarëve janë jo-gjyqtarë. KPK vëren se në rastin e Ligjit të kontestuar, përbërja e KPK-së në raport me anëtarët jo-prokurorë është vetëm me një anëtar më tepër nga sistemi, rrjedhimisht tre (3) anëtarë prokurorë që përzgjedhen nga kolegët e tyre dhe tre (3) anëtarë që zgjedhen nga jashtë sistemit prokurorial. Sipas KPK-së, pjesëmarrja e Kryeprokurorit të Shtetit, në mënyrë *ex-officio*, nuk paraqet apo nuk konsiderohet ndonjë shumicë sepse nuk përzgjedhet nga kolegët në mënyrë të drejtpërdrejt, por përfaqësohet në KPK sipas detyrës zyrtare. Sipas KPK-së, kjo përbërje është në kundërshtim me Kushtetutën sepse nuk përbëhet nga një

shumicë e anëtarëve prokurorë të përzgjedhur nga vet sistemi prokurorial, siç është rasti me KGJK-në. Për pasojë, sipas KPK-së, Ligji i kontestuar: “...bie në kundërshtim me aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese Nr. ref.: AGJ 1583/20 të datës 9 korrik 2020 e cila ka garantuar barazinë e sistemit prokurorial, si ai gjyqësor.”

94. Për më tepër, KPK, gjithashtu pretendon se neni 6 i Ligjit të kontestuar bie ndesh edhe me paragrafin 2 të nenit 110 të Kushtetutës, ku theksohet: “*Këshilli Prokurorial i Kosovës do të rekrutojë, propozojë, avancojë, transferojë, dispijnojë prokurorët në mënyrën e rregulluar me ligj. Këshilli do t’i japë përparësi emërimit për prokurorë të anëtarëve të komuniteteve të nën përfaqësuar në mënyrën e përcaktuar me ligj. Te gjithë kandidatët duhet t’i plotësojnë kriteret e përcaktuara me ligj*”. Në këtë rast, KPK pretendon se disiplinimin, avancimin, por edhe performancën e prokurorëve që është e rregulluar me ligj, do të administrojë një trupë e cila nuk e përbën shumicën e pushtetit gjyqësor-prokurorial. Në këtë kontekst, sipas KPK-së, përbërja KPK-së në këtë mënyrë të paraparë me Ligjin e kontestuar, bie ndesh dhe me nenet 3, 4, 7, 21, 22, 24, 32 dhe 110 të Kushtetutës.

(iii) mënyra e zgjedhjes dhe votimit të anëtarëve jo-prokurorë të KPK-së nga Kuvendi dhe Avokati i Popullit

95. Sipas KPK-së, Ligji i kontestuar është në kundërshtim me nenin 4 të Kushtetutës, pasi që nuk sigurohet mënyra unike e zgjedhjes së anëtarëve të Këshillit, ngase në këtë përbërje, një nga anëtarët caktohet nga Avokati i Popullit dhe kjo bie ndesh me barazinë e zgjedhjes së anëtarëve të tjerë të Këshillit, e që zgjedhen nga Kuvendi apo nga komuniteti i prokurorëve. KPK tutje shton se ky ligj i jep autorizime ligjore Avokatit të Popullit, i cili ka për obligim mbrojtjen e të drejtave dhe lirive edhe të anëtarëve të sistemit prokurorial, duke cituar kështu nenin 132 të Kushtetutës, që përcakton: “1. *Avokati i Popullit mbikëqyr dhe mbron të drejtat dhe liritë e individëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike*”.
96. Në këtë vazhdë, KPK, argumenton se paragrafi 12 i nenit 7 të Ligjit të kontestuar, parasheh se anëtarët jo-prokurorë, pas përfundimit të të gjitha procedurave, zgjedhen nga Kuvendi me votim të fshehtë me shumicë të votave të deputetëve të pranishëm dhe që votojnë. Sipas KPK-së, kjo mënyrë e votimit është tejet e thjeshtë dhe nuk siguron pavarësinë dhe gjithëpërfshirjen e nevojshme për një institucion të pavarur kushtetues. Për më tepër, KPK thekson se paragrafi 2 i nenit 8 të Ligjit të kontestuar, parasheh kriteret për zgjedhjen e anëtarit jo-prokuror nga radhët e institucionit të Avokatit të Popullit, përkatësisht vetëm detyrimin e Avokatit të Popullit që të konsultohet me shoqërinë civile përkitazi me zgjedhjen e tij për anëtar të KPK-së. KPK thekson se kjo dispozitë ligjore nuk parasheh ndonjë kriter që kandidatët duhet të plotësojnë për t’u zgjedhur anëtarë të Këshillit.
97. KPK, më tej thekson se, caktimi i anëtarit jo-prokuror nga institucioni i Avokatit të Popullit në KPK, paraqet konflikt interesi, duke marrë për bazë kompetencën e Avokatit të Popullit sipas Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve për të iniciuar raste disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve. Prandaj, sipas KPK-së “...propozimi për caktimin e anëtarit jo-prokuror nga radhët e institucionit të Avokatit të Popullit të është plotësisht e papranueshme”.
98. KPK gjithashtu thekson se kjo kompetencë e Avokatit të Popullit e cila nuk është e paraparë me Kushtetutë, nuk mund të përcaktohet as me ligj, aq më tepër që shkarkimi i anëtarit të KPK-së nga Avokati të Popullit, nuk është e rregulluar përmes Ligjit të kontestuar. Gjithashtu, KPK thekson se, kjo dispozitë bie ndesh edhe me barazinë para ligjit pasi që procedura e shkarkimit të anëtarëve jo-prokurorë nuk është e njëjtë, derisa shkarkimi i anëtarëve jo-prokurorë bëhet me shumicën e votave, ndërsa shkarkimi i

anëtarit jo-prokuror të caktuar nga Avokati i Popullit, bëhet vetëm me vendim të Avokatit të Popullit, gjë që bie ndesh me kompetencat e tij kushtetuese. Po ashtu, sipas KPK-së, “neni 10/a i Ligjit të kontestuar është në kundërshtim me vetveten, nga se në titull të këtij neni thuhet: “Anëtari jo-prokurorë i caktuar nga Avokati i Popullit” ndërsa në të njëjtin nen, në paragrafin 3, thuhet: “Kur mandati i anëtarit nga paragrafi 1 i këtij neni përfundon para kohe, siç përcaktohet me këtë Ligj, Avokati i Popullit zgjedh anëtarin, me mandat të plotë, brenda tridhjetë (30) ditësh nga dita e mbetjes së vendit të lirë”.

(iv) kuorumi dhe vendimmarrja

99. Përkitazi me kuorumin dhe vendimmarrjen, KPK pretendon se pika 2/a e Ligjit të kontestuar, parasheh votim me shumicë të kualifikuar, prej pesë (5) votash, ku dy (2) prej tyre duhet të jenë nga anëtarët jo-prokurorë, duke rezultuar në të drejtë vetoje dhe duke rrezikuar për pasojë funksionimin përmbajtësor të KPK-së në çështjet kryesore siç janë: (i) zgjedhja e Kryeprokurorit të Shtetit, kryeprokurorëve të prokurorive të Republikës së Kosovës; dhe (ii) procedurat e disiplinimit, transferimit si dhe avancimit të prokurorëve. KPK, gjithashtu thekson se edhe pse kjo dispozitë parasheh se në rast të votave të pamjaftueshme në mbledhjen e radhës mbahet votim i dytë dhe vendimmarrja i nënshtrohet dy të tretave (2/3) të votave të anëtarëve të KPK-së, kjo mënyrë e vendimmarrjes sërish mund të shkaktojë probleme dhe vonesa në përfundimin e këtyre proceseve. Sipas, KPK-së, kjo dispozitë ligjore bie ndesh me dispozitat kushtetuese, konkretisht me nenin 4 dhe 110 të Kushtetutës, për faktin që KPK-së si kategori kushtetuese i pamundësohet funksionimi i pavarur, çdo herë kur tre (3) anëtarët jo-prokurorë, për çfarëdo qëllimi politik ose personal, vendosin që të mos marrin pjesë në takim apo në votim, e bllokojnë vendimmarrjen e KPK-së.
100. Sipas KPK-së, Ligji i kontestuar e pamundëson KPK-në që të realizojë mandatin e saj kushtetues të paraparë me paragrafin 2 të nenit 110 të Kushtetutës, sepse, bazuar në dispozitat e Ligjit të kontestuar, ajo në shumicën e vendimeve, do të jetë e bllokuar dhe jo funksionale. Për më tepër, sipas KPK-së, bllokimi i vendimmarrjes brenda KPK-së, do të krijonte situata të cilat do të mund të zgjidheshin vetëm ndërmjet kompromiseve të jashtëligjshme. Gjithashtu, edhe pse anëtarët e KPK-së sipas Kushtetutës janë të barabartë në vendimmarrje, nëse ky ligj do të hyjë në fuqi, do të rezultojë në shkelje kushtetuese sepse një rregullore e caktuar e propozuar e KPK-së, nuk do të mund të hynte në fuqi nëse nuk e ka votën edhe të një anëtari jo-prokuror dhe kjo bie ndesh me parimet e pavarësisë së KPK-së. Sipas KPK-së, anëtarët e Këshillit janë të barabartë dhe votat e tyre nuk duhet dalluar apo kërkuar për ndonjë proces si të veçanta. Sipas tyre, Magna Carta e Gjyqtarëve e vitit 2010 në parimet fundamentale të saj, ndër të tjera, përcakton se: “Për të siguruar pavarësinë e gjyqtarëve, secili shtet do të krijojë një Këshill për Gjyqësorin ose nj organ tjetër specifik, të pavarur nga pushteti legjislativ dhe ekzekutiv, i pajisur me kompetenca të gjëra për të gjitha çështjet në lidhje me statusin e tyre, si dhe organizimin, funksionimin dhe imazhin e institucionit gjyqësor. Këshilli do të përbëhet ekskluzivisht nga gjyqtarë ose nga një shumicë e konsiderueshme e gjyqtarëve të zgjedhur nga koleget e tyre”.

(v) përfundimi i mandatit të anëtarëve aktualë të KPK-së

101. KPK, pretendon se Ligji i kontestuar parasheh ndërprerjen e parakohshme të mandatit të anëtarëve aktualë të KPK-së dhe këtë ndërprerje e ndërlidhë me momentin: (i) e zgjedhjes së dy (2) anëtarëve jo-prokurorë që do të zgjedhen nga Kuvendi dhe një (1) nga Avokati i Popullit; si dhe (ii) hedhjen e shortit për dy (2) anëtarë prej anëtarëve aktual nga prokuroritë themelore, si dhe një (1) anëtar nga Prokuroria e Apelit ose Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës. Ky propozim, sipas KPK-së, paraqet një rrezik të madh për një shtyllë të pushtetit gjyqësor, në këtë rast sistemit prokurorial.

Për më tepër, sipas KPK-së, përzgjedhja dhe ndërprerja e mandatit me short, nuk e siguron barazinë gjinore dhe etnike të KPK-së, garanci këto të përcaktuara me Kushtetutë.

(vi) avancimi i prokurorëve pas përfundimit të mandatit të tyre në KPK

102. Në lidhje me avancimin pas përfundimit të mandatit, KPK, ndër të tjera, thekson se bazuar në nenin 6 të Ligjit të kontestuar, përkatësisht paragrafit 5/a, parashihet mos lejimi i avancimit për dy (2) vite të anëtarëve prokurorë të KPK-së pas përfundimit të mandatit, dhe se një ndalesë e tillë e avancimit të anëtarëve të KPK-së dy (2) vite pas përfundimit të mandatit do të penalizonte në mënyrë të padrejtë anëtarët prokurorë të KPK-së, siç e thekson dhe Opinioni i Komisionit të Venecias, në pikën e 66-të. Sipas KPK-së, parimi i ndarjes së pushteteve nënkupton edhe garantimin e ushtrimit të pushtetit në mënyrë të pavarur dhe pa ndërhyrje, dhe se kufizimi duhet të jetë i bazuar në balancimin e pushteteve dhe vetëm në masën që e lejon Kushtetuta dhe kompetencat e secilit pushtet respektivisht.

(vii) mbrojtja gjyqësore e anëtarëve jo-prokurorë të KPK-së

103. Përkitazi me mbrojtjen gjyqësore të të drejtave, KPK thekson se neni 23/a i Ligjit të kontestuar, përcakton që prokurori ka të drejtë të paraqesë ankesë drejtpërdrejt në Gjykatën Supreme ndaj vendimeve të KPK-së për shkarkim, vlerësim të performancës si dhe vendimeve disiplinore që për pasojë mund të kenë uljen në detyrë të prokurorëve, duke saktësuar që: *“Gjykata Supreme, brenda nëntëdhjetë (90) ditëve nga koha e pranimit të ankesës, duhet të vendose sipas meritës, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj”*. Kjo dispozitë, sipas KPK-së, *“...bie ndesh me Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese [KO203/19] pasi që vlerësimi i performancës së prokurorëve është mandat i Këshillit dhe se me këtë dispozitë kjo e drejtë i bartet Gjykatës Supreme”*. Prandaj, nga sa u tha më lartë, KPK konsideron që kërkesat e parashtruesve të kërkesave janë të bazuara dhe Ligji i kontestuar *“duhet të anulohet në tërësi”*.

Komentet e dorëzuara nga Ministria e Drejtësisë më 19 korrik 2022

104. Më 19 korrik 2022, Ministria e Drejtësisë i dorëzoi në Gjykatë komentet e saj ndaj pretendimeve të parashtruesve të kërkesave, ku fillimisht theksoi se kërkesat e parashtruara janë *“plotësisht të pabazuara”*. Më tej, lidhur me iniciativën për ndryshimin e Ligjit bazik, Ministria e Drejtësisë, ndër të tjera, theksoi se nga Strategjia për Sundimin e Ligjit 2021-2026, rezulton në të gjetura përkitazi me funksionimin e KPK-së, duke filluar nga: *“...përbërja, ku ka kritere kufizuese për anëtarësimin e personave jashtë sistemit prokuroria dhe se veçanërisht numri i prokurorëve në KPK është mjaft i madh, duke nënkuptuar se kriteret ligjore mundësojnë përfaqësim jo kualitativ dhe jo domosdoshmërisht të pavarur nga politika”*.
105. Në vijim, Gjykata do të përmbledhë komentet e Ministrisë së Drejtësisë përkitazi me pretendimet e parashtruesve të kërkesave dhe Ligjit të kontestuar, duke përfshirë ato që ndërlidhen me: (i) përbërjen e re të anëtarëve të KPK-së; (ii) caktimin e një anëtari jo-prokuror nga Avokati i Popullit; (iii) zgjedhjen e dy (2) anëtarëve jo-prokurorë me shumicë të thjeshtë të votave në Kuvend; (iv) të drejtën e *“shumicës speciale apo e drejta e vetos”* së anëtarëve jo-prokurorë në procese të rëndësishme të KPK-së; (v) shortin për ndërprerjen e parakohshme të mandatit të anëtarëve aktual; dhe (vi) mbrojtjen gjyqësore të të drejtave.

(i) *përbërja e re e anëtarëve të KPK-së*

106. Ministria e Drejtësisë, duke u thirrur në përbërjen e KPK-së të përcaktuar sipas Ligjit bazik, ndër të tjera, thekson se: *“...përbërja prej 13 anëtarëve e pa balancuar në mes anëtarëve prokurorë dhe jo-prokurorë, krijon rrezik për korporatizim brenda KPK-së”*. Për më tepër, sipas Ministrisë së Drejtësisë, KPK ka funksionuar me gjithsej njëmbëdhjetë (11) anëtarë nga trembëdhjetë (13) sa ishin paraparë gjithsej përmes Ligjit bazik, dhe se nëntë (9) prej tyre kanë qenë prokurorë sepse dy (2) nga anëtarët jo-prokurorë, nuk kanë arritur të zgjedhen.
107. Lidhur me zvogëlimin e numrit të anëtarëve të KPK-së, Ministria e Drejtësisë, pretendon se përmes ndryshimeve të parapara me Ligjin e kontestuar, eliminohet *“...rreziku për korporatizim të KPK-së”*, dhe arrihet një përfaqësim i balancuar në funksion të sigurimit të efikasitetit të KPK-së në ushtrimin e kompetencave të saj. Ministria e Drejtësisë, gjithashtu referohet në të gjeturat e Opinionit të Komisionit të Venecias, duke theksuar se sipas Komisionit të Venecias: *“...prokurorët duhet të kenë përfaqësim substancial, por jo domosdoshmërisht shumicë”*.

(ii) *caktimi i një anëtari jo-prokuror nga Avokati i Popullit*

108. Ministria e Drejtësisë në këtë kontekst, së pari thekson se ekziston një keqkuptim në këtë pikë nga parashtruesit e kërkesave, sepse sipas tyre neni 8 i Ligjit të kontestuar nuk e parasheh, siç pretendohet nga parashtruesit e kërkesës së dytë se anëtari i caktuar nga Avokati i Popullit zgjedhet nga shoqëria civile, por sipas nenit 8 të këtij Ligji të kontestuar që shton nenin 10/A, *“Avokati i Popullit cakton një anëtar në Këshill që plotëson kriteret ligjore dhe këtë e bën pas mbajtjes së takimit konsultues përmbajtësor me organizatat e shoqërisë civile të cilat janë aktive në fushën e sistemit prokurorial në Kosovë,”* dhe se *“kjo nuk domethënë se ai përfaqësues duhet medoemos të jetë nga shoqëria civile ose nga Avokati i Popullit”*. Më tej dhe lidhur me pretendimin e parashtruesve të kërkesave, se Avokati i Popullit nuk ka kompetencë për propozimin e një anëtari të KPK-së, Ministria e Drejtësisë thekson se çfarë e ka shtyrë për një propozim të këtillë është pikërisht neni 132 i Kushtetutës, që definon Avokatin e Popullit si institucion të pavarur dhe për pasojë, sipas tyre, Avokati i Popullit mund të caktojë një (1) nga tre (3) anëtarët jo-prokurorë me qëllim të arritjes së *“pluralizmit”* të anëtarëve të KPK-së.
109. Më tej, Ministria e Drejtësisë, thekson se edhe Opinioni i parë ka sugjeruar që një numër i anëtarëve jo-prokurorë të rezervohet për përfaqësuesit e Institucioneve të Pavarura, siç është edhe Avokati i Popullit, ndërsa lidhur me pretendimin e parashtruesve të kërkesës se caktimi i një kompetence të tillë Avokatit të Popullit rezulton në shkelje të nenit 16 të Kushtetutës, Ministria e Drejtësisë thekson se pushteti i Avokatit të Popullit buron pikërisht nga Kushtetuta dhe *“në realizimin e kompetencave të tij si organ i pavarur ka të drejtë të bëjë emërim të tilla”*. Lidhur me pretendimin e parashtruesve të kërkesave se Avokati i Popullit është në konflikt të interesit, Ministria e Drejtësisë shton se ky pretendim: *“...është i paqartë dhe nuk ofron detaje të mëtejshme (...)”*.

(iii) *zgjedhja e dy anëtarëve jo-prokurorë me shumicë të thjeshtë të votave në Kuvend*

110. Lidhur me pretendimet e parashtruesve të kërkesave se zgjedhja e dy anëtarëve jo-prokurorë me shumicë të thjeshtë nga ana e Kuvendit cenon pavarësinë kushtetutese të KPK-së, Ministria e Drejtësisë, thekson se neni 80 [Miratimi i Ligjeve] i Kushtetutës, shprehimisht përcakton se Ligjet, vendimet dhe aktet tjera miratohen nga Kuvendi me shumicën e votave të deputetëve të pranishëm dhe që votojnë, përveç në rastet kur është ndryshe e përcaktuar me këtë Kushtetutë. Andaj, sipas tyre, çdo mënyrë tjetër e votimit do të ishte në kundërshtim me Kushtetutë.

(iv) e drejta e “shumicës speciale apo e drejta e vetos” së anëtarëve jo-prokurorë në procese të rëndësishme të KPK-së

111. Lidhur me pretendimet e parashtruesve të kërkesave se mënyra e votimit brenda KPK-së dhe e cila kushtëzohet nga vota e anëtarëve jo-prokurorë cenon pavarësinë kushtetuese të KPK-së, Ministria e Drejtësisë thekson se qëllimi i përfshirjes së domosdoshme të së paku një (1) anëtari jo-prokuror në vendime të caktuara, është eliminimi i rrezikut të “*korporatizimit në KPK*”, duke pamundësuar që vendimet të merren vetëm nga prokurorët dhe të siguroarit që “*...ky organ funksionon me të vërtet si organ pluralist, ku për vendimet e rëndësishme është e nevojshme të gjendet konsensusi*”. Për më tepër, edhe nëse ky konsensus nuk arrihet, Ministria e Drejtësisë thekson se mundësia e bllokimit nga ana e dy (2) anëtarëve të zgjedhur nga Kuvendi është eliminuar sipas propozimit të Komisionit të Venecias për të gjetur mekanizëm de-blokimin në rast se anëtarët e KPK-së të zgjedhur nga Kuvendi votojnë kundër, pasi me draftin e miratuar të Ligjit, të gjitha vendimet mund të miratohet me votat e njërit nga anëtarët jo-prokurorë, që në këtë rast mund të jetë anëtari i caktuar nga Avokati i Popullit.

(v) shorti për ndërprerjen e mandatit të anëtarëve aktualë

112. Sipas Ministrisë së Drejtësisë, mandati i anëtarëve të KPK-së, nuk është kategori kushtetuese por ligjore, dhe sipas vlerësimit të Komisionit të Venecias, parimi i “*mbajtjes së mandatit*” nuk është absolut dhe se një gjë e tillë mund të arsyetohet nëse “*shpien në përparim të dukshëm të sistemit në përgjithësi*”. Sipas Ministrisë së Drejtësisë, kjo masë është proporcionale me qëllim që të arrihet “*pavarësia, paanshmëria dhe profesionalizmi i sistemit prokurorial*”.
113. Për më tepër, sipas komenteve, e gjithë kjo është në funksion të përparimit të dukshëm të sistemit prokurorial dhe se edhe nga vlerësimi i Komisionit të Venecias, duke interpretuar Opinionin e parë, kjo mbështetet nga fakti se përbërja e re e KPK-së do të eliminonte: “*...përfaqësimin jo-proporcional të nivelit të prokurorive në KPK (ku aktualisht ka përfaqësim shumë më të madh të prokurorive themelore dhe numër të vogël të përfaqësuesve nga prokuroritë më të larta) dhe do të siguronte një balancim të përfaqësimit.*” Ministria e Drejtësisë thekson se “*me ndërprerjen e parakohshme të mandatit të disa prej anëtarëve aktual të KPK-së nuk shkelet Neni 110 i Kushtetutës. Përkundrazi, vazhdimi i përbërjes aktuale të KPK-së me rrezikun e ‘korporatizimit’ dhe me një disbalanc të 10 anëtarëve prokurorë dhe vetëm 1 anëtar jo-prokuror edhe për 4 vite tjera, do t’i pamundësonte KPK-së të zbatoj kompetencat e veta kushtetuese*”.

(vi) procedurat disiplinore për anëtarët e Këshillit/mbrojtja gjyqësore e të drejtave

114. Lidhur me argumentin e parashtruesve të kërkesave, se anëtarëve jo-prokurorë të KPK-së nuk u mundësohet mbrojtje gjyqësore dhe për pasojë, shkelet barazia para ligjit në krahasim me anëtarët prokurorë, Ministria e Drejtësisë thekson se procedura e emërimit të anëtarëve jo-prokurorë në këtë rast dallon, andaj dallon edhe procedura e shkarkimit. Sipas Ministrisë së Drejtësisë, Ligji i kontestuar nuk e ka ndaluar mbrojtjen gjyqësore për anëtarët jo-prokurorë në rast të shkarkimit, por Ministria e Drejtësisë ka vlerësuar se: “*...kjo çështje është mjaftueshëm e mbuluar me ligjet tjera të aplikueshme në Kosovë*”. Më tej, theksohet se anëtarët jo-prokurorë mund të kontestojnë vendimet për shkarkim në gjykata të rregullta nëpërmes procedurës së konfliktit administrativ apo drejtpërdrejtë në Gjykatën Kushtetuese përmes njëres nga palët e autorizuar. Në anën tjetër, mundësia e anëtarëve prokurorë që të ankohen drejtpërdrejtë në Gjykatën Supreme, u është dhënë duke marrë parasysh unifikimin me sistemin e rregullt disiplinor për prokurorët, sipas Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Komentet e dorëzuara nga Avokati i Popullit më 29 korrik 2022

115. Më 29 korrik 2022, pasi Gjykata miratoi kërkesën e Avokatit të Popullit për zgjatje të afatit për komente, ky i fundit të njëjtën datë i dorëzoi në Gjykatë komentet e tij ndaj pretendimeve të parashtruesve të kërkesave.
116. Lidhur me ndryshimet në përbërje të KPK-së që rezultojnë përmes Ligjit të kontestuar, Avokati i Popullit, ndër të tjera, thekson se është me rëndësi që Gjykata të vlerësojë nëse të njëjtat janë në pajtim me dispozitat kushtetuese dhe nëse: *“...cenohet pavarësia e Avokatit të Popullit sipas nenit 132 të Kushtetutës, po ashtu nëse cenohet ndarja e pushteteve,”* si dhe funksionimi i pavarur i KPK-së, siç garantohet edhe me nenin 110 të Kushtetutës. Sipas Avokatit të Popullit, mundësia që Avokati i Popullit të caktojë një (1) anëtar të KPK-së *“...eventualisht do të mund të shihej si cenim i pavarësisë së Avokatit të Popullit, por edhe i asaj të KPK-së”*. Sipas Avokatit të Popullit, kjo kompetencë e re e cila parashihet me Ligjin e kontestuar, nuk buron as nga Kushtetuta dhe as nga Ligji për Avokatin e Popullit, dhe bazuar në këtë, Avokati i Popullit *“...e vlerëson si shumë të rëndësishme që Gjykata Kushtetuese të vlerësoj kushtetutshmërinë e përcaktimit të kompetencës së Avokatit të Popullit në caktimin e një anëtari të KPK-së, në aspekt të cenimit të pavarësisë së tij”*.
117. Më tej lidhur me kompetencën e Kuvendit për të zgjedhur anëtarët jo-prokurorë të KPK-së, Avokati i Popullit thekson, ndër të tjera, se: *“...nuk lëshohet në vlerësimin nëse përzgjedhja e anëtarëve jo-prokurorë nga Kuvendi mund të jetë ndërhyrje apo cenim i pavarësisë së KPK-së “, sepse sipas Avokatit të Popullit, kjo kompetencë e Kuvendit ka ekzistuar edhe në të kaluarën. Megjithatë, Avokati i Popullit kërkon nga Gjykata që të vlerësojë nëse zvogëlimi i anëtarëve prokurorë të KPK-së, mund të reflektojë në cenimin e parimit të ndarjes së pushteteve. Në këtë kontekst, Avokati i Popullit, gjithashtu i referohet edhe rastit të Gjykatës KO219/19, me parashtrues *Avokati i Popullit*, Aktgjykim i 30 qershorit 2020, paragrafit 325.*
118. Lidhur me *“shumicën e kualifikuar”*, Avokati i Popullit konsideron se ekziston rreziku i bllokadave procedurale në rast se nuk plotësohet, *“...kuorumi i shumicës së kualifikuar”*. Sipas tij, *“duke pasur parasysh përmbajtjen e normës, vëren se ligjvënësi nuk ka lënë një alternativë tjetër nëse nuk plotësohet kuorumi i shumicës së kualifikuar, dhe moslënia e një alternative tjetër nëse dështon votimi me shumicë të kualifikuar shpien tek bllokimi i funksionimit të KPK-së”*.
119. Në fund, Avokati i Popullit kërkon nga Gjykata që të vlerësojë nëse: (i) kompetenca e Avokatit të Popullit për caktimin e një (1) anëtari jo-prokurorë të KPK-së bie në kundërshtim me dispozitat që garantojnë pavarësinë e Avokatit të Popullit dhe me dispozitat që garantojnë funksionimin e pavarur të KPK-së, si institucion i pavarur; (ii) struktura e propozuar e KPK-së është në pajtim me ndarjen e pushteteve të përcaktuara me parimet kushtetuese; (iii) votimi me shumicë të kualifikuar për çështjet e caktuara shprehimisht përmes Ligjit të kontestuar, e cenon funksionimin e pavarur të KPK-së, në frymën e nenit 110 të Kushtetutës.

Komentet e dorëzuara nga Oda e Avokatëve më 9 gusht 2022

120. Pas miratimit të kërkesës së Odës së Avokatëve, nga ana e Gjykatës për të qenë palë e interesuar në rastin konkret, e njëjta më 9 gusht 2022 dorëzoi komentet e saj, ku mes tjerash, theksoi se, *“...do të kufizohet vetëm në dhënien e komenteve në raport me dy kërkesat e cekura më sipër, por jo edhe në raport me komentet e palëve tjera të përfshira”*.

121. Në këtë kontekst, Oda e Avokatëve, fillimisht theksoi se e mbështet kërkesën e parashtruesve të kërkesave dhe vendosjen e masës së përkohshme. Për më tepër, Oda e Avokatëve theksoi se Ligji i kontestuar e cenon interesin juridik të saj, duke i specifikuar arsyet si në vijim, (i) “...rolin e institucionit të OAK-së dhe përfaqësimin e saj në Këshillin Prokurorial të Kosovës prezenton edhe praktika gjerësisht të pranuar ndërkombëtare është segment që ndër të tjera meriton vëmendje të veçantë edhe në rrethanat e rastit konkret pasi që ligji i kontestuar propozon zgjidhje ndryshe jo vetëm të numrit të anëtarëve të KPK-së, por mbi të gjitha parasheh ndryshim të institucioneve përfaqësuese në këtë trup, duke e përjashtuar mundësinë e të përfaqësuarit të OAK-së në KPK”; (ii) “...përjashtimi i OAK-së, në përfaqësimin e interesit të saj në KPK, përveç që është tërësisht i pabazuar dhe i paarsyeshëm, njëkohësisht paraqet qasje arbitrare dhe privim të OAK për të ushtruar funksionin e saj përfaqësues në institucionet e drejtësisë, funksionin e cili, është i domosdoshëm mbi të gjitha për shkak të rolit të avokatit dhe rolit të prokurorit në një proces gjyqësor”; dhe (iii) “një qasje e tillë, paraqet asgjë më shumë se paragjykim të aftësisë përfaqësuese të OAK”.
122. Për më tepër, sipas Odës së Avokatëve, (i) zvogëlimi i numrit të anëtarëve të KPK-së, nëpërmjet Ligjit të kontestuar, cenon dy segmentet kryesore të organizimit, pavarësisht dhe vendimmarrjen e këtij institucioni, përkatësisht KPK-së; (ii) çështja e përcaktimit të kuorumit në pesë (5) anëtarë nga shtatë (7) sosh, “paraqet goditje të drejtpërdrejtë të garancioneve kushtetuese të mishëruara në parimet kushtetuese të Këshillit si pavarësia dhe paanshmëria“ sepse në këtë mënyrë pamundësohet çdo vendim i KPK-së; (iii) kriteri që vendime të rëndësishme të KPK-së të mund të merren vetëm me mbështetjen e dy (2) anëtarëve jo-prokurorë të KPK-së, e bën votën e tyre “shumëfish më e fuqishme” dhe “për rrjedhojë, jo e barabartë me të”, dhe në këtë mënyrë, cenohen drejtpërdrejt garancionet kushtetuese të mishëruara në nenin 110 të Kushtetutës; dhe (iv) ndërprerja e mandatit të anëtarëve aktualë të KPK-së, në “mënyrë arbitrare dhe të parakohshme është e pa bazë, për faktin se tejkalohen kriteret e aplikueshme ligjore nga neni 13 i ligjit në fuqi”, i cili edhe i parasheh arsyet kur një mandat përfundon. Sipas tyre, ndërprerja e mandatit ka për pasojë shkeljen e të drejtës për të zgjedhur dhe për t’u zgjedhur si dhe është në kundërshtim me KEDNJ-në dhe vendimet e GJEDNJ-së si dhe nenin 25 të Konventës Ndërkombëtare për të drejtat Civile e Politike.
123. Në mbështetje të pretendimeve të saj, Oda e Avokatëve i referohet edhe rastit të Gjykatës, KO203/19, me parashtrues *Avokati i Popullit*, Aktgjykim i 30 qershorit 2020, duke theksuar se: “Kushtetuta e Kosovës ka pasur për qëllim që sistemit prokurorial (KPK-së dhe Prokurorit të Shtetit) ti sigurojë pavarësinë e njëjtë për ushtruar funksionet e tij po aq sa edhe sistemit gjyqësor”. Sipas Odës së Avokatëve, Aktgjykimi i lartpërmendur i Gjykatës, qartë e argumenton faktin që Kushtetuta i ka garantuar sistemit gjyqësor dhe prokurorial pavarësi të njëjtë.

Përgjigja e Avokatit të Popullit e 29 gushtit 2022 ndaj komenteve të KPK-së, Ministrisë së Drejtësisë dhe Odës së Avokatëve

124. Më 29 gusht 2022, Avokati i Popullit ka dorëzuar përgjigje ndaj komenteve të dorëzuara në Gjykatë nga KPK, Ministria e Drejtësisë dhe Oda e Avokatëve, përkritazi me vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit të kontestuar. Në përgjigjen e tij, Avokati i Popullit, thekson se KPK në komentet e dorëzuara në Gjykatë, veç tjerash, ka ngritur edhe çështjen e konfliktit të interesit të Avokatit të Popullit, duke marrë për bazë kompetencën e këtij të fundit sipas Ligjit për Përgjegjësitë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, si iniciues i rasteve disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve. Andaj, Avokati i Popullit e konsideron të nevojshme që Gjykata Kushtetuese të vlerësojë nëse: (i) kompetenca e Avokatit të Popullit për caktimin e një anëtari jo-prokuror në KPK bie në kundërshtim me dispozitat që garantojnë funksionimin e pavarur të KPK-së si

institucion i pavarur; dhe (ii) struktura e propozuar e KPK-së është në pajtim me ndarjen e pushteteve të përcaktuara me parimet kushtetuese.

125. Në këtë kontekst, duke u thirrur edhe në analizën e tij lidhur me Ligjin për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, ai thekson, se *“kompetenca e cila nuk është paraparë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, nuk mund t’i jepet me ligj”*.

Përgjigja e Ministrisë së Drejtësisë e 29 gushtit 2022 ndaj komenteve të KPK-së, Avokatit të Popullit dhe Odës së Avokatëve

126. Më 29 gusht 2022, Ministria e Drejtësisë, dorëzoi përgjigje ndaj komenteve të dorëzuara nga KPK, Avokati i Popullit dhe Oda e Avokatëve. Në vijim, Gjykata do të përmbledh, përgjigjet/komentet e Ministrisë së Drejtësisë, për sa i përket komenteve të dorëzuara nga: (i) KPK; (ii) Avokati i Popullit; dhe (iii) Oda e Avokatëve.

(i) për sa i përket komenteve të dorëzuara nga KPK

127. Përkitazi me komentet e dorëzuara nga KPK në Gjykatë, Ministria e Drejtësisë, ndër të tjera, thekson se: (i) të njëjtat janë: *“...paragjyquese, të paargumentuara dhe se rasteve që u është referuar KPK-ja janë jashtë kontekstit të trajtimit nga Gjykata Kushtetuese”*; (ii) se KPK përmend vetëm Opinionin e parë të Komisionit të Venecias; dhe (iii) se të njëjtat pretendojnë se njëanshëm është iniciuar ndryshimi i këtij Ligjit të kontestuar, pa përmendur faktin se janë iniciuar ndryshimet edhe të Ligjit për Prokurorin e Shtetit dhe Ligjit për Prokurorinë Speciale, të cilat pritet të miratohen së shpejti nga Qeveria.

128. Për më tepër, sa i përket pretendimeve të KPK-së, se përbërja e re e KPK-së cenon garancitë e përcaktuara përmes nenit 4 të Kushtetutës, Ministria e Drejtësisë, ndër të tjera, thekson se Ligji i kontestuar nuk shkel parimin e unifikimit dhe pavarësinë e pushtetit gjyqësor, duke shtuar se pushteti gjyqësor dallon nga ai prokurorial dhe kjo është përmendur në Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese në rastin KO29/12 dhe KO48/12. Tutje, Ministria e Drejtësisë, thekson se: (i) ekziston një dallim esencial në masën e rregullimit kushtetues të gjykatave dhe të prokurorive me Kushtetutë dhe se në rastin e sistemit prokurorial, sipas Kushtetutës, organi legjislativ mund ta vendos këtë mënyrë në kuadër të kufizimeve diskrecionale ligjore; (ii) prokuroria nuk është gjykatë dhe puna e tyre, përkatësisht prokurorisë, dallon esencialisht me gjykatat, por që është e pakontestueshme pavarësia edhe e gjykatës edhe e prokurorisë, e cila garantohet përmes Kushtetutës dhe e cila nuk cenohet nga Ligji i kontestuar; dhe (iii) fakti që sistemi prokurorial është rregulluar në Kapitullin VII (Sistemi i Drejtësisë) të Kushtetutës dhe se sistemi prokurorial përfshihet në pushtetin gjyqësor, është i paqëndrueshëm, ngase Kapitulli VII i Kushtetutës përfshin edhe Avokaturën, që është një natyrë krejt tjetër e punës nga gjykatat dhe prokuroria, por gjithsesi i pavarur. Sipas Ministrisë së Drejtësisë, janë tri sisteme, përkatësisht profesione të ndryshme, njërin prej të cilëve Kushtetuta e ka rregulluar në mënyrë specifike, ndërsa dy të tjerët, përkatësisht prokurorinë dhe avokaturën përmes ligjeve specifike.

129. Më tej, sa i përket komenteve të KPK-së në lidhje me përbërjen e re të përcaktuar me Ligjin e kontestuar dhe faktin që KPK konteston përbërjen e re të saj, Ministria e Drejtësisë thekson se, *“siç është konfirmuar edhe nga Komisioni i Venecias, standardet ndërkombëtare lejojnë që prokurorët nuk duhet të jenë domosdo shumicë në këshilla prokurorial, por të kenë vetëm përfaqësim substancial, dhe ajo çka është kyçe është pluralizmi i Këshillit Prokurorial, për të siguruar që prokurorët nuk mund të qeverisin të vetëm, dhe, në anën tjetër, që anëtarët jo-prokurorë të cilët zgjedhën nga shumica parlamentare nuk mund t’i mbivotojnë ata.”* Ministria e Drejtësisë thekson se, KPK me përbërje prej dhjetë (10) anëtarëve prokurorë dhe vetëm një (1) anëtar jo-prokuror nuk

- është pluraliste, pra është në shpërputhje me standardet e Komisionit të Venecias, dhe krijon rrezik për “*korporatizim*”. Prandaj, sipas Ministrisë së Drejtësisë, përbërja e re e KPK-së e përcaktuar sipas Ligjit të kontestuar nuk cenon nenin 110 të Kushtetutës.
130. Më tej, sipas Ministrisë së Drejtësisë: (i) pretendimi i KPK-së për shkelje të nenit 3 të Kushtetutës sepse Ligji i kontestuar nuk siguron barazi gjinore dhe etnike, është i paqëndrueshëm sepse me nenin 6 të Ligjit të KPK-së, që ndryshon paragrafin 4 të nenit 9 të Ligjit bazik, shprehimisht është theksuar se “*me rastin e zgjedhjes të anëtarëve të Këshillit, Këshilli dhe Kuvendi sigurojnë përfaqësimin gjinor dhe shumetnik të Këshillit*” dhe bazuar në këtë dispozitë, dy institucione zgjedhin më shumë se një anëtar në përbërjen e KPK-së dhe e kanë mundësinë që nga shpallja e konkursit për këto pozita, t’i shpallin specifikisht për gjininë e nënpërfaqësuar dhe për komunitetin joshumicë në Kosovë; (ii) pretendimi i KPK-së për shkelje të nenit 4 të Kushtetutës sepse Ligji i kontestuar nuk siguron barazinë e zgjedhjes së anëtarëve të KPK-së, ngase caktimi i një anëtari nga Avokati i Popullit bie ndesh me barazinë e zgjedhjes së anëtarëve të tjerë të KPK-së, është i paqëndrueshëm sepse caktimi i një anëtari nga Avokati i Popullit në përbërje të KPK-së nuk bie ndesh me Kushtetutën; dhe (iii) pretendimi i KPK-së që votimi i anëtarëve jo-prokurorë nga Kuvendi me shumicë të votave të deputetëve të pranishëm dhe që votojnë nuk siguron pavarësinë dhe gjithëpërfshirjen për një institucion të pavarur kushtetues, është gjithashtu i paqëndrueshëm sepse sipas nenit 80 të Kushtetutës, kjo është mënyra e vetme e votimit. Ministria e Drejtësisë, rikujton që përbërja e propozuar e KPK-së sipas Ligjit të kontestuar është vlerësuar nga Komisioni i Venecias se nuk është në kundërshtim me standardet ndërkombëtare.
131. Tutje, për sa i përket pretendimit të KPK-së se caktimi i një anëtari të KPK-së nga Avokati i Popullit përbën konflikt interesi, për shkak të rolit që Avokati i Popullit e ka sipas Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore për Gjyqtarët dhe Prokurorët, Ministria e Drejtësisë sqaron se: (i) anëtari i caktuar nga Avokati i Popullit nuk shërben si përfaqësues i interesave të Avokatit të Popullit; (ii) Ligji i kontestuar e ka vendosur Avokatin e Popullit si autoritet për të caktuar një anëtar në KPK, për shkak të pavarësisë së tij institucionale të garantuar me Kushtetutë dhe ligj në mënyrë që të sigurohet pluralizmi i KPK-së duke evituar përcaktimin e anëtarëve të tjerë të përfaqësuar drejtpërdrejtë nga Qeveria ose të zgjedhur nga Kuvendi, çka do të krijonte rrezik të mundshëm për ndikim politik; (iii) një zgjidhje e tillë është rekomanduar madje shprehimisht nga Komisioni i Venecias dhe është vlerësuar nga ata si diçka që zvogëlon rrezikun për politizim të KPK-së dhe që nuk është në kundërshtim me standardet ndërkombëtare; dhe (iv) sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, në ushtrimin e funksionit publik, konflikti i interesit përkufizohet si në vijim: “*Konflikti i interesit lind nga një rrethanë në të cilën zyrtari ka interes privat që ndikon, mund të ndikojë ose duket se ndikon në kryerjen me paanshmëri dhe objektivitet të detyrës së tij zyrtare*”.
132. Ndërsa, për sa i përket pretendimeve që mënyra e vendimmarrjes së KPK-së siç është përcaktuar në Ligjin e kontestuar është në kundërshtim me Kushtetutën, Ministria e Drejtësisë thekson se (i) KPK është “*paragjykuese*” kur flet për mënyrën e votimit të caktuar për KPK-në, sepse “*përmend interesa politike, personale apo arsye tjera që anëtarët jo-prokurorë do t’i shtyejnë për të mos marrë pjesë në votim, që shpien pastaj në kompromise të jashtëligjshme. Si duket, KPK në komentet e tij, nisat nga praktika e funksionimit të këtij institucioni dhe përvoja e anëtarëve të caktuar të saj, me marrjen e vendimeve të jashtëligjshme siç është shpjeguar në hyrje të kësaj përgjigje [...]*”; (ii) KPK gjithashtu thekson se mënyra e votimit me shumicë të kualifikuar, mund të shkaktojë probleme dhe vonesa në përfundimin e proceseve ndërsa kjo nuk qëndron ngase votimi me shumicë të kualifikuar dhe pastaj votimi alternativ me dy të tretat (2/3) e të gjithë anëtarëve në rast se me shumicë të kualifikuar nuk kalon propozimi, mund

të bëhet brenda një mbledhje dhe brenda ditës së njëjtë; dhe (iii) KPK gjithashtu krijon konfuzion me përmendjen e Magna Carta të Gjyqtarëve sepse ky dokument përcakton standarde për përbërjen e këshillave gjyqësore dhe jo prokuroriale, dhe Komisioni i Venecias në Opinionin e tij, ka qenë tejet i qartë se nuk zbatohen standardet e njëjta për të dy këshillat.

133. Në fund, Ministria e Drejtësisë, gjithashtu përgjigjet në pretendimet e KPK-së lidhur me: (i) ndërprerjen e mandateve; (ii) avancimin e prokurorëve; dhe (iii) mbrojtjen gjyqësore të të drejtave. Përkitazi me të parën, Ministria e Drejtësisë thekson se këtë çështje e ka sqaruar në komentet e dorëzuara më parë dhe mbetet pranë qëndrimit se kjo ndërprerje arsyetohet me *“përparim të dukshëm të sistemit”*, siç është përmendur nga Komisioni i Venecias, për eliminimin e rrezikut të *“korporatizimit”* dhe *“depolitizimit”* e Këshillit. Përkitazi me të dytën, Ministria e Drejtësisë rikujton se nenit 6 i Ligjit të kontestuar ndryshon nenin 9 të Ligjit bazik, duke shtuar paragrafin 5/a, ku shprehimisht theksohet se deri në dy (2) vite pas përfundimit të mandatit, anëtarët e Këshillit nuk mund të përfitojnë nga mundësitë e avancimit në sistemin prokurorial, të cilat janë krijuar si rezultat i vendimeve në të cilat ata kanë marrë pjesë si anëtarë të Këshillit dhe se kjo dispozitë theksohet të jetë në përputhje të plotë me atë që e ka rekomanduar Komisioni i Venecias në Opinionet e tij. Ndërsa, përkitazi me çështjen e tretë, përkatësisht pretendimin e KPK-së që mundësia e dhënë përmes nenit 23/A të Ligjit të kontestuar, që prokurorët të ankohen në Gjykatën Supreme ndaj vendimeve të KPK-së për shkarkim, vlerësimin e performancës dhe vendimeve disiplinore, është në kundërshtim me Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese, ngase vlerësimi i performancës së prokurorëve është mandat i KPK-së dhe jo i Gjykatës Supreme, Ministria e Drejtësisë vlerëson se me këtë dispozitë nuk zvogëlohet kompetenca e KPK-së për vlerësimin e performancës dhe as një kompetence tjetër, ngase Gjykata Supreme do të bëjë vetëm kontrollin gjyqësor të këtyre vendimeve në rast të ankesës së palës dhe se me këtë nen madje mundësohet zbatimi efektiv i nenit 32 të Kushtetutës, *“...e cila çuditërisht sipas Këshillit në këtë rast nuk është e rëndësishme, kurse në rastin paraprak të hedhjes se shortit ishte e rëndësishme”*.

(ii) *për sa i përket komenteve të Avokatit të Popullit*

134. Ministria e Drejtësisë, thekson se përputhshmëria e Ligjit të kontestuar me nenin 132 të Kushtetutës është jashtë fushëveprimit të kërkesave KO100/22 dhe KO101/22, megjithatë e njëjta përmend faktin se gjatë hartimit të projektligjit dhe diskutimeve me Komisionin e Venecias, ka analizuar me kujdes rolin e Avokatit të Popullit dhe përfshirjen e tij në këtë ligj, duke rikujtuar se vetë Komisioni i Venecias në Opinionin e tij ka sugjeruar që anëtarët e KPK-së mund të zgjedhën edhe nga Avokati i Popullit. Sipas vlerësimit të Ministrisë së Drejtësisë, anëtari i caktuar nga Avokati i Popullit bazuar në Ligjin e kontestuar, nuk vepron në KPK si përfaqësues i interesave e as kompetencave që ushtrohen nga Avokati i Popullit, por si anëtar jo-prokuror me orar të plotë që do të sigurojë pluralizmin e KPK-së. Për më tepër, sipas komenteve, është i pabazuar konstatimi i Avokatit të Popullit, se kompetenca e Avokatit të Popullit për caktimin e një anëtari të KPK-së nuk parashihet as me Kushtetutë e as me Ligjin për Avokatin e Popullit, sepse vet Ligji për Avokatin e Popullit në paragrafin 13 të nenit 16 të tij, thekson shprehimisht se Avokati i Popullit, kryen edhe detyra të tjera të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.
135. Ministria e Drejtësisë më tej thekson se rasti i Ligjit të kontestuar nuk është rast i izoluar në kuadrin ligjor të Kosovës, ku anëtarët e një institucioni caktohen nga institucione të tjera, duke u referuar në shembuj si: (i) Ligji për Akademinë e Drejtësisë, sipas të cilit në Këshillin e Akademisë, shtatë (7) nga anëtarët caktohen në numra të caktuar nga KGJK, KPK dhe Ministria e Drejtësisë, pavarësisht që Akademia e Drejtësisë është e definuar si institucion i pavarur dhe që i raporton Kuvendit; dhe (ii) Agjencia Kosovare

për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, ku në Bordin Mbikëqyrës të Agjencisë, një numër i anëtarëve emërohen drejtpërdrejt nga Përfaqësuesi Special i Bashkimit Evropian dhe se ky rol specifik i Përfaqësuesit Special të Bashkimit Evropian, sipas Ministrisë, nuk rregullohet as me Kushtetutë e as ligjet e Kosovës.

136. Si përfundim, Ministria e Drejtësisë vlerëson se Ligji i kontestuar dhe mundësia përkatëse që Avokati i Popullit të caktojë një (1) nga anëtarët jo-prokurorë drejtpërdrejtë në KPK, nuk cenon nenin 135 të Kushtetutës. Sipas Ministrisë, përkundrazi kështu mundësohet pluralizmi dhe zbatimi i kompetencave të KPK-së.

(iii) për sa i përket komenteve të Odës së Avokatëve

137. Sa i përket pretendimit të Odës së Avokatëve se praktikat e gjëra ndërkombëtare njohin përfaqësimin e Odës së Avokatëve në Këshill Prokurorial, Ministria e Drejtësisë thekson se Oda e Avokatëve: *“...nuk ofron as edhe një shembull te vetëm të ndonjë shteti ne këtë drejtim”*. Lidhur me këtë, Ministria e Drejtësisë thekson se sipas analizës së saj krahasuese me vendet e rajonit, *“...në asnjë nga vendet e rajonit përfaqësuesi i Odës së Avokatëve nuk është pjesë e Këshillave Prokuroriale”*. Ministria e Drejtësisë më tej thekson se, *“ekziston mundësia që Odës së Avokateve ti përcaktohet nominimi apo caktimi i drejtpërdrejtë i një anëtari në KPK, por kjo nuk është detyrim, por një nga opsionet e mundshme për anëtarët e zgjedhur jo-prokurorë”*. Për më tepër, Ministria thekson se duke pasur parasysh dhe qëllimin e ligjit, *“...që të gjithë anëtarët e KPK-së, të shërbejnë me orar të plotë, është vlerësuar se anëtarët e Odës së Avokateve të Kosovës, mund të jenë më pak të motivuar për të qenë anëtarë të Këshillit, pasi që do të duhej të pezullonin për 5 vite punën e tyre si Avokat dhe posaçërisht marr parasysh faktin që Oda e Avokatëve të Kosovës edhe pse e ka pasur mundësinë sipas ligjit të vitit 2019 për të emëruar një anëtar në KPK, ajo këtë nuk e ka bërë asnjëherë, duke e lënë KPK-në të funksionojë pothuajse vetëm me anëtarë prokurorë”*. Rrjedhimisht, Ministria e Drejtësisë mban qëndrimin se me faktin që një nga anëtarët nuk do të nominohet nga Oda e Avokatëve, *“...siç ka qenë e rregulluar me Ligjin e vitit 2019, nuk shkelet Kushtetuta e Kosovës”*.

Dispozitat Relevante Kushtetuese dhe Ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 4

[Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit]

- 1. Kosova është Republikë demokratike e bazuar në parimin e ndarjes së pushteteve dhe kontrollit e balancimit në mes tyre, sikurse është përcaktuar me këtë Kushtetutë.*
 - 2. Kuvendi i Republikës së Kosovës ushtron pushtetin legjislativ.*
 - 3. Presidenti i Republikës së Kosovës përfaqëson unitetin e popullit. Presidenti i Republikës së Kosovës është përfaqësues legjitim i vendit brenda dhe jashtë dhe garantues i funksionimit demokratik të institucioneve të Republikës së Kosovës, në pajtim me këtë Kushtetutë.*
 - 4. Qeveria e Republikës së Kosovës është përgjegjëse për zbatimin e ligjeve e politikave shtetërore dhe i nënshtrohet kontrollit parlamentar.*
 - 5. Pushteti gjyqësor është unik, i pavarur dhe ushtrohet nga gjykatat.*
- [...]*

Neni 16
[Epërsia e Kushtetutës]

1. Kushtetuta është akti më i lartë juridik i Republikës së Kosovës. Ligjet dhe aktet e tjera juridike duhet të jenë në pajtim me këtë Kushtetutë.
2. Pushteti qeverisës buron nga Kushtetuta.
3. Republika e Kosovës respekton te drejtën ndërkombëtare,
4. Secili person dhe organ ne Republikën e Kosovës u nënshtrohet dispozitave të Kushtetutës.

Neni 24
[Barazia para Ligjit]

1. Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim.
2. Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal.
3. Parimet e mbrojtjes së barabartë ligjore nuk parandalojnë vënien e masave të nevojshme për mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave të individëve dhe grupeve që janë në pozitë të pabarabartë. Masat e tilla do të zbatohen vetëm derisa të arrihet qëllimi për të cilin janë vënë ato.

Neni 31
[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.
[...]

Neni 32
[E Drejta për Mjete Juridike]

Secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij në mënyrën e përcaktuar me ligj.

Neni 45
[Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes]

1. Çdo shtetas i Republikës së Kosovës që ka arritur moshën tetëmbëdhjetë vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, gëzon të drejtën të zgjedhë dhe të zgjedhet, me përjashtim kur kjo e drejtë i kufizohet me vendim gjyqësor.
2. Vota është personale, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë.
3. Institucionet shtetërore mbështesin mundësitë për pjesëmarrjen e çdonjërit në aktivitete publike dhe të drejtën e secilit për të ndikuar në mënyrë demokratike në vendimet e organeve publike.

Neni 54
[Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave]

Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur.

Neni 65
[Kompetencat e Kuvendit]

Kuvendi i Republikës së Kosovës:
[...]

(10) zgjedh anëtarët e Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe të Këshillit Prokurorial të Kosovës, në pajtim me këtë Kushtetutë;
[...]

Neni 108
[Këshilli Gjyqësor i Kosovës]

1. Këshilli Gjyqësor i Kosovës siguron pavarësinë dhe paanësinë e sistemit gjyqësor.

2. Këshilli Gjyqësor i Kosovës është institucion plotësisht i pavarur në ushtrimin e funksioneve të tij. Këshilli Gjyqësor i Kosovës siguron që gjykatat në Kosovë të jenë të pavarura, profesionale e të paanshme, dhe të pasqyrojnë plotësisht natyrën shumetnike të Republikës së Kosovës e të ndjekin parimet e barazisë gjinore. Këshilli do t'u japë përparësi për emërim si gjyqtarë, anëtarëve të komuniteteve të nën përfaqësuar në mënyrën e përcaktuar me ligj.
[...]

6. Këshilli Gjyqësor i Kosovës përbëhet nga trembëdhjetë (13) anëtarë, me kualifikime dhe ekspertizë profesionale. Anëtarët emërohen për një mandat pesëvjeçar dhe zgjedhën në këtë mënyrë:

(1) Pesë (5) anëtarë do të jenë gjyqtarë të zgjedhur nga anëtarët e gjyqësorit;

(2) Katër (4) anëtarë i zgjedhin deputetët e Kuvendit, të cilët i mbajnë vendet e fituara gjatë ndarjes së përgjithshme të vendeve. Të paktën dy (2) nga katër

(4) anëtarët

duhet të jenë gjyqtarë, dhe një (1) do të jetë anëtar i Odës së Avokatëve të Kosovës;

(3) Dy (2) anëtarë i zgjedhin deputetët e Kuvendit, të cilët i mbajnë vendet e rezervuara ose të garantuara për përfaqësuesit e komunitetit Serb në Kosovë, dhe të paktën njëri prej këtyre të dyve, duhet të jetë gjyqtar;

(4) Dy (2) anëtarë i zgjedhin deputetët e Kuvendit, të cilët mbajnë vendet e rezervuara ose të garantuara për përfaqësuesit e komuniteteve të tjera, dhe të paktën njëri prej këtyre të dyve, duhet të jetë gjyqtar;

(5) Papajtueshmëria e të qenit anëtar i Këshillit Gjyqësor rregullohet me ligj.

[...]

Amendamenti i Kushtetutës së Republikës së Kosovës nr. 25

Neni 108, paragrafi 6, nënparagrafi 1 dhe 2 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës ndryshohen, si në vijim:

(1) shtatë (7) anëtarë do të jenë gjyqtarë të zgjedhur nga anëtarët e gjyqësorit.

(2) dy (2) anëtarë i zgjedhin deputetët e Kuvendit, të cilët i mbajnë vendet e fituara gjatë ndarjes së përgjithshme të vendeve dhe të paktën njëri prej këtyre të dyve, duhet të jetë gjyqtar.

Neni 109
[Prokurori i Shtetit]

1. Prokurori i Shtetit është institucion i pavarur me autoritet dhe përgjegjësi për ndjekjen penale të personave të akuzuar për ndonjë veprë penale ose për ndonjë veprë tjetër, sikurse është rregulluar me ligj.

2. Prokurori i Shtetit është institucion i paanshëm, dhe vepron në bazë të Kushtetutës dhe të ligjit.
3. Organizimi, kompetencat dhe detyrat e Prokurorit të Shtetit rregullohen me ligj.
4. Prokurori i Shtetit pasqyron përbërjen shumetnike të Republikës së Kosovës dhe respekton parimet e barazisë gjinore.
5. Mandati fillestar për prokuror është trevjeçar. Në rast të riemërimit, mandati është i përhershëm deri në moshën e pensionimit, sikurse është përcaktuar me ligj, përveç nëse shkarkohet në pajtim me ligjin.
6. Prokurorët mund të shkarkohen nga funksioni për shkak të dënimit për një vepër të rëndë penale ose për mosrespektimin e rëndë të detyrave.
7. Kryeprokurori i Shtetit emërohet dhe shkarkohet nga Presidenti i Republikës së Kosovës, në bazë të propozimit të Këshillit Prokurorial të Kosovës. Mandati i Kryeprokurorit të Shtetit është shtatëvjeçarë, pa mundësi riemërimi.

Neni 110 **[Këshilli Prokurorial i Kosovës]**

1. Këshilli Prokurorial i Kosovës është institucion plotësisht i pavarur në kryerjen e funksioneve të tij, në pajtim me ligjin. Këshilli Prokurorial i Kosovës siguron qasje të barabartë në drejtësi për të gjithë personat në Kosovë. Këshilli Prokurorial i Kosovës siguron që Prokurori i Shtetit të jetë i pavarur, profesional, i paanshëm dhe pasqyron natyrën shumetnike të Kosovës dhe parimet e barazisë gjinore.
2. Këshilli Prokurorial i Kosovës do të rekrutojë, propozojë, avancojë, transferojë, disiplinojë prokurorët në mënyrën e rregulluar me ligj. Këshilli do t'i japë përparësi emërimit për prokurorë të anëtarëve të komuniteteve të nën përfaqësuar në mënyrën e përcaktuar me ligj. Të gjithë kandidatët duhet t'i plotësojnë kriteret e përcaktuara me ligj.
3. Propozimet për emërimin e prokurorëve duhet të bëhen në bazë të procesit të hapur për emërim, në bazë të meritave të kandidatëve, dhe ky propozim pasqyron parimin e barazisë gjinore dhe përbërjen etnike të jurisdiksionit territorial përkatës.
4. Përbërja e Këshillit Prokurorial të Kosovës, si dhe dispozitat për emërimin, shkarkimin, mandatin, strukturën organizative dhe rregullat e procedurës, rregullohen me ligj.

Neni 132 **[Roli dhe Kompetencat e Avokatit të Popullit]**

1. Avokati i Popullit mbikëqyr dhe mbron të drejtat dhe liritë e individëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike.
2. Avokati i Popullit është i pavarur në ushtrimin e detyrës dhe nuk pranon udhëzime e ndërhyrje nga organet, institucionet ose autoritetet e tjera, të cilat ushtrojnë pushtetin në Republikën e Kosovës.
3. Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t'u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t'i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj.

Neni 133 **[Zyra e Avokatit të Popullit]**

1. Zyra e Avokatit të Popullit është e pavarur, dhe propozon e administron buxhetin e vet, në pajtim me ligj.

2. Avokati i Popullit ka një (1) ose më shumë zëvendës. Numri, mënyra e përzgjedhjes dhe mandati i tyre, rregullohen me ligjin për Avokatin e Popullit. Të paktën një (1) nga zëvendësit e Avokatit të Popullit është pjesëtar i komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë.

Ligji nr. 06/L-156 Për Këshillin Prokurorial të Kosovës (Ligji Bazik)

Neni 9 Përbërja e anëtarëve të Këshillit

1. Këshilli, përbëhet nga trembëdhjetë (13) anëtarë, si vijon:
 - 1.1. dhjetë (10) anëtarë, nga radhët e prokurorëve dhe atë:
 - 1.1.1. Kryeprokurori i Shtetit;
 - 1.1.2. shtatë (7) anëtarë, prokurorë nga prokuroritë themelore, të përfaqësuar me nga një (1) anëtar, të zgjedhur nga prokurorët e asaj prokurorie;
 - 1.1.3. një (1) anëtar, prokuror nga Prokuroria e Apelit, i zgjedhur nga prokurorët e asaj prokurorie;
 - 1.1.4. një (1) anëtar, prokuror nga Prokuroria Speciale, i zgjedhur nga prokurorët e asaj prokurorie.
 - 1.2. një (1) anëtar avokat nga Oda e Avokatëve të Kosovës;
 - 1.3. një (1) anëtar, profesor universitar i drejtësisë;
 - 1.4. një (1) anëtar, përfaqësues nga shoqëria civile.
2. Anëtarët e Këshillit nga nën-paragrafi 1.1. i këtij neni, përveç Kryeprokurorit të Shtetit, nuk mund të ushtrojnë njëkohësisht detyrën e kryeprokurorit të cilësdo prokurori.
3. Tre (3) anëtarët jo-prokurorë të Këshillit, të zgjedhur nga Kuvendi, sipas nenit 65 (10) të Kushtetutës, zgjidhen me votim të fshehtë, me shumicën e votave të deputetëve të pranishëm dhe që votojnë, bazuar në një listë prej dy (2) kandidatëve për secilën pozitë të propozuar nga organet përkatëse e që përfshin:
 - 3.1. një (1) anëtar nga Oda e Avokatëve të Kosovës;
 - 3.2. një (1) profesor nga fakultetet juridike të Republikës së Kosovës;
 - 3.3. “një (1) përfaqësues nga shoqëria civile. Përfaqësuesi i shoqërisë civile përzgjidhet me anë të konkursit publik të shpallur nga Kuvendi, i cili duhet të ketë përgatitje të lartë profesionale, njohuri të dëshmuara nga fusha e drejtësisë, njohuri nga fusha e të drejtave të njeriut, përvojë pune në çështjet ligjore prej pesë (5) viteve, dhe përkrahjen e së paku pesë (5) organizatave të shoqërisë civile të fushës së drejtësisë.
4. Anëtarët e Këshillit pasqyrojnë natyrën shumetnike dhe parimet e barazisë gjinore në Republikën e Kosovës dhe zgjedhën bazuar në kompetencën, përvojën dhe njohurinë e tyre.
5. Gjatë kohës së ushtrimit të funksionit të anëtarit të Këshillit, i njëjti nuk mund të ngritët në detyrë në sistemin prokurorial.
6. Anëtarët e Këshillit me orar të plotë nuk mund të ushtrojnë detyrën e prokurorit në asnjë zyrë të prokurorisë.
7. Këshilli do të miratojë rregullore të veçantë për zbatimin e këtij neni.

Neni 15 Kuorumi dhe vendimmarrja

1. Kuorumi i Këshillit formohet me nëntë (9) anëtarë.
2. Vendimet e Këshillit merren me shumicë të thjeshtë votash të anëtarëve të pranishëm, përveç nëse ligji parasheh ndryshe.
3. Kryesuesi, gjegjësisht zëvendës kryesuesi kur udhëheq mbledhjen e Këshillit, voton i fundit.

Neni 19
Procedurat disiplinore për anëtarët e Këshillit

1. Këshilli përcakton dhe publikon rregullat dhe procedurat disiplinore të zbatueshme ndaj anëtareve të vet duke përfshirë ato procedura që përcaktojnë hetimin, pezullimin apo rekomandimin për shkarkim të cilitdo anëtarë të Këshillit.
2. Komisioni i përbërë nga tre (3) anëtarë, njëri nga të cilët duhet të jetë anëtar prokuror i Këshillit, dhe dy (2) të tjerë nga radhët e prokuroreve, i themeluar nga Këshilli, vendos për masat disiplinore dhe për sanksione, përfshirë pezullimin dhe shkarkimin e cilitdo anëtarë të Këshillit.
3. Me rekomandimin e komisionit, një (1) anëtar i Këshillit mund të shkarkohet me anë të dy të tretave (2/3) të votave të anëtareve të Këshillit.
4. Një (1) anëtar i Këshillit i cili është shkarkuar gëzon të drejtën të ankohet kundër vendimit të Këshillit drejtpërsëdrejti në Gjykatën Supreme brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga vendimi për shkarkim.

Neni 23
Emërimi dhe riemërimi i prokuroreve

1. Presidenti emëron dhe riemëron prokuroret bazuar në propozimet e Këshillit.
2. Presidenti, brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh, pas pranimit të propozimit, nxjerr dekret për emërimin në detyrën e prokurorit të kandidatit të propozuar nga Këshilli. Nëse brenda këtij afati Presidenti nuk e emëron prokurorin, Këshilli mund ta paraqesë edhe një herë tjetër kandidatin e propozuar së bashku me arsyetimin plotësues në formë të shkruar. Pas kësaj Presidenti emëron prokurorin sipas propozimit të Këshillit.

KAPITULLI VI
DISPOZITAT KALIMTARE DHE PERFUNDIMTARE

Neni 36
Qëndrimi në detyrë

1. Anëtarët e zgjedhur të Këshillit, që ushtrojnë këtë funksion në kohën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, mund të qëndrojnë në këtë detyrë deri në mbarim të mandatit të tyre aktual.
2. Mandati i Kryesuesit dhe Zëvendës Kryesuesit të Këshillit i përcaktuar në paragrafin 1. të nenit 11 të këtij ligji, zbatohen edhe për Kryesuesin dhe Zëvendës Kryesuesin që aktualisht ushtrojnë këto funksione.
3. Anëtarët e Këshillit vazhdojnë të kryejnë detyrat sipas dispozitave të përcaktuara në këtë ligj.
4. Anëtarët e zgjedhur të Këshillit kanë të drejtë të paraqesin dorëheqje brenda 30 ditësh dhe duhet të vazhdojnë në pozitën e zgjedhur deri në zgjedhjen e anëtareve të rinj sipas dispozitave të përcaktuara në këtë ligj.

Ligji Nr. 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokuroreve

Neni 15
Ankesa ndaj vendimeve disiplinore

1. Palët kanë të drejtë të ankohen ndaj vendimeve disiplinore të Këshillit, drejtpërdrejt në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimit të vendimit. Gjykatat tjera në Kosovë, nuk kanë kompetencë të

shqyrtojnë dhe të vendosin lidhur me procedurën disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve.

2. Ankesa ndaj vendimit të Këshillit ka efekt suspensiv dhe ndalon implementimin e atij vendimi, derisa të shqyrtohet ankesa.

[...]

5. Gjykata Supreme, në një trup gjykues të përbërë nga tre anëtarë, të zgjedhur nga Kryetari i Gjykatës Supreme, brenda tridhjetë (30) ditëve, shqyrton dhe vendos lidhur me ankesën. Në rast se Kryetari i Gjykatës Supreme është subjekt i vendimit të Këshillit, atëherë zgjedhjen e anëtareve e bën gjyqtari më i moshuar i Gjykatës Supreme.

[...]

Ligjit nr.08/L-136 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.06/L-156 Për Këshillin Prokurorial të Kosovës

Neni 6

1. Neni 9 i Ligjit bazik, paragrafi 1. ndryshohet me tekstin si në vijim:

1. Këshilli përbëhet nga shtatë (7) anëtarë si në vijim:

1.1. Kryeprokurori i Shtetit sipas detyrës zyrtare;

1.2. tre (3) anëtarë prokurorë, të zgjedhur nga sistemi prokurorial, si në vijim:

1.2.1. një (1) prokuror i zgjedhur nga Prokuroria e Apelit apo Prokuroria Speciale;

1.2.2. dy (2) prokurorë të zgjedhur nga radhët e prokurorive themelore, dhe

1.3. tre (3) anëtarë jo prokurorë, si në vijim:

1.3.1. dy (2) prej të cilëve të zgjedhur nga Kuvendi dhe

1.3.2. një (1) i caktuar nga Avokati i Popullit.

2. Në nenin 9 të Ligjit bazik, paragrafi 3 fshihet.

3. Në nenin 9 të Ligjit bazik, paragrafi 4 ndryshohet si në vijim:

4. Me rastin e zgjedhjes të anëtareve të Këshillit, Këshilli dhe Kuvendi sigurojnë përfaqësimin gjinor dhe shumetnik të Këshillit.

4. Në nenin 9 të ligjit bazik, pas paragrafit 5, shtohet paragraf i ri 5/a me tekstin si në vijim:

5/a. Deri në dy (2) vite pas përfundimit të mandatit, anëtarët e Këshillit nuk mund të përfitojnë nga mundësitë e avancimit në sistemin prokurorial, të cilat janë krijuar si rezultat i vendimeve në të cilat ata kanë marre pjesë si anëtar të Këshillit.

5. Në Nenin 9 të ligjit bazik, paragrafi 6 fjalët "me orar të plotë" fshihen.

Neni 7

Neni 10 i Ligjit bazik ndryshohet si në vijim :

Neni 10

Procedurat e zgjedhjes së anëtarëve nga Kuvendi

[...]

12. Kuvendi me votim të fshehtë, me shumicën e votave të deputetëve të pranishëm dhe që votojnë, zgjedh anëtarin e Këshillit.

[...]

Neni 8

Pas nenit 10 të ligjit bazik, shtohen nenet 10/A, 10/B dhe 10/C me tekstin si ne vijim:

Neni 10/A

Anëtari jo prokurorë i caktuar nga Avokati i Popullit

- 1. Avokati i Popullit cakton një anëtar në Këshill, që përmbushe kushtet nga neni 5 paragrafi 2 i këtij ligji.*
- 2. Avokati i Popullit mban takim konsultues përmbajtjesor me organizatat e shoqërisë civile të cilat janë aktive në fushën e sistemit prokurorial në Kosovë, para caktimit të anëtarit të Këshillit.*
- 3. Kur mandati i anëtarit nga paragrafi 1 i këtij neni përfundon para kohe, siç përcaktohet me këtë ligj, Avokati i Popullit zgjedh anëtarin, me mandat të plotë, brenda tridhjetë (30) ditësh nga dita e mbetjes së vendit të lirë.*

Neni 13

- 1. Në Nenin 15 të Ligjit bazik, paragrafi 1 ndryshohet si në vijim:*

1. Kuorumi i Këshillit formohet me pesë (5) anëtarë, përveç; nëse parashihet ndryshe me këtë ligj. Kuorumi formohet me pesë (5) anëtarë edhe për rastet disiplinore.

- 2. Në nenin 15 të Ligjit Bazik, pas paragrafit 2, shtohet një paragraf i ri 2/a me tekstin si në vijim:*

2/a. Përfshirja nga paragrafi 2 i këtij neni, votimi për pozitën e Kryeprokurorit të Shtetit dhe Kryeprokuroreve të Prokurorive, bëhet me shumicë të kualifikuar, me ç'rast kërkohen jo më pak se pesë (5) vota nga përbërja e plotë e Këshillit, dy (2) prej të cilave vota duhet të jenë nga radhët e anëtareve jo prokurorë. Përfshirja e përcaktuar me këtë paragraf ulen edhe për miratimin e akteve nënligjore që rregullojnë emërimin e kryeprokuroreve, si dhe emërimin, transferimin, disiplinimin dhe ngritjen në detyrë të prokurorëve. Në rast të votave të pamjaftueshme, në mbledhjen e radhës mbahet votim i dytë, me ç'rast propozimet nga ky paragraf miratohen me votat e dy të tretave (2/3) të të gjithë anëtareve të Këshillit.

Neni 16

- 1. Neni 19 i Ligjit bazik ndryshohet si në vijim:*

Neni 19

Procedurat disiplinore për anëtarët e Këshillit

- 1. Këshilli përcakton dhe publikon rregullat dhe procedurat disiplinore të zbatueshme ndaj anëtareve të vet, duke përfshirë ato procedura që përcaktojnë hetimin, pezullimin apo shkarkimin e anëtarit prokurorë, gjegjësisht rekomandimin për shkarkim të anëtarit jo prokurorë, të Këshillit.*
- 2. Komisioni i përbërë nga tre (3) anëtarë prokurorë të cilët nuk janë anëtarë të Këshillit, të cilët zgjedhën përmes shortit nga Këshilli, zhvillon procedurën disiplinore brenda tridhjetë (30) ditëve dhe vendos për masat disiplinore dhe për sanksione, përfshirë pezullimin e përkohshëm dhe rekomandimin për shkarkimin e anëtarit të Këshillit.*
- 3. Me propozimin e Komisionit nga paragrafi 2 i këtij neni, anëtari prokuror i Këshillit mund të shkarkohet me dy të tretat (2/3) e votave të anëtareve të Këshillit.*

4. Këshilli i rekomandon Kuvendit, përkatësisht Avokatit të Popullit, shkarkimin e anëtarit jo prokuror, në bazë të propozimit të Komisionit nga paragrafi 2 i këtij neni. Shkarkimi i anëtareve jo prokurorë të zgjedhur nga Kuvendi, bëhet nga Kuvendi me shumicën e votave. Shkarkimi i anëtarit të zgjedhur nga Avokati i Popullit bëhet me vendim të tij.

5. Anëtari prokuror i Këshillit ka të drejtë të ankohet kundër vendimit për shkarkim, drejtpërsëdrejti në Gjykatën Supreme brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga pranimi i vendimi për shkarkim.

6. Gjykata Supreme vendos për ankesat nga paragrafi 5 i këtij neni brenda tridhjetë (30) ditëve nga pranimi i ankesës.

Neni 18

Pas **nenit 23** të Ligjit Bazik, **shtohet neni 23A** me tekstin si në vijim:

Neni 23A

Mbrojtja Gjyqësore

1. Prokurori ka të drejtë të paraqesë ankesë drejtpërdrejt në Gjykatën Supreme të Kosovës, ndaj vendimeve të Këshillit për shkarkim, vendimeve lidhur me vlerësimin e performancës së prokurorëve si dhe vendimeve disiplinore, që për pasojë kanë uljen në detyrë të prokurorëve.

2. Gjykata Supreme, brenda nëntëdhjetë (90) ditëve nga koha e pranimit të ankesës, duhet të vendosë sipas meritës, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj.

Neni 20

Neni 36 i Ligjit bazik ndryshohet si në vijim:

Neni 36

1. Jo me vone se pesëmbëdhjetë (15) dite nga hyrja në fuqi e këtij ligji, Kuvendi i Republikës së Kosovës bën shpalljen publike për aplikim të kandidateve për dy (2) pozitat e anëtareve jo prokurorë të Këshillit që zgjedhën nga Kuvendi sipas këtij ligji dhe përfundon procedurën e zgjedhjes së tyre brenda tre (3) muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

2. Jo me vone se tridhjetë (30) dite nga hyrja në fuqi e këtij ligji, Avokati i Popullit cakton anëtarin në Këshill sipas dispozitave të këtij ligji.

3. Jo me vone se shtatë (7) dite nga zgjedhja e të gjithë anëtareve jo prokurorë, obligohet Kryetari i Gjykatës Supreme të Kosovës që bashkë me Kryesuesin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Avokatin e Popullit, të organizojnë dhe mbajnë shortin për të caktuar anëtarët e Këshillit që vazhdojnë të mbeten anëtar nga radhët e anëtareve prokurorë të Këshillit.

4. Shorti ndahet në dy radhe, ku njeri mbahet për anëtarin prokurorë që vazhdon të mbetet anëtar i Këshillit nga radhët e Prokurorisë së Apelit apo Prokurorisë Speciale, si dhe tjetri për dy (2) anëtarët prokurorë që vazhdojnë të mbesin anëtarë të Këshillit nga radhët e prokurorëve themelore. Kryetari i Gjykatës Supreme të Kosovës thërret takimin, e kryeson atë dhe në fund të procesit nënshkruan rezultatin e shortit.

5. Procesi i shortit nga paragrafi 4 i këtij neni është publik.

6. Anëtarët e caktuar me short nga radhët e prokurorëve, ushtrojnë detyrën e tyre deri në përfundim të mandatit për të cilin fillimisht janë zgjedhur.

7. Pas caktimit me short të anëtareve që vazhdojnë të mbeten anëtar të Këshillit nga radhët e anëtareve prokurorë, mandati i anëtareve tjerë të Këshillit nga radhët e prokurorëve përfundon.

8. Me zgjedhjen e te gjithë anëtareve jo prokurorë të Këshillit sipas dispozitave te këtij ligji, mandati i anëtarit jo prokurorë të zgjedhur para hyrjes ne fuqi te këtij ligji, përfundon.

9. Pas përfundimit te procedurës se short it nga ky nen, Këshilli fillon punën me përbërjen e re sipas këtij ligji.

10. Përrjashtimisht nga paragrafi 3 i këtij Neni, ne rast se Kuvendi ose Avokati i Popullit nuk zgjedhin anëtarët e Këshillit sipas afateve te përcaktuara ne këtë Nen, procesi i shortit dhe përfundimi i mandateve zbatohet ne perputhje me paragrafët 3 deri 7 të këtij neni, dhe Këshilli fillon punën me këtë përbërje.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesave

138. Gjykata duhet së pari të vlerësojë nëse kërkesat e parashtruara para Gjykatës i kanë përmbushur kriteret për pranueshmëri të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuar më tej me Ligj dhe Rregullore të punës.

139. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafit 1 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, që përcakton se: “Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para Gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar”.

140. Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesave i kanë ngritur kërkesat e tyre në bazë të paragrafit 5 të nenit 113 të Kushtetutës, i cili përcakton:

“5. Dhjetë (10) a më shumë deputetë të Kuvendit të Kosovës, brenda një afati prej tetë (8) ditësh nga dita e miratimit, kanë të drejtë të kontestojnë kushtetutshmërinë e cfarëdo ligji ose vendimi të miratuar nga Kuvendi, si për përmbajtjen, ashtu edhe për procedurën e ndjekur.”

141. Andaj, bazuar në të lartcekurat, një kërkesë e parashtruar para Gjykatës sipas paragrafit 5 të nenit 113 të Kushtetutës, duhet (i) të parashtrohet nga së paku dhjetë (10) deputetë të Kuvendit; (ii) të kontestoj kushtetutshmërinë e një ligji ose vendimi të miratuar nga Kuvendi, përkitazi me përmbajtjen dhe/ose për procedurën e ndjekur; si dhe (iii) të parashtrohet brenda një afati prej tetë (8) ditësh nga dita e miratimit të aktit të kontestuar.

142. Gjykata, në vlerësimin e përmbushjes së kriterit të parë përkatësisht numrit të nevojshëm të deputetëve të Kuvendit për të parashtruar kërkesat përkatëse, vëren se kërkesat janë parashtruar nga njëmbëdhjetë (11) deputetë secila, përkatësisht njëzet e dy (22) deputetë të Kuvendit, numër ky i cili përmbush kriterin e përcaktuar përmes fjalisë së parë të paragrafit 5 të nenit 113 të Kushtetutës për të vënë në lëvizje Gjykatën.

143. Gjykata, gjithashtu në vlerësimin e përmbushjes së kriterit të dytë, vëren se parashtruesit e kërkesës e kontestojnë Ligjin nr.08/L-136 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, të miratuar në Kuvend. Ndërsa sa i përket kriterit të tretë, përkatësisht afatit kohor brenda të cilit duhet të parashtrohet kërkesa përkatëse në Gjykatë, kjo e fundit vëren se të dy kërkesat janë dorëzuar në Gjykatë më 1 korrik 2022, ndërkohë që Ligji i kontestuar është miratuar nga Kuvendi më 23 qershor 2022, që nënkupton se kërkesat janë dorëzuar në Gjykatë brenda afatit të përcaktuar me paragrafin 5 të nenit 113 të Kushtetutës.

144. Andaj, Gjykata vlerëson se parashtruesit e kërkesave legjitimohen si palë e autorizuar në kuptim të paragrafit 5 të nenit 113 të Kushtetutës për të kontestuar kushtetutshmërinë e aktit të kontestuar para Gjykatës, si për nga përmbajtja, ashtu dhe për nga procedura e ndjekur, pasi në rastin konkret, parashtruesit e kërkesave, që të gjithë janë deputetë të legjislaturës së VIII të Kuvendit, andaj të njëjtit konsiderohen

palë e autorizuar dhe rrjedhimisht, e kanë të drejtën e kontestimit të kushtetutshmërisë së Ligjit të kontestuar të miratuar nga Kuvendi.

145. Përveç kriterëve të lartcekura kushtetuese, Gjykata gjithashtu merr parasysh edhe nenin 42 (Saktësimi i kërkesës) të Ligjit, që saktëson parashtrimin e kërkesës në bazë të paragrafit 5 të nenit 113 të Kushtetutës, i cili përcakton si në vijim:

Nenin 42
(Saktësimi i kërkesës)

“1. Në kërkesën e ngritur në pajtim me nenin 113, paragrafi 6 të Kushtetutës, ndër të tjera, paraqiten informatat e mëposhtme:

- 1.1. emrat dhe nënshkrimet e të gjithë deputetëve të Kuvendit që kontestojnë kushtetutshmërinë e ligjit apo vendimit të nxjerrë nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës;*
- 1.2. dispozitat e Kushtetutës apo të ndonjë akti apo ligji që ka të bëjë me këtë kërkesë; dhe*
- 1.3. paraqitjen e provave mbi të cila mbështetet kontesti.”*

146. Gjykata, gjithashtu, i referohet dhe rregullit 74 [Kërkesa në pajtim me nenin 113. 5 të Kushtetutës dhe me nenet 42 dhe 43 të Ligjit] të Rregullores së punës, i cili parasheh:

Rregulli 74
[Kërkesa në pajtim me nenin 113. 5 të Kushtetutës dhe me nenet 42 dhe 43 të Ligjit]

“[...]

(1) Kërkesa e parashtruar sipas këtij rregulli, duhet, inter alia, të paraqesë informatat e mëposhtme:

- (a) emrat dhe nënshkrimet e të gjithë deputetëve të Kuvendit që kontestojnë kushtetutshmërinë e një ligji ose të një vendimi të miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës;*
 - (b) dispozitat e Kushtetutës ose të aktit tjetër ose legjislacionit relevant për këtë kërkesë; dhe*
 - (c) provat mbi të cilat mbështetet kontesti.*
- (2) Parashtruesit i bashkëngjisin kërkesës një kopje të ligjit të kontestuar ose vendimit të miratuar nga Kuvendi, regjistrin dhe nënshkrimet personale të deputetëve që paraqesin kërkesën dhe autorizimin e personit që i përfaqëson ata para Gjykatës.”*

147. Në kontekst të dy dispozitave të lartcekura, Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesave (i) kanë shënuat emrat dhe nënshkrimet e tyre në kërkesat e tyre përkatëse; (ii) kanë specifikuar Ligjin e kontestuar të Kuvendit të 23 qershorit 2022; (iii) iu janë referuar neneve specifike të Kushtetutës, me të cilat ata pretendojnë se dispozitat e Ligjit të kontestuar nuk janë në përputhshmëri; dhe (iv) kanë dorëzuan argumentet në mbështetje të pretendimeve të tyre.

148. Rrjedhimisht, marrë parasysh plotësimin e kriterëve kushtetuese dhe ligjore përkitazi me pranueshmërinë e kërkesave përkatëse, Gjykata i deklaron kërkesat e parashtruesve të kërkesave të pranueshme dhe në vijim do të shqyrtojë meritat e tyre.

Meritat e Kërkesës

I. Hyrje

149. Gjykata fillimisht rikujton që parashtruesit e kërkesës, respektivisht njëzet e dy (22) deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, duke u bazuar në paragrafin 5 të nenit 113 të Kushtetutës, kërkojnë vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit të kontestuar dhe i cili pretendojnë se është në kundërshtim me nenet 4, 16, 24, 32, 45, 54, 109 dhe 110 të Kushtetutës. Këto pretendime, në esencë dhe sipas sqarimeve të dhëna në pjesën që ndërlidhet me pretendimet dhe përgjigjet e palëve të interesuara para Gjykatës, mbështeten edhe nga KPK, Oda e Avokatëve dhe Avokati i Popullit përkitazi me kompetencat e tij, ndërsa kundërshtohen nga Ministria e Drejtësisë.
150. Gjykata thekson se thelbi i pretendimeve të parashtruesve të kërkesave, të mbështetura edhe nga Këshilli Prokurorial, Oda e Avokatëve por, në esencë, edhe nga Avokati i Popullit sa i përket çështjeve që ndërlidhen me kompetencat e tij dhe të kundërshtuara nga Ministria e Drejtësisë, ndërlidhet me cenimin e pavarësisë kushtetuese të Këshillit Prokurorial dhe ndarjen e balancin e pushteteve, në kundërshtim me garancitë e nenit 4 dhe nenit 110 të Kushtetutës, respektivisht, sepse Ligji i kontestuar, sipas parashtruesve të kërkesës, ndër tjerash: (i) ndryshon përbërjen e Këshillit Prokurorial, duke e zvogëluar proporcionin në mes të anëtarëve prokurorë dhe jo-prokurorë, me këta të fundit, të zgjedhur me votën e shumicës së thjeshtë të deputetëve të pranishëm dhe që votojnë në Kuvend, duke e nënshtruar zgjedhjen e anëtarëve të një institucioni të pavarur kushtetues vetëm në vullnetin e shumicës qeverisëse të përfaqësuar në Kuvend; (ii) përcakton kompetencën e Avokatit të Popullit për të zgjedhur një (1) nga anëtarët jo-prokurorë të Këshillit Prokurorial, në kundërshtim me Kushtetutën dhe funksionet kushtetuese të Avokatit të Popullit; (iii) duke e përcaktuar shumicën vendimmarrëse të Këshillit Prokurorial në shumicë të kualifikuar dhe duke e kushtëzuar të njëjtën nga vota e anëtarëve jo-prokurorë të tij të zgjedhur me shumicë të thjeshtë nga Kuvendi, e nënshtron vendimmarrjen e një institucioni të pavarur kushtetues ndaj vullnetit politik të shumicës qeverisëse të përfaqësuar në Kuvend; (iv) nuk trajton në mënyrë të barabartë anëtarët prokurorë dhe jo-prokurorë në kontekst të mjetit juridik në dispozicion në rast të shkarkimit të tyre, duke u mundësuar ankesën e drejtpërdrejtë në Gjykatën Supreme vetëm anëtarëve prokurorë të Këshillit; dhe (v) ndërpre në mënyrë arbitrare mandatet e anëtarëve të Këshillit Prokurorial, në kundërshtim me garancitë kushtetuese, praktikën gjyqësore të Gjykatës dhe të GJEDNJ-së.
151. Gjykata rikujton që parashtruesit e kërkesës në rastin KO100/22, kontestojnë kushtetutshmërinë e neneve 13, 16, 18 dhe 20 të Ligjit të kontestuar, ndërsa parashtruesit në rastin KO101/22 kontestojnë Ligjin e kontestuar në tërësinë e tij, por duke paraqitur argumente konkrete lidhur me nenet 6, 13 dhe 20 të Ligjit të kontestuar. Thënë këtë, (i) marrë parasysh pretendimet dhe argumentet respektive të parashtruesve të kërkesave si dhe përgjigjet e palëve të interesuara; dhe (ii) ndërlidhjen e neneve respektive me njëri tjetrin, Gjykata, në rrethanat e rastit konkret, do të vlerësojë nenet e Ligjit të kontestuar si në vijim: (i) nenin 6 [pa titull] përmes të cilit ndryshohet dhe plotësohet neni 9 (Përbërja e anëtarëve të Këshillit) i Ligjit bazik; (ii) nenin 7 [pa titull] përmes të cilit ndryshohet dhe plotësohet neni 10 (Procedura e zgjedhjes së anëtarëve të Këshillit nga Kuvendi) i Ligjit bazik; (iii) nenin 8 [pa titull] përmes të cilit ndryshohet, përkatësisht plotësohet neni 10 (Procedura e propozimit, zgjedhjes dhe e shkarkimit të anëtarëve që zgjedhen nga Kuvendi) i Ligjit bazik, përkatësisht shtohet neni i ri 10/A (Anëtari jo prokuror i caktuar nga Avokati i Popullit); (iv) nenin 13 [pa titull] përmes të cilit ndryshohet dhe plotësohet neni 15 (Kuorumi dhe Vendimmarrja) i Ligjit bazik; (v) nenin 16 [pa titull] përmes të cilit ndryshohet dhe plotësohet neni 19 (Procedura disiplinore për anëtarët e Këshillit) i Ligjit bazik dhe

nenin 18 [pa titull] përmes të cilit ndryshohet, përkatësisht plotësohet neni 23 (Emërimi dhe riemërimi i prokurorëve) i Ligjit bazik, përkatësisht shtohet neni i ri 23/A (Mbrojtja gjyqësore); dhe (vi) neni 20 [pa titull] për ndryshimin dhe plotësimin e nenit 36 (Qëndrimi në detyrë) të Ligjit bazik në lidhje edhe me paragrafin 3 të nenit 11 [pa titull] të Ligjit të kontestuar për ndryshimin dhe plotësimin e nenit 13 (Përfundimi i mandatit) të Ligjit bazik.

152. Gjykata më tej thekson se me qëllim të vlerësimit të kushtetutshmërisë së dispozitave të lartcekura të Ligjit të kontestuar, ajo fillimisht do të përmbledh: (i) parimet themelore kushtetuese përkitazi me sistemin e drejtësisë, siç janë të saktësuara me Kushtetutë dhe të sqaruara më tej përmes praktikës së saj gjyqësore; (ii) historikun e shkurtër të KPK-së, përmes ligjeve respektive që nga themelimi i saj, për aq sa është relevante për rrethanat e rastit konkret; dhe (iii) Opinionet e Këshillit Konsultativ të Prokurorëve Evropian dhe Opinionet relevante të Komisionit të Venecias, duke përfshirë ato për Kosovë dhe që ndërlidhen me analizën e Ligjit të kontestuar.

II. Parime të Përgjithshme

1. Sistemi Prokurorial në Rendin Juridik të Republikës së Kosovës

153. Gjykata, fillimisht thekson që Kushtetuta përbëhet nga një tërësi unike e parimeve dhe vlerave kushtetuese mbi bazën e të cilave është ndërtuar dhe duhet të funksionojë Republika e Kosovës. Normat e parapara me Kushtetutë duhet të lexohen në ndërlidhje me njëra tjetrën ngase vetëm në atë mënyrë nxirret kuptimi i saktë i tyre. Normat kushtetuese nuk mund të nxirren jashtë kontekstit dhe të interpretohen në mënyrë mekanike dhe të pavarur nga pjesa tjetër e Kushtetutës. Kjo për faktin se Kushtetuta ka një kohezion të brendshëm sipas të cilit gjithsecila pjesë ka një ndërlidhje me pjesët e tjera. Çdo paqartësi e normave duhet të interpretohet në frymën e Kushtetutës dhe vlerave të saj (shih rastin e Gjykatës në rastin KO72/20, parashtrues: *Rexhep Selimi dhe 29 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës*, vlerësim i kushtetutshmërisë së Dekretit të Presidentit të Republikës së Kosovës, nr. 24/2020, të datës 30 prill 2020, Aktgjykimin i Gjykatës i 28 majit 2020, paragrafi 549).
154. Në kontekstin e lartcekur dhe në vijim, Gjykata thekson që bazuar në nenin e parë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, përkatësisht nenin 1 [Përkufizimi i Shtetit], Republika e Kosovës është “*shtet i pavarur, sovran, demokratik, unik, dhe i pandashëm*”. Përkufizimi “*demokratik*” i shtetit të Republikës së Kosovës, ndër tjerash dhe për aq sa është relevante për rrethanat e rastit konkret, plotësohet përmes katër (4) dispozitave thelbësore kushtetuese, përkatësisht nenit 3 [Barazia para Ligjit], nenit 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit], nenit 7 [Vlerat] dhe nenit 16 [Epërsia e Kushtetutës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.
155. Së pari, neni 3 i Kushtetutës, ndër tjerash, saktëson që (i) Republika e Kosovës, qeveriset në mënyrë demokratike, me respektim të plotë të sundimit të ligjit, përmes institucioneve të veta legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore; dhe (ii) ushtrimi i autoritetit publik në Republikën e Kosovës, bazohet në parimet e barazisë para ligjit të të gjithë individëve dhe në respektimin e plotë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të pranuar ndërkombëtarisht, si dhe në mbrojtjen e të drejtave dhe në pjesëmarrjen e të gjitha komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre. Së dyti, neni 4 i Kushtetutës dhe i cili përcakton formën e qeverisjes dhe ndarjen e pushtetit, mes tjerash saktëson që Kosova është Republikë demokratike e bazuar në parimin e ndarjes së pushteteve dhe kontrollit e balancimit në mes tyre, sikurse është përcaktuar me këtë Kushtetutë, parime këto sipas të cilave, (i) Kuvendi ushtron pushtetin legjislativ; (ii) Presidenti është përfaqësues legjitim i vendit brenda dhe jashtë dhe garantues i funksionimit demokratik të institucioneve të Republikës së Kosovës, në pajtim me

Kushtetutën dhe duke përfaqësuar unitetin e popullit sipas të njëjtës; (iii) Qeveria është përgjegjëse për zbatimin e ligjeve e politikave shtetërore dhe i nënshtrohet kontrollit parlamentar; (iv) pushteti gjyqësor është unik, i pavarur dhe ushtrohet nga gjykatat; dhe (v) Gjykata Kushtetuese është organ i pavarur i mbrojtjes së kushtetutshmërisë dhe bën interpretimin përfundimtar të Kushtetutës. Së treti, neni 7 i Kushtetutës, saktëson që rendi kushtetues i Republikës së Kosovës, ndër tjerash dhe për aq sa është relevante në rrethanat e rastit konkret, bazohet në parimet e demokracisë, respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut, sundimit të ligjit, mosdiskriminimit, pluralizmit dhe ndarjes së pushtetit shtetëror dhe barazisë gjinore. Ky nen, gjithashtu mbështetet përmes nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës, bazuar në të cilin, ndër tjerash, të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të pacenueshme dhe janë bazë e rendit juridik të Republikës së Kosovës. Në fund, dhe me rëndësi, neni 16 i Kushtetutës, saktëson që: (i) Kushtetuta është akti më i lartë juridik i Republikës së Kosovës dhe se ligjet dhe aktet e tjera juridike duhet të jenë në pajtim me këtë Kushtetutë; (ii) Republika e Kosovës respekton të drejtën ndërkombëtare; dhe (iii) secili person dhe organ në Republikën e Kosovës, u nënshtrohet dispozitave të Kushtetutës.

156. Përtej këtyre dispozitave themelore dhe të cilat saktësojnë parimet e pavarësisë, ndarjes dhe balancimit të pushteteve, Kushtetuta, i ka shtjelluar më tej këto parime në kapituj të veçantë, përkatësisht në: (i) Kapitullin II, të Drejtat dhe Liritë Themelore; (ii) Kapitullin III, të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre; (iii) Kapitullin IV, Kuvendin e Republikës së Kosovës; (iv) Kapitullin V, Presidentin e Republikës së Kosovës; (v) Kapitullin VI, Qeverinë e Republikës së Kosovës; (vi) Kapitullin VII, Sistemin e Drejtësisë; (vii) Kapitullin VIII, Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës; dhe (viii) në Kapitullin XII, Institucionet e Pavarura.
157. Parimet themelore të ndarjes dhe balancimit të pushteteve dhe garancitë për institucionet e pavarura kushtetuese, Gjykata që nga themelimi i saj, i ka shtjelluar në Aktgjykimet e saj, duke u bazuar, ndër tjerash, edhe në praktikën e mira ndërkombëtare, Opinionet relevante të Komisionit të Venecias si dhe praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së dhe Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian (në tekstin e mëtejme: GJDBE), për aq sa ka qenë e nevojshme dhe e aplikueshme. Më saktësisht, Gjykata, ka shtjelluar parimet përkitazi me ndarjen dhe balancimin e pushteteve dhe pavarësinë e institucioneve të pavarura kushtetuese, përmes Aktgjykimeve që përfshijnë por nuk kufizohen në (i) Aktgjykimin e Gjykatës në rastin KO73/16, me parashtrues *Avokati i Popullit*, në të cilin Gjykata e kishte bërë vlerësimin e kushtetutshmërisë së Qarkores Administrative nr. 01/2016, të nxjerrë nga Ministria e Administratës Publike të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Aktgjykimi në rastin KO73/16); (ii) Aktgjykimin e Gjykatës në rastin KO171/18, me parashtrues *Avokati i Popullit*, në të cilin Gjykata e kishte bërë vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Aktgjykimi në rastin KO171/18); (iii) Aktgjykimin e Gjykatës në rastin KO203/19, me parashtrues *Avokati i Popullit*, në të cilin Gjykata kishte bërë vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë (në tekstin e mëtejme: Aktgjykimi në rastin KO203/19); (iv) Aktgjykimin në rastin KO219/19, me parashtrues *Avokati i Popullit*, në të cilin Gjykata kishte bërë vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit nr. 06/L-111 për Pagat në Sektorin Publik (në tekstin e mëtejme: Aktgjykimi në rastin KO219/19); dhe (v) Aktgjykimin në rastin KO127/21, me parashtrues *Abelard Tahiri dhe 10 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës*, lidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë së Vendimit nr. 08-V-29 të Kuvendit të Republikës së Kosovës të 30 qershorit 2021, për shkarkimin e pesë (5) anëtarëve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Aktgjykimi në rastin KO127/21).

158. Përmes Aktgjykimeve të lartcekura, Gjykata ka theksuar, ndër tjerash, që (i) ndër vlerat themelore të mishëruara në Kushtetutë, mbi të cilat bazohet rendi kushtetues i Republikës së Kosovës, janë edhe “*ndarja e pushteteve*” dhe “*sundimi i ligjit*”; (ii) funksionimi i shtetit demokratik të Republikës së Kosovës bazohet në parimin kushtetues të ndarjes së pushteteve dhe kontrollit e balancit në mes tyre; (iii) të tri pushtetet e pavarura të përcaktuara me Kushtetutë, përbëjnë trekëndëshin klasik të ndarjes së pushteteve dhe se raporti në mes tyre mbështetet në parimin e ndarjes së pushteteve dhe kontrollit e balancimit në mes tyre; (iv) secili nga pushtetet, përfshirë edhe institucionet e pavarura, janë të rregulluara në kapituj të veçantë kushtetues dhe secili prej këtyre kapitujve përcakton parimet e përgjithshme, si dhe detyrat dhe përgjegjësitë e secilit pushtet, duke përfshirë mekanizmat e kontrollit dhe balancit në mes tyre, që përbëjnë thelbin e mënyrës se si këto pushtete duhet të kontrollojnë dhe balancojnë njëra tjetrën, pa krijuar ndonjë “*ndërhyrje*”, “*varësi*” apo “*vartësi*” kundërkushtetuese në mes tyre, që potencialisht do të mund të ndikonte në pavarësinë e njërit apo tjetrit pushtet; (v) përveç tri pushteteve klasike, vend të veçantë në sistemin e ndarjes së pushteteve ka edhe Gjykata Kushtetuese, si institucion përgjegjës për garantimin përfundimtar të kushtetutshmërisë në nivel vendi, Presidenti, si përfaqësues i unitetit të popullit dhe garantues i funksionimit demokratik të institucioneve të Republikës së Kosovës, si dhe institucionet e pavarura të referuara në Kapitullin XII të Kushtetutës; dhe në fund, (vi) ndarja e pushteteve si parim themelor i nivelit më të lartë kushtetues, është i mishëruar në frymën e Kushtetutës së vendit dhe si i tillë, është i panegociueshëm.
159. Për sa i përket pavarësisë së pushtetit gjyqësor në veçanti dhe ndërveprimet të tij me pushtetet tjera në Republikën e Kosovës, Gjykata fillimisht thekson që sistemi i drejtësisë është i saktësuar përmes Kapitullit VII të Kushtetutës. I njëjti përcakton: (i) parimet e përgjithshme të sistemit gjyqësor; (ii) organizmin dhe juridiksionin e gjykatave; (iii) emërimin dhe shkarkimin e gjyqtarëve; (iv) mandatin dhe riemërimin e tyre; (v) papajtueshmërinë e funksionit; (vi) imunitetin; (vii) KGJK-në; (viii) Prokurorin e Shtetit; (ix) KPK-në; dhe (x) Avokaturën.
160. Bazuar në këto dispozita dhe për aq sa është relevante në rrethanat e rastit konkret, Kushtetuta përcakton dy (2) institucione të pavarura kushtetuese, përkatësisht KGJK-në dhe KPK-në, të cilat i mandaton me detyrën e sigurimit të pavarësisë dhe paanësisë së sistemit gjyqësor dhe atij prokurorial, respektivisht. Më saktësisht dhe për këtë qëllim, KGJK dhe KPK, janë të vetmet institucione kushtetuese, të cilat bashkë me Gjykatën Kushtetuese, siç është rregulluar në kapitull të veçantë kushtetues, përkatësisht kapitullin VIII, janë të përkufizuara si “*plotësisht të pavarura*” në Kushtetutën e Republikës së Kosovës.
161. Në këtë kontekst, Gjykata rikujton që nenet 108 dhe 110 të kapitullit përkitazi me “*Sistemin e Drejtësisë*” saktësojnë që (i) KGJK është institucion “*plotësisht i pavarur*” në ushtrimin e funksioneve të saj; dhe (ii) KPK është institucion “*plotësisht i pavarur*” në kryerjen e funksioneve të saj, në pajtim me ligjin. Përkundër dallimeve në kompetencat dhe funksionet e këtyre institucioneve, përdorimi i terminologjisë së njëjtë në kuptim të pavarësisë së tyre, duke i cilësuar ato si “*plotësisht të pavarura*”, reflekton qëllimin e kushtetutbërësit që të akordojë nivelin më të lartë të pavarësisë kushtetuese për këto institucione.
162. Thënë këtë dhe për aq sa është relevante për rrethanat e rastit konkret, Gjykata vëren që: (i) secilin prej këtyre institucioneve, Kushtetuta e ka trajtuar në mënyrë të veçantë; (ii) për secilin prej tyre ka përcaktuar mekanizmat e balancimit dhe ndërveprimet me pushtetet tjera; dhe (iii) bazuar në dispozitat përkatëse kushtetuese, ka përcaktuar edhe dallimet në mes tyre.

163. Më saktësisht dhe përkitazi me KGJK-në, neni 108 i Kushtetutës saktëson, ndër tjerash, që KGJK (i) siguron pavarësinë dhe paanësinë e sistemit gjyqësor; (ii) është institucion plotësisht i pavarur në ushtrimin e funksioneve të tij; (iii) siguron që gjykatat në Kosovë të jenë të pavarura, profesionale e të paanshme dhe të pasqyrojnë plotësisht natyrën shumetnike të Republikës së Kosovës e të ndjekin parimet e barazisë gjinore; (iv) është përgjegjës për rekrutimin dhe propozimin e kandidatëve për emërim dhe riemërim për pozita gjyqësore, bazuar në parimet e përcaktuara me Kushtetutë; dhe (v) është përgjegjës për inspektimin gjyqësor, administrimin gjyqësor, përpilimin e rregullave për gjykatat në pajtim me ligjin, punësimin dhe mbikëqyrjen e administratorëve të gjykatave, hartimin dhe mbikëqyrjen e buxhetit për gjyqësorin, përcaktimin e numrit të gjyqtarëve në secilin juridiksion dhe bën rekomandime për themelimin e gjykatave të reja.
164. Kushtetuta gjithashtu, në po të njëjtin nen, përcakton përbërjen e KGJK-së dhe mënyrën e përcaktimit të kësaj përbërjeje, duke saktësuar, ndër tjerash, se KGJK përbëhet nga trembëdhjetë (13) anëtarë, (i) pesë (5) prej të cilëve janë gjyqtarë të zgjedhur nga anëtarët e gjyqësorit; dhe (ii) tetë (8) prej të cilëve zgjedhen nga Kuvendi, në mënyrën e përcaktuar në Kushtetutë, përkatësisht katër (4) prej deputetëve që mbajnë vendet e fituara gjatë ndarjes së përgjithshme të vendeve me kushtin që së paku dy (2) nga ta të jenë gjyqtarë dhe një (1) të përfaqësojë Odën e Avokatëve dhe nga dy (2) prej deputetëve që mbajnë vendet e garantuara për përfaqësuesit e komunitetit serb dhe vendet e garantuara për përfaqësuesit e komuniteteve të tjera, respektivisht, duke përcaktuar gjithashtu që të paktën njëri nga të dy (2) të jenë gjyqtarë. Kjo strukturë e KGJK-së është ndryshuar përmes amendamenteve kushtetuese të 24 shkurtit 2016, përkatësisht përmes Amendamentit nr. 25 të Kushtetutës, sipas të cilit, numri i anëtarëve të zgjedhur nga vet gjyqësori është rritur nga pesë (5) në shtatë (7), ndërsa numri i anëtarëve të zgjedhur të KGJK-së nga Kuvendi, përkatësisht deputetët që mbajnë vendet e fituara gjatë ndarjes së përgjithshme të vendeve, është zvogëluar nga katër (4) në dy (2), me kushtin që njëri nga ta të jetë gjyqtar. Mënyra e zgjedhjes së anëtarëve të KGJK-së nga ana e deputetëve që mbajnë vende të garantuara për përfaqësuesit e komunitetit serb dhe komuniteteve tjera, ka mbetur i njëjtë. Bazuar në strukturën kushtetuese të përcaktuar për KGJK-në, në fakt, e njëjta përbëhet nga të paktën dhjetë (10) gjyqtarë, shtatë (7) prej të cilëve janë të zgjedhur nga KGJK dhe të paktën tre (3) të zgjedhur nga Kuvendi, ndërsa zgjedhja e tre (3) anëtarëve të tjerë, është në diskrecion të Kuvendit, por i cili nuk është i kufizuar që të zgjedh edhe gjyqtarë shtesë.
165. Në anën tjetër, nenet 109 dhe 110 të Kushtetutës, respektivisht, saktësojnë parimet themelore përkitazi me (i) Prokurorin e Shtetit; dhe (ii) KPK-në. I pari, përkatësisht neni 109, përcakton, për aq sa është relevante për rrethanat e rastit konkret, që (i) Prokurori i Shtetit është institucion i pavarur me autoritet dhe përgjegjësi për ndjekjen penale të personave të akuzuar për ndonjë vepër penale ose për ndonjë vepër tjetër, sikurse është rregulluar me ligj; (ii) Prokurori i Shtetit është institucion i paanshëm, dhe vepron në bazë të Kushtetutës dhe të ligjit; (iii) organizimi, kompetencat dhe detyrat e Prokurorit të Shtetit rregullohen me ligj; dhe (iv) Prokurori i Shtetit pasqyron përbërjen shumetnike të Republikës së Kosovës dhe respekton parimet e barazisë gjinore. Për më tepër, i njëjti nen, përcakton edhe dy parime themelore kushtetuese: (i) mandati i prokurorëve, pas riemërimit, është i përhershëm deri në moshën e pensionimit, përveç nëse shkarkohen në pajtim me ligjin; dhe (ii) prokurorët mund të shkarkohen nga funksioni për shkak të dënimit për një vepër të rëndë penale ose për mosrespektimin e rëndë të detyrave. Me rëndësi, sipas nenit 109 të Kushtetutës, Kryeprokurori i Shtetit emërohet dhe shkarkohet nga Presidenti i Republikës, në bazë të propozimit të KPK-së.

166. I dyti, përkatësisht, neni 110 i Kushtetutës, përcakton parimet themelore përkitazi me KPK-në. Ky nen saktëson funksionet themelore të KPK-së, përkatësisht dhe ndër tjerash, (i) sigurimin që Prokurori i Shtetit të jetë i pavarur, profesional, i paanshëm dhe të pasqyrojë natyrën shumetnike të Kosovës dhe parimet e barazisë gjinore; (ii) kompetencën për të rekrutuar, propozuar, avancuar, transferuar dhe disiplinuar prokurorët në mënyrën e rregulluar me ligj; (iii) kompetencën për t'i propozuar Presidentit të Republikës prokurorët për emërim, bazuar në parimet dhe kriteret që janë të përcaktuara në Kushtetutë dhe në ligje të aplikueshme; dhe (iv) kompetencën për t'i propozuar Presidentit emërimin e Kryeprokurorit të Shtetit me mandat shtatë (7) vjeçar, sipas dispozitave kushtetuese. Kjo dispozitë kushtetuese, gjithashtu i ngarkon KPK-së detyrat (i) që t'i sigurojë qasje të barabartë në drejtësi të gjithë personave në Kosovë; dhe (ii) që në propozimin për emërim për prokurorë, t'i jap përparësi emërimit për prokurorë të anëtarëve të komuniteteve të nënpërfaqësuar, në mënyrën e përcaktuar me ligj; dhe (iii) që propozimet përkatëse të pasqyrojnë parimin e barazisë gjinore dhe përbërjen etnike të juridiksionit territorial përkatës.
167. Gjykata vëren që përtej dallimeve në përbërje dhe funksione, dy Këshillat e përcaktuar përmes kapitullit kushtetues të Sistemit të Drejtësisë, janë garantuesit themelorë të pavarësisë së sistemit të drejtësisë, atij gjyqësor e prokurorial, pavarësi kjo, ndër tjerash, e mishëruar në nenet 3, 4 dhe 7 të Kushtetutës së Republikës, që përcaktojnë ndarjen dhe balancimin e pushteteve dhe vlerat e një Republike të përcaktuar si demokratike në nenin e parë të Kushtetutës së saj. Për më tepër, të njëjtat, siç është theksuar më lart, cilësohen si "*plotësisht të pavarura*" dhe në ushtrimin e kësaj pavarësie dhe ndër tjerash, bartin detyrimin e (i) propozimit të Kryetarit të Gjykatës Supreme dhe Kryeprokurorit të Shtetit; (ii) propozimin për emërim të të gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve të Republikës së Kosovës; dhe (iii) në përcaktimin e këtyre propozimeve, sigurimin që të njëjtat të jenë bërë bazuar në parimet e meritës, të përcaktuara me Kushtetutë dhe ligje përkatëse, gjithnjë duke ruajtur vlerat e mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore, barazisë gjinore dhe përfaqësimit të komuniteteve joshumicë në Republikën e Kosovës.
168. Megjithatë, Gjykata më tej vëren që siç është përcaktuar në dispozitat themelore kushtetuese, përkatësisht nenet 1, 3, 4 dhe 7 të Kushtetutës, të shtjelluara më lart, pavarësia e pushteteve dhe institucioneve të pavarura kushtetuese, është e kushtëzuar me balancimin dhe ndërvartësinë në mes tyre. Më saktësisht dhe bazuar në Kushtetutë dhe për aq sa është relevante për rrethanat e rastit konkret, ndërveprimi në mes të KGJK-së dhe KPK-së, është përcaktuar në raport me Kuvendin, Presidentin dhe Qeverinë e Republikës së Kosovës.
169. Të parit, përkatësisht Kuvendit, Kushtetuta i përcakton kompetencën për (i) miratimin e ligjeve bazuar në paragrafin 1 të nenit 65 [Kompetencat e Kuvendit] të Kushtetutës dhe të cilave iu referohet Kushtetuta edhe në kuptim të sistemit të drejtësisë, përfshirë edhe funksioneve dhe kompetencave të KGJK-së dhe KPK-së, respektivisht; dhe (ii) të zgjedhur anëtarët e KGJK-së dhe të KPK-së në pajtim me Kushtetutën, bazuar në paragrafin 10 të nenit 65 të Kushtetutës. Të dytit, përkatësisht Presidentit të Republikës, Kushtetuta i përcakton kompetencën për (i) fillimisht, garantimin e funksionimit kushtetues të institucioneve të përcaktuara me Kushtetutë bazuar në paragrafin 2 të nenit 84 [Kompetencat e Presidentit] të Kushtetutës; dhe (ii) emërimin dhe shkarkimin e Kryetarit të Gjykatës Supreme, gjyqtarëve, Kryeprokurorit të Shtetit dhe prokurorëve të Republikës së Kosovës, bazuar në propozimet e KGJK-së dhe KPK-së, respektivisht, siç është përcaktuar në paragrafët 15, 16, 17 dhe 18 të nenit 84 të Kushtetutës. Ndërsa, të tretës, përkatësisht Qeverisë, Kushtetuta i kufizon kompetencat vetëm në propozimin e projektligjeve dhe akteve tjera të Kuvendit, përfshirë në fushën e sistemit të drejtësisë, bazuar në paragrafin 3 të nenit 93 [Kompetencat e Qeverisë] të Kushtetutës.

170. Thënë këtë, Gjykata gjithashtu vëren që përtej dallimeve në funksionet përkatëse në kuadër të sistemit të drejtësisë dhe siç janë përcaktuar në nenet respektive të Kushtetutës, Kushtetuta gjithashtu ka përcaktuar dallime në kuptim të KGJK-së dhe KPK-së dhe të cilat më tej janë sqaruar përmes praktikës gjyqësore të Gjykatës, me theks në dy Aktgjykime të saj, përkatësisht (i) Aktgjykimin e Gjykatës KO29/12 dhe KO48/12, në të cilin Gjykata kishte shqyrtuar kushtetutshmërinë e amendamenteve të propozuara kushtetuese të dorëzuara nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës më 23 mars 2012 dhe 5 maj 2012 (në tekstin e mëtejme: Aktgjykimi i Gjykatës në rastet KO29/12 dhe KO48/12); dhe (ii) Aktgjykimin e Gjykatës në rastin KO219/19.
171. Në kontekstin e lartcekur, Gjykata fillimisht vë theks në nenet 108 dhe 110 të Kushtetutës, bazuar në të cilat, KGJK dhe KPK, respektivisht, janë saktësuar si “*plotësisht të pavarura*” në ushtrimin e funksioneve të tyre. Megjithatë dhe së pari, për dallim nga neni 108 që saktëson funksionimin “*plotësisht të pavarur*” të KGJK-së, në rastin e KPK-së, përkatësisht në nenin 110 të Kushtetutës, funksionimi “*plotësisht i pavarur*” i tij, i referohet edhe ligjit. Thënë këtë, ky i fundit, përkatësisht ligji, marrë parasysh paragrafin 1 të nenit 110 të Kushtetutës, është në funksion të garantimit të kësaj pavarësie. Ndërsa, së dyti, për dallim nga paragrafi 6 i nenit 108 të Kushtetutës, që saktëson përbërjen e KGJK-së në nivel kushtetues, në rastin e KPK-së, paragrafi 4 i nenit 110 të Kushtetutës, përcakton që (i) përbërja e KPK-së; si dhe (ii) dispozitatat për emërimin, shkarkimin, mandatin, strukturën organizative dhe rregullat e procedurës, rregullohen me ligj.
172. Siç është theksuar më lart, këto dallime në funksione, por edhe në rregullim në nivel kushtetues, janë trajtuar nga Gjykata, ndër tjerash, në dy Aktgjykimet e lartcekura. Përmes të parit, përkatësisht Aktgjykimin të Gjykatës në rastet KO29/12 dhe KO48/12, ndër tjerash, Gjykata kishte vlerësuar kushtetutshmërinë e amendamenteve të propozuara përkritazi me nenet 104 dhe 109 të Kushtetutës, lidhur me emërimin, riemërimin dhe shkarkimin e gjyqtarëve dhe emërimin dhe shkarkimin e Kryeprokurorit pas propozimit të Këshillave përkatës. Më saktësisht, Kuvendi kishte propozuar që lidhur me emërimin, riemërimin dhe shkarkimin e gjyqtarëve dhe Kryeprokurorit të Shtetit sipas propozimeve të KGJK-së dhe KPK-së, respektivisht, Presidentit të Shtetit, i cili bazuar në të njëjtat amendamente kushtetuese do të zgjedhë drejtpërdrejtë nga populli për dallim të sistemit aktual, t’i përcaktohet kompetenca kushtetuese që të ketë mundësinë që kandidatët e propozuar, t’i rikthejë për rishqyrtim në KGJK dhe/ose KPK vetëm nga një herë, duke i lënë mundësinë të dyjave që të propozojnë sërish kandidatët e njëjtë për emërim, por kësaj radhe me propozimin e dy të tretave (2/3) të anëtarëve të Këshillit përkatës.
173. Përmes Aktgjykimin të lartcekur, Gjykata kishte theksuar (i) pavarësinë e plotë të Këshillave në ushtrimin e funksioneve përkatëse, por, (ii) duke e bërë dallimin në mes të gjyqtarëve dhe Kryeprokurorit, kishte theksuar që nëse do të miratohej amendamenti i propozuar kushtetues, në rastin e kompetencës së propozuar të Presidentit për të drejtën për kthim të njëhershëm për rishqyrtim në KGJK të kandidatit të propozuar për gjyqtar, do të pakësoheshin të drejtat dhe liritë themelore të përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës, përderisa ky nuk do të ishte rasti edhe me Kryeprokurorin e Shtetit. Kjo sipas këtij Aktgjykimi të Gjykatës, sepse në rastin e gjyqtarëve, ndër tjerash, një kompetencë e tillë kushtetuese e Presidentit, do të rezultonte në “*rrezik që administrimi i sigurt dhe i vazhdueshëm i drejtësisë, i garantuar me Kushtetutë, do të pengohet nëse me kohë nuk emërohet numër i mjaftueshëm i gjyqtarëve*” dhe për pasojë, do të cenoheshin edhe garancitë kushtetuese përkritazi me të drejtën në mjet juridik dhe mbrojtje gjyqësore të të drejtave, siç janë të përcaktuara përmes nenit 32 [E Drejta për Mjete Juridike] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës, ndërsa dhe për dallim, posti i Kryeprokurorit, do të mund të ushtrohej edhe nga “*zëvendësit deri në emërimin e Kryeprokurorit të ri të Shtetit*”, nëse një kompetencë e tillë e propozuar

përmes amendamenteve kushtetuese do të miratohej në Kuvend, duke mos rezultuar kështu në pakësim të të drejtave dhe lirive themelore të përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës (shih, Aktgjykimin e Gjykatës në rastin KO29/12 dhe 48/12, paragrafët 205 deri më 212).

174. Më tej, përmes Aktgjykimit të Gjykatës në rastin KO219/19, Gjykata gjithashtu vuri në pah dallimet dhe ngjashmëritë kushtetuese dhe ato që burojnë nga parimet ndërkombëtare, të përmbledhura kryesisht nga Opinionet relevante të Komisionit të Venecias, për sa i përket sistemit gjyqësor dhe atij prokurorial. Gjykata përmes Aktgjykimit të lartcekur, ndër tjerash, kishte saktësuar se (i) Kushtetuta e Kosovës nuk e përfshin në mënyrë specifike sistemin prokurorial në ndarjen klasike të pushteteve, pra brenda sistemit gjyqësor si pushtet i tretë, pasi në mënyrë specifike, Kushtetuta ka paraparë që pushteti gjyqësor ushtrohet nga gjykatat; por (ii) megjithatë, Kushtetuta ka përfshirë sistemin prokurorial në kapitullin VII lidhur me Sistemin e Drejtësisë së bashku me sistemin gjyqësor, ku në mënyrë specifike është përcaktuar se Prokuroria e Shtetit është institucion i pavarur, me autoritet dhe përgjegjësi për ndjekjen penale, ndërsa KPK është mandatar që të sigurojë, mes tjerash, pavarësinë e Prokurorit të Shtetit, ngjashëm sikurse është mandatar KGJK për të siguruar pavarësinë e gjykatave; dhe për pasojë, (iii) përkundër faktit që bazuar në Opinionet relevante të Komisionit të Venecias, përderisa ka një standard të konsoliduar dhe uniform përkitazi me pavarësinë e plotë të pushteteve gjyqësore dhe se ky jodetyrimisht është rasti me sistemet prokuroriale, Kushtetuta ka pasur për qëllim që sistemit prokurorial t'i sigurojë pavarësinë e njëjtë për të ushtruar funksionet e saj po aq sa edhe sistemit gjyqësor (shih, rastin e Gjykatës KO219/19, parashtrues *Avokati i Popullit*, Aktgjykim, paragrafët 209 dhe 210).
175. Në këtë kontekst dhe marrë parasysh së pari, dallimet në funksionet e gjyqësorit dhe prokurorisë në kuadër të sistemit të drejtësisë, siç janë të përcaktuara në Kapitullin VII të Kushtetutës dhe së dyti, dallimet në mes të paragrafit 6 të nenit 108 dhe paragrafit 4 të nenit 110 të Kushtetutës, përkitazi me përbërjen e KGJK-së, siç është rregulluar në nivel kushtetues dhe KPK-së, siç është referuar në nivel ligji, Gjykata, megjithatë, thekson që një dallim i tillë, nuk zvogëlon "*pavarësinë e plotë*" të KPK-së. Kjo sepse, paragrafi 4 i nenit 110 të Kushtetutës, duhet të lexohet në përputhje me paragrafin 1 të nenit 110 të Kushtetutës, përkatësisht referenca në një ligj nënkupton që i njëjti duhet t'i shërbejë dhe të jetë në përputhje me dispozitën kushtetuese dhe e cila i përcakton KPK-së "*pavarësi të plotë*" në ushtrimin e funksioneve përkatëse, ashtu siç ia përcakton edhe KGJK-së.

2. KPK sipas ligjeve të Republikës së Kosovës

(i) KGJK dhe KPK sipas Rregulloreve të UNMIK-ut

176. Gjykata në vijim dhe për aq sa është relevante në rrethanat e rastit konkret, do të përvijojë shkurtimisht historikun dhe kontekstin e themelimit të KGJK-së dhe KPK-së, nëpër etapa të ndryshme të zhvillimit institucional të tyre. Në këtë kontekst, duhet fillimisht të theksohet që përgjatë administrimit të UNMIK-ut, Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (në tekstin e mëtejshëm: PSSP), kishte nxjerrë tri (3) dekrete emergjente, përkitazi me të cilat u themelua, ndër tjerash, Këshilli i Përbashkët Konsultativ mbi Emërimet e Përkohshme Gjyqësore. Në konsultim me këtë trup, PSSP-ja emëroi gjyqtarët dhe prokurorët e parë për të shërbyer në baza të përkohshme në sistemin emergjent gjyqësor të ngritur. Në shtator të vitit 1999, përmes Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/7 për Emërimin dhe Shkarkimin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, u themelua Komisioni Këshillëdhënës Gjyqësor, i cili zëvendësoi Këshillin e Përbashkët Konsultativ mbi Emërimet e Përkohshme Gjyqësore. Komisioni Këshillëdhënës Gjyqësor kishte kompetencë të këshillonte PSSP-në në çështjet lidhur me emërimin e

gjyqtarëve e prokurorëve, ankesave kundër tyre, si dhe lidhur me çështje të tjera për sa i përket sistemit gjyqësor.

177. Në prill të vitit 2001, PSSP-ja nxori Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2001/8 për Themelimin e Këshillit Gjyqësor dhe të Prokurorisë së Kosovës (në tekstin e mëtejme: KGJPK), i cili zëvendësoi Komisionin Këshillëdhënës Gjyqësor. KGJPK-ja ishte trup i pavarur, i përbërë prej nëntë (9) anëtarësh, me kompetencë për të këshilluar PSSP-në lidhur me emërimin e gjyqtarëve, prokurorëve dhe gjyqtarëve porotë, për të dëgjuar ankesat kundër cilitdo gjyqtar, prokuror ose gjyqtari porotë, nëse kishte të tilla. KGJPK kishte gjithashtu kompetencë të vendoste për sanksione disiplinore dhe t'i rekomandonte PSSP-së shqiptimin e masave disiplinore, përfshirë shkarkimin e gjyqtarëve, prokurorëve apo gjyqtarëve porotë. Me kërkesë të PSSP-së, KGJPK ofronte këshilla edhe për çështje të tjera lidhur me sistemin gjyqësor dhe prokurorial. Më tej, Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/9 për Kornizën Kushtetuese të Vetëqeverisjes së Përkohshme në Kosovë e 15 majit 2001, përcaktonte kompetencën e KGJPK-së për t'i propozuar PSSP-së listën e kandidatëve për gjyqtarë dhe prokurorë, pasi e njëjta të ishte miratuar në Kuvend, si dhe për t'i rekomanduar PSSP-së avancimin, transferimin dhe gjithashtu shkarkimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve.
178. Me nxjerrjen e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2005/52 për Themelimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës në dhjetor të vitit 2005, KGJPK-ja u zëvendësua me Këshillin Gjyqësor të Kosovës. KGJK kishte rol primar të përcaktonte politikat administrative dhe të bënte mbikëqyrjen administrative të gjyqësorit dhe të gjykatave, përderisa PSSP-ja vazhdonte të ushtronte pushtetin përfundimtar lidhur me emërimin dhe shkarkimin e gjyqtarëve. Sipas paragrafit 1.6 të nenit 1 (Këshilli Gjyqësor i Kosovës) të kësaj Rregulloreje, ishte përcaktuar që dispozitat përkitazi me çështjet që vlejnë për gjyqtarët, të zbatohen edhe për prokurorët, derisa PSSP-ja të shpallte rregulloren që do të themelonte subjektin përgjegjës për këshillimin e PSSP-së lidhur me çështjet e emërimit, sanksionimit dhe shkarkimit të prokurorëve. Neni 2 (Përbërja) e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2005/52, përcaktonte se KGJK përbëhej nga njëmbëdhjetë (11) anëtarë, prej të cilëve, shtatë (7) gjyqtarë dhe katër (4) jo-gjyqtarë, ndërsa, sipas paragrafit 2.3 të nenit 2 (Përbërja) të kësaj Rregulloreje, deri në shpalljen e rregullores përkatëse për prokurorët, dy (2) nga shtatë (7) pozitat e gjyqtarëve, do t'u takonin prokurorëve.

(ii) KPK sipas ligjeve të Republikës së Kosovës

179. Përfundimisht, Kushtetuta përmes neneve të saj 108 dhe 110, respektivisht, vuri bazat për dy trupa të ndarë dhe të ndryshëm me kompetenca të pavarura lidhur me administrimin e sistemit gjyqësor, përkatësisht prokurorial. Megjithatë, megjithëse përkohësisht, paragrafi 1 i nenit 151 [Përbërja e Përkohshme e Këshillit Gjyqësor të Kosovës] të Kushtetutës, shfuqizuar më vonë përmes Amendamentit nr. 12 të Kushtetutës lidhur me Përfundimin e Mbikëqyrjes Ndërkombëtare të Pavarësisë së Kosovës, përcaktonte që KGJK të përbëhej bashkërisht nga gjyqtarë dhe prokurorë. Në zbatim të kësaj dispozite kushtetuese, Kuvendi kishte miratuar Ligjin nr. 03/L-123 për Përbërjen e Përkohshme të Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Ky ligj u shfuqizua nga Ligji nr. 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, e që vazhdoi të parashihte në përbërjen e vet edhe anëtarë prokurorë, deri në themelimin e Këshillit Prokurorial. Megjithatë, neni 53 (Tranzicioni i Këshillit Prokurorial) i këtij Ligji, përcaktonte se (i) me themelimin e KPK-së sipas nenit 110 të Kushtetutës, KGJK nuk do të ushtronte më detyrat dhe funksionet përkatëse lidhur me prokurorinë publike; dhe (ii) prokurorët të cilët janë anëtarë të KGJK-së në kohën që themelohet Këshilli Prokurorial, transferohen tek Këshilli Prokurorial dhe mbeten aty deri në skadimin e natyrshëm të mandateve të tyre.

180. Me miratimin e Ligjit nr. 03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Ligji i KPK-së i vitit 2010), i cili hyri në fuqi më 1 janar 2011, përmes paragrafit 1 të nenit 43 (Transferimi i kompetencave të tij) të tij, ishte saktësuar që me themelimin e KPK-së, detyrat dhe kompetencat që deri në atë kohë u ushtruan nga KGJK, të transferohen në KPK-në e sapoformuar. Me themelimin e KPK-së, sipas paragrafit 2 të nenit 43 të këtij ligji, anëtarët prokurorë të KGJK-së, u transferuan si anëtarë të KPK-së për të vazhduar mandatet deri në skadimin e natyrshëm të tyre.
181. Ligji për KPK-në i vitit 2010, është ndryshuar dhe plotësuar në vitin 2012, përmes Ligjit nr. 04/L-115 në ndërlidhje me përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës. I njëjti, më pas është ndryshuar dhe plotësuar edhe një herë në vitin 2015 përmes Ligjit nr. 05/L-035 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Ligji i KPK-së i vitit 2015). Në fund, në vitin 2019, Kuvendi ka miratuar ligjin e ri për KPK-në, përkatësisht Ligjin nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Ligji i KPK-së i vitit 2019). Është ky i fundit, i cili është ndryshuar dhe plotësuar përmes Ligjit të kontestuar në rrethanat e rastit konkret. Megjithatë, fillimisht dhe para se Gjykata të shtjellojë ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit të kontestuar, në vijim do të përmbledh një kronologji të ndryshimeve dhe plotësimeve të ligjeve përkitazi me KPK-në, për aq sa është relevante për rrethanat e rastit konkret, me theks në (i) përbërjen e KPK-së; (ii) kuorumin dhe vendimmarrjen; dhe (iii) mandatet anëtarëve të KPK-së dhe përfundimin e tyre.
182. Fillimisht dhe përkitazi me përbërjen e KPK-së, Gjykata thekson që bazuar në nenin 5 (Përbërja dhe Përzgjedhja e Anëtarëve të Këshillit) të Ligjit të vitit 2010, KPK është përbërë nga nëntë (9) anëtarë, pesë (5) nga të cilët prokurorë dhe katër (4) jo-prokurorë. Kategoria e prokurorëve të përfaqësuar në KPK, sipas këtij neni, përfshinte (i) Kryeprokurorin e Shtetit; (ii) një (1) prokuror nga Prokuroria Speciale; (iii) një (1) prokuror nga Prokuroria e Apelit; (iv) dy (2) prokurorë nga Prokuroria Themelore, që përzgjedhen nga prokurorët që shërbejnë në atë zyrë, respektivisht. Ndërsa, kategoria e jo-prokurorëve, me përjashtim të Ministrit të Drejtësisë, i cili bazuar në Ligjin e vitit 2010, ishte anëtarë *ex-officio* i KPK-së, emëroheshin nga KPK, bazuar në një listë prej së paku pesë (5) kandidatësh për secilën pozitë të dërguar nga organet relevante, përkatësisht: (i) një (1) anëtar nga Oda e Avokatëve; (ii) një (1) profesor nga fakultetet juridike të Republikës së Kosovës; dhe (iii) një (1) përfaqësues nga shoqëria civile, sipas specifikave të përcaktuara në këtë ligj, respektivisht.
183. Përmes miratimit të Ligjit të vitit 2015, Kuvendi ndryshoi strukturën e KPK-së, duke e rritur numrin e anëtarëve të saj nga nëntë (9) në trembëdhjetë (13). Më saktësisht, neni 3 [pa titull] i Ligjit të vitit 2015, i shtoi përbërjes së atëhershme të KPK-së edhe pesë (5) anëtarë prokurorë shtesë dhe eliminoi pjesëmarrjen *ex-officio* të Ministrit të Drejtësisë në KPK, duke saktësuar që ky institucion do të përbëhet nga trembëdhjetë (13) anëtarë, prej të cilëve dhjetë (10) prokurorë, duke përfshirë (i) Kryeprokurorin; (ii) shtatë (7) anëtarë prokurorë nga prokuroritë themelore, të përfaqësuar me nga një (1) anëtar; (iii) një (1) anëtar prokuror nga Prokuroria e Apelit; dhe (iv) një (1) anëtar prokuror nga Prokuroria Speciale, të përzgjedhur nga prokurorët e prokurorive përkatëse. Numri i anëtarëve jo-prokurorë, u mbajt i njëjtë, përkatësisht tre (3) anëtarë dhe të cilët njëjtë si në ligjin paraprak, do të përfaqësonin propozimet e Odës së Avokatëve, njëri do të ishte profesor universitar i drejtësisë, si dhe i treti, përfaqësues i shoqërisë civile. Thënë këtë, për dallim nga Ligji paraprak, sipas Ligjit të vitit 2015, tre (3) anëtarët jo-prokurorë, do të zgjedheshin përmes Kuvendit të Republikës së Kosovës, sipas mënyrës së përcaktuar në atë ligj. Kjo strukturë mbeti e pandryshuar përmes ndryshimit dhe plotësimit të Ligjit në vitin 2019, përkatësisht neni 9 (Përbërja e anëtarëve të Këshillit) të tij, me përjashtim të ndryshimit të mekanizmit të administrimit të konkursit për zgjedhjen së anëtarit të shoqërisë civile. Më saktësisht, për dallim nga Ligji i vitit 2015,

sipas Ligjit të vitit 2019, konkursi përkitazi me këtë anëtar, do të administrohej përmes Kuvendit në mënyrën dhe sipas kritereve të saktësuara në këtë ligj.

184. Çështjet që ndërlidhen me kuorumin dhe vendimmarrjen, gjithashtu kishin ndryshuar ndër vite përmes ndryshimeve dhe plotësimeve të lartcekura të ligjit përkatës, varësisht nga ndryshimet në përbërjen e KPK-së. Më saktësisht dhe së pari, neni 12 (Selia e Këshillit, Kuorumi dhe Natyra Publike e Takimeve) i Ligjit të vitit 2010, në një strukturë të Këshillit që përbëhej nga pesë (5) anëtarë prokurorë dhe katër (4) anëtarë jo-prokurorë, kishte përcaktuar (i) kuorumin prej gjashtë (6) anëtarësh; ndërsa (ii) vendimmarrjen, me shumicë të thjeshtë të anëtarëve të pranishëm, përveç nëse ligji kishte përcaktuar ndryshe. Përmes ndryshimit dhe plotësimit të Ligjit të vitit 2015, përkatësisht neni 8 [pa titull] të tij, në një strukturë të Këshillit që përbëhej nga dhjetë (10) anëtarë prokurorë dhe tre (3) anëtarë jo-prokurorë, (i) kuorumi ishte caktuar në nëntë (9) anëtarë, ndërsa (ii) vendimmarrja me shumicë të thjeshtë të anëtarëve të pranishëm, përveç nëse ligji kishte përcaktuar ndryshe. Në fund, përmes Ligjit të vitit 2019, përkatësisht përmes neni 15 (Kuorumi dhe Vendimmarrja) të tij, në një strukturë të Këshillit që përbëhej nga dhjetë (10) anëtarë prokurorë dhe tre (3) anëtarë jo-prokurorë, (i) kuorumi mbeti sërish i caktuar në nëntë (9) anëtarë, ndërsa (ii) vendimmarrja me shumicë të thjeshtë të anëtarëve të pranishëm, përveç nëse ligji kishte përcaktuar ndryshe. Në të tri rastet, përjashtimi nga rregulli i vendimmarrjes me shumicë të thjeshtë, përmes neni 11 (Procedurat Disiplinore për Anëtarët e Këshillit), neni 8 (Pushimi dhe shkarkimi nga funksioni i anëtarit të Këshillit) dhe neni 19 (Procedurat disiplinore për anëtarët e Këshillit) të ligjeve të viteve 2010, 2015 dhe 2019, respektivisht, ndërlidhej me vendimmarrjen përkitazi me shkarkimin e anëtarëve të Këshillit, me ç'rast kërkohej shumica prej dy të tretash (2/3) të anëtarëve të Këshillit, sipas specifikave të ligjeve të aplikueshme.
185. Përkitazi me mandatet e anëtarëve të KPK-së, të tri ligjet e lartcekura, saktësojnë (i) kohëzgjatjen e mandatit; (ii) mënyrën e përfundimit të mandatit; dhe (iii) dispozitat tranzitore që ndërlidhen me afektimin e këtyre mandateve si pasojë e ndryshimeve ligjore. Përkitazi me të parën, përkatësisht kohëzgjatjen e mandatit, neni 7 (Mandatet e Anëtarëve të Këshillit), 3 [pa titull] dhe 12 (Mandati i Anëtarëve të Këshillit) të ligjeve të viteve 2010, 2015 dhe 2019, respektivisht, kishin përcaktuar mandatin e anëtarëve të Këshillit në pesë (5) vite, me dallimin që (i) Ligji i vitit 2010, mundësonte rizgjedhjen për mandat të dytë, por jo në mënyrë të njëpasnjëshme; (ii) Ligji i vitit 2015, nuk saktësonte këtë mundësi; ndërsa (iii) Ligji i vitit 2019, pamundësonte të drejtën e rizgjedhjes, duke e kufizuar ushtrimin e këtij funksioni vetëm në një mandat.
186. Përkitazi me mënyrën e përfundimit të mandatit dhe bazat përkatëse, të tri ligjet, pra ligjet e viteve 2010, 2015 dhe 2019, përmes neneve 8 (Përfundimi i mandatit), 8 (Pushimi dhe shkarkimi nga funksioni i anëtarit të Këshillit) dhe 13 (Përfundimi i mandatit), respektivisht, kishin përcaktuar se mandati i anëtarit të Këshillit, përfundon (i) me vdekje; (ii) me humbjen e zotësisë për veprim për më shumë se tre (3) muaj për shkak të arsyeve mjekësore të vërtetuara; (iii) me dështimin e vazhdueshëm për të marrë pjesë në veprimtaritë të Këshillit për më shumë se tre (3) muaj; (iv) me pushimin e statusit mbi të cilin bazohet emërimi, nëse emërimi bazohet në një status të caktuar; dhe (v) me dorëheqje, duke informuar Këshillin me njoftim paraprak prej tridhjetë (30) ditësh. Ndërsa për dallim nga bazat e përbashkëta të përfundimit të mandatit të përvijuara më sipër, (i) Ligji i vitit 2010, si bazë për përfundim të mandatit, kishte përcaktuar edhe dënimin për vepër penale, me përjashtim të kundërvajtjes siç përkufizohet me ligj, ndërsa përkundër faktit që në nenin 11 të tij parashihte mundësinë e shkarkimit të anëtarit të Këshillit, nuk e kishte përcaktuar të njëjtën shprehimisht si një nga bazat për përfundim të mandatit, të numëruara në nenin 8 të tij; (ii) Ligji i vitit 2015, kishte shtuar si bazë për përfundim të mandatit edhe skadimin e mandatit, ndërsa kishte saktësuar shkarkimin si bazë për përfundim të mandatit në tri rrethana,

përkatësisht kur një anëtar i Këshillit nuk e kryen funksionin përkatës në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin, ushtron funksionin në kundërshtim me detyrat dhe përgjegjësitë e tij dhe kur është dënuar për veprë penale, respektivisht; ndërsa (iii) Ligji i vitit 2019, kishte shtuar si bazë për përfundim të mandatit edhe arritjen e moshës së pensionimit dhe dënimin për veprë penale, me përjashtim të veprave penale të kryera nga pakujdesia, ndërsa kishte kufizuar mundësinë e përfundimit të mandatit si rezultat i shkarkimit në vetëm dy rrethana, përkatësisht kur një anëtar i Këshillit nuk e kryen funksionin përkatës në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin dhe kur ushtron funksionin në kundërshtim me detyrat dhe përgjegjësitë e tij.

187. Ndërsa, në fund dhe përkitazi me dispozitat tranzitore që ndërlihen me afektimin e këtyre mandateve si pasojë e ndryshimeve ligjore ndër vite, Gjykata vëren që për sa i përket Ligjit të vitit 2010, përkatësisht ligjit të parë përkitazi me KPK-në sipas nenit 110 të Kushtetutës pas shpalljes së pavarësisë së Republikës së Kosovës, Dispozitat Tranzitore, përkatësisht nenet 41 (Vlefshmëria e Veprimeve të Mëparshme të Këshillit themeluar sipas Rregullores Administrative të UNMIK-ut 2005/52 dhe Ligjit mbi Përbërjen e Përkohshme të Këshillit Gjyqësor të Kosovës), 42 (Përbërja fillestare e Këshillit) dhe 43 (Transferimi i kompetencave) të tij, respektivisht, përcaktonte transferimin e kompetencave nga përbërja e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në Këshillin e ri të themeluar Prokurorial, duke saktësuar që prokurorët të cilët në kohën e themelimit të këtij Këshilli, ishin anëtarë të KGJK-së, transferohen në KPK dhe mbesin aty deri në skadimin e natyrshëm të mandateve të tyre. Ngjashëm, Ligji i vitit 2015, i cili, ndër tjerash, kishte përcaktuar disa ndryshime në përbërjen e KPK-së, siç është shtjelluar më sipër, përkatësisht (i) kishte shtuar pesë (5) anëtarë prokurorë në përbërje të KPK-së; (ii) kishte eliminuar përfaqësimin *ex-officio* të Ministrit të Drejtësisë në Këshill; dhe (iii) kishte ndryshuar mënyrë e zgjedhjes së tre (3) anëtarëve jo-prokuror, duke e saktësuar zgjedhjen e anëtarëve jo-prokurorë nga Kuvendi në mënyrën e saktësuar me këtë ligj, por në nenin 6 [pa titull] të tij, kishte saktësuar vazhdimin e mandateve ekzistuese, duke përcaktuar që vendet në KPK që lirohen para skadimit të mandatit të një anëtari, plotësohen në të njëjtën mënyrë si për anëtarin të cilit i ka skaduar mandati dhe se të njëjtit, përveç Kryeprokurorit të Shtetit, emërohen apo zgjedhen me një mandat të plotë pesë (5) vjeçar. Në fund, dhe sa i përket Ligjit të vitit 2019, i cili nuk kishte ndryshuar strukturën e KPK-së, por vetëm mënyrën e administrimit të konkursit për zgjedhjen e anëtarit të shoqërisë civile, në nenin 36 (Qëndrimi në detyrë) të tij, kishte përcaktuar, ndër tjerash, që anëtarët e zgjedhur të KPK-së, që ushtrojnë këtë funksion në kohën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, mund të qëndrojnë në detyrë deri në mbarim të mandateve të tyre aktuale.

3. Parimet që burojnë nga Raportet dhe Opinionet e Komisionit të Venecias dhe Këshillit të Evropës

188. Gjykata më poshtë do të paraqesë pjesë të shkëputura, relevante për rrethanat e rastit konkret, nga dokumentet tematike të Komisionit të Venecias dhe Këshillit të Evropës, që trajtojnë në mënyrë të veçantë çështjet që kanë të bëjnë me sistemin prokurorial. Gjykata do të paraqesë dokumentet si vijon: (i) Raportin mbi Standardet Evropiane përkitazi me Pavarësinë e Sistemit Gjyqësor: Pjesa II – “*Shërbimi i Prokurorisë*”, i miratuar nga Komisioni i Venecias në seancën e tij të 85-të plenare më 17-18 dhjetor 2010; (ii) “*Roli i Prokurorisë Publike në Sistemin e Drejtësisë Penale*”, Rekomandimi Rec (2000) 19, i miratuar nga Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës më 6 tetor 2000 dhe Memorandumi Shpjegues; (iii) Opinionet nr. 9 (2014) dhe nr. 13 (2018) të Këshillit Konsultativ të Prokurorëve Evropian; dhe (iv) Përmbledhjen e Opinioneve dhe Raporteve të Komisionit të Venecias lidhur me Prokurorët CDL-PI(2022)23, publikuar më 26 prill 2022, e cila përmban edhe disa referenca në dy Opinionet e Komisionit të Venecias përkitazi me Ligjin e kontestuar.

- (i) Raporti mbi Standardet Evropiane përkitazi me Pavarësinë e Sistemit Gjyqësor: Pjesa II – “*Shërbimi i Prokurorisë*”, i miratuar nga Komisioni i Venecias në seancën e tij të 85-të plenare më 17-18 dhjetor 2010
189. Raporti mbi Standardet Evropiane përkitazi me Pavarësinë e Sistemit Gjyqësor: Pjesa II – “*Shërbimi i Prokurorisë*”, i miratuar nga Komisioni i Venecias në seancën e tij të 85-të plenare më 17-18 dhjetor 2010 (në tekstin e mëtejme: Raporti mbi Shërbimin e Prokurorisë ose Raporti), fillimisht thekson se sistemet e drejtësisë penale ndryshojnë në mbarë Evropën dhe Botën. Në këtë aspekt, Raporti thekson gjithashtu se “*shumëllojshmëria në sistemet e ndjekjes penale mund të duket arbitrare dhe pa formë, por në realitet ajo formësohet nga dhe pasqyron shumëllojshmërinë e vetë sistemeve të drejtësisë penale. Është e mundur të identifikohen tipare dhe vlera që janë të përbashkëta për pothuajse të gjitha sistemet moderne të drejtësisë penale*” (paragrafi 10). Në këtë aspekt dhe për aq sa është e rëndësishme për rrethanat e rastit në fjalë, në kapitullin VII, Raporti adreson “*Modelet kryesore të organizimit të shërbimit të prokurorisë*”. Lidhur me këtë të fundit, Raporti, ndër të tjera, qartëson (i) shumëllojshmërinë e modeleve për sa i përket shërbimit të prokurorisë; (ii) tendencat drejt pavarësisë së tyre; dhe (iii) dallimet përkatëse me sistemin gjyqësor.
190. Në lidhje me të parën, Raporti, ndër të tjera, pohon se “*tekstet kryesore të referencës lejojnë sisteme, ku sistemi i prokurorisë nuk është i pavarur nga ekzekutivi dhe sa i përket sistemeve të tilla, përqendrohen në nevojën për garanci në nivel të rastit individual, ashtu që të ketë transparencë lidhur me çdo udhëzim që mund të jepet*” (paragrafi 23). Megjithatë, gjithashtu në paragrafin 24 të Raportit theksohet se “*për vite të tëra, fushëveprimi ose shkalla e pavarësisë që duhet të gëzojë prokuroria, ka ngjallur diskutime. Kjo rrjedhë në një masë të madhe nga fakti se standardet evropiane lejojnë dy mënyra të ndryshme për të zgjidhur pozicionin e prokurorisë përballë organeve të tjera shtetërore:*
- “Legjislacioni evropian është i ndarë në këtë çështje kyçe midis sistemeve nën të cilat zyra e prokurorit publik gëzon pavarësi të plotë nga Parlamenti dhe Qeveria dhe ato ku prokuroria është në varësi të njërit apo tjetrit prej këtyre autoriteteve, ndërkohë që megjithatë, gëzon njëfarë shkalle të fushëveprimit për veprim të pavarur. Si koncept mbizotërues, mund të shihet se në situatën aktuale, vetë nocioni i harmonizimit evropian rreth një koncepti të vetëm të prokurorisë, duket i parakohshëm.”*
191. Thënë këtë dhe në kontekstin e së dytës, përkatësisht tendencës drejt sistemeve më të pavarura të prokurorisë, Raporti mbi Shërbimin e Prokurorisë, ndër të tjera, vëren se (i) “*megjithatë, vetëm disa nga vendet që i përkasin Këshillit të Evropës kanë një prokurori që është pjesë formuese e autoritetit ekzekutiv dhe në vartësi të Ministrisë së Drejtësisë (p.sh. Austria, Danimarka, Gjermania, Holanda). Komisioni vëren se ekziston një tendencë e përhapur për të lejuar një prokurori më të pavarur, në vend të një prokurorie të varur apo të lidhur me ekzekutivin. [...]*” (paragrafi 26); dhe (ii) “*tendencë e përshkruar më sipër është e dukshme jo vetëm midis shteteve anëtare të Këshillit të Evropës të së drejtës civile (kontinentale), por edhe në botën e të drejtës anglo-saksone*” (paragrafi 27).
192. Ndërsa sa i përket të tretës, përkatësisht dallimit me sistemin gjyqësor, Raporti mbi Shërbimin e Prokurorisë, ndër të tjera, vëren se “*përveç këtyre tendencave, ka një dallim thelbësor se si perceptohet koncepti i pavarësisë apo autonomisë kur zbatohet te gjyqtarët në krahasim me prokurorinë. Edhe kur është pjesë e sistemit gjyqësor, prokuroria nuk është gjykatë. Pavarësia e gjyqësorit dhe ndarja e tij nga autoriteti ekzekutiv është një gurthemel i sundimit të ligjit, nga i cili nuk mund të ketë përjashtime. [...] Megjithatë, pavarësia apo autonomia e prokurorisë, nuk është aq*

katégorike në natyrë sa ajo e gjykatave. Edhe kur prokuroria si institucion është e pavarur, aty mund të ketë një kontroll hierarkik të vendimeve dhe veprimtarive të prokurorëve, përpos të Prokurorit të Përgjithshëm” (paragrafi 28).

193. Në pjesët VIII dhe IX, Raporti mbi Shërbimin e Prokurorisë adreson “Prokurorin e Përgjithshëm” dhe “Prokurorët tjerë”, respektivisht. Në të dyja kategoritë, Raporti adreson (i) emërimin dhe shkarkimin; (ii) llogaridhënien publike; (iii) disiplinën; (iv) garancitë për mosndërhyrje në punën e prokurorëve tjerë; dhe (v) imunitetin, kufizimin dhe sigurinë (shih, paragrafët 23-33 dhe 47-63).
194. Në fund, Raporti mbi Sistemet Prokuroriale adreson edhe Këshillat Prokurorial, që është aspekti më domethënës i rrethanave të rastit konkret, kështu që Gjykata do të paraqesë më poshtë paragrafët 64 deri 68 të Raportit në tërësinë e tyre:

“64. Një Këshill Prokurorial po bëhet gjithnjë e më i përhapur në sistemet politike të shteteve individuale. Një numër vendesh kanë krijuar këshilla prokurorial, por nuk ka asnjë standard për ta bërë këtë.

65. Nëse ato janë të përbërë në mënyrë të balancuar, p.sh. nga prokurorët, juristët dhe shoqëria civile dhe kur janë të pavarur nga organet e tjera shtetërore, këshillat e tillë kanë përparësinë e të qenit në gjendje të japin kontributin e vlefshëm si ekspertë në procesin e emërimit dhe disiplinimit dhe kështu t’i mbrojnë ata [prokurorët], sado pak nga ndikimi politik. Në varësi të mënyrës së emërimit të tyre, ata mund të ofrojnë legjitimitet demokratik për sistemin e prokurorisë. Aty ku ekzistojnë, përveç pjesëmarrjes në emërimin e prokurorëve, ata [këshillat prokurorial] shpesh luajnë një rol edhe në disiplinim, duke përfshirë shkarkimin e prokurorëve.

66. Aty ku ekziston, përbërja e një Këshilli Prokurorial duhet të përfshijë prokurorë nga të gjitha nivelet, por edhe akterë të tjerë si juristë apo përfaqësues të akademisë. Nëse anëtarët e një këshilli të tillë do të zgjedheshin nga Parlamenti, preferohet që kjo zgjedhje të bëhet me shumicë të kualifikuar. Nëse këshillat prokurorial dhe gjyqësor janë një trup i vetëm, do të duhej të sigurohet që gjyqtarët dhe prokurorët të mos mund të mbivotojnë grupin tjetër në emërimet dhe procedurat disiplinore të njëri-tjetrit, sepse për shkak të ‘punës prokuroriale’ të tyre të përditshme, prokurorët mund të kenë një qëndrim të ndryshëm nga gjyqtarët për pavarësinë gjyqësore dhe veçanërisht për procedurat disiplinore. Në atë rast, Këshilli mund të ndahet në dy dhoma, sikurse në Francë, ku Këshilli i Lartë i Magjistraturës qëndron në dy dhoma, të cilat janë kompetente përkatësisht për gjyqtarët dhe prokurorët.

67. Efektet e vendimeve të këshillave prokurorial mund të jenë të ndryshme. Vendimet e tyre mund të kenë efekt të drejtpërdrejtë te prokurorët ose mund të jenë vetëm të natyrës këshilluese, duke kërkuar kështu zbatimin e tyre nga Ministria e Drejtësisë. E para është për t’u preferuar, sepse e heq diskrecionin nga Ministria dhe lë më pak mundësi për ndërhyrje politike në karrierat e prokurorëve.

68. Do të ishte e vështirë të imponohej një model i vetëm i një këshilli të tillë në të gjitha shtetet e Këshillit të Evropës. Për më tepër, ekzistenca e një Këshilli të tillë nuk mund të konsiderohet si një standard uniform i detyrueshëm për të gjitha shtetet evropiane”.

- (ii) *“Roli i Prokurorisë Publike në Sistemin e Drejtësisë Penale”*, Rekomandimi Rec (2000) 19, i miratuar nga Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës më 6 tetor 2000 dhe Memorandumi Shpjegues
195. *“Roli i Prokurorisë Publike në Sistemin e Drejtësisë Penale”*, Rekomandimi Rec (2000) 19, i miratuar nga Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës më 6 tetor 2000 dhe Memorandumi Shpjegues (në tekstin e mëtejme: Rekomandimi Rec (2000)19 ose Rekomandimi), adreson (i) funksionet e prokurorit publik; (ii) garancitë e ofruara për prokurorët publikë për kryerjen e funksioneve të tyre; (iii) marrëdhëniet ndërmjet prokurorëve publikë dhe pushtetit ekzekutiv dhe legjislativ; (iv) marrëdhëniet ndërmjet prokurorëve publikë dhe gjyqtarëve; (v) marrëdhëniet ndërmjet prokurorëve publikë dhe policisë; (vi) detyrat e prokurorit publik ndaj individëve; dhe (vii) bashkëpunimin ndërkombëtar. Në pikën 14 të Rekomandimit përkatës dhe në adresimin e atyre sistemeve në të cilat sistemi i prokurorisë publike është i pavarur nga pushteti ekzekutiv, Rekomandimi thekson: *“Në vendet ku prokuroria publike është e pavarur nga qeveria, shteti duhet të marrë masa efektive për të garantuar që natyra dhe fushëveprimi i pavarësisë së prokurorisë publike të përcaktohet me ligj”*. Në lidhje me këtë çështje, Memorandumi Shpjegues shpjegon më tej se *“Kur prokurori publik është i pavarur nga autoriteti ekzekutiv, natyra dhe shtrirja e kësaj pavarësie duhet të përcaktohet me ligj në mënyrë që të përjashtohen (a) praktikat joformale që mund të dëmtojnë atë parim dhe (b) çdo rrezik të devijimit drejt interesit vetjak nga vetë prokurorët publikë”*.
- (iii) Opinioni nr. 9 (2014) i Këshillit Konsultativ të Prokurorëve Evropianë për Komitetin e Ministrave të Këshillit të Evropës për normat dhe parimet evropiane në lidhje me prokurorët (Karta e Romës) dhe Opinioni nr. 13 (2018) i Këshillit Konsultativ të Prokurorëve Evropianë për pavarësinë, llogaridhënien dhe etikën e prokurorëve
196. Karta e Romës, ndër të tjera, vlerëson se (i) *“pavarësia dhe autonomia e shërbimeve të prokurorisë përbën një ndërlidhje të domosdoshme me pavarësinë e gjyqësorit, prandaj, duhet të inkurajohet tendenca e përgjithshme për të rritur pavarësinë dhe autonominë efektive të shërbimeve të prokurorisë”* (pika IV); (ii) *“GJEDNJ e konsideroi të nevojshme të theksojë se “në një shoqëri demokratike, si gjykatat ashtu edhe autoritetet hetimore duhet të jenë të lira nga presioni politik”. Nga kjo rezulton se prokurorët duhet të jenë autonomë në vendimmarrje dhe duke bashkëpunuar me institucionet e tjera, duhet të kryejnë detyrat e tyre përkatëse pa presione apo ndërhyrje të jashtme nga pushteti ekzekutiv apo parlamenti, duke pasur parasysh parimet e ndarjes së pushteteve dhe llogaridhënies. GJEDNJ gjithashtu iu referua çështjes së pavarësisë së prokurorëve në kontekstin e “garancive të përgjithshme siç janë garancitë që sigurojnë pavarësinë funksionale të prokurorëve nga hierarkia e tyre dhe kontrolli gjyqësor i akteve të shërbimit të prokurorisë”* (paragrafi 34); dhe (iii) *“mënyra e emërimit dhe shkarkimit të Prokurorit të Përgjithshëm luan një rol të rëndësishëm në sistemin që garanton funksionimin e drejtë të prokurorisë”* (paragrafi 55).
197. Opinioni nr. 13, ndër të tjera, vlerëson se (i) *“duke pasur parasysh se shumë instrumente ndërkombëtare i janë kushtuar tashmë pavarësisë së prokurorëve, KKPE mbështetet veçanërisht në Opinionin e saj nr. 4 (2009) të titulluar “Gjyqtarët dhe prokurorët në një shoqëri demokratike” (Deklarata e Bordosë), miratuar së bashku me Këshillin Konsultativ të Gjyqtarëve Evropianë (KKGJE), dhe rikujton se pavarësia e prokurorisë publike është një rrjedhojë e domosdoshme për pavarësinë e gjyqësorit. KKPE i referohet gjithashtu Opinionit të saj Nr. 9 (2014) me titull “Normat dhe parimet evropiane në lidhje me prokurorët” Karta e Romës), ku thuhet se duhet të inkurajohet tendenca e përgjithshme për të rritur pavarësinë dhe autonominë efektive të shërbimeve të prokurorisë, prokurorët duhet të jenë autonomë në vendimmarrjen e*

tyre dhe të kryejnë detyrat e tyre pa presion ose ndërhyrje të jashtme” (paragrafi 3); (ii) “në vitet e fundit, GJEDNJ ka zhvilluar praktikë të rëndësishme gjyqësore në mbështetje të pavarësisë së prokurorëve, pavarësisht nëse konsiderohen apo jo autoritet gjyqësor. Prokurori që drejton dhe kontrollon fazën e parë të procedurës penale duhet të konsiderohet "mbrojtës i avancuar i të drejtave të njeriut" dhe ky rol thelbësor duhet të luhet gjatë gjithë procesit” (paragrafi 7); (iii) “duke marrë parasysh afërsinë dhe natyrën plotësuese të misioneve të gjyqtarëve dhe prokurorëve, si dhe të kërkesave në lidhje me statusin dhe kushtet e tyre të shërbimit, prokurorët duhet të kenë garanci të ngjashme me ato për gjyqtarët” (paragrafi 14); (iv) “prokurorët duhet të jenë të pavarur në statusin dhe sjelljen e tyre, ata duhet të gëzojnë pavarësi të jashtme, përkatësisht përballë ndërhyrjeve të padrejta ose të paligjshme nga autoritetet e tjera publike ose jo publike, p.sh. partitë politike dhe ata duhet të gëzojnë pavarësinë e brendshme dhe duhet të jenë në gjendje të kryejnë lirisht funksionet e tyre dhe të vendosin, edhe nëse modalitetet e veprimit ndryshojnë nga një sistem juridik në tjetrin, sipas marrëdhënieve me hierarkinë” (paragrafi 31); dhe (v) “duhet të miratohen dispozitat e përkatëse në shtetet anëtare, paralelisht me pavarësinë e gjyqtarëve, për të forcuar pavarësinë, llogaridhënien dhe etikën e prokurorëve, qoftë në fushën e së drejtës penale apo në lidhje me fushat e tjera të kompetencës së tyre. Ndikimi politik nuk duhet të jetë i pranueshëm” (rekomandimet, pika i).

(iv) *Përmbledhja e Opinioneve dhe Raporteve të Komisionit të Venecias lidhur me Prokurorët CDL-PI(2022)23, publikuar më 26 prill 2022*

198. Përmbledhja e Opinioneve dhe Raporteve të Komisionit të Venecias lidhur me Prokurorët CDL-PI(2022)23, publikuar më 26 prill 2022 (në tekstin e mëtejshëm: Përmbledhja e Komisionit të Venecias për Prokurorët), përmban pjesë të shkëputura të opinioneve, raporteve e hulumtimeve të miratuara ndër vite nga Komisioni i Venecias lidhur me prokurorët, duke përfshirë pjesë të caktuara të Opinionit të parë dhe të dytë të Komisionit të Venecias përkitazi me Ligjin e kontestuar. Ky dokument trajton parimet kryesore të vendosura përmes Opinioneve dhe Raporteve të Komisionit të Venecias, në fusha që përfshijnë, por nuk kufizohen në (i) pavarësinë kundrejt autonomisë së shërbimit të prokurorisë; (ii) nivelin e rregullimit: Kushtetuta, Legjislacioni, Dekretet dhe Vetërregullimi; (iii) funksionet dhe kompetencat e shërbimit prokurorial; (iv) statusin e prokurorëve; (v) konfliktin e interesit dhe papajtueshmëritë; dhe (vi) Këshillin Prokurorial.
199. Në vijim, Gjykata do të përmbledhë parimet kryesore të përvijuara në këtë Përmbledhje, për aq sa ato janë të rëndësishme për rrethanat e rastit në fjalë, të paraqitura sipas strukturës dhe grupimit tematik të kësaj Përmbledhjeje, përkatësisht (i) pavarësinë dhe autonominë; (ii) Këshillat Prokurorial, duke përfshirë ekuilibrin ndërmjet anëtarëve prokurorë dhe jo-prokurorë; dhe (iii) mandatin, përkatësisht mandatin e anëtarëve të Këshillit Prokurorial dhe përfundimin e parakohshëm të mandatit përkatës.
200. Duke iu referuar parimeve kyçe që kanë të bëjnë me fushat e përshkruara më sipër, Gjykata do t'i referohet Opinioneve dhe Raporteve të Komisionit të Venecias, duke përfshirë por pa u kufizuar në (i) Opinionin e parë mbi Ligjin e kontestuar; (ii) Opinionin e dytë mbi Ligjin e kontestuar; (iii) Opinionin mbi Konceptin rregullator të Kushtetutës së Republikës Hungareze; (iv) Opinionin për draft-amendamentet e Ligjit për Prokurorinë Publike të Serbisë; (v) Opinionin mbi Aktin për Sistemin Gjyqësor të Bullgarisë; (vi) Opinionin për dispozitat për Këshillin Prokurorial në Projektligjin Organik për Prokurorinë dhe për dispozitat për Këshillin e Lartë të Drejtësisë në Ligjin Organik ekzistues për Gjykatat e Përgjithshme të Gjeorgjisë; (vii) Opinionin e përbashkët të Komisionit të Venecias, Këshillit Konsultativ të Prokurorëve Evropianë (KKPE) dhe Zyrës së OSBE-së për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (OSBE/ODIHR), për draft-amendamentet e Ligjit për Prokurorinë e Gjeorgjisë; (viii)

Opinionin lidhur me Aktin për Prokurorinë Publike të Polonisë; (ix) Opinionin mbi Projektligjin për Shërbimin e Prokurorëve Publikë të Moldavisë; dhe (x) Opinionin mbi Projektligjin për ndryshimin e Ligjit për Zyrën e Prokurorit Publik të Ukrainës.

a) *Sa i përket pavarësisë dhe autonomisë*

CDL-AD(2015)039, Opinion i Përbashkët i Komisionit të Venecias, Këshillit Konsultativ të Prokurorëve Evropianë (KKPE) dhe Zyrës së OSBE-së për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (OSBE/ODIHR), lidhur me Projekt-amendamentet në Ligjin për Prokurorinë e Gjeorgjisë

16. Megjithatë, ekzistojnë disa standarde dhe rekomandime më të detajuara. Kështu, Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës, u kërkon shteteve anëtare të sigurojnë që prokurorët publikë janë të lirë nga 'ndërhyrja e pajustificuar' në aktivitetet e tyre profesionale. Karta e Romës, e miratuar nga KKPE më 2014, shpall parimin e pavarësisë dhe autonomisë së prokurorëve, ndërsa KKPE inkurajon tendencën e përgjithshme drejt pavarësisë më të madhe të sistemit prokurorial. Në shumë shtete anëtare të Këshillit të Evropës, mund të vërehet një tendencë për t'i dhënë më shumë pavarësi prokurorisë, veçanërisht në lidhje me vendimet e marra nga prokuroria në rastet penale. [...] Komisioni i Venecias thekson më tej se në shumë vende "nënshtrimi i prokurorisë ndaj autoritetit ekzekutiv, është më shumë çështje parimore sesa realitet, në kuptimin që ekzekutivi është në fakt veçanërisht i kujdesshëm për të mos ndërhyrë në raste individuale". Thënë kjo, një tendencë e përgjithshme për t'i dhënë më shumë pavarësi shërbimit të prokurorisë, nuk është transformuar ende në një rregull detyrues që zbatohet në mënyrë uniforme në tërë Evropën.

CDL(1995)073rev, Opinion lidhur me Konceptin rregullator të Kushtetutës së Republikës Hungareze

Parimi themelor që duhet të udhëheqë sistemin e prokurorisë publike në një shtet është pavarësia e plotë e sistemit, asnjë shqyrtim administrativ apo konsideratë tjetër, nuk është aq e rëndësishme sa ky parim. Vetëm aty ku pavarësia e sistemit garantohet dhe mbrohet me ligj, publiku do të ketë besim në sistemin që është thelbësor në çdo shoqëri të shëndoshë. (kapitulli 11, f. 6)

b) *Sa i përket Këshillave Prokurorial*

CDL-AD(2019)034, Republika e Moldavisë - Përmbledhje Amicus Curiae për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Moldavisë lidhur me amendamentet e Ligjit për Prokurorinë

40. Nëse një amendament legjislativ është miratuar për të penguar KLP-në (Këshilli i Lartë i Prokurorisë) të nominojë një kandidat të caktuar, ose që të sigurojë që disa persona të caktuar mund ose nuk mund të marrin pjesë në konkursin e ri, ose për ndonjë arsye të papërshtatshme, kjo mund të cenojë "ndarjen e punës" kushtetuese ndërmjet ligjvënësit (detyra kryesore e të cilit është miratimi i rregullave të zbatimit të përgjithshëm) dhe KLP-së (detyra kryesore e të cilit, në këtë kontekst, është të zgjedhë kandidatët e duhur për pozitën prokuroriale). Kjo do t'i ngjasonte legjislacionit ad hominem (të drejtuar ndaj një personi të caktuar) të kritikuar më parë nga Komisioni i Venecias.

41. Komisioni i Venecias pranon, në të njëjtën kohë, se një ligjvënës mund të ketë arsye të forta për të ndërhyrë në një procedurë rekrutimi në zhvillim e sipër, e cila është jashtëzakonisht e padrejtë, joefikase, diskriminuese etj. Duke ripërcaktuar kriteret e përshtatshmërisë dhe duke ridizajnuar rregullat procedurale,

legjislativioni i ri mund të përjashtojë disa kandidatë nga konkursi ose të hapë rrugën për kandidatë të rinj, që përndryshe nuk kualifikoheshin ose të rrisë/ulë mundësitë e tyre për sukses. Prandaj, çështja nëse një ndërhyrje e tillë legjislative në një procedurë në zhvillim e sipër është e lejueshme me Kushtetutë, nuk ka një përgjigje të thjeshtë dhe kategorike. Me shumë mundësi, për t'iu përgjigjur kësaj pyetjeje, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Moldavisë do të duhet të vendosë nëse ndërhyrja legjislative ishte e justifikuar nga konsideratat të rëndësishme të interesit publik apo nëse ndjek arsye të fshehta.

- c) *Në lidhje me ekuilibrin e anëtarëve prokurorë dhe jo-prokurorë në Këshilla Prokurorial*

CDL-AD(2021)051, Kosova – Opinion lidhur me Projekt-amendamentet e Ligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës

25. [...] Në përbërjen e re të KPK-së, prokurorët “e zgjedhur nga kolegët e tyre” do të jenë në shkallë të lehtë në pakicë (tre nga shtatë anëtarët). Katër anëtarë zgjedhen nga Kuvendi. Një nga ta duhet të jetë prokuror, por meqë mandatin e tij ia detyron Kuvendit, sipas mendimit të Komisionit të Venecias, ky anëtar duhet të konsiderohet më përpara si “anëtar jo-prokuror” (për dallim nga “anëtarët prokurorë” që zgjedhen nga kolegët e tyre).

26. [...] Ka një dallim të rëndësishëm në mes të standardeve që u përkasin këshillave prokurorial dhe atyre rreth këshillave gjyqësor. Përderisa prokurorët duhet të jenë të mbrojtur nga ndërhyrjet politike dhe përderisa një këshill prokurorial mund të ofrojë mbrojtje të tillë, nuk ka ndonjë kërkesë që ky këshill të jetë medoemos i dominuar nga prokurorët. Komisioni i Venecias ka avokuar vazhdimisht që këshillat prokurorial, në të cilët prokurorët që përzgjedhen nga kolegët e tyre, të përfaqësojnë një “pjesë substanciale”, por që jo patjetër të përbëjnë shumicën e anëtarëve.

55. [...] Mandati i anëtarëve aktualë, do të përfundohet sapo anëtarët e rinj jo-prokurorë të zgjedhen nga Kuvendi. [...]

56. Këto dispozita kalimtare ngrisin dy shqetësime madhore. Së pari, “KPK-ja e reduktuar”, do të jetë e përbërë ekskluzivisht nga anëtarë jo-prokurorë, të zgjedhur me shumicë të thjeshtë në Kuvend. [...] Më e rëndësishmja, kjo përbërje mund të vendosë rreth zgjedhjes së Kryeprokurorit të ri, që do të zhvillohet në fillim të vitit 2022. Për më tepër, “KPK-ja e reduktuar” mund të zëvendësojë kryesuesin e Sekretarisë së KPK-së dhe kështu të sigurojë kontrollë të Komisionit Zgjedhor, që mbikëqyrë procesin e zgjedhjes së anëtarëve prokurorë.

58. Sipas mendimit të Komisionit të Venecias, amendamentet e propozuara bien në kundërshtim me standardet ndërkombëtare dhe evropiane: efektivisht largojnë prokurorët nga qeverisja e sistemit në momentin më kritik, kur Kryeprokurori dhe anëtarët prokurorë kanë për tu zgjedhur.

CDL-AD(2022)006, Kosova – Opinion mbi Projekt-amendamentet e rishikuara të Ligjit për Këshillin Prokurorial

11. Drafti i rishikuar propozon përbërjen e KPK-së si vijon: nga shtatë anëtarët, tre do të jenë prokurorë të përzgjedhur nga kolegët e tyre (dy nga prokuroritë e ulëta dhe një nga Prokuroria e Apelit ose Prokuroria Speciale), tre do të jenë anëtarë jo-prokurorë (një i zgjedhur nga Avokati i Popullit dhe dy të zgjedhur nga Kuvendi, me shumicë të thjeshtë), dhe Kryeprokurori do të jetë anëtar sipas

detyrës zyrtare. Kështu, në përbërjen e ardhshme të KPK-së, prokurorët do të marrin sërish shumicën, bashkë me Kryeprokurorin, çka nuk është kundër standardeve.

12. [...] Drafti i rishikuar kthen te një model ku KPK-ja është e dominuar nga prokurorët. Për më tepër, drafti i rishikuar parasheh që një nga anëtarët jo-prokurorë të emërohet drejtpërdrejtë nga Avokati i Popullit. Komisioni i Venecias supozon se institucioni i Avokatit të Popullit mund të shihet si trup i pavarur në rendin juridik të Kosovës. [...] Në këtë përbërje, fakti se dy anëtarët jo-prokurorë të mbetur, zgjedhen me shumicë të thjeshtë në Kuvend, e zvogëlon rrezikun nga politizimi i KPK-së.

15. Neni 12 i draftit të rishikuar (që amendamenton nenin 15 2a të ligjit ekzistues dhe përcakton kërkesën për një “shumicë speciale”) tërheq vëmendjen për një vërejtje tjetër të rëndësishme. Megjithëse nuk lejon anëtarët prokurorë të qeverisin të vetëm (që është pozitive), në të njëjtën kohë, mekanizmi i një “shumice speciale” ngërthen një rrezik të qenësishëm për bllokim, nëse anëtarët e emëruar nga Kuvendi votojnë bashkërisht dhe bllokojnë vendime të caktuara, përfshirë vendimin për të zgjedhur Kryeprokurorin e ri. Prandaj, do të ishte e këshillueshme që të parashihet një mekanizëm deblokues për ato raste të cilat do të lejonin KPK-në të marrë ato vendime për të cilat anëtarët prokurorë dhe jo-prokurorë nuk mund të gjejnë një kompromis. Parametrat e posaçëm për një mekanizëm të tillë deblokues mund të identifikohen nga ligjvënësi, në dialog me partnerët ndërkombëtarë dhe palët kryesore të interesit.

CDL-AD(2021)030, Mali i Zi - Opinion Urgjent lidhur me Projekt-amendamentet e rishikuara të Ligjit për Shërbimin e Prokurorisë Shtetërore

13. Rekomandimi i dytë kryesor kishte të bënte me përbërjen e re të parashikuar të KP-së (Këshillit Prokurorial), ku anëtarët jo-prokurorë të zgjedhur nga Parlamenti me shumicë të thjeshtë, ishin më të shumtë në numër se prokurorët e përzgjedhur nga kolegët e tyre (5 me 4). Shumica e anëtarëve jo-prokurorë në krahasim me prokurorët, nuk ishte si e tillë në kundërshtim me standardet evropiane dhe mund të justifikohet në mënyrë që të shmangej korporatizmi. Megjithatë, duke qenë se të gjithë anëtarët jo-prokurorë do të zgjedheshin nga Parlamenti me shumicë të thjeshtë në të njëjtën kohë, pra nga e njëjta shumicë politike, ekzistonte rreziku serioz që KP të politizohej edhe më tej. Për të shmangur një rrezik të tillë, Komisioni i Venecias propozoi disa alternativa:

- zgjedhja e anëtarëve jo-prokurorë nga Parlamenti me shumicë të kualifikuar (me një mekanizëm efektiv kundër bllokimit);
- zgjedhja e anëtarëve jo-prokurorë nga Parlamenti në bazë të sistemit proporcional (në mënyrë që anëtarët jo-prokurorë të përfaqësojnë forca të ndryshme politike);
- nominimi apo edhe emërimi i drejtpërdrejtë nga akterë të jashtëm joqeveritar (si universitetet, avokatia, gjyqësori, etj.).

65. [...] [Është e nevojshme të sigurohet që Këshilli Prokurorial nuk duhet të politizohet. Komisioni nuk konsideron se zgjedhja nga Parlamenti me shumicë të thjeshtë përputhet me neutralitetin politik ose të paktën pluralizmin. Kur sistemet e votimit me shumicë të kualifikuar ose proporcionale nuk paraqesin një zgjidhje të pranueshme, shumica e thjeshtë mund të pranohet si zgjidhje kalimtare vetëm nëse shoqërohet me garanci solide shtesë dhe masa mbrojtëse.

36. Çfarë është e rëndësishme që Këshilli Prokurorial t'i shpëtojë dy rreziqeve: korporatizmit dhe politizimit. Tani anëtarët jo-prokurorë janë pakicë, gjë që mund të çojë në dominimin e prokurorëve dhe rrjedhimisht, në qeverisjen korporatiste. Ky rrezik është më i shprehur në këshillat prokurorial sesa në këshillat gjyqësor për shkak të organizimit hierarkik të sistemeve prokuroriale dhe kulturës së vartësisë që rezulton, që anëtarët prokurorë të këtyre këshillave të votojnë në bllok së bashku me PP-në (Prokurorin e Përgjithshëm). Nga ana tjetër, rritja e kuotës së anëtarëve jo-prokurorë mund të sjellë politizimin dhe mungesën e pavarësisë, duke qenë se të gjithë anëtarët jo-prokurorë zgjedhen njëkohësisht (pra nga i njëjti Parlament) dhe me shumicë të thjeshtë.

37. Ekzistojnë disa mënyra të mundshme për të shmangur ose të paktën zvogëluar rrezikun e politizimit. [...] Në teori, kërkesa për shumicë të kualifikuar duhet të ndihmojë në zgjedhjen e një kandidati që gëzon besimin e forcave të ndryshme politike dhe për këtë arsye është politikisht neutral. Megjithatë, zgjidhja e shumicës së kualifikuar mund të paraqesë mangësi. Para së gjithash, mund të çojë në quid pro quo politike, kur votat e dhëna nga opozita në mbështetje të një kandidati të shumicës, mund të shkëmbehen me disa koncesione të tjera. Nëse është kështu, kërkesa për shumicë të kualifikuar, nuk do të arrijë domosdoshmërisht objektivin e saj për të siguruar zgjedhjen e një figure politikisht neutrale. Përveç kësaj, siç tregon përvoja e Malit të Zi, mund të jetë praktikisht e vështirë të arrihet një marrëveshje politike. Kështu, një kërkesë për shumicë të kualifikuar, duhet të shoqërohet me një mekanizëm efektiv kundër bllokimit.

40. Një zgjidhje tjetër e mundshme është që nominimi i kandidatëve në këto pozita të bëhet nga shoqëria civile dhe/ose komuniteti juridik, Gjykata Supreme ose Këshilli Gjyqësor. Nëse Parlamenti duhet të zgjedhë në mesin e kandidatëve që kanë mbështetjen e disa institucioneve joqeveritare ose të pavarura, kjo mund të zvogëlojë disi rrezikun e politizimit (por jo ta heqë plotësisht, pasi gjithmonë ekziston rreziku i manipulimit të procesit të nominimit dhe ka një rrezik që OJQ-të që marrin pjesë në këtë proces, të mos jenë plotësisht neutrale politikisht ose jo mjaftueshëm përfaqësuese të shoqërisë civile në tërësi, dhe si rrjedhojë, nuk janë legjitime për të luajtur këtë rol).

41. Trupave të jashtëm mund tu jepet jo vetëm kompetenca për të nominuar kandidatë për pozitat e anëtarëve jo-prokurorë për zgjedhjen e tyre të ardhshme nga Parlamenti, por edhe kompetenca për të emëruar drejtpërdrejtë një numër të caktuar anëtarësh jo-prokurorë, për të bërë përbërjen e Këshillit Prokurorial më pluraliste.

42. Siç është theksuar më parë nga Komisioni i Venecias, në lidhje me mekanizmat de-bllokues, “çdo shtet duhet të hartojë formulën e vet”, e cila duhet të çojë në krijimin e një Këshilli Prokurorial pluralist, nëse anëtarët e përcaktuar politikisht nuk kanë një shumicë të qartë.

43. Kushtetuta e Malit të Zi nuk e përcakton përbërjen e Këshillit Prokurorial dhe as mënyrën e zgjedhjes së anëtarëve të tij, por ia lë këto çështje një ligji të zakonshëm. Komisioni i Venecias ka rekomanduar më parë që përbërja dhe kompetencat thelbësore të Këshillit Prokurorial të rrënjosen në Kushtetutë. Fatkeqësisht, ky rekomandim nuk është zbatuar në Mal të Zi. Në Opinionin e vitit 2015, Komisioni i Venecias gjithashtu sugjeroi që kërkesa për të pasur një shumicë të kualifikuar për zgjedhjen e anëtarëve jo-prokurorë, mund të futet në ligj dhe ky

rekomandim vazhdon të mbetet i vlefshëm. Ligjvënësi malazez duhet të konsiderojë të parashohë një prej mënyrave alternative për të siguruar depolitizimin, siç janë ato të përmendura më sipër. Megjithatë, çdo mekanizëm ligjor do të funksionojë vetëm nëse shoqërohet me vullnet politik. Një Parlament i ardhshëm, i dominuar nga një shumicë tjetër, mund të jetë e tunduar të përpiqet të fitojë kontrollin mbi anëtarët jo-prokurorë dhe, përmes tyre, mbi Këshillin Prokurorial. Rrjedhimisht, rekomandohet fuqishëm që të gjendet një zgjidhje më e qëndrueshme dhe që përbërja e Këshillit Prokurorial dhe mënyra e zgjedhjes së anëtarëve të tij, të përkruhen në vetë Kushtetutën – siç është bërë në rastin e Këshillit Gjyqësor.

59. Përbërja e re e parashikuar e Këshillit Prokurorial (i cili do të kishte një shumicë të lehtë anëtarësh jo-prokurorë) nuk është si e tillë drejtpërdrejtë në kundërshtim me standardet evropiane dhe mund të shpjegohet me nevojën për të shmangur korporatizmin. Megjithatë, në mjedisin aktual, ku të gjithë anëtarët jo-prokurorë zgjedhen në të njëjtën kohë, me shumicë të thjeshtë votash në Parlament, kjo reformë mund të çojë në politizimin e shtuar të Këshillit Prokurorial. Për ta shmangur këtë, autoritetet kanë një mori opsionesh. Për shembull, anëtarët jo-prokurorë mund të zgjedhen me shumicë të kualifikuar. Por në këtë rast, duhet të krijohet një mekanizëm efektiv deblokues. Një alternativë tjetër do të ishte zgjedhja e anëtarëve jo-prokurorë mbi bazën e një sistemi proporcional (në mënyrë që ata të përfaqësojnë forca të ndryshme politike) ose të parashikohet nominimi apo edhe emërimi i tyre i drejtpërdrejtë nga akterë të jashtëm joqeveritar (siç janë universitetet, avokatia, gjyqësori etj.). Në mënyrë ideale, përbërja dhe mënyra e zgjedhjes së anëtarëve jo-prokurorë, duhet të rrënjosen në Kushtetutë.

CDL-AD(2014)042, Mendim i përkohshëm në lidhje me Projektligjin për Prokurorinë e Shtetit të Malit të Zi

38. [...] Ekuilibri i propozuar për Këshillin, në të cilin prokurorët kanë një shumicë të lehtë, por që përmban një pakicë të konsiderueshme juristësh të shquar, gjithashtu duket të jetë i përshtatshëm. Është gjithashtu e mirëseardhur që kompetenca për të emëruar gjysmën e anëtarëve të Këshillit Prokurorial t'u jepet trupave të ndryshëm: kjo ndihmon që të shmanget një administrim korporatist i shërbimit të prokurorisë dhe mund t'i sigurojë atij një legjitimitet demokratik. Për më tepër, është e zgjuar që Ministri i Drejtësisë të mos jetë vetë anëtar, por është e arsyeshme që një zyrtar i asaj ministrie të marrë pjesë. Megjithatë, dikush mund të pyesë nëse dhjetë anëtarë, përveç kryetarit, nuk janë tepër shumë, pasi raportohet se ka vetëm 140 prokurorë shtetërorë në Mal të Zi.

CDL-AD(2015)039, Opinion i Përbashkët i Komisionit të Venecias, Këshillit Konsultativ të Prokurorëve Evropianë (KKPE) dhe Zyrës së OSBE-së për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (OSBE/ODIHR), mbi Projekt-amendamentet në Ligjin për Prokurorinë e Gjeorgjisë

33. [...] [Është shumë e rëndësishme që Këshilli Prokurorial të konceptohet si një organ pluralist, i cili përfshin deputetë, prokurorë, anëtarë të shoqërisë civile dhe një zyrtar të qeverisë. [...]]

35. Nëse Kryeprokurori zgjedhet dhe shkarkohet me shumicë të thjeshtë votash në Parlament (shih nenin, 91 par. 4 dhe nenin, 92 par. 12), bëhet edhe më e rëndësishme që Këshilli Prokurorial të ketë një komponent të mjaftueshëm jopolitik, për të penguar shumicën parlamentare të imponojë vullnetin e saj mbi këtë organ.

38. Është e mirëseardhur që një numër i konsiderueshëm i anëtarëve të Këshillit janë prokurorë të përzgjedhur nga kolegët e tyre (katër nga nëntë), dhe vihet re se në sisteme të caktuara, prokurorët mund të jenë edhe shumicë në trupa të tillë. [...]

CDL-AD(2018)029, Gjeorgji - Opinion lidhur me dispozitat për Këshillin Prokurorial në Projektligjin Organik për Prokurorinë dhe për dispozitat për Këshillin e Lartë të Drejtësisë në Ligjin Organik ekzistues për Gjykatat e Përgjithshme

33. [...] Këshilli Prokurorial përbëhet nga një shumicë prokurorësh të përzgjedhur nga kolegët e tyre. Kjo siguron përfaqësim dhe ekspertizë profesionale, por nuk rrit mjaftueshëm besueshmërinë publike të pavarësisë. Një përbërje e tillë ishte e përshtatshme para se Këshilli të merrte rolin e ri kushtetues që i ishte dhënë me nenin 65. 3 të Kushtetutës së re. Natyra vertikale e autoritetit brenda Prokurorisë dhe vartësia profesionale, siç parashihet me nenin 5 (d), cenon pavarësinë e shërbimit prokurorial. Ky boshllëk nuk plotësohet mjaftueshëm nga komponentët e tjerë të anëtarësisë së Këshillit, secili prej të cilëve mund të jetë i vlefshëm, por dizajni i përgjithshëm, nuk është i mjaftueshëm për të arritur pavarësinë. Autoritetet gjeorgjiane duhet të marrin parasysh një përfaqësim të zgjeruar nga shoqëria civile.

d) Përkitazi me anëtarët sipas detyrës zyrtare ose anëtarët e institucioneve të pavarura

CDL-AD(2021)051, Kosova – Opinion lidhur me Projekt-amendamentet e Ligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës

32. [...] Një numër i caktuar i vendeve në një këshill prokurorial, mund të rezervohen për përfaqësues të institucioneve të jashtme të pavarura (si Oda e Avokatëve, konferenca e fakulteteve të drejtësisë, Avokati i Popullit etj.) ose për shoqërinë civile. Në këtë model, është e nevojshme që të sigurohet se institucioni që delegon anëtarë jo-prokurorë, është me të vërtetë neutral (gjë që mund të jetë e vështirë për t'u arritur në një shoqëri të vogël dhe shumë të polarizuar politikisht), dhe/ose që anëtarët të delegohen nga OJQ-të që me të vërtetë përfaqësojnë shoqërinë civile.

37. [...] Në një shërbim prokurorial me organizim hierarkik, është e kuptueshme që Kryeprokurori duhet të marr pjesë në vendimet lidhur me emërimet, karrierën dhe disiplinën e prokurorëve, të ndikojë politikisht boxhetore dhe organizative dhe të marr pjesë në zhvillimin e standardeve dhe procedurave profesionale.

38. Sigurisht, Kryeprokurori nuk duhet të mund të marr këto vendime i vetëm – për këtë arsye janë krijuar këshillat prokurorial. Sidoqoftë, përjashtimi i tërësishëm i Kryeprokurorit nga KPK-ja mund të kundërshtohet, nëse barazpesha e propozuar në mes të anëtarëve prokurorë dhe jo-prokurorë do të ruhej.

[...]

Në përgjithësi, pjesëmarrja e Kryeprokurorit në një Këshill Prokurorial duhet të vlerësohet në formë abstrakte, por në dritën e disa faktorëve të veçantë për secilin shtet, posaçërisht:

- përbërjen e këshillit (nëse këshilli dominohet nga anëtarë prokurorë ose jo-prokurorë);
- organizimin e sistemit prokurorial (nëse është sistem hierarkik, me Kryeprokurorinë në majë, ose sistem i decentralizuar, ku prokurorët janë të

lidhur me gjykatat dhe nuk i nënshtrohen Kryeprokurorit nga pikëpamja procedurale dhe administrative);

- *kompetencat e këshillit (nëse vendosë në çështjet që kanë të bëjnë me disiplinën, karrierën e prokurorëve; çështjet buxhetore dhe organizative, etj., ose nëse ato kompetenca i përkasin trupave të tjerë);*
- *kompetencat vendimmarrëse të Kryeprokurorit brenda këshillit (pjesëmarrja me të drejtë vote ose vetëm në cilësi këshilldhënëse) dhe nëse ka masa mbrojtëse të mjaftueshme në mënyrën se si këshilli operon, në mënyrë që të kundërbalansohet qfarëdo ndikimi i tepërt i Kryeprokurorit brenda hierarkisë, etj..*

Nëse i kthehemi situatës në Kosovë, pjesëmarrja e Kryeprokurorit në KPK, nuk mund të kundërshtohet nëse Kryeprokurori nuk ka të drejtë vote ose nëse anëtarët prokurorë në KPK-në e reformuar, vazhdojnë të mbesin në pakicë edhe me Kryeprokurorin. Nëse Kryeprokurori vazhdon të mbetet në përbërjen e KPK-së si anëtar sipas detyrës zyrtare dhe me të drejtë vote, kjo mund të kërkojë rishikim të përbërjes së KPK-së në mënyrë që të ruhet barazpesha në mes të grupeve të ndryshme të anëtarëve. Shkurtimisht, është e rëndësishme që të shmanget ajo situatë kur Kryeprokurori, duke përdorur pozitën e tij përballë anëtarëve prokurorë (dhe madje edhe ndaj disa anëtarëve jo-prokurorë), të mund t'ia diktojë vullnetin e tij/saj KPK-së. Ngjashëm, ekzekutivi ose Presidenti, nuk duhet të jenë në pozitë që të dominojnë KPK-në – KPK duhet të mbetet një trup vet-qeverisës, i panështruar ndaj asnjë dege të pushtetit. Prandaj, nëse Kryeprokurori merr pjesë në KPK pa të drejtë vote, Ministri i Drejtësisë mund gjithashtu të marr pjesë pa të drejtë vote, ashtu që të barazpeshohet ndikimi në mes të ekzekutivit dhe sistemit prokurorial përbrenda këtij trupi.

CDL-AD(2015)039, Opinion i Përbashkët i Komisionit të Venecias, Këshillit Konsultativ të Prokurorëve Evropianë (KKPE) dhe Zyrës së OSBE-së për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (OSBE/ODIHR), mbi Projekt-amendamentet në Ligjin për Prokurorinë të Gjeorgjisë

45. [...] [S]ipas Projektligjit, shkalla e politizimit të Këshillit zvogëlohet nga fakti se dy nga katër anëtarët e zgjedhur nga Parlamenti, vijnë nga shoqëria civile dhe jo nga radhët e deputetëve. Megjithatë, këta kandidatë duhet megjithatë të marrin miratimin e shumicës qeverisëse (shih nenin 81, par 2 (d)), e cila mund të paracaktojë pozitën e tyre për tërë periudhën e shërbimit të tyre. Për t'i bërë këta persona më pak të varur nga vullneti i shumicës qeverisëse, është e nevojshme të vendosen garanci shtesë, të zbatuara si në fazën e nominimit ashtu edhe në atë të zgjedhjes së kandidatëve.

46. Para së gjithash, nominimi i anëtarëve të shoqërisë civile dhe akademisë (neni 81, par 2 (d)) duhet të bëhet në mënyrë transparente, me një proces të përzgjedhjes që ndjek rregulla dhe kritere të qarta, të cilat duhet të përcaktohen në Projektligj. Këtu mund të merren parasysh një sërë opsionesh. Një mundësi (opsioni më i thjeshtë) është që disa mbajtës të posteve të fitojnë anëtarësimin në Këshill automatikisht, p.sh. drejtuesi i fakultetit juridik ose kryetari i Odës së Avokatëve, mund të bëhen anëtarë të Këshillit Prokurorial sipas detyrës zyrtare, pa u zgjedhur nga Parlamenti.

47. Përveç kësaj, një opsion i mundshëm do të ishte emërimi i një ose më shumë anëtarëve të gjyqësorit në Këshillin Prokurorial. Gjyqtarët mund të sjellin ekspertizën e tyre praktike nga sistemi i drejtësisë penale në punën e Këshillit dhe gjithashtu, do të ndihmonin në rritjen e pavarësisë së këtij trupi dhe në këtë mënyrë, edhe në rritjen e besimit të publikut në punën e Këshillit. Një sërë

gjyqtarësh të mundshëm mund të merren parasysh për këtë pozitë, duke përfshirë kryetarët e gjykatave të caktuara (p.sh. Gjykata Supreme, gjykata e qytetit të Tbilisit dhe/ose gjykatat rajonale).

48. Një zgjidhje alternative, e cila i afrohet më shumë skemës së propozuar nga Projektligji, do të ishte dhënia e kompetencës për të nominuar një ose disa trupave të pavarura, jashtë Ministrisë së Drejtësisë ose Këshillit Prokurorial, siç është Këshilli i Lartë i Drejtësisë, Oda e Avokatëve, ose një organ që përfaqëson universitetet juridike dhe institucionet akademike. Në këtë proces, duhet t'i kushtohet vëmendje nevojës për të arritur ekuilibrin e duhur gjinor në mesin e kandidatëve. Kompetenca për të nominuar mund t'u jepet gjithashtu disa OJQ-ve të shquara, gjë që do të rrisë transparencën e Këshillit Prokurorial dhe besimin e publikut në autonominë e tij. Në rastet kur kompetenca për të nominuar kandidatin do t'u takonte akterëve të jashtëm, Parlamenti duhet të ruajë ende kompetencën për t'i miratuar ose jo ata.

50. Në fazën e zgjedhjeve nga Parlamenti është e rëndësishme të sigurohet që përbërja rezultuese e katër anëtarëve të Këshillit të zgjedhur nga Parlamenti, të mos jetë politikisht monolite. Për të arritur këtë, mund të konsiderohen dy zgjidhje alternative: zgjedhja me shumicë të kualifikuar ose vendosja e kuotave për opozitën.

51. Zgjedhja më radikale do të ishte të kërkohet që të paktën dy nga katër anëtarët e zgjedhur nga Parlamenti të zgjedhen me shumicë të kualifikuar (një anëtar që përfaqëson Parlamentin dhe një anëtar që përfaqëson shoqërinë civile). Kjo do të siguronte që të paktën dy anëtarë të Këshillit të zgjedhen si rezultat i një kompromisi, i cili do të kundërbalansonte disi ata dy anëtarë, zgjedhja e të cilëve varet më shumë nga mbështetja e shumicës qeverisëse dhe nga fakti që Ministri i Drejtësisë është anëtar i Këshillit sipas detyrës zyrtare.

52. Meqenëse një shumicë e tillë e kualifikuar mund të arrihet vështirë në kontekstin aktual politik në Gjeorgji, është e mundur gjithashtu një zgjidhje alternative: Projektligji mund të vendosë kuota për anëtarët e emëruar nga partitë opozitare. Kjo do të thotë se partitë opozitare duhet të kenë të drejtën të emërojnë të paktën një anëtar të Këshillit, pavarësisht nga numri i vendeve në Parlament. Duke pasur parasysh fuqinë aktuale relative të opozitës në Parlamentin gjeorgjian, opozitës madje mund t'i jepen dy vende nga katër: një për një deputet dhe një për një përfaqësues të shoqërisë civile të cilin opozita dëshiron ta emërojë. Cilado zgjidhje të përzgjidhet, shumica parlamentare do të kontrollonte sërish më shumë vende në Këshillin Prokurorial, për shkak të pjesëmarrjes së Ministrit të Drejtësisë, por ndikimi i saj vendimtar brenda Këshillit do të zvogëlohej dhe Këshilli do të bëhej më i balancuar politikisht; për të miratuar vendime të rëndësishme ose për t'i bllokuar ato, kandidatët e zgjedhur nga shumica parlamentare, do të duhet të marrin mbështetjen e atyre që zgjedhen me shumicë të kualifikuar ose të emëruar nga opozita, ose atyre anëtarëve që përzgjedhen nga Konferenca e Prokurorëve.

CDL-AD(2021)047, Republika e Moldavisë - Opinion për Amendamentet e 24 gushtit 2021 në Ligjin për Shërbimin e Prokurorisë

46. Sa i përket Avokatit të Popullit, është krejt e pazakontë që një mbrojtës i të drejtave të marrë pjesë në qeverisjen e sistemit të prokurorisë. Është e diskutueshme nëse funksionet e një anëtari të KLP-së [Këshillit të Lartë të Prokurorëve] janë në përputhje me mandatin e Avokatit të Popullit. Raportohet se në kontekstin moldav, Avokati i Popullit, vetë refuzoi të merrte pjesë në punën e

KLP-së. Thënë këtë, Avokati i Popullit, si një figurë politikisht neutrale, mund të shërbejë si arbitër ndërmjet anëtarëve prokurorë dhe anëtarëve jo-prokurorë të afërt me Qeverinë, kështu që pjesëmarrja e tij/saj në një këshill prokurorial mund të ndihmojë në shmangien e bllokimeve.

e) *Mandati i anëtarëve të Këshillit Prokurorial dhe largimi i parakohshëm i tyre*

CDL-AD(2021)051, Kosova – Opinion lidhur me Projekt-amendamentet e Ligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës

54. Komisioni i Venecias e përsëritë se përfundimi i hershëm i mandatit të një anëtari të këshillit (pavarësisht a ndodhë për shkak të dorëheqjes vullnetare, shuarjes së tërë institucionit ose arsyeve të ngjashme) duhet të ndërlihet me një shkëlqje të identifikueshme ose me dështim për të kryer detyrat e tij/saj. Anëtarët e KPK-së nuk duhet të “shkarkohen” vetëm sepse shumica parlamentare ose kolegët e tyre nuk i përkrahin vendimet e tyre.

59. Kundërshtimi i dytë ndërlihet me përfundimin e hershëm të mandateve të anëtarëve aktualë të KPK-së. Kushtetuta nuk e përcakton kohëzgjatjen e mandatit të anëtarëve të KPK-së, por autorizon që kjo të bëhet me ligj. Sidoqoftë, kjo nuk do të thotë se legjislativi mund të shkurtojë kohëzgjatjen e mandateve apo t'i ndërpres ato si e ka vullnetin. Siguria e kohëzgjatjes së mandatit duhet të respektohet. Në një Opinion për Malin e Zi, Komisioni i Venecias ka formuluar një rregull të përgjithshëm që edhe nëse Këshilli Prokurorial reformohet, anëtarëve aktualë do të duhej që normalisht tu lejohej të përfundonin mandatet. Do të ishte jokorrekte të lejohej një ripërtëritje e tërësishme e përbërjes së një Këshilli Prokurorial pas çdo zgjedhjeje parlamentare, kur ndërrohet shumica qeverisëse.

60. Thënë këtë, parimi i sigurisë së kohëzgjatjes së mandatit nuk është absolut; përfundimi i hershëm i mandateve mund të arsyetohet nganjëherë. Kështu, në Opininionin e njëjtë për Malin e Zi, Komisioni i Venecias ka pranuar se ripërtëritja e përbërjes së një Këshilli Prokurorial mund të jetë e nevojshme kur mënyra e emërimit të anëtarëve jo-prokurorë të ketë ndryshuar, nga zgjedhja me shumicë të thjeshtë, në zgjedhje me shumicë të kualifikuar, meqë kjo do të zvogëlonte rrezikun nga politizimi i Këshillit. Ngjashëm, nëse parashihen kritere të reja të papërshtatshmërisë që forcojnë pavarësinë dhe shkëputjen politike të anëtarëve, do të mund të arsyetohej zëvendësimi i atyre anëtarëve që nuk përmbushin këto kritere. Thjeshtë, përfundimi i hershëm i mandateve të disa anëtarëve mund të justifikohet nëse çon drejt një përmirësimi të dukshëm të sistemit përgjithësisht.

61. Ministria e Drejtësisë, në komentet e saj, ka argumentuar se qëllimi kryesor i reformës së propozuar është të luftojë korporatizmin brenda KPK-së, duke rritur përfaqësimin e anëtarëve jo-prokurorë në të. Në teori, ky qëllim mund të arrihet duke i shtuar përbërjes aktuale të KPK-së një numër të caktuar të anëtarëve jo-prokurorë shtesë. Kjo do të mundësonte që anëtarët aktualë prokurorë, të mbeteshin në KPK deri në përfundim të mandateve të tyre. Megjithatë, në këtë rast, KPK-ja do të bëhej shumë e madhe (me më se 20 anëtarë), duke marrë parasysh numrin relativisht të ulët të prokurorëve në Kosovë. Kjo zgjidhje do të ishte gjithashtu shumë e kushtueshme, marrë parasysh që amendamentet parashohin punësimin e plotë të të gjithë antëtarëve në KPK.

62. Komisioni konsideron nëse, në vend të përfundimit të njëhershëm të mandateve të të gjithë anëtarëve prokurorë, do të mund të hulumtoheshin modele alternative për ripërtëritjen e përbërjes së KPK-së. Kjo të paktën do të respektonte sigurinë e

kohëzgjatjes së mandatit të tyre dhe në të njëjtën kohë, do të lejonte KPK-në të nisë të funksionojë me përbërje të re menjëherë.

63. Një rishikim i tillë i përbërjes së KPK-së mund të mbështetet gjithashtu me faktin se sistemi i ardhshëm do të eliminonte shpërputhjet në përfaqësim të prokurorive të ulëta në KPK, që është cilësi e sistemit aktual. Aktualisht, secila prokurori themelore delegon nga një anëtar në KPK, që do të thotë se prokuroritë më të vogla janë të mbipërfaqësuar, ndërsa prokuroritë e mëdha janë të nënpërfaqësuar në KPK. Sistemi i rishikuar do të kthente barazpeshën, duke përcaktuar se secili prokuror ka një votë.

64. Si përfundim, [...] anëtarëve prokurorë aktualë, duhet tu lejohet të përfundojnë mandatet e tyre. Ata mund të largohen parakohshëm vetëm nëse Qeveria demonstroi bindshëm se zëvendësimi i tyre i shërben një interesi vital publik dhe çon në përmirësimin e përgjithshëm të sistemit.

CDL-AD(2022)006, Kosova – Opinion mbi Projekt-amendamentet e rishikuara të Ligjit për Këshillin Prokurorial

30. Në draftin e rishikuar, ideja e përfundimit automatik të mandateve të të gjithë anëtarëve të KPK-së, është braktisur. Drafti i rishikuar propozon të mbajë tre nga anëtarët prokurorë aktualë, duke i zgjedhur me short, që ndjek sugjerimin e dhënë në Opinionin e dhjetorit. Drafti i rishikuar gjithashtu ka braktisur idenë e “KPK-së së reduktuar”, që funksionon me vetëm ose esencialisht me anëtarët jo-prokurorë të sapozgjedhur. Neni 18 i draftit të rishikuar, që amendamenton nenin 36 të Ligjit, parasheh procedurën e ripërtëritjes së Këshillit si vijon: së pari, anëtarët e rinj jo-prokurorë do të zgjedhen nga Kuvendi/emërohen nga Avokati i Popullit; pastaj, organizohet tërheqja e shortit, që do të përcaktonte tre anëtarët që do të vazhdonin të qëndronin në Këshill deri në përfundim të mandateve të tyre dhe në fund, pasi të jenë zgjedhur, “Këshilli do të fillojë punën me përbërjen e re, në përputhje me këtë ligj” (shih nenin 36.8).

31. Edhe pse, si rregull, Komisioni i Venecias nuk është në favor të përfundimit të hershëm automatik të mandateve të anëtarëve të një Këshilli Prokurorial si rrjedhojë e një reforme institucionale, dispozitat e reja kalimtare janë më të respektueshme lidhur me sigurinë e kohëzgjatjes së mandatit të anëtarëve aktualë të KPK-së, krahasuar me modelin e mëparshëm.

CDL-AD(2021)012, Mali i Zi - Opinion lidhur me Projekt-amendamentet e Ligjit për Prokurorinë e Shtetit dhe Projektligjit për Prokurorinë për Krim të Organizuar dhe Korrupsion

29. Në disa situata të jashtëzakonshme, një ligj mund të ketë një efekt të drejtpërdrejtë në mandatin e një zyrtari. Për shembull, mund të konceptohet që nëse i gjithë institucioni shuhet, nuk mund të garantohet siguria e mandatit të drejtuesit të tij. Megjithatë, ndryshimet e vogla në një institucion nuk justifikojnë zëvendësimin e drejtuesit të tij. Gjithashtu, reformat institucionale nuk duhet të nisin me qëllimin e vetëm të zëvendësimit të individëve në pozitat kyçe.

30. Është legjitime të zëvendësohen ministrat ose bartësit e tjerë të posteve politike pas zgjedhjeve. Por nëse në sistemin e brendshëm, një institucion gëzon një lloj autonomie ose, a fortiori, përkufizohet si “i pavarur”, duke zëvendësuar zyrtarët kryesorë në një institucion të tillë për shkak të ndryshimit të shumicës politike dhe nën pretekstin e një reforme legjislative, duket se bie ndesh me Kushtetutën dhe sundimin e ligjit. Nëse çdo shumicë e re parlamentare në Parlament do të kishte të drejtë ta bënte këtë, kjo do të ishte në kundërshtim me vetë idenë e “mandatit” dhe

me stabilitetin e mandatit të zyrtarëve, dhe me natyrën “e pavarur”- përkatësisht apolitike - të këtyre trupave. Kjo gjithashtu do të pengonte dispozitat lidhur me përgjegjësinë disiplinore. Përgjegjësia disiplinore caktohet nga një trup disiplinor për sjellje të papërshtatshme të caktuar, trup i cili, në rastin e këshillave gjyqësor dhe prokurorial, gëzon pavarësi ose të paktën një shkallë të lartë autonomie. Meqenëse shumica parlamentare nuk ka kontroll mbi këto procedura, mund të tundohet të përdorë amendamentin ligjor për të anashkaluar dispozitat e përgjegjësisë disiplinore.

31. Nëse koalicioni qeverisës, siç rezulton nga takimet me raportuesit, është i zhgënjyer me veprimet e supozuara joprofesionale ose të anshme politikisht të KLP-së, atëherë ai duhet të kontrollohet për përgjegjësi disiplinore për sjellje specifike të papërshtatshme dhe të mos shkarkohet me pretekstin e ndryshimit të titullit të tij dhe/ose të emrit të institucionit që drejton. [...]

45. Projekt-amendamentet e Ligjit për KLP-në parashikojnë që, pas miratimit të tyre, anëtarët e Këshillit Prokurorial do të duhet të rizgjedhen, sipas rregullave të reja.

46. Analiza e mësipërme për zëvendësimin e KLP-së, është gjithashtu e zbatueshme edhe për zëvendësimin e anëtarëve të Këshillit Prokurorial. Këshilli Prokurorial vazhdon të ekzistojë dhe një ndryshim i vogël në përbërjen e tij, as nuk e shuan organin dhe as nuk i modifikon në mënyrë drastike kompetencat, natyrën apo funksionet e tij. Më tej, mandati i anëtarëve aktualë të Këshillit Prokurorial, skadon brenda më pak se një viti. Komisioni i Venecias nuk e sheh nevojën e zëvendësimit të anëtarëve ekzistues të Këshillit Prokurorial, së paku për hir të respektimit të sigurisë së mandatit të tyre.

47. Komisioni i Venecias i referohet një opinioni të mëparshëm në lidhje me ripërtëritjen e përbërjes së një Këshilli Gjyqësor pas një reforme legjislativë. Funksionet e Këshillit Gjyqësor dhe të Këshillit Prokurorial në sistemin e kontroleve dhe balancave janë shumë të ngjashme, kështu që gjetjet e Komisionit janë të zbatueshme edhe për çështjen në fjalë:

“Komisioni i Venecias është i mendimit se kur përdor fuqinë e tij legjislativë për të dizajnuar organizimin dhe funksionimin e ardhshëm të gjyqësorit, Parlamenti duhet të përmbahet nga miratimi i masave që do të rrezikojnë vazhdimësinë e anëtarësisë në Këshillin e Lartë Gjyqësor.

Largimi i parakohshëm i të gjithë anëtarëve të Këshillit do të krijonte një precedent ku çdo qeveri e ardhshme ose çdo Parlament i ri, i cili nuk e kishte miratuar as përbërjen dhe as anëtarësinë e Këshillit, do të mund të përfundonte parakohshëm ekzistencën e tij dhe ta zëvendësonte atë me një Këshill të ri. Në shumë rrethana, një ndryshim i tillë, veçanërisht në një njoftim të shkurtër, do të ngrinte dyshimin se qëllimi pas kësaj ishte të ndikonte në rastet që ishin në pritje në Këshill. [...]”

48. Dikush mund të argumentojë se qëllimi politik i reformës, për të ndryshuar ekuilibrin ndërmjet anëtarëve jo-prokurorë dhe anëtarëve prokurorë në Këshillin e ardhshëm, nuk do të arrihej nëse anëtarëve aktualë u lejohet të shërbejnë deri në fund të mandatit të tyre origjinal. Ky synim, megjithatë, mund të arrihet pa rizgjedhjen e menjëhershme të të gjithë anëtarëve jo-prokurorë. Për të arritur këtë ekuilibër të ri, do të mjaftonte të zgjedhej një anëtar jo-prokuror shtesë dhe të shkarkohej një anëtar prokuror (për shembull, duke hedhur shortin, ose duke shkarkuar një anëtar që përfaqëson [Prokurorinë Speciale]), ose të shtohen dy anëtarë jo-prokurorë dhe të mos largohen fare anëtarët prokurorë, si zgjidhje

kalimtare. Nëse, për çfarëdo arsye, është e vështirë të caktohet një anëtar prokuror për t'u larguar, duhet të jetë e mundur që të rizgjedhen të gjithë, përfundimisht, sipas rregullave të reja. Në këtë skenar, anëtarët prokurorë dhe jo-prokurorë do të përfundonin mandatet e tyre në periudha të ndryshme. Shumica e anëtarëve jo-prokurorë, të zgjedhur nga Parlamenti i mëparshëm dhe deri në fund të mandatit të tyre, nuk do të perceptoheshin si të emëruar politikë të shumicës aktuale dhe rreziku i politizimit total të Këshillit (për shkak të ardhjes së anëtarëve të rinj të emëruar nga shumica aktuale) do të zvogëlohej, të paktën përkohësisht. Në çdo rast, Komisioni i Venecias nuk rekomandon shkarkimin e menjëhershëm të anëtarëve jo-prokurorë dhe prokurorë dhe vlerëson se ata duhet të lejohen të mbarojnë mandatin e tyre.

CDL-AD(2021)030 Mali i Zi - Opinion Urgjent lidhur me Projekt-amendamentet e rishikuara të Ligjit për Prokurorinë e Shtetit

46. Drafti i rishikuar vazhdon të përmbajë dispozitën që me hyrjen në fuqi të ligjit, të zëvendësohen menjëherë të gjithë anëtarët aktualisht në detyrë të KP [Këshillit Prokurorial], pra para përfundimit të mandatit të tyre (i cili skadon më 22 janar 2022). Në opinionin e marsit, Komisioni i Venecias shprehu qëndrimin se anëtarëve aktualë të KP-së, duhet t'u lejohet përfundimi i mandatit. Komisioni është deklaruar më parë në lidhje me këshillat gjyqësor, se pasi një nga funksionet e tyre të rëndësishme është mbrojtja e gjyqtarëve nga ndikimi politik, "do të ishte jokonsistente të lejohej një ripërtëritje e plotë e përbërjes së një këshilli gjyqësor pas zgjedhjeve parlamentare". [...] Duke përdorur fuqinë e tij legjislativë për të dizenuar organizimin dhe funksionimin e ardhshëm të gjyqësorit, Parlamenti duhet të përmbahet nga miratimi i masave që do të rrezikojnë vazhdimësinë e anëtarësisë në Këshillin e Lartë Gjyqësor [dhe pavarësinë e gjyqësorit (gjyqtarët dhe prokurorët)]. Shkarkimi i parakohshëm i të gjithë anëtarëve të Këshillit do të përbente një precedent ku çdo qeveri e ardhshme ose çdo Parlament i ri, i cili nuk e miratoi as përbërjen dhe as anëtarësinë e Këshillit, mund ta përfundonte para kohe ekzistencën e tij dhe ta zëvendësonte atë me një Këshill të ri, e që kjo përbën një shkelje të pavarësisë së tij. Komisioni i Venecias konstatoi nga ana tjetër se ripërtëritja e anëtarëve mund të justifikohet me kushtin që mënyra e emërimit është ndryshuar nga emërimi me shumicë të thjeshtë në shumicë të kualifikuar, pasi kjo do të zvogëlonte rrezikun e politizimit të Këshillit.

CDL-AD(2021)030, Mali i Zi - Opinion urgjent për projekt-amendamentet e rishikuara në Ligjin për Prokurorinë e Shtetit

48. [...] [Komisioni nuk konsideron se ndërprerja e mandatit të të gjithë anëtarëve aktualë të Këshillit Prokurorial do të ishte e justifikuar.

49. Megjithatë, Komisioni konsideron se kriteret e papërshtatshmërisë të paraqitura përmes draftit janë një mjet adekuat për të krijuar kushtet për të forcuar pavarësinë në një mjedis që paraqet rrezik të ndikimit të papërshtatshëm politik. Interesi i përgjithshëm përkatës për vendosjen e standardeve të tilla, mund të konsiderohet proporcional dhe të justifikojë zbatimin e tyre të menjëhershëm nga rasti në rast për anëtarët aktualë të KP, pa cenuar parimin e besimit në integritetin e mandateve. Prandaj, mund të krijohet një procedurë për vlerësimin e papërshtatshmërisë së mundshme të anëtarëve aktualë të KP-së, në dritën e këtyre kriterëve. Nëse kjo do të çonte në humbjen e mandateve, mund të rivlerësohet barazpesha në mes të anëtarëve jo-prokurorë dhe atyre prokurorë, për të parë nëse janë të nevojshme rregullime para skadimit të rregullt të mandatit më 22 janar 2022. Në përgjithësi, sipas mendimit të Komisionit, për aq kohë sa zgjedhjet bëhen me shumicë të thjeshtë, do të ishte e preferueshme që anëtarët jo-

prokurorë të zgjedheshin në momente të ndryshme (mundësisht nga parlamente të ndryshme).

CDL-AD(2021)047, Republika e Moldavisë - Opinion lidhur me ndryshimet e 24 gushtit 2021 në ligjin për shërbimin e prokurorisë

55. [...] Si i tillë, përcaktimi i moshës së pensionit për një zyrtar publik nuk është në kundërshtim me asnjë standard apo parim ndërkombëtar. Siç vërehet nga GJKRM [Gjykata Kushtetuese e Republikës së Moldavisë] [...], ideja e një kufiri të moshës, nuk është e papajtueshme me të drejtën kushtetuese për punë. Çështje të tilla mund të rregullohen nga ligjvënësi për të siguruar që disa mbajtës të posteve të kenë aftësinë mendore dhe fizike për të kryer detyrat e tyre.

56. Thënë këtë, nuk duhet të vendoset një kufi moshe me efektin që të ndërprejë mandatet e individëve të caktuar, të zgjedhur sipas rregullave ekzistuese të mëparshme. Komisioni i Venecias kritikoi masa të tilla në një opinion për Poloninë dhe e përsëritë këtë në kontekstin e Republikës së Moldavisë. [...]

60. Komisioni i Venecias është i gatshëm ta pranojë këtë argument. Megjithatë, ajo që është problematike, është se anëtarët jo-prokurorë të emëruar sipas rregullave të vjetra (të cilat nuk parashikonin asnjë kufizim moshe) u larguan (ose do të largoheshin) para kohe, për shkak të zbatimit të rregullit të ri. Është e vërtetë se siguria e mandatit të anëtarëve të KPSH -së nuk garantohet me Kushtetutë (e cila është e heshtur lidhur me kohëzgjatjen e mandatit të tyre, kufirin e moshës, etj.). Megjithatë, emërimi si anëtar i një organi kushtetues – i cili, sipas Kushtetutës, është garantuesi kryesor i pavarësisë së sistemit prokurorial, krijon të paktën njëfarë pritshmërie legjitime që mandati të mos ndërpritet në mes pa një arsye të fortë. Çështja është nëse qëllimi i deklaruar i këtij amendamenti – vënia e të gjithë anëtarëve të Këshillit në baza të barabarta për sa i përket moshës së tyre të daljes në pension – pengon pavarësinë e këtij trupi dhe nëse është një arsye mjaftueshëm e fortë për një ndërprerje të parakohshme të mandatit të disa prej anëtarëve të tij. Ky është një argument tjetër në favor të rrënjës së kërkesave bazë për anëtarët e KPSH-së dhe kushteve të përfundimit të parakohshëm të mandatit në Kushtetutë.

CDL-AD(2014)029, Opinion për Projekt-amandamentet e Ligjit për Këshillin Prokurorial Shtetëror të Serbisë

52. Një procedurë për ruajtjen e besimit është specifike për institucionet politike si qeveritë që veprojnë nën kontrollin parlamentar. Nuk është i përshtatshëm për institucione, siç është KPSH-ja [Këshilli Prokurorial Shtetëror], anëtarët e të cilit zgjedhen për një mandat të caktuar. Mandati i këtyre anëtarëve duhet të përfundojë vetëm me skadimin e këtij mandati, me daljen në pension, me dorëheqjen ose vdekjen, ose me shkarkimin e tyre për arsye disiplinore.

53. Procedura disiplinore mund të zbatohet vetëm në rastet e shkeljeve disiplinore dhe jo për shkak të “mungesës së besimit”. Neni 41 përcakton qartë arsyet që mund të çojnë në shkarkimin e anëtarëve të KPSH-së. Prandaj, procedura disiplinore duhet të përqendrohet vetëm në çështjen nëse anëtari i KPSH-së nuk ka kryer detyrat e tij ose të saj ‘në përputhje me Kushtetutën dhe ligjin’. Kjo çështje nuk duhet të ngatërrohet me çështjen nëse ky anëtar e gëzon ende besimin e prokurorëve publikë dhe zëvendësprokurorëve publikë që morën pjesë në zgjedhjen e tij ose të saj. Procedura disiplinore duhet t’i garantojë anëtarit të KPSH-së një gjykim të drejtë. Ndërsa referenca për një gjykim të drejtë bëhet sipas nenit 46 (a), duhet të jepen detaje mbi garancitë përkatëse.

56. [...] Anëtarët e këshillave prokurorial janë autonomë (shih nenin 164 të Kushtetutës) dhe nënshtrimi i tyre ndaj votës së mosbesimit, i bën ata shumë të varur nga dëshirat e prokurorëve dhe në mënyrë efektive, do të thotë që një anëtar i zgjedhur i KPSH-së mund të shkarkohet në çdo moment pa arsye objektive. Komisioni i Venecias rekomandon fuqishëm që një procedurë e tillë të mos parashihet.

III. Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Ligjit të Kontestuar

201. Gjykata thekson që parashtruesit e kërkesës në rastin KO100/22, kontestojnë kushtetutshmërinë e neneve 13, 16, 18 dhe 20 të Ligjit të kontestuar, ndërsa parashtruesit e kërkesës në rastin KO101/22, kontestojnë Ligjin kontestuar në tërësinë e tij, por duke paraqitur argumente konkrete lidhur me kushtetutshmërinë e neneve 6, 13 dhe 20 të Ligjit të kontestuar. Thënë këtë, marrë parasysh (i) pretendimet e parashtruesve të kërkesave dhe argumentet e paraqitura para Gjykatës nga parashtruesit e kërkesave dhe përgjigjet e palëve të interesuara; dhe (ii) ndërlidhjen e neneve respektive me njëri-tjetrin, Gjykata, në rrethanat e rastit konkret, do të vlerësojë kushtetutshmërinë e neneve të Ligjit të kontestuar si në vijim: (i) nenin 6 [pa titull] të Ligjit të kontestuar përmes të cilit ndryshohet dhe plotësohet neni 9 (Përbërja e anëtarëve të Këshillit) i Ligjit bazik; (ii) nenin 7 [pa titull] të Ligjit të kontestuar përmes të cilit ndryshohet dhe plotësohet neni 10 (Procedura e zgjedhjes së anëtarëve të Këshillit nga Kuvendi) i Ligjit bazik; (iii) nenin 8 [pa titull] të Ligjit të kontestuar përmes të cilit ndryshohet, përkatësisht plotësohet neni 10 (Procedura e propozimit, zgjedhjes dhe e shkarkimit të anëtarëve që zgjedhen nga Kuvendi) i Ligjit bazik, përkatësisht shtohet neni i ri 10/A (Anëtari jo prokurorë i caktuar nga Avokati i Popullit) i Ligjit të kontestuar; (iv) nenin 13 [pa titull] të Ligjit të kontestuar përmes të cilit ndryshohet dhe plotësohet neni 15 (Kuorumi dhe Vendimmarrja) i Ligjit bazik; (v) nenin 16 [pa titull] të Ligjit të kontestuar përmes të cilit ndryshohet dhe plotësohet neni 19 (Procedura disiplinore për anëtarët e Këshillit) i Ligjit bazik dhe nenin 18 [pa titull] të Ligjit të kontestuar përmes të cilit ndryshohet, përkatësisht plotësohet neni 23 (Emërimi dhe riemërimi i prokurorëve) i Ligjit bazik, përkatësisht shtohet neni 23/A (Mbrojtja gjyqësore) i Ligjit të kontestuar; dhe (vi) nenin 20 [pa titull] të Ligjit të kontestuar për ndryshimin dhe plotësimin e nenit 36 (Qëndrimi në detyrë) të Ligjit bazik në lidhje edhe me paragrafin 3 të nenit 11 [pa titull] të Ligjit të kontestuar për ndryshimin dhe plotësimin e nenit 13 (Përfundimi i mandatit) të Ligjit bazik.
202. Nenet e lartcekura të Ligjit të kontestuar, Gjykata do t'i vlerësojë secilin veç e veç, duke (i) përmbledhur fillimisht pretendimet thelbësore të parashtruesve të kërkesës dhe argumentet dhe kundër-argumentet e palëve të interesuara para Gjykatës; dhe (ii) duke aplikuar parimet e përgjithshme të shtjelluara më lart, përkatësisht praktikën gjyqësore të Gjykatës dhe të GJEDNJ-së dhe GJDBE-së dhe parimet relevante që burojnë nga Raportet dhe Opinionet relevante të Komisionit të Venecias, me theks në dy Opinionet për Kosovë përkitazi me Ligjin e kontestuar.
- 1. Vlerësimi i kushtetutshmërisë së nenit 6 [pa titull] të Ligjit të kontestuar përmes të cilit ndryshohet dhe plotësohet neni 9 (Përbërja e anëtarëve të Këshillit) të Ligjit bazik**
203. Fillimisht dhe për qëllime të vlerësimit të kushtetutshmërisë së nenit 6 të Ligjit të kontestuar, Gjykata do të paraqesë: (i) thelbin e pretendimeve të parashtruesve të kërkesës dhe komentet mbështetëse të dorëzuara nga palët e interesuara si dhe thelbin e argumenteve të palës kundërshtare (shih, paragrafët 74-137 të këtij Aktgjykimi për një pasqyrim të hollësishëm të argumenteve dhe kundër-argumenteve përkatëse); dhe (ii) vlerësimin e Gjykatës lidhur me këto pretendime përkitazi me jokushtetutshmërinë e nenit përkatës.

(i) *Thelbi i pretendimeve/argumenteve dhe kundër-argumenteve të parashtruesve dhe palëve të interesuara*

204. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë që neni 6 i Ligjit të kontestuar është në kundërshtim me nenet 4 dhe 110 të Kushtetutës, në thelb, sepse (i) zvogëlon raportin, përkatësisht proporcionin në mes të anëtarëve prokurorë dhe jo-prokurorë në KPK, duke cenuar pavarësinë e një institucioni të pavarur kushtetues; (ii) përbërja e re e KPK-së, me këtë proporcion të ri në mes të anëtarëve prokurorë dhe jo-prokurorë, mundëson që shumica parlamentare të ndërhyjë në ushtrimin e pavarur të funksionit të sistemit prokurorial; (iii) Avokati i Popullit nuk është i autorizuar, përkatësisht nuk ka kompetencë kushtetuese dhe ligjore për të caktuar një anëtar në KPK; (iv) një kompetencë e tillë e shtuar e Avokatit të Popullit përbën konflikt interesi në raport me detyrimin e tij kushtetues për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave themelore; (v) zgjedhja e dy (2) anëtarëve jo-prokurorë nga Kuvendi me shumicë të thjeshtë të votave, cenon pavarësinë dhe integritetin e KPK-së si organ i pavarur kushtetues, duke i dhënë kështu secilës shumicë parlamentare mundësi të madhe për ndikim dhe kontroll politik mbi anëtarët jo-prokurorë në KPK.
205. Në mbështetje të pretendimeve të parashtruesve të kërkesës, komente në Gjykatë kanë dorëzuar edhe KPK, Avokati i Popullit dhe Oda e Avokatëve. Sipas KPK-së, në thelb, (i) struktura aktuale e KPK-së është e ngjashme me atë të KGJK-së, e cila në përbërjen e saj ka dhjetë (10) gjyqtarë dhe ku vetëm tre (3) prej anëtarëve janë jo-gjyqtarë dhe se ky dallim në trajtimin e KPK-së dhe KGJK-së është në kundërshtim me Kushtetutën dhe praktikën gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese; (ii) përbërja e propozuar e KPK-së, në fakt, përcakton përfaqësim të barabartë të prokurorëve dhe jo-prokurorëve në Këshill, sepse pjesëmarrja e Kryeprokurorit të Shtetit, në mënyrë *ex-officio* në KPK, nuk konsiderohet shumicë e anëtarëve prokurorë, sepse i njëjti nuk përzgjedhet nga kolegët në mënyrë të drejtpërdrejtë, por përfaqësohet në KPK sipas detyrës zyrtare; (iii) caktimi i një anëtarit nga Avokati i Popullit në KPK është në kundërshtim me autorizimet e tij për të mbikëqyrur dhe mbrojtur të drejtat dhe liritë e individëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike, përfshirë vet KPK-në; (iv) kjo kompetencë e shtuar e Avokatit të Popullit, paraqet konflikt interesi, duke marrë për bazë kompetencën e Avokatit të Popullit sipas Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtareve dhe Prokurorëve për të iniciuar raste disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve; dhe (v) Ligji i kontestuar, sa i përket Avokatit të Popullit, vetëm përcakton detyrimin e tij për t'u konsultuar me shoqërinë civile dhe nuk saktëson asnjë kriter tjetër lidhur me caktimin e anëtarit përkatës në KPK.
206. Sipas Avokatit të Popullit, (i) mundësia që Avokati i Popullit të caktojë një (1) anëtar të KPK-së "*eventualisht do të mund të shihej si cenim i pavarësisë së Avokatit të Popullit, por edhe i asaj të KPK-së*"; dhe (ii) kjo kompetencë e re e cila parashihet me Ligjin e kontestuar, nuk buron as nga Kushtetuta dhe as nga Ligji për Avokatin e Popullit. Në fund edhe Oda e Avokatëve, gjithashtu konteston strukturën e propozuar të KPK-së dhe përfshirjen e Avokatit të Popullit përmes kompetencës për të caktuar njërin nga shtatë (7) anëtarët e KPK-së, duke kontestuar gjithashtu përjashtimin e përfaqësimit të Odës së Avokatëve në KPK, për dallim nga Ligji bazik.
207. Ministria e Drejtësisë në anën tjetër, konteston/kundërshton pretendimet e deputetëve parashtrues të Kuvendit dhe argumentet e palëve tjera, përkatësisht KPK-së, Avokatit të Popullit dhe Odës së Avokatëve, respektivisht, duke theksuar se (i) ekziston një dallim esencial në masën e rregullimit kushtetues të gjykatave dhe të prokurorive me Kushtetutë dhe se në rastin e sistemit prokurorial, sipas Kushtetutës, organi legjislativ mund ta vendosë mënyrën e zgjedhjes së anëtarëve të KPK-së në kuadër të kufizimeve diskrecionale ligjore; (ii) prokuroria nuk është gjykatë dhe puna e prokurorisë dallon esencialisht nga puna e gjykatës, por që është e pakontestueshme pavarësia edhe e

gjykatës edhe e prokurorisë, e cila garantohet përmes Kushtetutës dhe e cila nuk cenohet nga Ligji i kontestuar; (iii) përbërja prej trembëdhjetë (13) anëtarëve dhe e pa balancuar në mes të anëtarëve prokurorë dhe jo-prokurorë, krijon rrezik për korporatizim brenda KPK-së; (iv) përmes ndryshimit dhe plotësimit të Ligjit bazik, arrihet një përfaqësim i balancuar në funksion të sigurimit të efikasitetit të KPK-së në ushtrimin e kompetencave të saj dhe se një qasje e tillë, është në përputhje me Opinionin e Komisionit të Venecias, sipas të cilit “*prokurorët duhet të kenë përfaqësim substancial, por jo domosdoshmërisht shumicë*”; (v) Avokati i Popullit është institucion i pavarur kushtetues dhe për pasojë, mund të caktojë një (1) nga tre (3) anëtarët jo-prokurorë me qëllim të arritjes së “*pluralizmit*” të anëtarëve të KPK-së, për më tepër që një rekomandim i tillë buron edhe nga Opinionet e Komisionit të Venecias; (vi) anëtari jo-prokuror i caktuar nga Avokati i Popullit nuk vepron në KPK si përfaqësues i interesave e as kompetencave që ushtrohen nga Avokati i Popullit, por si anëtar jo-prokuror me orar të plotë, që do të sigurojë pluralizmin e KPK-së; dhe (vii) Ligji për Avokatin e Popullit thekson shprehimisht se Avokati i Popullit, kryen edhe detyra të tjera të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

(ii) *Vlerësimi i Gjykatës*

208. Bazuar në pretendimet e parashtruesve të kërkesës dhe përgjigjet e kundërshtimet përkatëse, Gjykata konsideron që përkitazi me nenin 6 të Ligjit të kontestuar, në esencë, është e rëndësishme të vlerësohet nëse përbërja e ndryshuar e KPK-së, përfshirë mënyrën e zgjedhjes së anëtarëve jo-prokurorë të saj, është në përputhje me Kushtetutën. Në këtë kontekst, Gjykata së pari do të trajtojë (i) zvogëlimin e numrit të anëtarëve të KPK-së, përfshirë ndryshimin e raportit në mes të anëtarëve prokurorë dhe jo-prokurorë, dhe nëse struktura e propozuar është në përputhje me pavarësinë kushtetuese të KPK-së, siç është përcaktuar në nenin 110 të Kushtetutës; dhe më pas, (ii) kompetencën e Avokatit të Popullit për të “*caktuar*” një anëtar të KPK-së bazuar në dispozitat e Kushtetutës, përkatësisht neneve 110 dhe 65 të saj.
209. Në këtë kontekst, Gjykata fillimisht rikujton përbërjen aktuale të KPK-së, të përcaktuar me Ligjin bazik, sipas nenit 9 të të cilit, KPK përbëhet nga trembëdhjetë (13) anëtarë si vijon: (i) dhjetë (10) anëtarë nga radhët e prokurorëve, duke përfshirë Kryeprokurorin e Shtetit, shtatë (7) anëtarë prokurorë nga prokuroritë themelore të përfaqësuar me nga një (1) anëtar; një (1) anëtar prokuror nga Prokuroria e Apelit dhe një (1) anëtar prokuror nga Prokuroria Speciale, të përzgjedhur nga prokurorët e prokurorive përkatëse; dhe (ii) tre (3) anëtarë jo-prokurorë, përkatësisht një (1) anëtar nga Oda e Avokatëve, një (1) anëtar profesor universitar i drejtësisë dhe një (1) anëtar përfaqësues nga shoqëria civile. Përkitazi me tre (3) anëtarët jo-prokurorë të KPK-së, Ligji bazik saktëson që të njëjtit zgjedhen nga Kuvendi, sipas paragrafit 10 të nenit 65 të Kushtetutës, me votim të fshehtë me shumicën e votave të të gjithë deputetëve të pranishëm dhe që votojnë, bazuar në një listë prej dy (2) kandidatëve, për secilën pozitë të propozuar nga organet përkatëse, përkatësisht Oda e Avokatëve dhe fakultetet juridike dhe saktëson që përfaqësuesi i shoqërisë civile, zgjedhet me anë të konkursit publik dhe zgjedhet nga Kuvendi, sipas kritereve të përcaktuar me këtë ligj.
210. Më saktësisht dhe përkitazi me mënyrën e zgjedhjes së anëtarëve jo-prokurorë nga Kuvendi, neni 10 (Procedura e propozimit, zgjedhjes dhe e shkarkimit të anëtarëve që zgjedhën nga Kuvendi) i Ligjit bazik, ndër tjerash, saktëson që (i) lista për seancën e Kuvendit përbëhet nga dy (2) kandidatë për një (1) pozitë, pas vlerësimit të komisionit përkatës siç është përcaktuar në këtë ligj; dhe (ii) zgjedhja nga Kuvendi bëhet bazuar në dy (2) radhë votimi, përkatësisht, nëse në rrethin e parë, kandidatët e propozuar nga komisioni përkatës i Kuvendit nuk marrin shumicën e votave të të gjithë deputetëve të pranishëm dhe që votojnë, atëherë në raundin e dytë, konsiderohet i zgjedhur kandidati me numrin më të madh të votave.

211. Përmes nenit 4 të draftit të parë të propozuar nga Qeveria për plotësim dhe ndryshim të Ligjit bazik dhe i cili ishte nënshtruar analizës së parë të Komisionit të Venecias, si rrjedhojë e së cilës Komisioni i Venecias hartoi Opinionin e parë, plotësim/ndryshimi i nenit 9 të Ligjit bazik, kishte përcaktuar që KPK të përbëhej prej shtatë (7) anëtarësh, (i) katër (4) prokurorë, duke përfshirë Kryeprokurorin dhe duke saktësuar që njëri nga prokurorët të zgjedhet nga Kuvendi; dhe (ii) tre (3) jo-prokurorë të zgjedhur nga Kuvendi. Sipas këtij ndryshim/plotësimi, katër (4) nga shtatë (7) anëtarët e KPK-së, do të zgjedheshin nga Kuvendi me shumicë të thjeshtë, përkatësisht shumicën e deputetëve të pranishëm dhe që votojnë.
212. Opinioni i parë i Komisionit të Venecias, kishte trajtuar përbërjen e re të propozuar të KPK-së, përfshirë procedurën për zgjedhjen e anëtarëve jo-prokurorë respektiv, në nëntitullin A të pjesës IV të Opinionit përkatës. Në kontekst të këtij të fundit, Gjykata vëren se objekt i analizës përkatëse ishte një draft i mëparshëm i Ligjit të kontestuar, përkatësisht projektligji i Qeverisë që i ishte dorëzuar Komisionit të Venecias përmes letrës së 26 tetorit 2021, siç është theksuar në paragrafin 29 të këtij Aktgjykimi. Prandaj, Gjykata do t'i referohet Opinionit të parë vetëm për atë që Opinioni ka adresuar parimet që ndërlidhen me draftin e miratuar në Kuvend, pra Ligjin e kontestuar, duke sqaruar që ky i fundit, i është nënshtruar (i) analizës së mëtejme nga Komisioni i Venecias, e që ka rezultuar me Opinionin e dytë, të miratuar në seancën e 130-të plenare të Komisionit të Venecias, të zhvilluar më 18-19 mars 2022; dhe (ii) amendamentimit pasues në Kuvend, siç është shtjelluar në këtë Aktgjykim në pjesën e Procedurës para Gjykatës.
213. Për sa i përket përbërjes së re të KPK-së dhe mënyrës së zgjedhjes së anëtarëve përkatës, Opinioni i parë i Komisionit të Venecias, fillimisht vëren se elementi qendror i reformës, përkatësisht bilanci i ri në mes të prokurorëve dhe jo-prokurorëve brenda KPK-së, nuk është në kundërshtim me standardet evropiane (shih, Opinionin e parë të Komisionit të Venecias, paragrafi 70). Megjithatë, Komisioni i Venecias gjithashtu thekson se *“reforma nuk duhet të shpie në nënshtrimin e KPK-së ndaj shumicës qeverisëse”* (shih, Opinionin e parë të Komisionit të Venecias, paragrafi 28). Thënë këtë dhe përkitazi me strukturën e rishikuar të KPK-së, si rezultat i uljes së pranisë së anëtarëve prokurorë dhe për rrjedhojë, proporcionit të rritur të anëtarëve jo-prokurorë, Komisioni i Venecias, ndër tjerash, ka theksuar se: (i) gjithnjë ka pranuar se në disa rreze juridike demokratike, nuk ka këshilla prokurorial dhe se aty ku ekzistojnë, ka një sërë modelesh të pranueshme sa i përket përbërjes së këtyre këshillave dhe se në këtë kuptim, ka një dallim të rëndësishëm në mes të standardeve që vlejnë për këshilla gjyqësor dhe ata prokurorial (shih, Opinionin e parë të Komisionit të Venecias, paragrafi 26); dhe (ii) përderisa prokurorët duhet të jenë të mbrojtur nga ndërhyrjet politike dhe përderisa këshillat prokurorial mund të ofrojnë këtë mbrojtje, nuk ka një kërkesë që këta këshilla të jenë patjetër *“të dominuar”* nga prokurorët dhe se Komisioni i Venecias, vazhdimisht ka avokuar për këshilla prokurorial në të cilët prokurorët e përzgjedhur nga kolegët e tyre, përfaqësojnë *“pjesë substanciale”*, por jo domosdoshmërisht shumicën e anëtarëve (shih, Opinionin e parë të Komisionit të Venecias, paragrafi 26).
214. Tutje dhe më konkretisht, Opinioni i parë i Komisionit të Venecias ka vërejtur se (i) aktualisht KPK përbëhet thajse në tërësi nga prokurorë dhe si e tillë, ka predispozita të jetë e rrezikuar nga *“korporatizmi”*; (ii) shumica e anëtarëve prokurorë të KPK-së vijnë nga prokurori më të ulëta dhe prandaj, është e natyrshme që mund të perceptohen se votojnë së bashku me kolegët e tyre të niveleve më të larta, e sidomos me vet Kryeprokurorin e Shtetit; dhe si rrjedhojë, (iii) zvogëlimi i proporcionit të anëtarëve prokurorë, mund të ndihmojë në luftimin e *“tendencës korporatiste”* të këtij trupi ose *“të perceptimit për tendencë të tillë”*, duke theksuar gjithashtu se reformimi i KPK-së, nuk duhet të çojë në nënshtrimin e saj ndaj shumicës qeverisëse në Kuvend (shih, Opinionin e parë të Komisionit të Venecias, paragrafët 27 dhe 28).

215. Sipas Opinionit të parë të Komisionit të Venecias, “*asnjë nga këto modele nuk është pa të meta*”, sidoqoftë, (i) “*çfarëdo modeli pluralist, është më i mirë se një model ku këshillat prokurorial janë të dominuar nga një grup monolitik i anëtarëve prokurorë, të nënshtruar ndaj Kryeprokurorit të Shtetit, ose një grup monolitik i të emëruarve politikë që i janë besnikë shumicës qeverisëse*”; dhe (ii) është e rëndësishme që përbërja e KPK-së të jetë mjaftueshëm “*pluraliste*” për të siguruar që prokurorët të mos mund të qeverisin të vetëm dhe në të njëjtën kohë, që anëtarët jo-prokurorë, zgjedhja e të cilëve është bërë me votat e shumicës që përfaqësojnë shumicën qeverisëse, “*të mos mund t'i mbivotojnë lehtë ata*” (shih, Opinionin e parë të Komisionit të Venecias, paragrafët 28 dhe 33). Sa i përket anëtarëve jo-prokurorë të KPK-së, Opinioni i parë i Komisionit të Venecias vëren se një numër i caktuar i vendeve në një Këshill Prokurorial, mund “*të rezervohen për përfaqësuesit e institucioneve të jashtme të pavarura (si Oda e Avokatëve, konferenca e fakulteteve të drejtësisë, Avokati i Popullit, etj.) ose për shoqërinë civile*” dhe se “*në këtë model është e rëndësishme të sigurohet se institucioni që delegon anëtarin jo-prokuror është me të vërtetë neutral (çka mund të jetë vështirë e arritshme në një shoqëri të vogël dhe shumë të politizuar) dhe/ose që anëtarët e deleguar nga OJQ-të, të jenë me të vërtetë përfaqësues të shoqërisë civile*” (shih, Opinionin e parë të Komisionit të Venecias, paragrafi 32).
216. Sa i përket zgjedhjes së anëtarëve jo-prokurorë të KPK-së, Opinioni i parë i Komisionit të Venecias ngritë shqetësimin se zgjedhja e anëtarëve jo-prokurorë nga Kuvendi përmes votimit me shumicë të thjeshtë, rritë rrezikun e politizimit të tyre dhe se në këtë kuptim, tri kushte janë me rëndësi, pra që trupi që bën zgjedhjen, në këtë rast Kuvendi: (i) të jetë “*me të vërtetë pluralist*”, pra “*të mos jetë i dominuar nga shumica qeverisëse ose anëtarë të afërt me të*”; (ii) procesi vendimmarrës brenda këtij trupi, pra Kuvendit, duhet të sigurojë që kandidatët e nominuar për t’u zgjedhur nga Kuvendi, kanë mbështetje përgjatë mbarë spektrit politik; dhe (iii) shumica në Kuvend nuk është në mundësi që të shmangë ose sabotojë procedurën e zgjedhjes (shih, Opinionin e parë të Komisionit të Venecias, paragrafi 42).
217. Sa i përket pranisë së Kryeprokurorit të Shtetit në përbërjen e KPK-së, që në thelb, Komisioni i Venecias ka rekomanduar në Opinionin e parë, Komisioni ka theksuar se (i) Kryeprokurori i Shtetit “*nuk duhet të jetë në mundësi që të marr vendimet i vetëm – dhe kjo është arsyeja se pse janë krijuar këshillat prokurorial*”; dhe (ii) nëse Kryeprokurori i Shtetit mbetet në përbërje të KPK-së si anëtar sipas detyrës zyrtare me të drejtë vote, kjo mund të bëjë të nevojshme një rishikim të përbërjes së KPK-së në mënyrë që “*të ruhet balanci në mes të grupeve të ndryshme të anëtarëve*”, meqenëse është e rëndësishme “*të shmanget situata kur Kryeprokurori i Shtetit, duke përdorur pozitën e tij përballë anëtarëve prokurorë (dhe madje edhe disa anëtarëve jo-prokurorë) t’ia diktojë vullnetin e tij/saj KPK-së*” (shih, Opinionin e parë të Komisionit të Venecias, paragrafi 38).
218. Përfundimisht dhe për aq sa është relevante për rrethanat e rastit konkret, Opinioni i parë i Komisionit kishte theksuar që (i) “*elementi qendror i reformës – përkatësisht ekuilibri i ri në mes të anëtarëve prokurorë dhe jo-prokurorë në KPK – nuk është në kundërshtim me standardet evropiane. Prokurorët e zgjedhur nga kolegët e tyre ende përfaqësojnë një pjesë thelbësore të këtij organi (tre anëtarë nga shtatë)*” (paragrafi 70); megjithatë (ii) “*reforma nuk duhet të rezultojë në nënshtrimin e KPK-së ndaj shumicës qeverisëse. Projekt-amendamentet propozojnë që të gjithë anëtarët jo-prokurorë të zgjedhen me shumicë të thjeshtë në Kuvend. Ky propozim shton rrezikun e ndikimit politik mbi KPK-në dhe duhet të rishikohet: zgjedhja me shumicë të thjeshtë duhet të zëvendësohet me një sistem proporcional të zgjedhjeve, ose emërimi i disa anëtarëve jo-prokurorë nga institucionet e jashtme të pavarura ose shoqëria civile*” (paragrafi 71); (iii) “*si përmbledhje, procedura e*

zgjedhjes së anëtarëve jo-prokurorë e propozuar në projekt-amendamente është, në të njëjtën kohë, shumë komplekse dhe shumë e paqartë, dhe për këtë arsye nuk ofron garanci të mjaftueshme kundër manipulimit ose perceptimit të manipulimit. Prandaj, ky propozim duhet të ripunohet substancialisht. Komisioni i Venecias i rikthehet rekomandimit të tij të mëparshëm për zgjedhjen e anëtarëve jo-prokurorë në bazë të sistemit proporcional, ose për të parashikuar emërimin e një numri të caktuar anëtarësh jo-prokurorë nga organe të pavarura, në mënyrë që të arrihet një përbërje pluraliste e KPK-së. Secila nga këto zgjidhje është më e thjeshtë dhe, në të njëjtën kohë, zvogëlon rrezikun e ndikimit të tepruar politik mbi KPK-në” (paragrafi 49); dhe (iv) “prandaj, rekomandimi i parë i Komisionit të Venecias do të ishte të sigurohej që anëtarët jo-prokurorë në përbërjen e ardhshme të KPK-së të zgjedhen në një mënyrë që siguron pluralizëm të mjaftueshëm në përbërjen e KPK-së dhe “kundër-balancon” anëtarët e emëruar me votat e shumicës qeverisëse” (paragrafi 35).

219. Pas Opinionit të parë të Komisionit të Venecias, përmes nenit 5 të draftit të dytë të propozuar nga Qeveria për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit bazik dhe i cili i ishte nënshtruar analizës së dytë të Komisionit të Venecias, si rrjedhojë e së cilës rezultoi Opinioni i dytë i Komisionit të Venecias, plotësim/ndryshimi i nenit 9 të Ligjit bazik, kishte përcaktuar që KPK të përbëhet nga shtatë (7) anëtarë, (i) katër (4) prokurorë, duke përfshirë Kryeprokurorin dhe duke saktësuar që njëri nga prokurorët, të përzgjedhet nga Prokuroria e Apelit ose Prokuroria Speciale, ndërsa dy (2) të tjerë nga prokuroritë themelore; dhe (ii) tre (3) anëtarë jo-prokurorë, dy (2) prej të cilëve zgjedhen nga Kuvendi me shumicë të thjeshtë dhe një (1) anëtar “*caktohet*” nga Avokati i Popullit.
220. Në kontekst të përbërjes së re të propozuar të KPK-së, Komisioni i Venecias, përmes Opinionit të dytë, theksoi sërish se (i) nuk është në kundërshtim me standardet evropiane që të ketë një shumicë anëtarësh jo-prokurorë në një Këshill Prokurorial; megjithatë, u theksua se (ii) është e rëndësishme që prania e shtuar e anëtarëve jo-prokurorë të mos rezultojë në politizimin e KPK-së; dhe që (iii) prokurorët e përzgjedhur nga kolegët e tyre, të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të anëtarësisë (shih, Opinioni e dytë të Komisionit të Venecias, paragrafi 10). Në këtë kuptim dhe duke analizuar nëse amendamentet në projektligj si rezultat i Opinionit të parë janë në përputhje me të gjeturat e Komisionit të Venecias, Komisioni theksoi se “*në KPK-në e ardhshme, prokurorët do të rimarrin një shumicë (të lehtë) bashkë me Kryeprokurorin e Shtetit, çfarë nuk është në kundërshtim me standardet*” (shih, Opinioni e dytë të Komisionit të Venecias, paragrafi 11).
221. Sa i përket propozimit të projektligjit për të shtuar kompetencën e Avokatit të Popullit për të “*caktuar*” një (1) anëtar jo-prokuror në KPK-në e ardhshme, Komisioni i Venecias ka theksuar se (i) supozon se institucioni i Avokatit të Popullit mund të shihet si trup i pavarur në sistemin juridik të Kosovës; (ii) është e rëndësishme që përfshirja e Avokatit të Popullit të mos e kufizojë aftësinë e tij apo saj për të bërë vlerësime të pavarura lidhur me çështjet që përfshijnë KPK-në; dhe (iii) përbërja e re e KPK-së (ku prokurorët e përzgjedhur nga kolegët e tyre përfaqësojnë tre (3) nga shtatë (7) anëtarët, me dy (2) anëtarë jo-prokurorë të zgjedhur nga Kuvendi, një (1) anëtar jo-prokuror i caktuar nga Avokati i Popullit dhe Kryeprokurorin e Shtetit si anëtar *ex officio*, nuk cenon standardet ndërkombëtare (shih, Opinioni e dytë të Komisionit të Venecias, paragrafët 12 dhe 33).
222. Gjykata rikujton që përtej dy Opinioneve përkitazi me Ligjin e kontestuar, ndër vite Komisioni i Venecias ka trajtuar çështje të ngjashme që ndërlidhen për përbërjen e këshillave prokurorial dhe balancin në mes anëtarëve prokurorë dhe jo-prokurorë në kontekste të shteteve të ndryshme dhe të cilat, për aq sa janë relevante për rrethanat e rastit konkret, janë përmbledhur edhe në këtë Aktgjykim përmes dy raporteve kryesore,

përkatësisht (i) Raportit mbi Shërbimin Prokurorial; dhe (ii) Përmbledhjes së Komisionit të Venecias për Prokurorët, që përfshinë edhe pjesë të caktuara të dy Opinioneve për Kosovë.

223. Të lartcekurat, ndër tjerash dhe në parim, theksojnë që për dallim prej emëruesit të përbashkët, përkatësisht standardit të konsoliduar që ekziston përkitazi me pavarësinë e sistemeve gjyqësore, përfshirë edhe këshillat gjyqësor, një i tillë nuk ekziston për sa i përket sistemeve/shërbimeve prokuroriale dhe të cilat varësisht nga Kushtetutat dhe/ose ligjet e aplikueshme, mund t'i nënshtrohen në masa të ndryshme, mbikëqyrjes nga pushtetet ekzekutive dhe/ose legislative, gjithnjë duke përmbajtur garancitë e nevojshme për pavarësinë dhe autonominë e ushtrimit të funksionit të prokurorisë dhe mekanizmat e nevojshëm për të parandaluar çdo lloj ndikimi të pushteteve të tjera në rastet individuale të ndjekjes penale. Të njëjtat Raporte dhe Opinione, duke përfshirë edhe Opinionet e Këshillit Konsultativ për Prokurorët Evropian, theksojnë, megjithatë, se trendet aktuale shkojnë drejt një pavarësie më të madhe edhe të sistemeve prokuroriale. Në raste të pavarësisë së plotë të sistemeve prokuroriale, në parim, këto sisteme janë të menaxhuara nga një institucion i pavarur, siç janë këshillat prokurorial, zgjidhje kjo e adaptuar edhe përmes Kushtetutës të Kosovës.
224. Thënë këtë, sipas Raporteve dhe Opinioneve relevante të Komisionit të Venecias, përderisa një numër shtetesh kanë themeluar këshilla prokurorial, nuk ka një standard uniform rreth përbërjes, strukturës dhe/ose funksioneve përkatëse. Megjithatë, karakteristikë e zakonshme e këtyre këshillave, është që në përbërje të kenë llojllojshmëri apo pluralizëm, përkatësisht një balanc të duhur në mes të anëtarëve prokurorë të përzgjedhur nga vet sistemi prokurorial dhe jo-prokurorë, me këta të fundit, në parim, të nevojshëm për legjitimitetin demokratik të këshillave përkatës, gjithnjë me garancitë e nevojshme për të evituar politizimin e tyre. Varësisht nga sistemet dhe rregullimet kushtetuese dhe/ose ligjore përkatëse, anëtarët jo-prokurorë mund të delegohen ose nominohen edhe nga institucione tjera apo të zgjedhen nga Kuvendi, dhe në atë rast, preferohet të zgjedhen me shumicë të kualifikuar, në mënyrë që të evitohen mundësitë e politizimit dhe ndërhyrjeve politike.
225. Është me rëndësi të theksohet që bazuar në Raportet dhe Opinioneve relevante të Komisionit të Venecias, ndër çështjet më delikate në kuptim të përcaktimit të përbërjes së këshillave prokurorial, është balanci në mes të anëtarëve prokurorë dhe jo-prokurorë. Këtë çështje, përpos Opinionit të parë dhe të dytë përkitazi me Ligjin e kontestuar, Komisioni i Venecias, rishtazi e ka trajtuar edhe në Opinionet për Malin e Zi, Gjeorgjinë, Moldavinë dhe Serbinë, dhe të cilat, për aq sa janë relevante për rrethanat e rastit konkret, janë sqaruar në paragrafët 188-200 të këtij Aktgjykimi.
226. Nga leximi i përbashkët i të gjitha këtyre raporteve dhe opinioneve, përfshirë kontekstet në të cilat janë nxjerrë, balancimi i duhur në mes të anëtarëve prokurorë dhe jo-prokurorë është i nevojshëm (i) për të shmangur rrezikun e korporatizimit, duke marrë parasysh natyrën hierarkike të sistemeve prokuroriale dhe potencialisht, kulturën organizative subordinuese ndaj Kryeprokurorit dhe për pasojë, duke e balancuar përbërjen e këshillave me anëtarë jo-prokurorë; dhe (ii) për të shmangur rrezikun e politizimit në rast të zgjedhjes së anëtarëve jo-prokurorë nga Kuvendi, duke e balancuar përbërjen e këshillave me anëtarë prokurorë të përzgjedhur nga vet sistemi prokurorial. Ky balanc duhet të rezultojë në një përbërje pluraliste të këshillave përkatës, në të cilët anëtarët prokurorë dhe jo-prokurorë, nuk do të kenë mundësi të dominojnë lehtë njëri-tjetrin.
227. Më tej dhe bazuar në Raportet dhe Opinioneve relevante të Komisionit të Venecias, përfshirë edhe dy Opinioneve për Kosovë përkitazi me Ligjin e kontestuar, në përbërje të këshillave prokurorial, në varësi të sistemeve kushtetuese përkatëse dhe duke mos

përcaktuar nëse shumica e anëtarëve duhet të jenë prokurorë apo jo, në parim (i) një numër prokurorësh përzgjedhen nga vet sistemi prokurorial; (ii) një numër anëtarësh mund të zgjedhen nga Kuvendi, ku preferohet zgjedhja me shumicë të kualifikuar ose një sistem proporcional, gjithnjë i shoqëruar me një mekanizëm efektiv de-blokimi; dhe (iii) anëtarë jo-prokurorë që mund të vijnë nga gjyqësori, institucionet e pavarura, shoqëria civile dhe të cilët delegohen *ex-officio* në përbërje të këshillave prokurorial dhe/ose nominohen dhe zgjedhen përmes sistemeve të përcaktuara në Kushtetutat dhe/ose ligjet përkatëse nga pushteti legjislativ.

228. Në kontekst të sqarimeve si më sipër, por me theks, në nenin 16 të Kushtetutës, bazuar në të cilin Kushtetuta është akti më i lartë juridik në Republikën e Kosovës dhe sipas të cilit ligjet dhe aktet tjera juridike duhet të jenë në pajtim me Kushtetutë, Gjykata, siç ka sqaruar më lart, në kontekst të nenit 6 të Ligjit të kontestuar, duhet të vlerësojë nëse (i) struktura e propozuar, përkatësisht proporcioni në mes të anëtarëve prokurorë dhe jo-prokurorë, është në përputhje me pavarësinë kushtetuese të KPK-së, siç është përcaktuar në nenin 110 të Kushtetutës; dhe (ii) kompetenca e Avokatit të Popullit për të “*caktuar*” një (1) anëtar jo-prokuror të KPK-së, është në përputhje me nenet 110 dhe 65 të Kushtetutës.

a) *Përkitazi me balancin në mes anëtarëve prokurorë dhe jo-prokurorë*

229. Gjykata rithekson fillimisht që bazuar në dispozitat kushtetuese, përkatësisht nenin 110 të Kushtetutës, nuk është kontestuese që KPK ka pavarësi të plotë kushtetuese. Kjo pavarësi e përcaktuar me Kushtetutë, përbën thelbin e formës së qeverisjes dhe ndarjes së pushteteve në Republikën e Kosovës dhe po ashtu, përbën vlerë të saj, siç është përcaktuar në nenet 4 dhe 7 të Kushtetutës, respektivisht. Një pavarësi e tillë e institucioneve të përcaktuara me kapitullin VII përkitazi me Sistemin e Drejtësisë, është qartësuar tashmë përmes një numri të Aktgjykimeve të kësaj Gjykate dhe të cilat janë të sqaruara gjithashtu, për aq as është relevante, në pjesën e parimeve të përgjithshme të këtij Aktgjykimi.

230. Gjykata gjithashtu rikujton që përkitazi me përbërjen e KPK-së, Kushtetuta ka dy (2) dispozita përcaktuese, nenin 65 dhe 110 të saj, të cilat përcaktojnë ndërveprimin në mes dy institucioneve, përkatësisht Kuvendit dhe KPK-së, respektivisht, në përcaktimin e përbërjes së këtij të fundit.

231. Më saktësisht, sipas paragrafit 4 të nenit 110 të Kushtetutës, përbërja e KPK-së rregullohet me ligj, të cilin sipas paragrafit 1 të nenit 65 të Kushtetutës, e miraton Kuvendi. Ndërsa, sipas paragrafit 10 të nenit 65 të Kushtetutës, është Kuvendi institucioni që zgjedh anëtarët e KPK-së në pajtim me Kushtetutën. Ushtrimi i funksioneve përkatëse edhe të KPK-së edhe të Kuvendit në këtë kontekst, i nënshtrohet parimeve dhe detyrimeve kushtetuese për balancimin dhe ndarjen e pushteteve. Gjykata thekson që përkundër faktit që Kushtetuta, përmes paragrafit 4 të nenit 110 të saj, ka përcaktuar që përbërja e KPK-së përcaktohet me ligj, duke i lënë Kuvendit kompetencën që të miratojë këtë ligj dhe të zgjedhë anëtarët e KPK-së në mënyrën e përcaktuar me Kushtetutë dhe ligj, kjo kompetencë e Kuvendit, duhet të ushtrohet gjithnjë në përputhje me paragrafin 1 të nenit 110 të Kushtetutës dhe i cili i garanton KPK-së pavarësi të plotë në ushtrimin e funksionit të saj kushtetues. Rrjedhimisht dhe siç është sqaruar tashmë, përderisa Kushtetuta i referohet edhe ligjit në kontekst të, ndër tjerash, përbërjes së KPK-së, garancia e pavarësisë së plotë të KPK-së, e akorduar me Kushtetutë, sigurisht që nuk mund të pakësohet përmes dispozitave ligjore.

232. Në këtë kontekst dhe siç është sqaruar në paragrafët 179-187 të këtij Aktgjykimi, Gjykata rikujton që pas shpalljes së pavarësisë, Kuvendi përmes ligjeve të viteve 2010, 2015 dhe 2019, respektivisht, ka ndryshuar përbërjen e KPK-së tri herë. Përgjatë këtyre tri ligjeve,

KPK ka pasur përbërje të ndryshme. Fillimisht, përmes Ligjit të vitit 2010, KPK-së i ishte përcaktuar përbërja prej nëntë (9) anëtarësh, pesë (5) nga të cilët prokurorë dhe katër (4) jo-prokurorë ndërsa më pas, përmes Ligjeve të viteve 2015 dhe 2019, numri i anëtarëve të KPK-së ishte rritur në trembëdhjetë (13), prej të cilëve, dhjetë (10) prokurorë dhe tre (3) jo-prokurorë. Përpos ndryshimeve/plotësimeve për sa i përket përbërjes dhe raportit në mes të anëtarëve prokurorë dhe jo-prokurorë, edhe mënyra e zgjedhjes së anëtarëve jo-prokurorë i ishte nënshtruar ndryshimeve. Më saktësisht, (i) përmes Ligjit të vitit 2010, administrimi i përzgjedhjes së anëtarëve jo-prokurorë ishte bërë nga KPK; (ii) përmes Ligjit të vitit 2015, administrimi i procesit të zgjedhjes së anëtarëve jo-prokurorë, me përjashtim të administrimit të konkursit për anëtarin e shoqërisë civile, ishte bërë nga Kuvendi; dhe (iii) përmes Ligjit të vitit 2019, edhe administrimi i konkursit për zgjedhjen e anëtarit të shoqërisë civile, kaloi në Kuvend, gjithnjë sipas specifikave që përcaktonte ligji përkatës për KPK-në.

233. Gjykata gjithashtu vëren që, ndër vite, Kuvendi i Republikës ka tentuar të gjejë proporcionin e duhur në mes të anëtarëve prokurorë dhe jo-prokurorë në përbërjen e KPK-së. Përkundër dallimeve në numrin e anëtarëve të KPK-së dhe raportit në mes të anëtarëve prokurorë dhe jo-prokurorë, përgjatë të gjitha rregullimeve ligjore, përkatësisht të gjitha ndryshimeve/plotësimeve të ligjeve për KPK-në që nga shpallja e pavarësisë, kompetenca për emërimin/zgjedhjen e anëtarëve të KPK-së ishte ndarë në mes KPK-së dhe Kuvendit, me përjashtim të përfaqësimit sipas detyrës zyrtare të Kryeprokurorit dhe Ministrisë të Drejtësisë, deri në ndryshimet dhe plotësimet e ligjit të vitit 2015 përkitazi me këtë të fundit. Ligji i kontestuar, përmes ndryshimit të nenit 9 të Ligjit bazik, sërish plotëson/ndryshon këtë strukturë, duke e ndryshuar edhe numrin e anëtarëve, përfshirë raportin në mes të anëtarëve jo-prokurorë dhe prokurorë, por duke e ndryshuar gjithashtu mënyrën e zgjedhjes së tyre, përkatësisht duke i përcaktuar/deleguar edhe Avokatit të Popullit kompetencë për të “caktuar”, përkatësisht zgjedhur një anëtar jo-prokuror të KPK-së.
234. Në kontekst të sqarimeve të lartcekura dhe marrë parasysh (i) paragrafin 4 të nenit 110 të Kushtetutës në ndërlidhje me paragrafin 1 të nenit 65 të Kushtetutës, përkatësisht, përcaktimin e Kushtetutës që përbërja e KPK-së të përcaktohet me ligj të miratuar nga Kuvendi; dhe (ii) standardet dhe parimet në kontekst të përbërjeve të këshillave prokurorial që burojnë nga Raportet dhe Opinionet relevante të Komisionit të Venecias, përfshirë dy Opinionet për Kosovë përkitazi me Ligjin e kontestuar, Gjykata fillimisht thekson se nuk është kontestuese që Kuvendi ka kompetencën kushtetuese për të përcaktuar përbërjen e KPK-së, gjithnjë në përputhje me paragrafin 1 të nenit 110 të Kushtetutës, përkatësisht duke mos cenuar pavarësinë e plotë në ushtrimin e funksionit kushtetues të KPK-së dhe parimet e ndarjes dhe balancit të pushteteve dhe vlerave të Republikës, siç janë të përcaktuar në nenet 4 dhe 7 të Kushtetutës, respektivisht.
235. Gjithashtu, dhe marrë parasysh (i) ndërlidhjen e paragrafit 4 të nenit 110 të Kushtetutës me paragrafin 1 të nenit 110 të Kushtetutës; dhe (ii) standardet dhe parimet në kontekst të përbërjeve të këshillave prokurorial që burojnë nga Raportet dhe Opinionet relevante të Komisionit të Venecias, përfshirë dy Opinionet për Kosovë përkitazi me Ligjin e kontestuar, Gjykata thekson që nuk është kontestuese që një pjesë e anëtarëve të KPK-së, në mënyrën e saktësuar përmes ligjeve të miratuara të Kuvendit, përkatësisht anëtarët prokurorë të saj, përzgjedhen nga vet sistemi prokurorial. Një standard i tillë buron nga Kushtetuta dhe parimet dhe standardet relevante të Komisionit të Venecias, ashtu siç është rasti me (i) përbërjen e Këshillit Gjyqësor dhe i cili përzgjedh një pjesë të anëtarëve të saj nga vet sistemi gjyqësor në mënyrën e përcaktuar me Kushtetutë dhe ligj të aplikueshëm; por dhe (ii) ligjet e KPK-së, ndër vite, bazuar në të cilat anëtarët prokurorë të KPK-së janë përzgjedhur nga vet sistemi prokurorial, ndërsa anëtarët jo-prokurorë janë zgjedhur nga Kuvendi, në mënyrën e saktësuar në këto ligje. Për më tepër, Gjykata vëren që përkundër faktit që të tri institucionet e përcaktuara si

“plotësisht të pavarura” me Kushtetutë, KGJK, KPK dhe Gjykata Kushtetuese, respektivisht dhe të cilat i nënshtrohen natyrës kolektive të vendimmarrjes, Kushtetuta ka përcaktuar shumica të ndryshme për zgjedhjen e anëtarëve të tyre. Më saktësisht, në rastin e KGJK-së dhe KPK-së, ka përcaktuar shumicë të thjeshtë sepse ka përcaktuar/paraparë që një pjesë e anëtarësisë/përbërjes përkatëse të Këshillave përzgjedhet nga vet sistemi gjyqësor dhe/ose prokurorial respektivisht, ndërsa kur ka përcaktuar që të gjithë anëtarët e një institucioni plotësisht të pavarur, siç është Gjykata Kushtetuese, të zgjedhen nga Kuvendi, atëherë ka saktësuar shumicën e nevojshme për zgjedhjen e anëtarëve përkatës në shumicë të kualifikuar prej dy të tretash (2/3) të deputetëve të pranishëm dhe që votojnë.

236. Kontestuese, megjithatë, në rrethanat e rastit konkret, është zvogëlimi i numrit të anëtarëve të KPK-së dhe zvogëlimi i raportit në mes të anëtarëve prokurorë dhe jo-prokurorë, përkatësisht bilanci në mes anëtarëve prokurorë dhe jo-prokurorë dhe mënyra e zgjedhjes së këtyre të fundit, në mënyrë që dy faktorët që rrezikojnë Këshillat Prokurorial, përkatësisht korporatizimi dhe politizimi, të kundër-balancojnë njëra tjetrën.
237. Megjithatë dhe siç është sqaruar në pjesët përkatëse të këtij Aktgjykimi, (i) bazuar në paragrafin 4 të nenit 110 të Kushtetutës, ndër tjerash, përbërja e KPK-së rregullohet me ligj; (ii) tri ligjet paraprake kanë paraparë përbërje të ndryshme të KPK-së, ndërsa në të gjitha rastet, në përbërjen e KPK-së janë përfshirë anëtarë të përzgjedhur nga vet sistemi prokurorial dhe anëtarë jo-prokurorë të përzgjedhur nga KPK dhe/ose të zgjedhur nga Kuvendi; (iii) Kuvendi, bazuar në ligjet përkatëse, ka zgjedhur në mënyrë të vazhdueshme anëtarë jo-prokurorë në përbërje të KPK-së sipas paragrafit 10 të nenit 65 të Kushtetutës; (iv) përderisa nuk ka ndonjë standard të paracaktuar kushtetues dhe/ose që buron nga praktika ndërkombëtare, përfshirë ato të saktësuara përmes Raporteve dhe Opinioneve të Komisionit të Venecias përkitazi me proporcionin në mes të anëtarëve prokurorë dhe jo-prokurorë në këshilla prokurorial, këta të fundit, përkatësisht anëtarët jo-prokurorë, kanë rol të rëndësishëm në përbërjen e këshillave përkatës dhe luajnë rolin e balancimit dhe të shmangies së korporatizimit të mundshëm në sistemin prokurorial, në dobi të pluralizimit dhe legjitimitetit demokratik të tij, për aq sa mënyra e zgjedhjes së tyre është e dizajnuar në mënyrë që të shmang ndikimin e mundshëm politik në Këshill, përkatësisht ndërhyrjen e mundshme në pavarësinë e këshillit përkatës.
238. Për pasojë, Gjykata thekson se marrë parasysh paragrafin 4 të nenit 110 të Kushtetutës në ndërlidhje me paragrafët 1 dhe 10 të nenit 65 të Kushtetutës, përbërja prej (7) anëtarësh e KPK-së, në të cilën përfaqësohen katër (4) prokurorë dhe 3 (tre) anëtarë jo-prokurorë, nuk është në kundërshtim me paragrafin 1 të nenit 110 të Kushtetutës dhe as parimet që burojnë nga standardet e përcaktuara nga Komisioni i Venecias, siç janë shtjelluar në këtë Aktgjykim.

b) *Përkitazi me kompetencën e Avokatit të Popullit për të “caktuar” një anëtarë të KPK-së*

239. Gjykata rikujton që përkitazi me mënyrën e zgjedhjes së anëtarëve jo-prokurorë në KPK, bazuar në Ligjin e kontestuar, një (1) nga tre (3) anëtarët jo-prokurorë *“caktohet”* nga Avokati i Popullit. Kompetenca e Avokatit të Popullit në këtë kontekst, është kontestuar nga parashtuesit e kërkesës dhe KPK por edhe vet Avokati i Popullit. Në këtë kontekst dhe ndër tjerash, është argumentuar që (i) Avokati i Popullit nuk e ka këtë kompetencë të përcaktuar në Kushtetutë; dhe që (ii) marrë parasysh funksionin e Avokatit të Popullit të përcaktuar me Kushtetutë, përkatësisht kompetencën për të mbikëqyrur dhe mbrojtur të drejtat dhe liritë e individëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike, siç është

përcaktuar në nenin 132 të Kushtetutës, duke përfshirë edhe kompetencat e Avokatit të Popullit për çështjet disiplinore përkitazi me prokurorë të përcaktuara sipas Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, kompetenca e këtij institucioni për të “caktuar” një anëtar në KPK, bie ndesh me funksionin e tij kushtetues dhe për pasojë, përbën “konflikt interesi”. Në anën tjetër, Ministria e Drejtësisë, në esencë, thekson se përfshirja e Avokatit të Popullit në KPK, përkatësisht përcaktimi i kompetencës ligjore për të “caktuar” një anëtar në këtë Këshill, buron nga rekomandimet e dala nga Opinionet e Komisionit të Venecias.

240. Gjykata së pari rikujton që pika 1.3.2 e nenit 6 të Ligjit të kontestuar, përcakton që në KPK, një (1) anëtar “caktohet” nga Avokati i Popullit. Së dyti, sipas nenit 10/A (Anëtari jo-prokuror i caktuar nga Avokati i Popullit) i Ligjit të kontestuar përcakton që (i) Avokati i Popullit “caktton” një anëtar në Këshill që përmbushë kushtet nga neni 5, paragrafi 2 i këtij ligji; (ii) Avokati i Popullit mban takim konsultues përmbajtësor me organizatat e shoqërisë civile të cilat janë aktive në fushën e sistemit prokurorial në Kosovë, para “caktimit” të anëtarit të Këshillit; dhe (iii) kur mandati i anëtarit nga paragrafi 1 i këtij neni përfundon para kohe, siç përcaktohet me këtë ligj, Avokati i Popullit “zgjedh” anëtarin, me mandat të plotë, nga dita e mbetjes së vendit të lirë. Së treti, sipas paragrafit 4 të nenit 16 të Ligjit të kontestuar, shkarkimi i anëtarit “të zgjedhur” nga Avokati i Popullit bëhet me vendim të tij. Në kontekst të kësaj të fundit, Gjykata thekson që sipas të njëjtit ligj, (i) anëtarët prokurorë të Këshillit shkarkohen me propozimin e dy të tretave (2/3) të anëtarëve të Këshillit dhe të njëjtit kanë të drejtë ankese në Gjykatë Supreme; (ii) anëtarët e zgjedhur nga Kuvendi, propozohen për shkarkim nga një komision i përbërë nga tre (3) anëtarë prokurorë që nuk janë anëtarë të Këshillit dhe pas propozimit të Këshillit, duke mos e saktësuar shumicën e nevojshme për këtë propozim, votohen në Kuvend me shumicën e deputetëve të pranishëm edhe që votojnë, pa mundësi ankese në Gjykatën Supreme, siç është rasti me anëtarët prokurorë të Këshillit; ndërsa (iii) anëtari i “zgjedhur” nga Avokati i Popullit, shkarkohet vetëm me vendimin e tij/saj, pas propozimit të një komisioni të përbërë nga tre (3) anëtarë prokurorë që nuk janë anëtarë të Këshillit dhe pas propozimit të Këshillit, duke mos e saktësuar shumicën e nevojshme për këtë propozim dhe pa mundësi ankese në Gjykatën Supreme, siç është rasti me anëtarët prokurorë të Këshillit.
241. Në kontekst të kompetencës së Avokatit të Popullit për të “caktuar/zgjedhur” një (1) anëtar jo-prokuror të KPK-së, Gjykata thekson që (i) është e saktë që në Opinionin e parë të Komisionit të Venecias, ky i fundit, kishte marrë edhe Avokatin e Popullit si një shembull të një institucioni që mund të jetë i përfaqësuar në këshilla prokurorial (paragrafi 32); dhe (ii) është gjithashtu e saktë që në Opinionin e dytë të Komisionit të Venecias, ishte theksuar që “caktimi” i një (1) anëtari nga Avokati i Popullit në KPK nuk është detyrimisht në kundërshtim me standardet ndërkombëtare, por gjithashtu në të njëjtin raport, Komisioni i Venecias kishte tërhequr vëmendjen që “është e rëndësishme që përfshirja e Avokatit të Popullit të mos e dëmtojë aftësinë e tij ose të saj që të bëjë përcaktime të pavarura lidhur me çështjet që ndërlidhen me KPK-në” (paragrafi 12).
242. Gjykata gjithashtu vëren që mundësia e përfaqësimit të Avokatit të Popullit në KPK ishte ngritur të paktën edhe në dy Opinionet tjera të Komisionit të Venecias, përkatësisht (i) Opinionin CDL-AD(2021)047 për Moldavinë, lidhur me amendamentet e 24 gushtit 2021 të Ligjit mbi Shërbimin Prokurorial (paragrafi 46); dhe (ii) Opinionin CDL-AD(2008)005 për Malin e Zi, lidhur me projekt-amendamentet e Ligjit mbi Prokurorin e Shtetit të Malit të Zi (paragrafi 53). Në asnjërin rast, Komisioni i Venecias nuk kishte deklaruar shprehimisht kundërshtimin lidhur me përfaqësimin e Avokatit të Popullit në këshillat përkatës prokurorial, përkundër që në Opinionin si më sipër për Moldavinë, ndër tjerash, kishte theksuar se “sa i përket Avokatit të Popullit, është mjaft e pazakontë që një mbrojtës i të drejtave të njeriut të marr pjesë në qeverisjen e sistemit prokurorial. Është e paqartë nëse funksionet si anëtar i KLP-së [Këshillit të Lartë

Prokurorial], janë në përputhje me mandatin e Avokatit të Popullit. Siç bëhet e ditur, në kontekstin moldav, vet Avokati i Popullit, ka refuzuar të merr pjesë në punën e KLP-së. Megjithatë, si figurë neutrale politikisht, mund të shërbej si arbitër në mes të anëtarëve prokurorë dhe atyre jo-prokurorë të afërt me Qeverinë, prandaj pjesëmarrja e tij apo saj në këshill prokurorial, mund të ndihmojë në shmangien e bllokadave” (shih, CDL-AD(2021)047, paragrafi 46).

243. Gjykata, në kontekst të sqarimeve të lartcekura dhe të përcaktimit të Ligjit të kontestuar që Avokatit të Popullit t’ia përcaktojë kompetencën për të “caktuar/zgjedhur” një anëtar të KPK-së, fillimisht thekson që nuk është kontestuese që (i) në rendin kushtetues të Kosovës, Avokati i Popullit është institucion i pavarur dhe kjo është konfirmuar nga një numër aktgjykimesh të Gjykatës ndër vite, përfshirë por duke mos u kufizuar në Aktgjykimet e Gjykatës, në rastet KO29/12 dhe KO48/12, KO73/16, KO171/18, KO203/19 dhe KO219/19; dhe (ii) përfshirja e Avokatit të Popullit në këshilla prokurorial, nuk është detyrues në kundërshtim me praktikën ndërkombëtare, ashtu siç, në kuptim të sistemeve prokuroriale dhe në kontekst të rregullimeve specifike kushtetuese dhe/ligjore, ka edhe praktika në të cilat sistemi prokurorial nuk i nënshtrohet menaxhimit të këshillave por edhe zgjidhjeve tjera kushtetuese dhe/ose ligjore që mund të përshijnë edhe rolin e pushteteve ekzekutive dhe legjislative, siç është shtjelluar në këtë Aktgjykim, bazuar në Raportet dhe Opinionet relevante të Komisionit të Venecias. Thënë këtë, Gjykata thekson që kompetenca e Avokatit të Popullit për të “caktuar/zgjedhur” një (1) anëtar të KPK-së, duhet të vlerësohet në kontekst të rregullimit kushtetues të Republikës së Kosovës.
244. Në këtë kontekst, Gjykata fillimisht rithekson që (i) bazuar në nenin 16 të Kushtetutës, kjo e fundit është akti më i lartë juridik i Republikës së Kosovës, me të cilën duhet të jenë në pajtim ligjet dhe aktet e tjera juridike dhe nga e cila buron pushteti qeverisës; dhe (ii) Kushtetuta përbëhet nga një tërësi unike e parimeve dhe vlerave kushtetuese mbi bazën e të cilave është ndërtuar dhe duhet të funksionojë Republika e Kosovës dhe se normat e parapara me Kushtetutë, duhet të lexohen dhe interpretohen në ndërlidhje me njëra tjetrën dhe bazuar në vlerat kushtetuese të Republikës së Kosovës, përfshirë ndarjen dhe balancimin e pushteteve.
245. Bazuar në dy parimet e lartcekura dhe rrethanat e rastit konkret, Gjykata thekson që kushtetutshmëria e Ligjit të kontestuar në kontekst të përcaktimit të kompetencës së Avokatit të Popullit, për të “caktuar/zgjedhur” një anëtar jo-prokuror në KPK, duhet të vlerësohet në kontekst të (i) paragrafit 10 i nenit 65 të Kushtetutës, sipas të cilit e ndër tjerash, Kuvendi zgjedh anëtarët e Këshillit Prokurorial; (ii) kompetencave kushtetuese të Kuvendit për të zgjedhur bartësit e funksioneve të institucioneve të pavarura kushtetuese të përcaktuara në Kapitujt VII dhe XII të Kushtetutës, respektivisht; dhe (iii) nenit 132 i Kushtetutës, sipas të cilit, dhe ndër tjerash, Avokati i Popullit, ka kompetenca për të mbikëqyrur të gjitha autoritetet publike, përfshirë Këshillin Prokurorial, në kontekst të veprimeve e mosveprimeve të paligjshme lidhur me të drejtat dhe liritë themelore.
246. Fillimisht dhe në kontekst të kompetencave të Kuvendit për të zgjedhur bartës të funksioneve të institucioneve të pavarura kushtetuese, Gjykata rikujton që (i) bazuar në paragrafin 10 të nenit 65 të Kushtetutës, Kuvendi zgjedh anëtarët e Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit Prokurorial në pajtim me Kushtetutën; ndërsa (ii) bazuar në paragrafin 4 të nenit 110 të Kushtetutës, përbërja e Këshillit Prokurorial si dhe dispozitat për emërimin, shkarkimin, mandatin, strukturën organizative dhe rregullat e procedurës, rregullohen me ligj. Në kontekst të ndërlidhjes së këtyre dy dispozitave, Gjykata, sipas edhe sqarimeve të mësipërme, rithekson që (i) në rastin e Këshillave Gjyqësor dhe Prokurorial, një pjesë e anëtarësisë përzgjedhet nga vet sistemet përkatëse, përkatësisht sistemi gjyqësor dhe prokurorial; ndërsa (ii) sipas paragrafit 10 të nenit 65 të

Kushtetutës, anëtarët tjerë zgjedhen nga Kuvendi, në rast të KGJK-së sipas përcaktimeve kushtetuese, ndërsa në rastin e KPK-së, sipas përcaktimeve të ligjit të miratuar nga Kuvendi.

247. Thënë këtë dhe për të vlerësuar nëse paragrafi 4 i nenit 110 të Kushtetutës, mund të nënkuptojë që jo vetëm kompetenca për përcaktimin e përbërjes, por edhe kompetenca kushtetuese e Kuvendit për të zgjedhur anëtarët e KPK-së, mund të delegohet te një autoritet tjetër publik përmes ligjit, Gjykata në vijim, do të analizojë të gjithë dispozitat e Kushtetutës të cilat saktësojnë kompetencën e Kuvendit për “zgjedhur” bartës të funksioneve të institucioneve pavarura.
248. Në këtë kontekst, Gjykata rikujton që kompetencat e Kuvendit për të zgjedhur bartës të funksioneve publike, janë të përcaktuara në (i) Kapitullin IV të Kushtetutës përkitazi me Kuvendin e Republikës së Kosovës; dhe (ii) Kapitullin XII të Kushtetutës përkitazi me Institucionet e Pavarura.
249. Në të parin përkatësisht, nenin 65 të Kapitullit IV të Kushtetutës, kjo e fundit përcakton që Kuvendi (i) zgjedh dhe shkarkon Kryetarin dhe nënkryetarët e Kuvendit; (ii) zgjedh dhe mund të shkarkojë Presidentin e Republikës së Kosovës; (iii) zgjedh Qeverinë dhe shpreh mosbesimin ndaj saj; (iv) zgjedh anëtarët e Këshillit Gjyqësor dhe të Këshillit Prokurorial; dhe (v) propozon gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese.
250. Mënyra e zgjedhjes së bartësve të funksioneve të lartcekura në rastin e (i) zgjedhjes së Kryetarit dhe nënkryetarët e Kuvendit; (ii) Presidentit të Republikës së Kosovës; (iii) Qeverisë; dhe (iv) anëtarëve të Këshillit Gjyqësor dhe gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, është përcaktuar në nenet 67 [Zgjedhja e Kryetarit dhe Nënkryetarëve], 86 [Zgjedhja e Presidentit], 95 [Zgjedhja e Qeverisë], 108 [Këshilli Gjyqësor i Kosovës] dhe neni 114 [Përbërja dhe Mandati i Gjykatës Kushtetuese] të Kushtetutës. Siç është sqaruar më lart, në rastin e Këshillit Prokurorial, paragrafi 10 i neni 65 të Kushtetutës, saktëson që Kuvendi zgjedh anëtarët e Këshillit Prokurorial, ashtu siç edhe atij gjyqësor, ndërsa në paragrafin 4 të nenit 110 të Kushtetutës përcakton që përbërja e Këshillit Prokurorial të Kosovës, si dhe dispozitat për emërimin, shkarkimin, mandatin, strukturën organizative dhe rregullat e procedurës, rregullohen me ligj.
251. Në anën tjetër, në të dytin, përkatësisht, Kapitulli XII të Kushtetutës, kjo e fundit përcakton Institucionet e Pavarura, siç janë Avokati i Popullit, Auditori i Përgjithshëm, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Banka Qendrore e Kosovës, Komisioni i Pavarur i Medieve dhe Agjencitë e Pavarura. Me përjashtim të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, përbërjen e të cilit e përcakton Kushtetuta dhe Agjencive të Pavarura, të cilat janë institucione të krijuara nga Kuvendi, në bazë të ligjeve përkatëse, të cilat rregullojnë themelimin, funksionimin dhe kompetencat e tyre, në rastin e katër (4) institucioneve tjera të pavarura, Kushtetuta, ose përcakton kompetencën e Kuvendit për të zgjedhur bartësit/titullarët e tyre ose e delegon këtë çështje në nivel të rregullimit ligjor.
252. Më saktësisht dhe së pari, në rastin e Avokatit të Popullit, (i) neni 134 [Kualifikimi, Zgjedhja dhe Shkarkimi i Avokatit të Popullit] i Kushtetutës përcakton që Avokatin e Popullit e zgjedh Kuvendi me shumicën e votave të të gjithë deputetëve të tij; ndërsa (ii) neni 133 [Zyra e Avokatit të Popullit], përcakton që Avokati i Popullit ka një (1) ose më shumë zëvendës dhe që numri, mënyra e përzgjedhjes dhe mandati i tyre, rregullohen me ligjin për Avokatin e Popullit. Së dyti, në rastin e Auditorit të Përgjithshëm, neni 136 [Auditori i Përgjithshëm i Kosovës], përcakton që i njëjti zgjedhet me shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit. Së treti, në rastin e Bankës Qendrore, neni 140 [Banka Qendrore e Kosovës], përcakton që qeverisja e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës dhe procedurat e zgjedhjes dhe të nominimit të anëtarëve të Bordit të Bankës Qendrore të Kosovës rregullohen me ligjin, i cili duhet të sigurojë pavarësinë dhe

- autonominë e saj. Dhe së katërtri, neni 141 [Komisioni i Pavarur i Medieve], përcakton që anëtarët e Komisionit të Pavarur të Medieve zgjedhen sipas ligjit, përmes një procesi transparent.
253. Sipas sqarimit të dhënë, përkundër faktit që në rastin e (i) zëvendës Avokatëve të Popullit; (ii) Guvernatorit të Bankës Qendrore dhe anëtarëve të Bordit të saj; dhe (iii) anëtarëve të Komisionit të Pavarur të Medieve, Kushtetuta, në kuptim të zgjedhjes, përzgjedhjes, emërimit, nominimit, i referohet rregullimit në nivel ligji, të gjithë bartësit e funksioneve të lartcekura publike të institucioneve të pavarura kushtetuese, në fakt zgjedhen nga Kuvendi.
 254. Më saktësisht, (i) sipas nenit 10 (Procedura për zgjedhjen e zëvendësve të Avokatit të Popullit) të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, zëvendësit e Avokatit të Popullit i zgjedh Kuvendi i Republikës së Kosovës, me shumicën e votave të deputetëve të pranishëm dhe që votojnë; (ii) sipas nenit 38 (Emërimet) të Ligjit nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, Guvernatori dhe anëtarët e Bordit të Bankës Qendrore zgjedhen nga Kuvendi dhe më pas emërohen nga Presidenti; dhe (iii) sipas nenit 11 (Zgjedhja e anëtarëve të KPM-së) të Ligjit nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave, anëtarët e KPM-së emërohen/zgjedhen nga Kuvendi.
 255. Bazuar në sqarimet e lartcekura, pa përjashtim, rezulton që në rastin e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe pa marrë parasysh nëse Kushtetuta specifikisht përcakton zgjedhjen e tyre nga Kuvendi apo këtë zgjedhje/emërim e delegon në nivel të rregullimit ligjor përmes Kushtetutës, të gjitha ligjet përkatëse që rregullojnë institucionet e pavarura kushtetuese, saktësojnë kompetencën e Kuvendit për të zgjedhur titullarët/bartësit e funksioneve të tyre.
 256. Në kontekstin e sqarimeve të mësipërme, Gjykata vë theks në faktin që në të gjitha rastet e institucioneve të pavarura të përcaktuara me Kushtetutë, duke marrë parasysh statusin e tyre të pavarur kushtetues dhe natyrën e funksioneve të tyre, kompetenca për zgjedhjen e titullarëve/bartësve të funksioneve përkatëse, ushtrohet nga Kuvendi, pa marrë parasysh nëse kjo kompetencë është saktësuar specifikisht në Kushtetutë ose është deleguar sipas Kushtetutës në nivel rregullimi ligjor.
 257. Në rastin e KPK-së, kjo kompetencë e Kuvendit, është saktësuar në nivel Kushtetute, përkatësisht në paragrafin 10 të nenit 65 të saj, dhe në vlerësimin nëse një kompetencë e tillë mund të bartet/delegohet në autoritete tjera publike përmes ligjit të miratuar sipas paragrafit 4 të nenit 110 të Kushtetutës, Gjykata përtej faktit që tashmë ka sqaruar që kompetenca e Kuvendit për të zgjedhur/emëruar udhëheqësit dhe/ose anëtarët institucioneve të pavarura kushtetuese, dhe pa marrë parasysh nëse një kompetencë e tillë është saktësuar në Kushtetutë dhe/ose është deleguar në nivel rregullimi ligjor, nuk është bartur/deleguar në asnjë rast, gjithashtu rikujton praktikën e saj gjyqësore, përmes të cilës ka mbajtur qëndrimin që kompetencat e përcaktuara me Kushtetutë, nuk mund të barten në autoritete tjera publike përmes akteve më të ulëta, përkatësisht ligjeve. Ky qëndrim është sqaruar, ndër tjerash, përmes Aktgjykimit në rastin KO43/19, me parashtrues *Albulena Haxhiu, Driton Selmanaj dhe tridhjetë (30) deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës*, përkritazi me vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit nr. 06/L-145 për Detyrat, Përgjegjësitë dhe Kompetencat e Delegacionit Shtetëror të Republikës së Kosovës në Procesin e Dialogut me Serbinë (në tekstin e mëtejme: Aktgjykimi i Gjykatës në rastin KO43/19). Gjykata rikujton që përmes këtij Aktgjykimi, kishte vlerësuar kushtetutshmërinë e Ligjit të lartcekur, sipas të cilit, ndër tjerash, Kuvendi kishte autorizuar Delegacionin përkatës Shtetëror që të negociojë dhe të arrijë marrëveshje me Serbinë gjatë procesit të dialogut. Në vlerësimin e këtij ligji, të cilin Gjykata e kishte shpallur si në kundërshtim me Kushtetutën, për aq sa është relevante për rrethanat e rastit konkret, Gjykata kishte theksuar se (i) në kuadër të sistemit juridik

- kushtetues, të gjitha normat tjera, i nënshtrohen epërsisë së normës kushtetuese; (ii) kur një materie është e përcaktuar me Kushtetutë, ajo nuk mund të ndryshohet, minohet apo transformohet përmes një akti me fuqi me të ulët juridike, sikurse që është ligji; dhe që (iii) kompetencat e përcaktuara shprehimisht me Kushtetutë, në kontekst të këtij rasti përkitazi me politikën e jashtme, nuk mund të barteshin te institucione apo trupa tjerë të posaçëm, përmes akteve më të ulëta juridike (shih, Aktgjykimin e Gjykatës në rastin KO43/19, paragrafët 68 dhe 88).
258. Në fakt dhe për më tepër, vlen të theksohet që përkundër faktit që neni 133 [Zyra e Avokatit të Popullit], saktëson që numri, mënyra e përzgjedhjes dhe mandati i zëvendës Avokatëve të Popullit, rregullohen me ligjin për Avokatin e Popullit, ky i fundit, bazuar në Ligjin për Avokatin e Popullit, nuk e ka as kompetencën për të “*caktuar/zgjedhur*” zëvendësit e vet, sepse në bazë të Ligjit të lartcekur, një kompetencë të tillë e ushtron Kuvendi i Republikës së Kosovës.
259. Kjo është e rëndësishme edhe në kontekst të kompetencave kushtetuese të Avokatit të Popullit. Më saktësisht, Gjykata thekson që roli dhe kompetencat e Avokatit të Popullit janë të saktësuara me nenin 132 [Roli dhe Kompetencat e Avokatit të Popullit] dhe i cili saktëson që: (i) Avokati i Popullit mbikëqyrë dhe mbron të drejtat dhe liritë e individëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike; (ii) Avokati i Popullit është i pavarur në ushtrimin e detyrës dhe nuk pranon udhëzime e ndërhyrje nga organet, institucionet ose autoritetet e tjera, të cilat ushtrojnë pushtetin në Republikën e Kosovës; dhe (iii) çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj. Përtej kësaj, bazuar në nenin 135 [Raportimi i Avokatit të Popullit] dhe 113 [Palët e Autorizuara dhe Juridiksioni] të Kushtetutës, Avokati i Popullit mund t’i drejtohet në mënyrë të drejtpërdrejtë Gjykatës Kushtetuese lidhur me kushtetutshmërinë e ligjeve, të dekreteve të Presidentit e të Kryeministrit dhe të rregulloreve të Qeverisë.
260. Marrë parasysh funksionet e kushtetuese të Avokatit të Popullit në rendin kushtetues të Republikës së Kosovës, me theks në kompetencën e tij për të mbikëqyruar dhe mbrojtur të drejtat dhe liritë e individëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike, përfshirë vet Këshillin Prokurorial dhe të drejtën që të referojë çështje në mënyrë të drejtpërdrejtë në Gjykatën Kushtetuese, Kushtetuta, në nenin 134 [Kualifikimi, Zgjedhja dhe Shkarkimi i Avokatit të Popullit] ka përcaktuar specifikisht që Avokati i Popullit dhe zëvendësit e saj/tij, nuk mund të jenë anëtarë të asnjë partie politike, as të ushtrojnë veprimtari politike, shtetërore a private profesionale dhe as të marrin pjesë në organet drejtuese të organizatave civile, ekonomike dhe tregtare.
261. Për më tepër, marrë parasysh natyrën e kompetencave kushtetuese të Avokatit të Popullit, përfshirë funksionin mbikëqyrës ndaj autoriteteve publike në kontekst të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore, bazuar në Ligjin për Përgjegjësinë Disiplinore për Gjyqtarët dhe Prokurorët, të njëjtit i janë dhënë kompetenca të zgjeruara përkitazi me procedurat disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve, kompetenca këto të Këshillave Gjyqësor dhe Prokurorial, respektivisht. Më saktësisht, bazuar në nenet 9 (Ankesat ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve për shkelje disiplinore), 11 (Vepra penale), 12 (Procedura hetimore), 14 (Procedurat Disiplinore) dhe 15 (Ankesa ndaj vendimeve disiplinore) të Ligjit të lartcekur, Avokati i Popullit ka (i) kompetencën për pranimin e ankesave nga persona fizikë dhe juridikë kundër gjyqtarëve dhe prokurorëve; (ii) në raste kur shkelja e supozuar përmban elemente të veprës penale, çështja i referohet Prokurorit të Shtetit dhe njoftohet Avokati i Popullit; (iii) kompetencën për t’i kërkuar Këshillit përkatës fillimin e hetimeve kundër gjyqtarëve

- dhe prokurorëve, përfshirë kryetarët e gjykatave, kryeprokurorëve dhe Kryeprokurorit të Shtetit, lidhur me veprimet e tyre si autoritete kompetente në procedurë disiplinore; dhe (iv) të drejtën që të parashtrijë ankesë në Gjykatën Supreme në rast se Këshillat përkatëse nuk ndërmarrin veprime, në cilësinë e tyre si autoritete kompetente.
262. Në kontekst të të lartcekurave, Gjykata rikujton që edhe (i) vet Komisioni i Venecias, kishte ngritur për vëmendje faktin që është e rëndësishme që përfshirja e Avokatit të Popullit të mos e kufizojë aftësinë e tij apo saj për të bërë vlerësime të pavarura lidhur me çështjet që përfshijnë KPK-në; dhe (ii) vet Avokati i Popullit, ka ngritur dilema para Gjykatës lidhur me kushtetutshmërinë e kompetencës që i përcakton Ligji i kontestuar për të “*caktuar/zgjedhur*” një (1) anëtar jo-prokuror të KPK-së.
263. Për më tepër, dhe për aq sa është relevante në rrethanat e rastit konkret, në kuptim të përbërjes së KGJK-së dhe KPK-së, ligjet e aplikueshme, gjithashtu kanë bërë dallimin në mes të “*zgjedhjes*”, “*nominimit/propozimit*” apo “*përfaqësimit sipas detyrës zyrtare*” në një institucion të pavarur kushtetues. Ky është rasti edhe me KPK-në sipas ligjeve të viteve 2010, 2015 dhe 2019, respektivisht, të cilët kanë përcaktuar (i) të drejtën e nominimeve/propozimeve të institucioneve të pavarura, përfshirë Odën e Avokatëve dhe fakultetet juridike dhe kompetencën e Kuvendit që të zgjedh, në mënyrën e saktësuar në ligjet e aplikueshme, nga nominimet/propozimet përkatëse; dhe (ii) përfaqësimin sipas detyrës zyrtare, siç ishte rasti me përfaqësimin e Ministrit të Drejtësisë në Këshill, deri në ndryshim/plotësimet e ligjit në vitin 2015 dhe me Kryeprokurorin e Shtetit. Një kombinim të tillë alternativash dhe mekanizmash në fakt, rekomandon edhe Komisioni i Venecias edhe në dy Opinionet për Kosovë, siç është sqaruar në pjesën e parimeve të përgjithshme të këtij Aktgjykimi. Është pikërisht një sistem i tillë, i cili përtej anëtarëve prokurorë të përzgjedhur nga vet sistemi dhe anëtarëve jo-prokurorë të zgjedhur nga Kuvendi dhe të cilët, varësisht nga mënyra e përcaktuar e votimit, mund të rrisin edhe rrezikun e politizimit të Këshillit, mundësojnë pluralizimin e një Këshilli, duke balancuar edhe ndikimin e prokurorëve, por edhe ndikimin e anëtarëve jo-prokurorë të zgjedhur nga Kuvendi në vendimmarrjen e Këshillit.
264. Thënë këtë, Avokati i Popullit, bazuar në Ligjin e kontestuar, (i) nuk nominon e as (ii) nuk përfaqësohet sipas detyrës zyrtare në KPK, por (iii) “*cakton*”, përkatësisht, “*zgjedh*” një anëtar jo-prokuror në KPK, kompetencë kjo që bazuar në paragrafin 10 të nenit 65 të Kushtetutës, i është përcaktuar Kuvendit të Republikës. Për më tepër dhe siç është sqaruar më lart, përtej kompetencës së “*caktimit/zgjedhjes*” së anëtarit përkatës, Avokati i Popullit, sipas Ligjit të kontestuar, ka edhe kompetencën për të shkarkuar të njëjtin me vendim vetanak, vetëm pas propozimit të Këshillit, pa e përcaktuar shumicën e nevojshme për një propozim të tillë dhe pa mundësi ankese në Gjykatën Supreme, për dallim nga (i) kolegët prokurorë për shkarkimin e të cilëve është e nevojshme shumica prej dy të tretash (2/3) e anëtarëve të Këshillit dhe të cilët mund të kontestojnë këtë vendim në mënyrë të drejtpërdrejtë në Gjykatën Supreme; dhe (ii) kolegët tjerë jo-prokurorë dhe të cilët mund të shkarkohen vetëm pas votimit të shumicës së deputetëve të pranishëm dhe që votojnë në Kuvend.
265. Prandaj dhe marrë parasysh (i) nenin 16 të Kushtetutës, bazuar në të cilin Kushtetuta është akti më i lartë juridik në Republikën e Kosovës dhe sipas të cilit ligjet dhe aktet tjera juridike duhet të jenë në pajtim me Kushtetutë; (ii) paragrafin 1 të nenit 110 të Kushtetutës, përmes të cilit KPK-së i akordohet pavarësi e plotë kushtetuese; (iii) paragrafin 10 të nenit 65 të Kushtetutës, bazuar në të cilin anëtarët e KPK-së zgjedhen nga Kuvendi në mënyrën e përcaktuar me Kushtetutë; (iv) faktin që përkitazi me institucionet e pavarura kushtetuese të Kapitujve VII dhe XII, kompetenca e Kuvendit për zgjedhur bartësit e funksioneve të tyre publike nuk është deleguar në autoritete publike, as atëherë kur Kushtetuta specifikisht nuk e përcakton kompetencën Kuvendit

për të “zgjedhur” por të njëjtën e delegon në nivel ligji; (v) praktikën e gjyqësore të Gjykatës, bazuar në të cilën kompetencat e përcaktuara me Kushtetutë për institucione përkatëse, nuk mund të barten te institucionet tjera përmes akteve më të ulëta juridike, përfshirë ligjet; dhe (vi) marrë parasysh kompetencat kushtetuese të Avokatit të Popullit, përfshirë funksionin e tij mbikëqyrës ndaj autoriteteve publike, përfshirë vet Këshillin Prokurorial, Gjykata konstaton që dispozita e Ligjit të kontestuar, përmes së cilës Kuvendi i bartë kompetencën e vet për të zgjedhur një (1) anëtar jo-prokuror të KPK-së Avokatit të Popullit, është në kundërshtim me Kushtetutën.

266. Gjykata vëren që qëllimet e ligjvënësit mund të jenë ndërlidhur me rritjen e pluralizmit në KPK dhe që një zgjidhje e tillë, sipas Komisionit të Venecias, nuk është në kundërshtim me standardet ndërkombëtare. Thënë këtë, Gjykata gjithashtu thekson që çfarëdo zgjidhjesh të parapara në ligje të miratuara nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, duhet që fillimisht dhe para së gjithash, të jetë në përputhje me dispozitat e Kushtetutës së Republikës.
267. Për pasojë dhe përfundimisht, Gjykata konstaton që pika 1.3.2 e paragrafit 1 të nenit 6 [pa titull] të Ligjit të kontestuar, përmes të cilit ndryshohet dhe plotësohet neni 9 (Përbërja e anëtarëve të Këshillit) i Ligjit bazik, nuk është në përputhshmëri me paragrafin 1 të nenit 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit], paragrafin 10 të nenit 65 të Kushtetutës dhe nenin 132 [Roli dhe Kompetencat e Avokatit të Popullit] të Kushtetutës.

2. Vlerësimi i kushtetutshmërisë së nenit 7 [pa titull] të Ligjit të kontestuar përmes të cilit ndryshohet dhe plotësohet neni 10 (Procedura e zgjedhjes së anëtarëve të Këshillit nga Kuvendi) të Ligjit bazik

268. Fillimisht dhe për qëllime të vlerësimit të kushtetutshmërisë së nenit 7 të Ligjit të kontestuar, Gjykata do të paraqesë: (i) thelbin e pretendimeve të parashtruesve të kërkesës dhe komentet mbështetëse të dorëzuara nga palët e interesuara, si dhe thelbin e argumenteve të palës kundërshtarë (shih, paragrafët 46-137 të këtij Aktgjykimi për një pasqyrim të hollësishëm të argumenteve dhe kundër argumenteve përkatëse); dhe (ii) përgjigjen e Gjykatës lidhur me këto pretendime përkitazi me jokushtetutshmërinë e nenit përkatës.

(i) Thelbi i pretendimeve/argumenteve dhe kundër argumenteve të parashtruesve dhe palëve të interesuara

269. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se (i) dispozitat e Ligjit të kontestuar që përcaktojnë zgjedhjen e dy (2) anëtarëve jo-prokurorë me shumicë të thjeshtë të votave në Kuvend, rrisin rrezikun që anëtarët e KPK-së të emëruar nga Kuvendi, të jenë persona që potencialisht përfaqësojnë politikën e shumicës së Kuvendit dhe jo persona me autoritet dhe integritet që marrin besimin gjithëpërfshirës të përfaqësuesve të popullit; (ii) në mënyrën se si është përcaktuar zgjedhja e dy (2) anëtarëve jo-prokurorë nga Kuvendi, këta anëtarë lehtësisht mund të emërohen me vetëm tridhjetë e një (31) vota të deputetëve, që si përfaqësim është minimal për emërim në një institucion të rëndësishëm kushtetues siç është KPK; dhe (iii) zgjedhja e këtyre anëtarëve të KPK-së, duhet të bëhet me ligj dhe me votat e se paku gjashtëdhjetë e një (61) deputeteve ose me dy të tretat (2/3) e deputetëve që votojnë në procedurën e zgjedhjes së tyre nga Kuvendi. Komentet e parashtruesve të kërkesës, përkitazi me shumicën e nevojshme për të zgjedhur anëtarët jo-prokurorë nga Kuvendi, mbështeten edhe nga KPK. Në anën tjetër, Ministria e Drejtësisë, thekson që neni 80 i Kushtetutës, shprehimisht përcakton se ligjet, vendimet dhe aktet tjera, miratohen nga Kuvendi me shumicën e votave të deputetëve të pranishëm dhe që votojnë, përveç në rastet kur është ndryshe e

përcaktuar me këtë Kushtetutë, andaj sipas tyre, “çdo mënyrë tjetër e votimit do të ishte në kundërshtim me Kushtetutën”.

(ii) *Vlerësimi i Gjykatës*

270. Gjykata fillimisht rikujton që neni 10 (Procedura e propozimit, zgjedhjes dhe e shkarkimit të anëtarëve që zgjedhën nga Kuvendi) i Ligjit bazik përcakton procedurën e zgjedhjes së anëtarëve të KPK-së nga Kuvendi, duke përcaktuar, ndër tjerash, (i) afatet e procedurave përkatëse; (ii) mënyrën e administrimit të konkurseve; (iii) komisionet përkatëse të Kuvendit dhe procedurat për zgjedhjen e anëtarëve jo-prokurorë të KPK-së. Përkitazi me mënyrën e zgjedhjes së anëtarëve jo-prokurorë, paragrafët 7, 9 dhe 10 të të njëjtit nen, përcaktojnë që (i) Kuvendi me votim të fshehtë zgjedh anëtarët e Këshillit; (ii) nëse në rrethin e parë, kandidatët e propozuar nga komisioni përkatës i Kuvendit nuk marrin shumicën e votave të të gjithë deputetëve të pranishëm dhe që votojnë, atëherë në raundin e dytë konsiderohet i zgjedhur kandidati me numrin më të madh të votave; dhe (iii) shkarkimi i anëtarëve jo-prokurorë të Këshillit, bëhet nga Kuvendi me shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit, me propozim të komisionit përkatës ose Këshillit, përkatësisht me së paku gjashtëdhjetë e një (61) vota të Kuvendit.
271. Neni 7 i Ligjit të kontestuar për ndryshimin dhe plotësimin e nenit 10 të Ligjit bazik, në paragrafin 12 të tij, përcakton që Kuvendi e zgjedh anëtarin jo-prokuror të KPK-së me shumicën e votave të deputetëve të pranishëm dhe që votojnë. Ndërsa, paragrafi 4 i nenit 19 të Ligjit të kontestuar, përcakton shkarkimin e anëtarit jo-prokuror të Këshillit, në shumicën e votave të deputetëve të pranishëm dhe që votojnë, për dallim nga Ligji bazik, që në këtë kontekst kërkon shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit.
272. Gjykata vëren që bazuar në Raportet dhe Opinionet relevante të Komisionit të Venecias, përfshirë edhe Opinionet për Kosovën përkitazi me Ligjin e kontestuar, është theksuar specifikisht që preferohet që zgjedhja e anëtarëve të KPK-së, të bëhet me shumicë të kualifikuar dhe jo me shumicë të thjeshtë. Komisioni i Venecias, në mënyrë të vazhdueshme ka rekomanduar që anëtarët e këshillave të (i) zgjedhen nga Kuvendi përmes shumicës së kualifikuar, të përcjellë me një mekanizëm efektiv de-blokimi; (ii) përmes një sistemi proporcional përmes të cilit do të sigurohej që shumica parlamentare të mos ketë mundësinë që të zgjedh të gjithë anëtarët jo-prokurorë të Këshillit; ose (iii) përmes nominimeve ose emërimeve të drejtpërdrejta nga akterë jo-qeveritarë, përfshirë gjyqësorin, avokatinë dhe universitetet, për t'i përmendur disa. Edhe në Opinionet për Kosovën, Komisioni i Venecias ka theksuar që disa ose të gjithë anëtarët jo-prokurorë, rekomandohet të zgjedhen përmes shumicës së kualifikuar, me supozimin që shumica parlamentare nuk e ka shumicën e kualifikuar në Kuvend, duke vënë theks edhe në rëndësinë e një mekanizmi efektiv de-blokimi, në mënyrë që anëtarët përkatës të mund të zgjedhen edhe nëse shumica e nevojshme nuk do të mund të arrihej në Kuvend (shih, Opinionin e Parë të Komisionit të Venecias, paragrafi 29; dhe Mendim i përkohshëm për Projektligjin për Prokurorinë e Shtetit të Malit të Zi CDL-AD(2014)042, paragrafi 49). Një rekomandim i tillë, që anëtarët jo-prokurorë të Këshillave përkatës Prokurorial të zgjedhën me shumicë të kualifikuar apo një sistemi proporcional në mënyrë që të sigurohej që anëtarët përkatës të Këshillit të mos jenë të zgjedhur vetëm nga shumica qeverisëse e përfaqësuar në Kuvend, ishte saktësuar edhe në Opinionet tjera të Komisionit të Venecias, siç është sqaruar në pjesën e parimeve të përgjithshme të këtij Aktgjykimi (shih, ndër tjerash edhe Raportin mbi Shërbimin e Prokurorisë, paragrafi 66).
273. Për më tepër, këto çështje janë trajtuar specifikisht edhe në Përmbledhjen e Raporteve dhe Opioneve të Komisionit të Venecias lidhur me shumicat e kualifikuara dhe mekanizmat përkatës de-blokues sa i përket Zgjedhjes nga Parlamenti të gjyqtarëve të

Gjykatave Kushtetuese, Prokurorëve të Përgjithshëm, anëtarëve të Këshillave Gjyqësore dhe Prokuroriale dhe Avokatit të Popullit, përkatësisht Përmbledhjes CDL-PI(2018)003rev të 27 qershorit 2018 (në tekstin e mëtejme: Përmbledhja lidhur me shumicat e kualifikuara dhe mekanizmat de-bllokues), në lidhje me zgjedhjen nga Kuvendet të gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, Prokurorit të Përgjithshëm, anëtarëve të këshillave gjyqësor dhe prokurorial dhe Avokatit të Popullit.

274. Në fakt, përmes kësaj Përmbledhje, Komisioni i Venecias, rekomandon që zgjedhja e anëtarëve të të gjitha institucioneve të lartcekura, të bëhet me shumicë të kualifikuar, duke marrë parasysh rëndësinë e këtyre institucioneve në çdo sistem kushtetues dhe shmangien e mundësisë që anëtarët e institucioneve të drejtësisë dhe atyre të pavarura, të jenë të zgjedhur përmes një shumice të thjeshtë parlamentare dhe për pasojë, të mund t'i nënshtrohen zgjedhjeve potencialisht të politizuara. Thënë këtë, e njëjta Përmbledhje, thekson edhe nevojën për dizajnimin e mekanizmave efektiv të de-bllokimit. Në kontekst të kësaj të fundit, ndër tjerash, theksohet se Komisioni “*është i mendimit se vështirësia e arritjes së një shumice të kualifikuar dhe që kjo mund të ketë për rrjedhojë rrezikun e paralizimit të mosfunksionimit të një institucioni që ka, sidomos në “institucionet mbrojtëse”, nuk duhet të shpie në heqjen dorë nga kërkesa për shumicë të kualifikuar, por tek dizejtimi i një mekanizmi të posaçëm dhe efektiv de-bllokimi. Duhet të gjendet një balanc në mes të interesave superiore të shtetit për ruajtjen e funksionimit të institucioneve dhe urgjencës demokratike që këto institucione të jenë të balansuara dhe jo të dominuara vetëm nga shumica qeverisëse. Thënë ndryshe, interesi kryesor shtetëror, qëndron në ruajtjen e institucioneve demokratike shtetërore*”; dhe (ii) “*shumicat e kualifikuara synojnë të sigurojnë që një marrëveshje më e gjerë është arritur në Kuvend, meqë kërkojnë që shumica të gjej kompromis me pakicën. Për këtë arsye, shumicat e kualifikuara zakonisht kërkojnë në fusha më të ndjeshme, sidomos sa i përket zgjedhjes së zyrtarëve në institucione shtetërore. Megjithatë, ka një rrezik që kërkesa që të arrihet shumicë e kualifikuar, të çojë në bllokim, i cili nëse nuk adresohet në mënyrën e duhur dhe me kohë, mund të shpie në paralizimin e një institucioni relevant. Një mekanizëm de-bllokues ka për synim të shmangë bllokimin e tillë. Sidoqoftë, funksioni parësor i një mekanizmi de-bllokues, është pikërisht që t'i mundësojë procedurës origjinale të funksionojë, duke shtyrë edhe shumicën edhe pakicën që të gjejnë një kompromis, me qëllim që të shmangët mekanizmi de-bllokues. Në të vërtetë, shumicat e kualifikuara forcojnë pikërisht pozicionin e pakicave parlamentare, ndërsa mekanizmat de-bllokues, e përmirësojnë prap balancin. Sigurisht, mekanizmat e tillë nuk duhet të veprojnë si dekurajim për arritjen e një marrëveshjeje mbi bazën e shumicës së kualifikuar në rastin e parë. Mund t'i ndihmojnë procesit të arritjes së marrëveshjes, nëse mekanizmi de-bllokues është joatraktiv si për shumicën, ashtu edhe për pakicën”* (shih, Përmbledhjen e Komisionit të Venecias lidhur me shumicat e kualifikuara dhe mekanizmat debllokues, faqe 4, 13).
275. Thënë këtë, Gjykata vëren se Kushtetuta në nenin 69 [Orari i Seancave dhe Kuorumi], fillimisht përcakton që Kuvendi ka kuorum kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e të gjithë deputetëve të Kuvendit. Më tej, neni 80 [Miratimi i Ligjeve], përcakton që ligjet, vendimet dhe aktet tjera, miratohen nga Kuvendi me shumicën e votave të deputetëve të pranishëm dhe që votojnë, përveç në rastet kur përcaktohet ndryshe me Kushtetutë. Këto përjashtime, Kushtetuta i përcakton në mënyrë specifike, duke i ndarë në dy (2) kategori: (i) rastet kur kërkohet shumicë që dallon nga e thjeshta; dhe (ii) rastet kur vendimmarrja është kushtëzuar edhe me shumicën e caktuar të komuniteteve joshumicë të përfaqësuara në Kuvendin e Republikës së Kosovës.
276. Kategoria e parë njeh (i) shumicën e të gjithë deputetëve të Kuvendit; dhe (ii) shumicën e kualifikuar, përkatësisht atë prej dy të tretave (2/3), megjithatë, duke dalluar rastet kur kërkohet shumica e kualifikuar e të gjithë deputetëve të Kuvendit apo shumica e

kualifikuar e deputetëve të pranishëm dhe që votojnë. Në rastin e parë përfshihen rrethanat e përcaktuara me nenin 86 [Zgjedhja e Presidentit], përkatësisht votimin e tretë për zgjedhjen e Presidentit, pasi të kenë dështuar dy votimet e para. Ndërsa, në rastin e dytë, dhe në të cilën kërkohen dy të tretat (2/3) e të gjithë deputetëve të Kuvendit, hyjnë rrethanat e përcaktuara me (i) nenin 18 [Ratifikimi i Marrëveshjeve Ndërkombëtare], përkitazi me ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare për çështjet e saktësuara në paragrafin 1 të këtij neni; (ii) nenin 20 [Bartja e Sovranitetit]; (iii) nenin 65 [Kompetencat e Kuvendit] bazuar në amendamentin nr. 23 të Kushtetutës përkitazi me dhënien e amnistisë; (iv) nenin 67 [Zgjedhja e Kryetarit dhe Nënkryetarëve], përkitazi me shkarkimin e Kryetarit dhe nënkryetarëve të Kuvendit; (v) nenin 76 [Rregullorja e Punës], përkitazi me miratimin e Rregullave të Punës së Kuvendit; (vi) nenin 82 [Shpërndarja e Kuvendit], përkitazi me shpërndarjen e Kuvendin në mënyrën e përcaktuar me Kushtetutë; (vii) neni 86 [Zgjedhja e Presidentit], në rastin e dy votimeve të para për zgjedhjen e Presidentit; (viii) neni 90 [Mungesa e Përkohshme e Presidentit], përkitazi me vendimmarrjen nëse Presidenti është përkohësisht i paaftë për të ushtruar përgjegjësitë e veta në mënyrën e përcaktuar me Kushtetutë; (ix) nenin 91 [Shkarkimi i Presidentit], përkitazi me shkarkimin e Presidentit lidhur me rrethanat e përcaktuara në paragrafin 3 të këtij neni; (x) nenin 131 [Gjendja e Jashtëzakonshme], përkitazi me zgjatjen e periudhës së gjendjes së jashtëzakonshme, të përcaktuar me paragrafin 6 të këtij neni; (xi) nenin 134 [Kualifikimi, Zgjedhja dhe Shkarkimi i Avokatit të Popullit], përkitazi me shkarkimin e Avokatit të Popullit; dhe (xii) nenin 136 [Auditori i Përgjithshëm i Kosovës] përkitazi me shkarkimin e Auditorit të Përgjithshëm. Ndërsa, rastet në të cilat kërkohet shumica e dy të tretave (2/3) të deputetëve që janë të pranishëm dhe që votojnë, përfshijnë rrethanat e përcaktuara përmes (i) neni 68 [Seancat], përkitazi me rastet kur, përjashtimisht, mbledhjet e Kuvendit duhet të jenë të mbyllura; (ii) nenin 131 [Gjendja e Jashtëzakonshme], përkitazi me dhënien e pëlqimit nga Kuvendi lidhur me dekretin e Presidentit për shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme, siç përcaktohet në paragrafin 3 të këtij neni; dhe (iii) nenin 114 [Përbërja dhe Mandati i Gjykatës Kushtetuese], përkitazi me zgjedhjen e shtatë (7) gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese.

277. Në anën tjetër, në kategorinë e dytë përfshihen rastet kur vendimmarrja është e kushtëzuar edhe me shumicën e caktuar të komuniteteve joshumicë të përfaqësuara në Kuvendin e Republikës së Kosovës, përkatësisht, (i) nenin 81 [Legjislacioni me Interes Vital], (i ndryshuar përmes Amendamentit nr. 2 të Kushtetutës) përkitazi me miratimin, ndryshimin ose shfuqizimin e kategorisë së ligjeve të saktësuara me Kushtetutë, raste në të cilat kërkohet vota e shumicës së deputetëve të Kuvendit dhe të shumicës së deputetëve të Kuvendit, të cilët mbajnë vendet e garantuara për përfaqësuesit e komuniteteve që nuk janë në shumicë; (ii) nenin 96 [Ministritë dhe Përfaqësimi Komuniteteve], përkitazi me mënyrën e zgjedhjes së ministrave dhe zëvendësministrave nga komuniteti serb dhe nga komunitetet e tjera joshumicë; (iii) nenin 114 [Përbërja dhe Mandati i Gjykatës Kushtetuese], përkitazi me zgjedhjen e dy (2) gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, rast ky në të cilin vendimi merret me shumicën e votave të deputetëve të Kuvendit, të cilët janë të pranishëm dhe që votojnë, por që mund të bëhet vetëm pas pëlqimit të shumicës së deputetëve të Kuvendit, të cilët i mbajnë vendet që janë garantuar për përfaqësuesit e komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë; dhe (iv) nenet 65 [Kompetencat e Kuvendit] dhe 144 [Amendamenti], përkitazi me amendamentimin e Kushtetutës, ku kërkohen dy të tretat (2/3) e votave të të gjithë deputetëve të tij, përfshirë dy të tretat (2/3) e të gjithë deputetëve që mbajnë vendet e garantuara për përfaqësuesit e komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë.
278. Bazuar në sqarimin e mësipërm, është e qartë që vendimet në Kuvendin e Kosovës merren, si rregull, me shumicë të thjeshtë të votave, përpos në rastet kur është përcaktuar specifikisht ndryshe. Rasti i zgjedhjes së anëtarëve jo-prokurorë të KPK-së,

- marrë parasysh që Kushtetuta nuk ka përcaktuar ndryshe, bie në kuadër të nenit 80 të Kushtetutës.
279. Njëjtë është rasti edhe me zgjedhjen e anëtarëve të KGJK-së. Kushtetuta, përcakton që gjashtë (6) nga trembëdhjetë (13) anëtarët e KGJK-së zgjedhjen nga Kuvendi, përderisa katër (4) prej tyre përfaqësojnë, përkatësisht zgjedhen nga deputetët e Kuvendit që mbajnë vende të garantuara për përfaqësuesit e komunitetit serb ose komuniteteve tjera joshumicë. Përkitazi me zgjedhjen e dy (2) anëtarëve të KGJK-së nga deputetët të cilët mbajnë vendet e fituara gjatë ndarjes së përgjithshme të vendeve, Kushtetuta nuk specifikon shumicën e nevojshme, dhe për pasojë, shumica përcaktohet bazuar në paragrafin 1 të nenit 80 të Kushtetutës, sipas të cilit, siç është sqaruar më lart, ligjet, vendimet dhe aktet tjera miratohen nga Kuvendi me shumicën e votave të deputetëve të pranishëm dhe që votojnë, përveç në rastet kur është ndryshe e përcaktuar me këtë Kushtetutë.
280. Thënë këtë, Gjykata duhet megjithatë të theksojë, që pa marrë parasysh nenin 80 të Kushtetutës, pushtetit legjislativ, ka përcaktuar edhe shumica më të larta për zgjedhjen e anëtarëve të KGJK-së dhe KPK-së përmes ligjeve të miratuara ndër vite. Më saktësisht, (i) neni 10 i Ligjit bazik përcakton shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit, përkatësisht të paktën gjashtëdhjetë e një (61) vota, për shkarkimin e anëtarëve jo-prokurorë të Këshillit; dhe (ii) neni 3 dhe neni 6 i Ligjit të vitit 2015, përcaktojnë shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit, përkatësisht të paktën gjashtëdhjetë e një (61) vota për zgjedhjen e anëtarëve jo-prokurorë të Këshillit dhe shumicën njëjtë për shkarkimin e tyre. Ngjashëm, (i) neni 10 i Ligji për KGJK-në, përcakton shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit, përkatësisht të paktën gjashtëdhjetë e një (61) vota, për shkarkimin e anëtarëve të KGJK-së të zgjedhur nga Kuvendi; dhe (ii) neni 4 i Ligjit të vitit 2015 për KGJK-në, përcakton shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit, përkatësisht të paktën gjashtëdhjetë e një (61) vota për zgjedhjen e anëtarëve të KGJK-së nga Kuvendi, duke saktësuar mekanizmin pasues të de-blokimit, përkatësisht shumicën e deputetëve të pranishëm dhe që votojnë. Për më tepër, bazuar në nenin 13 (Shkarkimi nga funksioni i Avokatit të Popullit dhe zëvendësve të tij/saj) të Ligjit për Avokatin e Popullit, edhe zëvendësit e Avokatit të Popullit shkarkohen nga Kuvendi me shumicën e të gjithë deputetëve të Kuvendit. Një qasje e tillë, përmes të cilës anëtarët e këshillave përkatës do të zgjedheshin me shumicë të kualifikuar ose edhe sisteme tjera proporcionale të votimit dhe të cilat do të siguronin që zgjedhja e një anëtari jo-prokuror në këshilla nuk do të përfaqësonte vetëm shumicën qeverisëse të përfaqësuar në Kuvend, është rekomanduar në mënyrë të vazhdueshme edhe nga Komisioni i Venecias, siç është sqaruar tashmë në këtë Aktgjykim.
281. Megjithatë dhe marrë parasysh (i) paragrafin 1 të nenit 80 të Kushtetutës, sipas të cilit, Kuvendi vendos me shumicën e votave të deputetëve të pranishëm dhe që votojnë, përveç në rastet kur është ndryshe e përcaktuar me këtë Kushtetutë; dhe (ii) faktin që ky nuk është rasti përkitazi me zgjedhjen e anëtarëve jo-prokurorë të KPK-së nga Kuvendi, Gjykata konstaton që paragrafi 12 i nenit 7 [pa titull] të Ligjit të kontestuar përmes të cilit ndryshohet neni 10 (Procedura e zgjedhjes së anëtarëve të Këshillit nga Kuvendi) i Ligjit bazik, nuk është në kundërshtim me Kushtetutën.

3. Vlerësimi i kushtetutshmërisë së nenit 8 [pa titull] i Ligjit të kontestuar përmes të cilit ndryshohet, përkatësisht plotësohet neni 10 (Procedura e propozimit, zgjedhjes dhe e shkarkimit të anëtarëve që zgjedhen nga Kuvendi) të Ligjit bazik, përkatësisht neni i ri 10/A (Anëtari jo prokurorë i caktuar nga Avokati i Popullit) të Ligjit të kontestuar

282. Gjykata rikujton që neni 8 [pa titull] i Ligjit të kontestuar, përkatësisht neni i ri 10/A (Anëtari jo prokurorë i caktuar nga Avokati i Popullit) i Ligjit të kontestuar, përcakton mënyrën e “caktimit/zgjedhjes”, së anëtarit jo-prokuror nga Avokati i Popullit.
283. Megjithatë, marrë parasysh që Gjykata tashmë ka konstatuar që pika 1.3.2 e paragrafit 1 të nenit 6 [pa titull] të Ligjit të kontestuar, përmes të cilit ndryshohet dhe plotësohet neni 9 (Përbërja e anëtarëve të Këshillit) i Ligjit bazik, nuk është në përputhshmëri me paragrafin 1 të nenit 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit], paragrafin 10 të nenit 65 të Kushtetutës dhe nenin 132 [Roli dhe Kompetencat e Avokatit të Popullit] të Kushtetutës, Gjykata nuk e konsideron të nevojshme që të trajtojë më tej kushtetutshmërinë e nenit 8 të Ligjit të kontestuar, përkatësisht neni të ri 10/A të Ligjit të kontestuar.
284. I njëjti, nuk është në përputhshmëri me paragrafin 1 të nenit 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit], paragrafin 10 të nenit 65 të Kushtetutës dhe nenin 132 [Roli dhe Kompetencat e Avokatit të Popullit] të Kushtetutës, për arsyet të cilat janë të shtjelluara në paragrafët 208-267 të këtij Aktgjykimi.

4. Vlerësimi i kushtetutshmërisë së nenit 13 [pa titull] të Ligjit të kontestuar përmes të cilit ndryshohet dhe plotësohet neni 15 (Kuorumi dhe Vendimmarrja) i Ligjit bazik

285. Fillimisht dhe për qëllime të vlerësimit të kushtetutshmërisë së nenit 13 të Ligjit të kontestuar, përkatësisht paragrafit 2 të tij, që plotëson nenin 15 të Ligjit bazik, duke i shtuar paragrafin e ri 2/a, Gjykata në vijim do të paraqesë: (i) thelbin e pretendimeve të parashtruesve të kërkesës dhe komentet mbështetëse të dorëzuara nga palët e interesuara, si dhe thelbin e argumenteve të palës kundërshtare (shih, paragrafët 46-137 të këtij Aktgjykimi për një pasqyrim të hollësishëm të argumenteve dhe kundër-argumenteve përkatëse); dhe (ii) përgjigjen e Gjykatës lidhur me këto pretendime përkitazi me jokushtetutshmërinë e nenit përkatës.

(i) Thelbi i pretendimeve/argumenteve dhe kundër-argumenteve të parashtruesve dhe palëve të interesuara

286. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se mënyra e përcaktimit të kuoromit dhe shumicës vendimmarrëse përkatëse në KPK, ndër tjerash, cenon pavarësinë e Këshillit, të përcaktuar me nenin 110 të Kushtetutës dhe mënyrën e ndarjes dhe balancit të pushteteve, të përcaktuar me nenin 4 të Kushtetutës. Në këtë kontekst, parashtruesit e kërkesës, ndër tjerash, theksojnë se (i) përveç kushtit të domosdoshëm të kuoromit vendimmarrës prej 5 (pesë) anëtarësh, paragrafi i ri 2/a, që i është shtuar nenit 15 të Ligjit bazik, përmes nenit 13 të Ligjit të kontestuar, për çdo vendimmarrje të rëndësishme të KPK-së, kërkon shumicë të kualifikuar votash, e cila duhet të përfshijë dy (2) vota të anëtarëve nga radhët e anëtarëve jo-prokurorë, pra votat e dy (2) ose të paktën të njërit prej dy (2) anëtarëve jo-prokurorë të zgjedhur me shumicë të thjeshtë nga Kuvendi ose/dhe votën e anëtarit jo-prokuror që “caktohet” me vendim të Avokatit të Popullit; (ii) në rast të dështimit të arritjes së shumicës së nevojshme në radhën e parë të votimit, për radhën e dytë të votimit, kërkohet shumica e kualifikuar prej dy të tretave (2/3) të të gjithë anëtarëve të KPK-së, që gjithashtu, në esencë, kushtëzohet me përfshirjen e të paktën një (1) vote të njërit prej dy (2) anëtarëve jo-prokurorë, të zgjedhur me shumicë të thjeshtë nga Kuvendi dhe/ose votën e anëtarit që caktohet me

vendim të Avokatit të Popullit; (iii) në rrethana të tilla, jo vetëm që do të bllokohej vendimmarrja e Këshillit, por anëtarët jo-prokurorë do të marrin rol vendimtar në çdo vendim të KPK-së, duke e politizuar skajshmërisht jo vetëm punën e tij, por edhe propozimin e kandidatëve të ardhshëm për prokurorë ose udhëheqës të prokurorive; dhe (iv) mënyra e përcaktuar e kuorumit dhe shumicës vendimmarrëse në KPK, e cila varet nga pjesëmarrja dhe/ose vota e anëtarëve jo-prokurorë të Këshillit, rrezikon funksionimin përmbajtësor dhe bllokimin e punës së KPK-së lidhur me çështjet kryesore, siç janë (i) zgjedhja e Kryeprokurorit të Shtetit, kryeprokurorëve të prokurorive të Republikës së Kosovës; dhe (ii) procedurat e disiplinimit, transferimit dhe avancimit të prokurorëve. Sipas parashtruesve të kërkesës, pushtetet e pavarura mund t'i nënshtrohen kontrollit reciprok, por ky kontroll asnjëherë nuk mund të rezultojë me mbivendosje të pushtetit tjetër ndaj pushtetit të pavarur, ndërsa kërkesa për shumicë të kualifikuar, efektivisht i siguron të drejtë vetoje anëtarëve jo-prokurorë, duke e vendosur kështu kontrollin e pushtetit legjislativ mbi KPK-në.

287. Në anën tjetër, Ministria e Drejtësisë konteston pretendimet e lartcekura, duke theksuar, ndër tjerash, se (i) votimi i tillë parashihet vetëm për radhën e parë të votimit dhe se në radhën e dytë mjaftojnë dy të tretat (2/3) e votave të të gjithë anëtarëve, që nënkupton se votat e katër (4) prokurorëve dhe të anëtarit të caktuar nga Avokati i Popullit, janë të mjaftueshme për marrjen e vendimeve të caktuara; (ii) qëllimi i përfshirjes së domosdoshme të së paku një (1) anëtari jo-prokuror për marrjen e vendimeve të caktuara, ka për qëllim eliminimin e rrezikut të “*korporatizimit*” të KPK-së, duke pamundësuar prokurorët që të marrin vendime të vetëm; (iii) “*është laudëruar*” nga Komisioni i Venecias për faktin se prokurorëve nuk u mundësohet të qeverisin të vetëm dhe se pikërisht Komisioni i Venecias, ka propozuar “*mekanizmin e debllokimit*”, i cili sipas Ministrisë së Drejtësisë është adresuar gjatë shqyrtimit në Kuvend; dhe (iv) kjo formë e kuorumit dhe votimit nga anëtarët e KPK-së, mundëson që i njëjti të funksionojë si organ pluralist dhe të zbatojë kompetencat e veta kushtetuese dhe se kjo nuk është në asnjë mënyrë në kundërshtim me nenet 4, 109 ose 110 të Kushtetutës.

(ii) *Vlerësimi i Gjykatës*

288. Gjykata fillimisht rikujton që neni 15 (Kuorumi dhe Vendimmarrja) i Ligjit bazik, përcakton që (i) kuorumi i Këshillit formohet nga nëntë (9) anëtarë; dhe (ii) vendimet e Këshillit merren me shumicë të thjeshtë votash të anëtarëve të pranishëm, përveç nëse ligji parasheh ndryshe. Rrethanat në të cilat i njëjti parasheh ndryshe, janë të përcaktuara në nenin 19 (Procedurat disiplinore për anëtarët e Këshillit) të Ligjit bazik, i cili në rastin e shkarkimit të anëtarëve të Këshillit, përcakton shumicën prej dy të tretave (2/3) të anëtarëve të Këshillit.
289. Përmes nenit 9 të draftit të parë të projektligjit të propozuar për plotësim dhe ndryshim të Ligjit bazik, i cili i ishte nënshtuar analizës së parë të Komisionit të Venecias, si rrjedhojë e së cilës rezultoi Opinioni i parë i Komisionit të Venecias, ndryshim/plotësimi i nenit 15 të Ligjit bazik, kishte përcaktuar që kuorumi vendimmarrës në KPK përbëhet nga pesë (5) anëtarë. Ndërsa, përmes nenit 14 të këtij drafti të projektligjit, që plotëson Ligjin bazik me, ndër tjerash, nenin e ri 36/C, (i) kuorumi vendimmarrës ishte zvogëluar në vetëm katër (4) anëtarë, përkatësisht në vetëm katër (4) anëtarët jo-prokurorë, derisa anëtarët prokurorë të zgjedheshin sipas dispozitave të ligjit të ri; dhe (ii) kishte përcaktuar kuorumin vendimmarrës prej pesë (5) anëtarësh për trajtimin e çështjeve disiplinore, ndërsa vendimmarrjen për këto raste, me shumicë të thjeshtë.
290. Gjykata rikujton që përmes Opinioni të parë, Komisioni i Venecias, çështjet që ndërliidhen me shumicën vendimmarrëse brenda Këshillit, i kishte trajtuar në nivel të

parimeve të përgjithshme dhe kryesisht në kontekst të zgjedhjes së anëtarëve jo-prokurorë dhe balancit përkatës me anëtarët prokurorë, duke theksuar, ndër tjerash, se (i) *“reformimi i KPK-së nuk duhet të shpie në nënshtrimin e tij ndaj shumicës qeverisëse në Kuvend. Çfarë është e rëndësishme, është që përbërja e KPK-së të jetë mjaftueshëm pluraliste për të siguruar që prokurorët nuk mund të qeverisin të vetëm dhe njëkohësisht, që anëtarët jo-prokurorë, zgjedhja e të cilëve është bërë me votat e shumicës ose që përfaqësojnë pushtetin ekzekutiv, të mos mund t’i mbivotojnë lehtësisht”* (shih, Opinionin e parë, paragrafi 28); (ii) *“një model tjetër ngërthen mundësinë e një sistemi proporcional për zgjedhjen e anëtarëve jo-prokurorë, ku disa nga ta do të zgjedheshin me votat e opozitës. Në një model të tillë, për të kaluar vendimet, anëtarët prokurorë do të duhej të merrnin mbështetjen e një numri të caktuar të anëtarëve jo-prokurorë dhe në anën tjetër, anëtarët jo-prokurorë të afërt me shumicën, nuk do të mund të qeverisnin të vetëm, por do të duhej të merrnin mbështetjen e/ose disa anëtarëve prokurorë ose të disa anëtarëve “të opozitës”* (shih, po aty, paragrafi 31); dhe (iii) *“prandaj, rekomandimi i parë i Komisionit të Venecias do të ishte që të sigurohet se anëtarët jo-prokurorë në përbërjen e ardhshme të KPK-së, të zgjedhen në një mënyrë që do të siguronte pluralizëm të mjaftueshëm në përbërjen e KPK-së dhe do të “kundërbalancoje” anëtarët e emëruar me votat e shumicës qeverisëse”* (shih, po aty, paragrafi 35).

291. Bazuar në të lartcekurat, rezulton që, në parim, sipas Komisionit të Venecias (i) përderisa duhet të evitohet mundësia që prokurorët të qeverisin të vetëm, po aq duhet të evitohet mundësia që anëtarët jo-prokurorë të zgjedhur nga shumica qeverisëse në Kuvend, të mund t’i mbivotojnë anëtarët prokurorë të Këshillit; duke sugjeruar për pasojë, që (ii) mënyra e zgjedhjes së anëtarëve jo-prokurorë nga Kuvendi, të jetë me shumicë të kualifikuar dhe/ose përmes një sistemi proporcional që mundëson përfaqësimin në Këshill edhe të anëtarëve jo-prokurorë të cilët nuk janë zgjedhur detyrimisht nga shumica qeverisëse e përfaqësuar në Kuvend.
292. Më pas dhe pas Opinionit të parë të Komisionit të Venecias, përmes nenit 13 të draftit të dytë të projektligjit të propozuar për plotësim dhe ndryshimin e nenit 15 të Ligjit bazik, përmes paragrafit të ri 2/a, ishte përcaktuar që (i) kuorumi vendimmarrës të përbëhet nga pesë (5) anëtarë të Këshillit, përpos nëse është përcaktuar ndryshe me ligj; dhe (ii) shumica vendimmarrëse, sa i përket të gjitha rasteve që ndërlidhen me Kryeprokurorin e Shtetit, kryeprokurorët e prokurorive, çështjet disiplinore, si dhe miratimit të akteve nënligjore që rregullojnë zgjedhjen e kryeprokurorëve dhe emërimin, transferimin, disiplinën dhe promovimin e prokurorëve, është po aq sa kuorumi, përkatësisht pesë (5) vota mbështetëse, me kushtin që dy (2) prej tyre, të përfaqësojnë vota të anëtarëve jo-prokurorë.
293. Opinioni i dytë i Komisionit të Venecias, në vlerësimin e zgjidhjes së lartcekur, kishte theksuar se marrë parasysh Opinionin e parë, në të cilin ishte trajtuar, ndër tjerash, rreziku i peshës së madhe të pjesëmarrjes së Kryeprokurorit në një Këshill të dominuar nga prokurorët, ndikimi i Kryeprokurorit në vendimmarrjen e KPK-së për çështjet disiplinore do të mund të kufizohet, përmes përcaktimit të shumicës së kualifikuar prej pesë (5) anëtarësh, përfshirë dy (2) anëtarë jo-prokurorë. Komisioni i Venecias, në Opinionin e dytë, e kishte cilësuar këtë si një zgjidhje *“shitesë e dobishme”*, në kontekst të zvogëlimit të ndikimit të Kryeprokurorit në fushën e çështjeve disiplinore” (shih, Opinionin e dytë, paragrafët 14 dhe 33).
294. Megjithatë, Komisioni i Venecias kishte theksuar që kriteri i *“shumicës speciale”* të saktësuar në nenin 2/a kërkon vëmendje sepse (i) përderisa nuk i lejon anëtarët prokurorë të vendosin të vetëm dhe që është pozitive; në anën tjetër (ii) ky mekanizëm ngërthen mundësinë e bllokadave të vazhdueshme, nëse anëtarët e Këshillit të emëruar nga Kuvendi, votojnë së bashku dhe bllokojnë vendime të caktuara, përfshirë vendimin

për të zgjedhur Kryeprokurorin e Shtetit; për pasojë dhe prandaj, (iii) “do të ishte e këshillueshme të parashihet një mekanizëm de-blokues për raste të tilla, që do t'i mundësonte KPK-së të marrë këto vendime në rast se anëtarët prokurorë dhe jo-prokurorë, nuk gjejnë kompromis. Parametrat specifikë të një mekanizmi të tillë de-blokues, do të mund të identifikoheshin nga ligjberësi, në bashkëbisedim me partnerët ndërkombëtarë dhe palët kryesore të interesit” (shih, Opinionin e dytë, paragrafi 15).

295. Më pas dhe pas Opinionit të dytë të Komisionit të Venecias, neni 13 i Ligjit të kontestuar, ishte amendamentuar në Kuvend, duke i shtuar paragrafit 2/a edhe një fjali shtesë, përmes të cilës ishte përcaktuar radha e dytë e votimit në Këshill, me shumicën prej dy të tretave (2/3) të anëtarëve të Këshillit. Më saktësisht, sipas këtij neni të amendamentuar në Kuvend, dhe i cili nuk i është nënshtruar vlerësimit të mëtejshëm të Komisionit të Venecias, vendimmarrja në Këshill do të organizohej me dy radhë votimit, përkatësisht (i) në radhën më parë me pesë (5) vota, me kushtin që dy (2) prej tyre të jenë të anëtarëve jo-prokurorë; ndërsa (ii) në radhën e dytë të votimit, me shumicë të kualifikuar prej dy të tretave (2/3) të anëtarëve të Këshillit.
296. Gjykata fillimisht dhe në kontekst të dispozitës së kontestuar, rikujton që çështjet që ndërlidhen me kuorumin dhe vendimmarrjen, janë rregulluar në mënyra të ndryshme përmes ligjeve të viteve 2010, 2015 dhe 2019, varësisht nga ndryshimet në përbërje të KPK-së. Më saktësisht, (i) neni 12 (Selia e Këshillit, Kuorumi dhe Natyra Publike e Takimeve) i Ligjit të vitit 2010, në një strukturë të Këshillit që përbëhej nga pesë (5) anëtarë prokurorë dhe katër (4) anëtarë jo-prokurorë, kishte përcaktuar kuorumin prej gjashtë (6) anëtarësh, ndërsa vendimmarrjen, me shumicë të thjeshtë të anëtarëve të pranishëm, përveç nëse ligji kishte përcaktuar ndryshe; (ii) neni 8 [pa titull] i Ligjit të vitit 2015 që ndryshonte dhe plotësonte Ligjin e vitit 2010, në një strukturë të Këshillit që përbëhej nga dhjetë (10) anëtarë prokurorë dhe tre (3) anëtarë jo-prokurorë, kishte përcaktuar kuorumin prej nëntë (9) anëtarësh, ndërsa vendimmarrjen, me shumicë të thjeshtë të anëtarëve të pranishëm, përveç nëse ligji kishte përcaktuar ndryshe; dhe (iii) neni 15 (Kuorumi dhe Vendimmarrja) i Ligjit të vitit 2019, në një strukturë të Këshillit që përbëhej nga dhjetë (10) anëtarë prokurorë dhe tre (3) anëtarë jo-prokurorë, kuorumin e kishte përcaktuar sërish në nëntë (9) anëtarë, ndërsa vendimmarrjen, me shumicë të thjeshtë të anëtarëve të pranishëm, përveç nëse ligji kishte përcaktuar ndryshe. Në të tri rastet, referenca në përjashtim të rregullit të vendimmarrjes me shumicë të thjeshtë, përmes nenit 11 (Procedurat Disiplinore për Anëtarët e Këshillit), nenit 8 (Pushimi dhe shkarkimi nga funksioni i anëtarit të Këshillit) dhe nenit 19 (Procedurat disiplinore për anëtarët e Këshillit) të ligjeve të viteve 2010, 2015 dhe 2019, respektivisht, ndërlidhej me vendimmarrjen përkitazi me shkarkimin e anëtarëve të Këshillit, me ç'rast kërkohej shumica prej dy të tretash (2/3) të anëtarëve të Këshillit. Ngjashëm, në rastin e KGJK-së, vendimet merren me shumicë të thjeshtë votash të anëtarëve të pranishëm, përveç nëse ligji parasheh ndryshe, ndërsa bazuar në nenin 19 (Procedurat disiplinore për anëtarët e Këshillit) të Ligjit për KGJK-në, ky përjashtim vlen për vendimmarrjen e KGJK-së për shkarkimin e anëtarit të saj, me ç'rast kërkohet shumica e kualifikuar prej dy të tretash (2/3) të anëtarëve të KGJK-së.
297. Bazuar në sqarimin e lartcekur, Gjykata vëren që përgjatë ligjeve përkitazi me KPK-në, (i) kuorumi vendimmarrës nuk ka qenë gjithnjë konsistent dhe ka ndryshuar varësisht nga struktura dhe përbërja e KPK-së; (ii) vendimmarrja gjithnjë i është nënshtruar shumicës së thjeshtë; dhe (iii) të vetmet përjashtime, janë ndërlidhur me shkarkimin e anëtarëve të KPK-së dhe KGJK-së respektivisht, raste këto të cilat vendimmarrja i është nënshtruar shumicës së kualifikuar prej dy të tretash (2/3) të anëtarëve të Këshillave përkatës.
298. Thënë këtë dhe në kontekst të sqarimeve si më sipër dhe pretendimeve të parashtruesve të kërkesës dhe përgjigjeve përkatëse të palëve të interesuara, Gjykata në vijim, do të

shqyrtojë dy çështje thelbësore në kontekst të nenit 13 të Ligjit të kontestuar: (i) kuorumin; dhe (ii) shumicën vendimmarrëse, respektivisht.

(a) Përkitazi me kuorumin

299. Për sa i përket kuorunit të vendimmarrjes, Gjykata fillimisht thekson që (i) paragrafi 1 i nenit 4 (Pavarësia dhe paanshmëria e anëtarëve të Këshillit) të Ligjit bazik të vitit 2019 parasheh se anëtarët e KPK-së, pra pa marrë parasysh mënyrën e zgjedhjes, ushtrojnë detyrat e tyre në mënyrë të pavarur, profesionale dhe të paanshme dhe kjo nënkupton që të njëjtit nuk përfaqësojnë në asnjë mënyrë interesat e autoriteteve që i kanë zgjedhur; (ii) anëtarët e KPK-së kanë detyrim të pjesëmarrjes në funksionet dhe vendimmarrjen e KPK-së, ashtu siç e kanë këtë detyrim të gjithë zyrtarët publikë të Republikës në institucionet përkatëse dhe që ky parim tashmë është saktësuar edhe përmes praktikës gjyqësore të Gjykatës, duke përfshirë por mos u kufizuar në Aktgjykimin e Gjykatës në rastin KO29/11, me parashtrues *Sabri Hamiti dhe deputetë të tjerë* lidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë së Vendimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, nr. 04-V-04, lidhur me zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës, i 22 shkurtit 2011 (në tekstin e mëtejme: Aktgjykimi i Gjykatës në rastin KO29/11); (iii) bazuar në nenin 13 të Ligjit bazik, mosushtimi i funksionit në përputhje me Kushtetutën dhe ligjin, duke përfshirë dështimin në detyrimin për të marrë pjesë në vendimmarrjen dhe funksionimin e KPK-së, përbën bazë për procedura disiplinore dhe shkarkim nga KPK; dhe (iv) ligjet e deritanishme që ndërlidhen me funksionimin e KPK-së por edhe të KGJK-së, edhe pse përjashtimisht, kanë përcaktuar edhe kuorume vendimmarrëse prej dy të tretash (2/3) siç është rasti me vendimet për shkarkimin e anëtarëve të këshillave përkatës, përfshirë në raste kur kjo shumicë ka tejkalluar proporcionin e anëtarëve prokurorë dhe jo-prokurorë.
300. Marrë parasysh të lartcekurat, përfshirë edhe paragrafin 4 të nenit 110 të Kushtetutës, sipas të cilit, ndër tjerash, rregullat e procedurës së KPK-së rregullohen me ligj, Gjykata konsideron që përcaktimi i kuorunit në pesë (5) anëtarë të Këshillit, siç është saktësuar në paragrafin 1 të nenit 13 të Ligjit të kontestuar, që ndryshon dhe plotëson nenin 15 të Ligjit bazik, nuk cenon pavarësinë e KPK-së të saktësuar përmes paragrafit 1 të nenit 110 të Kushtetutës.

(b) Përkitazi me vendimmarrjen

301. Në vlerësimin e kushtetutshmërisë së dispozitës që përcakton shumicën e nevojshme për vendimmarrjen e Këshillit, Gjykata duhet të vë theks në dy çështje: (i) strukturën, përkatësisht përbërjen e Këshillit, duke përfshirë mënyrën e zgjedhjes së anëtarëve jo-prokurorë nga Kuvendi; dhe (ii) natyrën e çështjeve të cilat i nënshtrohen vendimmarrjes përkatëse në Këshill.
302. Në këtë kontekst dhe fillimisht, Gjykata rikujton që paragrafi 2/a i nenit 13 të Ligjit të kontestuar, përcakton vendimmarrjen (i) me pesë (5) vota të anëtarëve të Këshillit nga të cilat dy (2) vota të anëtarëve jo-prokurorë në radhën e parë të votimit; dhe (ii) me shumicë të kualifikuar prej dy të tretash (2/3) të anëtarëve të Këshillit në radhën e dytë të votimit. Gjykata rikujton që përzgjedhja përkitazi me radhën e dytë të votimit, është shtuar përmes amendamenteve në Kuvend, pas Opinionit të dytë të Komisionit të Venecias dhe i cili, përkitazi me shumicën vendimmarrëse të saktësuar në radhën e parë të votimit, ndër të tjera kishte theksuar mundësinë e bllokimit të vendimmarrjes në KPK dhe për pasojë, kishte rekomanduar përfshirjen e një mekanizmi de-blokues, duke theksuar që “*parametrat specifikë të një mekanizmi të tillë de-blokues, do të mund të identifikoheshin nga ligjbërësi, në bashkëbisedim me partnerët ndërkombëtar dhe palët kryesore të interesit*” (paragrafi 15).

303. Në këtë kontekst të zgjidhjes së lartcekur të saktësuar përmes paragrafit 2/a të nenit 13 të Ligjit të kontestuar, Gjykata vëren që në fakt, vendimmarrja e Këshillit është e përcaktuar në shumicën prej dy të tretave (2/3) në të dy radhët e votimit. Më saktësisht, (i) në radhën e parë të votimit për çështjet e saktësuar në këtë nen, do të mund të merret vendim me pesë (5) vota, përkatësisht shumicë prej dy të tretash (2/3) në një përbërje prej shtatë (7) anëtarësh, shumicë kjo që duhet të përfshijë edhe dy (2) vota të anëtarëve jo-prokurorë; dhe (ii) në radhën e dytë të votimit për çështjet e saktësuar në këtë nen, do të mund të merret vendim sërish me pesë (5) vota, përkatësisht shumicë prej dy të tretash (2/3) në një përbërje prej shtatë (7) anëtarësh, shumicë kjo që nënkupton edhe një (1) votë të anëtarëve jo-prokurorë.
304. Për sa i përket çështjeve për të cilat vendimmarrja e Këshillit i nënshtrohet shumicës së kualifikuar, përkatësisht pesë (5) votave ose dy të tretave (2/3) të anëtarëve të Këshillit në dy radhë të votimit, përkatësisht *“votimit për pozitat e Kryeprokurorit të Shtetit dhe Kryeprokurorëve të Prokurorive”* dhe *“miratimin e akteve nënligjore që rregullojnë emërimin e kryeprokurorëve, si dhe emërimin, transferimin, disiplinimin dhe ngritjen në detyrë të prokurorëve”*, Gjykata thekson që të dy kategoritë e çështjeve, përbëjnë funksionet më thelbësore të Këshillit, siç janë të saktësuar në Kushtetutë. Më saktësisht, Gjykata rikujton që (i) zgjedhja dhe propozimi i Kryeprokurorit të Shtetit është një ndër funksionet më themelore të KPK-së sipas paragrafit 7 të nenit 109 të Kushtetutës; dhe (ii) çështjet që ndërlidhen me rekrutimin, propozimin, ngritjen në detyrë, transferimin dhe disiplinimin e prokurorëve, janë po ashtu kompetenca thelbësore të KPK-së, bazuar në paragrafin 1, 2 dhe 3 të nenit 110 të Kushtetutës. Gjykata thekson që në ushtrimin e këtyre kompetencave kushtetuese, sipas paragrafit 1 të nenit 110 të Kushtetutës dhe siç është sqaruar më lart, KPK ka pavarësi të plotë kushtetuese.
305. Thënë këtë, Gjykata vëren që bazuar në paragrafin 4 të nenit 110 të Kushtetutës, ndër tjerash, struktura organizative dhe rregullat e procedurës të KPK-së, rregullohen me ligj të miratuar nga Kuvendi. Kjo përfshin edhe mënyrën e vendimmarrjes së Këshillit, sigurisht, për aq sa nuk cenohen garancitë kushtetuese për pavarësinë vendimmarrëse të KPK-së, siç është përcaktuar në paragrafin 1 të nenit 110 të Kushtetutës. Për pasojë, Gjykata duhet të vlerësojë nëse (i) përcaktimi i shumicës së kualifikuar prej dy të tretash (2/3) në dy radhë të votimit, me kushtin që në radhën e parë, detyrimisht të jenë dy (2) vota të anëtarëve jo-prokurorë dhe në radhën dytë, një (1) votë e anëtarëve jo-prokurorë, në kontekst të zgjedhjes së këtyre të fundit me shumicë të thjeshtë të votave në Kuvend dhe përkitazi me funksione esenciale të Këshillit, siç janë të përcaktuara në paragrafin 7 të nenit 109 të Kushtetutës dhe paragrafin 1, 2 dhe 3 të nenit 110 të Kushtetutës, cenon pavarësinë e funksionimit të KPK-së, siç është përcaktuar përmes paragrafit 1 të nenit 110 të Kushtetutës.
306. Në këtë kontekst dhe fillimisht, Gjykata, siç është sqaruar në paragrafët 276-277 të këtij Aktgjykimi, rikujton që Kushtetuta, por edhe ligjet e Republikës së Kosovës, njohin shumica të ndryshme vendimmarrëse, përfshirë (i) shumicën e thjeshtë të anëtarëve të pranishëm dhe që votojnë; (ii) shumicën e thjeshtë të të gjithë anëtarëve; (iii) shumicën e kualifikuar prej dy të tretash (2/3) të anëtarëve të pranishëm dhe që votojnë; dhe (iv) shumicën e kualifikuar prej dy të tretash (2/3) të të gjithë anëtarëve. Nga këto kategori shumicash vendimmarrëse ka edhe përjashtime, në të cilat vendimmarrja është e kushtëzuar me votën e anëtarëve të caktuar të institucioneve përkatëse. Në kontekst të Kushtetutës, janë dy (2) kategori përjashtimesh të tilla. E para, ndërlidhet me të gjitha ato raste kur vendimmarrja është e kushtëzuar edhe me votën e përfaqësuesve të komuniteteve joshumicë në institucionet e Kosovës, përfshirë por pa u kufizuar në rastet e sqaruara në këtë Aktgjykim, që ndërlidhen me ndryshimet kushtetuese apo edhe miratimin e ligjeve me interes vital. Ndërsa e dyta, ndërlidhet saktësisht me vendimmarrjen në Këshillin Gjyqësor me përbërje të përkohshme, që përfshinte edhe

anëtarë prokurorë dhe kryente funksione edhe lidhur me sistemin prokurorial, deri në themelimin e KPK-së sipas nenit 110 të Kushtetutës përmes Ligjit të vitit 2010. Vendimmarrja e KGJK-së me përbërje të përkohshme, përgjatë pavarësisë së mbikëqyrur të Republikës së Kosovës, ishte e kushtëzuar me pjesëmarrjen dhe/ose votimin e njërit nga anëtarët ndërkombëtarë.

307. Më saktësisht, Gjykata rikujton që neni 151 [Përbërja e Përkohshme e Këshillit Gjyqësor të Kosovës] i Kushtetutës, kishte përcaktuar një përbërje të përkohshme të KGJK-së, duke përfshirë, gjyqtarë, prokurorë, anëtarë të zgjedhur nga Kuvendi në mënyrën e përcaktuar në këtë nen, si dhe dy (2) anëtarë ndërkombëtarë të zgjedhur nga Përfaqësuesi Ndërkombëtar Civil, sipas propozimit të Misionit Evropian për Politika të Sigurisë dhe Mbrojtjes, prej të cilëve njëri duhej të ishte gjyqtar. Kuorumi dhe vendimmarrja e KGJK-së me përbërje të përkohshme nuk ishte saktësuar në këtë dispozitë kushtetuese, megjithatë, bazuar në ligjin që buron nga i njëjti, përkatësisht Ligjin nr. 03/L-123 për Përbërjen e Përkohshme të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji për Përbërjen e Përkohshme të Këshillit), përkatësisht nenet 4 (Anëtarët e Këshillit), 5 (Përbërja e Këshillit gjatë procesit të emërimit) dhe 6 (Kuorumi dhe votimi) të tij, ishte saktësuar edhe kuorumi dhe vendimmarrja e Këshillit, duke përcaktuar që e njëjta (i) në fazën e parë të përbërjes së Këshillit, i nënshtrohej shumicës së thjeshtë, me kushtin që njëri nga dy (2) anëtarët e zgjedhur nga Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar të jetë pjesë e shumicës; (ii) në fazën e dytë të përbërjes së Këshillit, kuorumi i përbërë nga pesë (5) anëtarë, i nënshtrohej kushtit të pjesëmarrjes së njërit prej dy (2) anëtarëve të zgjedhur nga Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar, ndërsa votimi bëhej me shumicë të thjeshtë dhe vota e Kryesuesit të Këshillit ishte vendimtare; dhe (iii) në fazën e tretë të përbërjes së Këshillit, kuorumi i përbërë nga shtatë (7) anëtarë, i nënshtrohej kushtit të pjesëmarrjes së njërit nga dy (2) anëtarët e zgjedhur nga Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar, ndërsa votimi bëhej me shumicë të thjeshtë dhe Kryesuesi i Këshillit kishte votë vendimtare.
308. Bazuar në të lartcekurat, Gjykata vëren që funksionimi i KPK-së që nga themelimi i saj, njeh dy përjashtime në kuptim të vendimmarrjes së kualifikuar dhe kushtëzuar në ligjet përkatëse të miratuara sipas nenit 151 dhe 110 të Kushtetutës, respektivisht. Sipas të parit, përbërja e përkohshme të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, pjesë e të cilit ishin edhe prokurorët dhe deri në përfundimin e pavarësisë së mbikëqyrur, kuorumi dhe vendimmarrja e Këshillit përkatës ishte e kushtëzuar në pjesëmarrjen dhe/ose votën e anëtarëve ndërkombëtarë. Ndërsa sipas të dytit, përkatësisht ligjeve të KPK-së të viteve 2010, 2015 dhe 2019, respektivisht, të nxjerra bazuar në paragrafin 4 të nenit 110 të Kushtetutës, përjashtimi i vetëm nga vendimmarrja me shumicë të thjeshtë, ishte votimi për shkarkimin e anëtarëve të Këshillit me shumicën e dy të tretave (2/3) të votave.
309. Për më tepër, Gjykata thekson (i) që propozimi për emërimin dhe shkarkimin e Kryeprokurorit të Shtetit është kategori kushtetuese, e përcaktuar me paragrafin 7 të nenit 109 të Kushtetutës. Për dallim nga dispozitat tjera kushtetuese në të cilat Kushtetuta ka specifikuar shumicën e nevojshme për zgjedhjen e anëtarëve apo/përfaqësuesve të institucioneve kushtetuese, ky nuk është rasti për Kryeprokurorin e Shtetit; për më tepër (ii) në amendamentet kushtetuese të propozuara nga Kuvendi në vitin 2012, të shqyrtuara nga Gjykata përmes Aktgjykimit në rastin KO 29/12 dhe KO48/12, shumica vendimmarrëse në Këshill ishte përcaktuar në dy të tretat (2/3) e anëtarëve të Këshillit, në kontekst të propozimit të përsëritur të Kryeprokurorit të Shtetit në rrethanat që Presidenti do të refuzonte, përkatësisht kthente kandidatin e propozuar në rishqyrtim në KPK vetëm një herë (shih, paragrafët 210 deri më 212 të Aktgjykimit të Gjykatës në rastin KO 29/12 dhe KO48/12).

310. Thënë këtë, Gjykata thekson se paragrafi 2/a i nenit 13 të Ligjit të kontestuar, dhe shumica përkatëse e kualifikuar e përcaktuar përkitazi me vendimmarrjen rreth funksioneve esenciale të Këshillit, siç janë të saktësuara Kushtetutë, duhet të vlerësohet, në kontekst të strukturës dhe përbërjes së KPK-së sipas Ligjit të kontestuar.
311. Në këtë kontekst, Gjykata duhet t'i kthehet parimeve të shtjelluara nga Komisioni i Venecias, në raportet dhe opinionet relevante, përfshirë ato për Kosovën, bazuar në të cilat e ndër tjerash, theksohet që një ndër çështjet më delikate të balancimit të përbërjes së këshillave prokurorial, është (i) proporcioni në mes të anëtarëve prokurorë dhe jo-prokurorë, përfshirë mënyrën e zgjedhjes së tyre; dhe (ii) vendimmarrja përkatëse në këta këshilla, në mënyrë që të shmanget, në njërin anë mundësia që anëtarët prokurorë të qeverisin të vetëm, duke rezultuar kështu në një kulturë institucionale korporatiste apo të një perceptimi të tillë marrë parasysh *“organizimin hierarkik të sistemit prokurorial dhe kulturës së subordinimit”* dhe njëkohësisht, të shmanget gjithashtu mundësia që anëtarët jo-prokurorë, të zgjedhur nga shumica qeverisëse në Kuvend, të bllokojnë këtë vendimmarrje (shih, mes tjerash, Opinionin e parë për Kosovë, paragrafin 35 dhe Opinionin e Komisionit të Venecias lidhur me Projekt-amendamentet e Ligjit për Prokurorinë e Shtetit dhe Projektligjit për Prokurorinë për Krim të Organizuar dhe Korrupsion të Malit Zi -CDL-AD(2021)012, paragrafi 36).
312. Gjykata gjithashtu rikujton që në përmbledhjen e raporteve të Komisionit të Venecias që ndërlidhen pikërisht me mënyrën e vendimmarrjes me shumicë të kualifikuar dhe mekanizmat përkatës të de-blokimit, edhe pse kryesisht në kontekst të shumicave të nevojshme nëpër kuvende dhe që ndërlidhen me zgjedhjen e anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese, Kryeprokurorit, anëtarëve të këshillave prokurorial dhe/ose gjyqësor dhe Avokatit të Popullit, ndër tjerash, është theksuar se (i) *“institucionet që nuk mund të përmbushin qëllimet e tyre kushtetuese, i japin emër të keq demokracisë. Prandaj, është kruciale që të ketë mekanizma de-blokimi”* (shih, Përmbledhjen e Komisionit të Venecias lidhur me shumicën e kualifikuara dhe mekanizmat de-blokues, fq. 3); (ii) *“Komisioni ka theksuar rëndësinë e shumicave të kualifikuara, por ka paralajmëruar rreth rrezikut të bllokimit dhe ka rekomanduar që të parashihen mekanizma efektivë dhe solid de-blokues, duke dhënë disa shembuj të zgjidhjeve të mundshme”* (po aty); dhe (iii) *“Komisioni i Venecias është shprehur se është i vetëdijshëm rreth vështirësisë së dizajnit të mekanizmave të përshtatshëm dhe efektivë de-blokues, për të cilët, nuk ka një model të vetëm. Një opsion do të ishte që të parashihet votim me shumica të ndryshme dhe të zvogëluara në raundet vijuese të votimit, por kjo ka si të metë që shumica mund të mos kërkojë të gjejë konsensus në raundin e parë, duke e ditur që në raundet vijuese, kandidati i tyre do të prijë. Zgjidhje të tjera, ndoshta të preferuara, përfshijnë përdorimin e metodave proporcionale të votimit, me rekurs në përfshirjen e akterëve të ndryshëm institucional ose vënien e marrëdhënieve të reja në mes të institucioneve shtetërore. Secili shtet duhet të parashohë formulën e vet”* (po aty, fq. 13).
313. Në kuptim të rëndësisë së shumicës së kualifikuar, por edhe balancit të nevojshëm me mekanizmin përkatës de-blokues, Komisioni i Venecias, kishte theksuar si në vijim: *“Shumicat e kualifikuara kanë si synim të sigurojnë se është gjetur marrëveshje më e gjerë në Kuvend, meqë kërkojnë që shumica të kërkojë një kompromis me pakicën. Për këtë arsye, shumicat e kualifikuara, parashihen normalisht në fushat më të ndjeshme, sidomos në zgjedhjen e zyrtarëve në institucione shtetërore. Sidoqoftë, ka një rrezik që kërkesa për të arritur shumicë të kualifikuar, të shpie në bllokim, i cili nëse nuk adresohet në mënyrë adekuate dhe me kohë, mund të çojë në paralizim të institucionit në fjalë. Një mekanizëm de-blokues synon të shmangë bllokimin e tillë. Sidoqoftë, funksioni parësor i një mekanizmi de-blokues, është pikërisht që t'i mundësojë procedurës origjinale të funksionojë, duke shtyrë edhe shumicën edhe pakicën që të gjejnë një kompromis, me qëllim që të shmanget mekanizmi de-blokues. Shumicat e*

kualifikuara forcojnë pikërisht pozicionin e pakicave parlamentare, ndërsa mekanizmat de-blokues, përmirësojnë balansin prapëseprapë. Sigurisht, mekanizmat e tillë nuk duhet të veprojnë si dekurajim për arritjen e një marrëveshjeje mbi bazën e shumicës së kualifikuar në rastin e parë. Mund t'i ndihmojnë procesit të arritjes së marrëveshjes, nëse mekanizmi de-blokues është joatraktiv sa për shumicën, aq edhe për pakicën” (shih, Përmbledhjen e Komisionit të Venecias lidhur me shumicat e kualifikuara dhe mekanizmat de-blokues, faqe 13).

314. Bazuar në këto parime dhe gjithnjë në funksion të institucioneve kushtetuese, Gjykata thekson që (i) shumica e kualifikuar është gjithnjë e dobishme, por e njëjta gjithnjë duhet të pasohet nga një mekanizëm de-blokues, në mënyrë që të sigurohet funksionimi i rregullt i institucionit përkatës; dhe (ii) mekanizmi de-blokues duhet të krijojë incentivë për arritjen e kësaj shumice dhe jo vetëm për shmangien e saj, në mënyrë që vendimi të merret, megjithatë, me shumicën e thjeshtë. Prandaj, në përmbledhjen e lartcekur të raporteve, Komisioni i Venecias, rekomandon zgjidhje të ndryshme varësisht nga specifikat e shteteve dhe institucioneve përkatëse, duke përfshirë shumicë të kualifikuar prej tre të pestash (3/5), sisteme proporcionale votimi apo edhe shumicë të thjeshtë. Thënë këtë, shumica prej dy të tretash (2/3), nuk është ajo që përbën mekanizmin de-blokues, por është shumica fillestare, e cila pastaj pasohet nga mekanizma de-blokues, në formë të shumicës më të ulët, apo mekanizma tjerë që e zhblokojnë vendimmarrjen e institucioneve përkatëse. Një shembull i tillë është i reflektuar edhe në Kushtetutën e Kosovës, përkatësisht nenin 86 [Zgjedhja e Presidentit] të saj, përmes të cilit, për zgjedhjen e Presidentit, janë përcaktuar dy (2) radhë të votimit që kërkojnë shumicën prej dy të tretash (2/3) të të gjithë deputetëve të Kuvendit, ndërsa, në fund, për radhën e tretë të votimit, është paraparë edhe mekanizmi de-blokues i votimit me shumicë të përbërë nga të gjithë deputetëve të Kuvendit.
315. Në rastin e paragrafit të ri 2/a, shtuar përmes paragrafit 2 të nenit 13 të Ligjit të kontestuar, shumica e kualifikuar prej pesë (5) votash, përkatësisht dy të tretash (2/3), është paraparë si në radhën e parë, ashtu edhe në radhën e dytë të votimit, përkundër rekomandimit të Opinionit të Komisionit të Venecias, siç është sqaruar më lart, që radha e parë e votimit, të pasohet me një mekanizëm efektiv de-blokimi. Në rrethana të tilla, (i) as anëtarët prokurorë dhe as ata jo-prokurorë nuk mund të vendosin vet; (ii) anëtarët jo-prokurorë duhet të kenë mbështetjen e të paktën dy (2) anëtarëve prokurorë për të vendosur; ndërsa (iii) anëtarët prokurorë, duhet të kenë mbështetjen e të paktën një (1) anëtari jo-prokurorë për të vendosur.
316. Gjykata vëren, që në kontekst të strukturës/përbërjes së KPK-së sipas Ligjit të kontestuar, (i) në rast të votimit me shumicë të thjeshtë, do t'ju mundësohej anëtarëve prokurorë që të qeverisin të vetëm dhe një zgjidhje e tillë, edhe sipas Opinioneve të Komisionit të Venecias, do të rriste rrezikun e korporatizimit, duke marrë parasysht natyrën hierarkike të sistemeve prokuroriale dhe potencialisht, kulturën organizative subordinuese ndaj Kryeprokurorit; ndërsa (ii) në rast të votimit me shumicë të kualifikuar prej dy të tretash (2/3) dhe marrë parasysht që Gjykata tashmë ka konstatuar që kompetenca e Avokatit të Popullit për të caktuar/zgjedhur një anëtarë të KPK-së nuk është në përputhshmëri me Kushtetutën, do të rriste rrezikun e politizimit të KPK-së, sepse vendimmarrja do të varej nga vota e të paktën një (1) anëtari jo-prokuror të zgjedhur me shumicë të thjeshtë në Kuvend. Prandaj, siç ka theksuar edhe Komisioni Venecias, Gjykata vë theks në faktin që mënyra e vendimmarrjes së KPK-së është e ndërlidhur me strukturën/përbërjen e saj, dhe se një KPK “pluraliste”, nënkupton një përbërje të saj, që aq sa kufizon mundësinë e anëtarëve prokurorë të vendosin vet, po aq kufizon edhe mundësinë që vendimmarrja të varet nga anëtarë jo-prokurorë të zgjedhur nga një shumicë qeverisëse e përfaqësuar në Kuvend.

317. Në këtë kontekst, Gjykata rithekson që çështjet që ndërlidhen me strukturën organizative dhe rregullat e procedurës, sipas paragrafit 4 të nenit 110 të Kushtetutës, në rastin e KPK-së, rregullohen me ligj të miratuar nga Kuvendi i Republikës. Thënë këtë, Gjykata thekson që ligjet e Kuvendit të miratuara bazuar në paragrafin 4 të nenit 110 të Kushtetutës, nuk mund të cenojnë pavarësinë e plotë të KPK-së në ushtrimin e funksioneve të saj, siç është përcaktuar me paragrafin 1 të nenit 110 të Kushtetutës. Një qasje e tillë është theksuar nga Gjykata vazhdimisht përmes praktikës së saj gjyqësore, duke përfshirë Aktgjykimin në rastin KO219/19, në të cilin Gjykata, ndër tjerash, ka theksuar që (i) të gjitha pushtetet pa përjashtim kanë detyrim kushtetues që të bashkëpunojnë me njëra-tjetrën dhe të kryejnë detyrat publike për të mirën e përgjithshme publike dhe në interesin më të mirë të të gjithë shtetasve të Republikës së Kosovës. Në këto detyra publike përfshihet edhe obligimi i secilit pushtet që përgjatë kryerjes së detyrave kushtetuese të përkuajdeset për respektim të pavarësisë së pushtetit tek i cili po krijon një “*ndërrhyrje*”; (ii) Qeveria dhe Kuvendi, megjithëse e kanë kompetencën për të propozuar dhe votuar ligje, respektivisht, e të cilat do të mund të ndikojnë edhe në sferën e gjyqësorit, si pushtet i tretë, ato [Qeveria dhe Kuvendi] duhet të sigurohen që gjatë hartimit të propozimeve të tyre e deri në finalizimin e tyre me votë të Kuvendit të ruhet pavarësia kushtetuese e pushtetit simotër, respektivisht gjyqësorit; (iii) kujdes dhe ndjeshmëri të njëjtë, Qeveria dhe Kuvendi, duhet të tregojnë edhe për akterët e tjerë shtetërorë të cilët Kushtetuta i ka pajisur me garanci kushtetuese të pavarësisë funksionale, organizative, strukturore dhe buxhetore; dhe (iv) garantimin dhe sigurimi paraprak i kushtetutshmërisë së iniciativave të Qeverisë dhe Kuvendit duhet të jetë aspekt i përhershëm dhe i pandashëm i krijimtarisë ligjore të këtyre dy pushteteve (shih, Aktgjykimin në rastin KO219/19, cituar më lart, paragrafit 332).
318. Prandaj, dhe bazuar në parimet e shtjelluara dhe sqarimet e dhëna më lart, Gjykata rikujton që në kontekst të nenit të ri 2/a, shumica prej dy të tretash (2/3) është përcaktuar në të dyja radhët e votimit, për dy kategori çështjesh që përbëjnë thelbin e funksioneve të KPK-sa, siç është përcaktuar në nenet 109 dhe 110 të Kushtetutës. Kjo shumicë, në radhën e parë të votimit, është kushtëzuar me dy (2) vota, ndërsa në radhën e dytë të votimit, është kushtëzuar me një (1) votë të anëtarëve jo-prokurorë. Këta të fundit, marrë parasysh që Gjykata tashmë ka konstatuar që kompetenca e Avokatit të Popullit për të “*caktuar/zgjedhur*” një anëtar në KPK është në kundërshtim me Kushtetutën, zgjedhen me vetëm shumicë të thjeshtë të deputetëve të Kuvendit. Në rrethana të tilla dhe në një përbërje të KPK-së vetëm prej anëtarëve prokurorë të përzgjedhur nga vet sistemi prokurorial dhe anëtarëve jo-prokurorë që zgjedhen nga Kuvendi me shumicë të thjeshtë, çdo vendimmarrje e KPK-së në kategoritë e çështjeve të caktuara, varësisht nga radha e votimit, do të ishte e kushtëzuar me votën e një (1) ose dy (2) anëtarëve jo-prokurorë të zgjedhur me shumicë të thjeshtë në Kuvend. Për pasojë, për aq sa në këtë mënyrë do të mund të kundërbalancohej pamundësia e prokurorëve për të qeverisur të vetëm, qëllim ky që mund të jetë legjitim në mënyrë që të kundërbalancohet ndikimi i mundshëm i Kryeprokurorit të Shtetit duke marrë parasysh strukturën dhe karakteristikat e sistemit prokurorial, në të njëjtën kohë do të mund të rritej mundësia e politizimit të Këshillit në ushtrimin e funksioneve më esenciale të tij, duke qenë se vendimmarrja e tij, në esencë, do të varej nga një (1) anëtar jo-prokuror, i zgjedhur nga shumica qeverisëse e përfaqësuar në Kuvend.
319. Për më tepër, që (i) neni 2/a nuk saktëson mekanizëm de-blokimi, siç ka rekomanduar edhe Komisioni i Venecias, por e mban shumicën e nevojshme të vendimmarrjes në pesë (5) vota, përkatësisht dy të tretat (2/3) në dy radhët e votimit; dhe (ii) çdo mënyrë e përcaktimit të vendimmarrjes së Këshillit, duhet të vlerësohet në dritën e përbërjes së tij, duke evituar edhe qeverisjen e vet prokurorëve por edhe politizimin e Këshillit, me theks në funksionalitetin e tij, sepse funksionimi ose jo efikasiteti i një institucioni kushtetues siç është KPK, ka ndikim të jashtëzakonshëm në sundimin e ligjit dhe funksionimin e shtetit të së drejtës. Prandaj, dhe bazuar në sqarimet si më lart, një

zgjdhje e tillë e adaptuar përmes paragrafit 2/a të nenit të kontestuar, përkitazi me funksionet më esenciale kushtetuese të KPK-së dhe në kontekst të përbërjes së propozuar së KPK-së, përfshirë mënyrën e zgjedhjes së anëtarëve jo-prokurorë të tij, do të cenonte “*pavarësinë e plotë*” funksionale të Këshillit, të përcaktuar përmes paragrafit 1 të nenit 110 të Kushtetutës dhe gjithashtu, do të cenonte parimet e ndarjes dhe balancit të pushteteve, të saktësuara përmes nenit 4 të Kushtetutës.

320. Marrë parasysh të lartcekurat në tërësinë e tyre, Gjykata konstaton që paragrafi 2/a i nenit 13 të Ligjit të kontestuar për ndryshimin dhe plotësimin e nenit 15 të Ligjit bazik, nuk është në përputhshmëri me paragrafin 1 të nenit 4 dhe me paragrafin 1 të nenit 110 të Kushtetutës .

5. Vlerësimi i kushtetutshmërisë së nenit 16 [pa titull] të Ligjit të kontestuar përmes të cilit ndryshohet dhe plotësohet neni 19 (Procedura disiplinore për anëtarët e Këshillit) i Ligjit bazik dhe nenit 18 [pa titull] të Ligjit të kontestuar përmes të cilit, shtohet neni 23/A (Mbrotjtja gjyqësore) e Ligjit të kontestuar

321. Gjykata fillimisht thekson që nenin 16 [pa titull] të Ligjit të kontestuar përmes të cilit ndryshohet dhe plotësohet neni 19 (Procedura disiplinore për anëtarët e Këshillit) të Ligjit bazik dhe nenin 18 [pa titull] të Ligjit të kontestuar përmes të cilit ndryshohet, përkatësisht plotësohet neni 23 (Emërimi dhe riemërimi i prokurorëve) i Ligjit bazik, përkatësisht shtohet neni 23/A (Mbrotjtja gjyqësore) të Ligjit të kontestuar, marrë parasysh ndërlidhshmërinë e tyre, do t'i vlerësojë së bashku. Siç është theksuar edhe në vlerësimin kushtetues të dispozitave tjera të Ligjit të kontestuar, Gjykata rikujton që për qëllime të vlerësimit të kushtetutshmërisë së neneve 16 dhe 18 të Ligjit të kontestuar, Gjykata fillimisht do të paraqesë: (i) thelbin e pretendimeve të parashtruesve të kërkesës dhe komentet mbështetëse të dorëzuara nga palët e interesuara, si dhe thelbin e argumenteve të palës kundërshtare (shih, paragrafët 46-137 të këtij Aktgjykimi për një pasqyrim të hollësishëm të argumenteve dhe kundër-argumenteve përkatëse); dhe (ii) përgjigjen e Gjykatës lidhur me këto pretendime përkitazi me jokushtetutshmërinë e neneve përkatëse.

(i) Thelbi i pretendimeve/argumenteve dhe kundër-argumenteve të parashtruesve dhe palëve të interesuara

322. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë që përmes ndryshimit dhe plotësimit të nenit 19 të Ligjit bazik, cenohet e drejta e anëtarëve jo-prokurorë të KPK-së për barazi para ligjit, ndër tjerash, sepse (i) e drejta e ankesës në rast të shkarkimit u njihet vetëm anëtarëve prokurorë të Këshillit dhe jo atyre jo-prokurorë, duke shkelur edhe të drejtën për mjet juridik të përcaktuar me nenet 32 dhe 54 të Kushtetutës për anëtarët jo-prokurorë të Këshillit sepse për anëtarët jo-prokurorë, Ligji i kontestuar nuk parasheh mundësinë e ankesës para Gjykatës Supreme ashtu siç parasheh për anëtarët prokurorë; si dhe (ii) për pasojë do të mundësojë nënshtrimin e të njëjtëve, përkatësisht anëtarëve jo-prokurorë të Këshillit ndaj presioneve të jashtme politike, më konkretisht nga shumica parlamentare që i zgjedh ata. Për më tepër, parashtruesit e kërkesës gjithashtu pretendojnë cenimin e parimeve të sigurisë juridike, duke vënë theks në (i) kundërthënien e përcaktuar në afatet përkatëse për Gjykatën Supreme për të vendosur për ankesat e prokurorëve, sepse sipas nenit 23/A të Ligjit të kontestuar Gjykata Supreme duhet të vendos brenda nëntëdhjetë (90) ditëve, ndërsa sipas nenit 15 (Ankesa ndaj vendimeve disiplinore) të Ligjit për Përgjegjësi Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve e që rregullon të njëjtën çështje, Gjykata Supreme duhet të vendos brenda tridhjetë (30) ditëve. Lidhur me këtë pretendim, KPK gjithashtu thekson që neni 18 i Ligjit të kontestuar që shton nenin 23/A të Ligjit bazik, duke paraparë që prokurori ka të drejtë të paraqesë ankesë drejtpërdrejtë në Gjykatën Supreme ndaj vendimeve të

Këshillit për (i) shkarkim; dhe (ii) “vendimeve lidhur me vlerësimin e performancës së prokurorëve, si dhe vendimeve disiplinore, që për pasojë kanë uljen në detyrë të prokurorëve”, bie ndesh me Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese (pa specifikuar rastin), pasi që vlerësimi i performancës së prokurorëve është mandat i Këshillit dhe se me këtë dispozitë kjo e drejtë i bartet Gjykatës Supreme.

323. Në anën tjetër Ministria e Drejtësisë kundërshton pretendimet, duke theksuar, ndër tjerash, se fakti që anëtarët jo-prokurorë të Këshillit nuk kanë të drejtë të ankohen drejtpërdrejtë në Gjykatën Supreme lidhur me vendimin për shkarkim është e justifikueshme sepse (i) procedura e emërimit të anëtarëve jo-prokurorë në këtë rast dallon nga mënyrë e emërimit të anëtarëve prokurorë prandaj dallon edhe procedura e shkarkimit të tyre; (ii) anëtarëve prokurorë i'u është mundësuar ankesa drejtpërdrejtë në Gjykatën Supreme duke marrë parasysh unifikimin me sistemin e rregullt disiplinor për prokurorët sipas Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore; dhe (iii) Ligji i kontestuar nuk e ka kufizuar mbrojtjen gjyqësore ndaj anëtarëve jo-prokurorë të Këshillit pasi të njëjtit mund të kontestojnë vendimet për shkarkim në gjykata të rregullta përmes mekanizmit të konfliktit administrativ apo “drejtpërdrejtë në Gjykatën Kushtetuese”. Ndërsa, përkitazi me afatet kundërthënëse të përcaktuara në nenin 18 të Ligjit të kontestuar në raport me nenin 15 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore, Ministria e Drejtësisë, ndër tjerash, thekson që (i) një afat i njëjtë nëntëdhjetë (90) ditor është përfshirë edhe në Ligjin për Këshillin Gjyqësor; dhe (ii) ka formuar grupin punës që do të propozojë ndryshimin e afatit në Ligjin për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve që ta harmonizojë atë me afatin nëntëdhjetë (90) ditor, pasi afati tridhjetë (30) ditor i përcaktuar në ligjin e lartcekur është shumë i shkurtër për të vendosur përkitazi me këto ankesa.

(ii) Vlerësimi i Gjykatës

a) Përkitazi me barazinë e anëtarëve të Këshillit për mjet juridik dhe mbrojtje gjyqësore të të drejtave

324. Gjykata fillimisht thekson që neni 19 (Procedurat disiplinore për anëtarët e Këshillit) i Ligjit bazik, saktëson që (i) Këshilli përcakton dhe publikon rregullat dhe procedurat disiplinore të zbatueshme ndaj anëtarëve të vet duke përfshirë ato procedura që përcaktojnë hetimin, pezullimin apo rekomandimin për shkarkim të cilitdo anëtar të Këshillit; (ii) Komisioni i përbërë nga tre (3) anëtarë, njëri nga të cilët duhet të jetë anëtar prokuror i Këshillit, dhe dy (2) të tjerë nga radhët e prokurorëve, i themeluar nga Këshilli, vendos për masat disiplinore dhe për sanksione, përfshirë pezullimin dhe shkarkimin e cilitdo anëtar të Këshillit; dhe (iii) me rekomandimin e komisionit, një (1) anëtar i Këshillit mund të shkarkohet me anë të dy të tretave (2/3) të votave të anëtarëve të Këshillit; dhe (iv) një (1) anëtar i Këshillit i cili është shkarkuar gëzon të drejtën të ankohet kundër vendimit të Këshillit drejtpërsëdrejti në Gjykatën Supreme brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga vendimi për shkarkim. Në anën tjetër, neni 10 (Procedura e propozimit, zgjedhjes dhe e shkarkimit të anëtarëve që zgjedhën nga Kuvendi) i Ligjit bazik, ndër tjerash, përcakton edhe procedurën e shkarkimit të anëtarëve jo-prokurorë të Këshillit të zgjedhur nga Kuvendi, duke saktësuar që shkarkimi i anëtarëve jo-prokurorë të Këshillit, bëhet nga Kuvendi me shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit, me propozim të komisionit përkatës ose Këshillit. Bazuar në paragrafin 4 të nenit 19 të Ligjit bazik, të gjithë anëtarët e Këshillit kanë të drejtë ankese në Gjykatën Supreme, kundër vendimit përkatës për shkarkim. Për më tepër, bazuar në paragrafin 5 të nenit 15 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore, gjyqtarët dhe prokurorët, kanë të drejtë të ankohen kundër vendimeve disiplinore të Këshillave përkatës, drejtpërdrejtë në Gjykatën Supreme, dhe e cila brenda tridhjetë (30) ditëve, shqyrton dhe vendos lidhur me ankesën.

325. Përmes ndryshimeve dhe plotësimeve të Ligjit bazik, përmes nenit 16 të Ligjit të kontestuar, respektivisht, (i) përcaktohet shumica e nevojshme për shkarkimin e anëtarëve prokurorë të Këshillit, përkatësisht shumica prej dy të tretave (2/3) të anëtarëve të Këshillit për shkarkimin e anëtarit prokuror të KPK-së, por nuk përcaktohet shumica e nevojshme për propozimin për shkarkim të anëtarit jo-prokurorë të Këshillit, duke e kufizuar kështu propozimin për shkarkim të anëtarit jo-prokuror vetëm në rekomandimin e Komisionit prej tre (3) anëtarësh; (ii) përcaktohet shumica e nevojshme në Kuvend për shkarkimin e anëtarit jo-prokuror të Këshillit në shumicë të deputetëve të pranishëm dhe që votojnë, për dallimin nga Ligji bazik në të cilin kjo shumicë është e përcaktuar në shumicën e votave të të gjithë deputetëve; (iii) përpos Kuvendit, i jep kompetencën edhe Avokatit të Popullit që të shkarkojë anëtarin përkatës të Këshillit me vendimin e tij/saj, pas rekomandimit të Komisionit prej tre (3) anëtarësh, kompetencë kjo e Avokatit të Popullit që tashmë është trajtuar në këtë Aktgjykim; dhe (iv) të drejtën në ankesë në Gjykatë Supreme, e përcakton vetëm për anëtarët prokurorë të Këshillit, duke përjashtuar nga kjo e drejtë anëtarët jo-prokurorë dhe duke mos përcaktuar në mënyrë shprehimore mjetin juridik në dispozicion për ta.
326. Gjykata vëren se një dallim i tillë në mes të anëtarëve prokurorë dhe jo-prokurorë të KPK-së për sa i përket mjeteve juridike në dispozicion në rast të shkarkimit të tyre si anëtarë të Këshillit, nuk është bërë në ligjet e mëparshme, përkatësisht në Ligjet e viteve 2010, 2015 dhe Ligjin bazik të vitit 2019. Sipas të tri këtyre ligjeve, anëtarëve të KPK-së, pa dallim, u është mundësuar qasja e drejtpërdrejtë në Gjykatën Supreme për të ankimuar vendimin, përkatësisht propozimin për shkarkim si anëtarë të KPK-së.
327. Më saktësisht, Ligji i vitit 2010, përmes nenit 11 (Procedurat disiplinore për Anëtarët e Këshillit), kishte saktësuar, ndër tjerash, se anëtarët e KPK-së, pa dallim nëse janë anëtarë prokurorë ose jo-prokurorë, mund të shkarkohen me rekomandimin e komisionit të themeluar nga Këshilli, me dy të tretat (2/3) e votave të anëtarëve të KPK-së. Paragrafi 4 i nenit 11 (Procedurat Disiplinore për Anëtarët e Këshillit) të Ligjit të vitit 2010, parashihte të drejtën e anëtarëve të Këshillit, pa dallim, për t'u ankuar ndaj vendimit të Këshillit për shkarkim drejtpërdrejtë në Gjykatën Supreme, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e marrjes së vendimit për shkarkim. Në anën tjetër, Ligji i vitit 2015 e kishte ndryshuar dhe plotësuar Ligjin e vitit 2010, ndër tjerash, duke bërë dallimin për sa i përket procedurës së shkarkimit të anëtarëve prokurorë dhe jo-prokurorë të KPK-së. Më saktësisht, sipas nenit 6 [pa titull] të Ligjit të vitit 2015, që plotësonte dhe ndryshonte nenin 8 (Përfundimi i Mandatit) të Ligjit të vitit 2010, anëtarët prokurorë, të cilëve ky ligj u referohet në këtë nen si "*anëtarë të Këshillit*", vazhdonin të shkarkoheshin sipas mekanizmit të njëjtë, pra, me votimin e dy të tretave (2/3) të anëtarëve të Këshillit, ndërkaq, tre (3) anëtarët jo-prokurorë të zgjedhur nga Kuvendi, shkarkoheshin me propozim të KPK-së dhe me shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit. Në fund, Ligji i vitit 2015, nuk përcakton ndonjë ndryshim apo plotësim të nenit 11 të Ligjit 2010 si ligj bazik, i cili po ashtu parashihte të drejtën e anëtarëve të Këshillit, pa dallim, për t'u ankimuar ndaj vendimit të Këshillit për shkarkim drejtpërdrejtë në Gjykatën Supreme, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e marrjes së vendimit për shkarkim.
328. Nga sa u tha më sipër, Gjykata vëren se (i) ligjet e viteve 2010, 2015 dhe 2019, respektivisht, u kanë vënë në dispozicion anëtarëve të KPK-së, pa dallim, mjetin juridik të ankesës kundër vendimit për shkarkim si anëtarë të Këshillit drejtpërdrejtë në Gjykatën Supreme, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të vendimit; (ii) pavarësisht se Ligji i vitit 2015, kishte paraparë procedura të ndryshme të shkarkimit të anëtarëve prokurorë dhe atyre jo-prokurorë të KPK-së, mjeti juridik kundër vendimit për shkarkim, pa specifikuar nëse bëhej fjalë për vendimin për shkarkim të KPK-së apo të Kuvendit, ishte i njëjtë për të dyja kategoritë e anëtarëve; dhe (iii) ligjet e viteve 2015 dhe 2019, respektivisht, shumicën e nevojshme në Kuvend

- për shkarkimin e anëtarëve jo-prokurorë të KPK-së e kishin caktuar në shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit, për dallim nga shumica e votave të deputetëve që janë të pranishëm dhe votojnë, që përcakton Ligji i kontestuar.
329. Lidhur me këtë çështje, Gjykata vëren se dy Opinionet e Komisionit të Venecias për Kosovë përkitazi me Ligjin e kontestuar, nuk kanë pasur objekt trajtimi çështjen e të drejtës në ankesë të anëtarëve prokurorë dhe jo-prokurorë të Këshillit në rast të shkarkimit të tyre. Ndërsa Opinionet tjera të Komisionit të Venecias, përfshirë Përmbledhjen e Opinioneve dhe Raporteve të Komisionit të Venecias lidhur me Prokurorët CDL-PI(2022)23 (faqe 45 dhe 110), përderisa nuk përcaktojnë specifikisht ndonjë kërkesë për institucionin gjyqësor që duhet të trajtojë ankesat ndaj vendimeve për shkarkim të anëtarëve të Këshillit, specifikisht kërkojnë që ankesa lidhur me shkarkimin e anëtarëve të këshillave prokurorial të trajtohet nga një gjykatë, gjë që nënkupton që në rastet e shkarkimit të anëtarëve të këshillave prokuroriale, duhet të sigurohet mjeti juridik dhe mbrojtja gjyqësore. Një çështje e tillë ishte shqyrtuar edhe në Opinionet përkatëse për Bosnje e Hercegovinën dhe Malin e Zi, duke saktësuar në rastin e të parës, ndër tjerash, që *“ankesa para një gjykate është esenciale, të paktën në rastet kur shqiptohet një dënim i ashpër”* (shih, Opinionin e Komisionit të Venecias për Projektligjin për Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe Prokurorial të Bosnje Hercegovinës CDL-AD(2014)008, të 24 marsit 2014, paragrafi 110), ndërsa në rastin e dytës, ndër tjerash, që *“në nenin aktual 32(4), vendimi i Këshillit Prokurorial sa i përket ankesës është përfundimtar dhe nuk mund të sfidohet në gjykatë. Amendamenti parasheh ankesën në gjykatën administrative ndaj vendimit të Këshillit Prokurorial. Ky është avancim, që është në harmoni me praktikën e shumë vendeve evropiane”* (shih, Opinionin e Komisionit të Venecias për Draft Amendamentet e Ligjit për Prokurorin e Shtetit të Malit të Zi, CDL-AD(2008)005, të 18 marsit 2008, paragrafi 37).
330. Bazuar në sqarimet e mësipërme, nuk është kontestuese që anëtarët e Këshillave përkatës duhet të kenë të drejtë në mbrojtje gjyqësore të të drejtave të tyre në rast të vendimeve/propozimeve për shkarkim. Kontestuese është, nëse neni 16 i Ligjit të kontestuar, trajton në mënyrë të barabartë anëtarët prokurorë dhe jo-prokurorë të KPK-së, në kuptim të së drejtës në mjet juridik, përkatësisht mbrojtjes gjyqësore të të drejtave. Në kontekst të kësaj çështjeje, Gjykata gjithashtu thekson që nuk është kontestuese që Ligji i kontestuar parasheh mjete juridike ndaj vendimeve të Këshillit për anëtarët prokurorë të Këshillit që shkarkohen në mënyrë të drejtpërdrejtë në Gjykatën Supreme, ndërsa i njëjti është i heshtur përkitazi me të drejtën për ankesë kundër vendimeve për shkarkimin e anëtarëve jo-prokurorë të Këshillit nga Kuvendi apo/edhe Avokati i Popullit. Thënë këtë, fakti që Ligji i kontestuar është i heshtur lidhur me mjetin juridik ndaj shkarkimit të anëtarëve jo-prokurorë, nuk nënkupton domosdoshmërisht se të njëjtit nuk mund të sfidojnë vendimet për shkarkimin e tyre. Në këtë aspekt, Gjykata ka theksuar në praktikën saj gjyqësore se *“veprimet e organeve të administratës publike”*, mund të kontestohen në procedurë administrative, siç është përcaktuar me Ligjin nr. 03/L-202 për Konflikte Administrative, ashtu siç është sqaruar përmes praktikës së saj gjyqësore, duke përfshirë por mos u kufizuar së fundi, në rastet e Gjykatës [KI57/22](#) dhe [KI79/22](#), parashtrues *Shqipdon Fazliu dhe Armend Hamiti*, Aktvendim për papranueshmëri, i 4 korrikut 2022; dhe Aktgjykimin e Gjykatës në rastin [KI214/21](#), me parashtrues *Avni Kastrati*, Aktgjykim i 7 dhjetorit 2022.
331. Në këtë kontekst, përkitazi me anëtarët jo-prokurorë, bazuar në praktikën e saj gjyqësore referuar më lart, Gjykata duhet të theksojë që (i) mjeti juridik ekziston; dhe (ii) që i njëjti është mjet efektiv juridik, përderisa parashtruesit e kërkesave nuk argumentojnë, duke përfshirë përmes praktikës gjyqësore të gjykatave të rregullta, që ky nuk është rasti. Prandaj, Gjykata thekson se kontestuese në rrethanat e nenit 16 të Ligjit të kontestuar, nuk është detyrimisht e drejta në mjet juridik dhe mbrojtje gjyqësore të të drejtave të garantuara përmes neneve 32 dhe 54 të Kushtetutës,

respektivisht, por kontestuese është nëse anëtarët prokurorë dhe jo-prokurorë të KPK-së janë trajtuar në mënyrë të barabartë përkitazi me të drejtën në mjet juridik në përputhje me të drejtën për barazi para ligjit, siç është saktësuar në nenin 24 të Kushtetutës.

332. Gjykata thekson se praktika e saj gjyqësore në kontekst të nenit 24 të Kushtetutës, përfshirë në lidhje me nenin 14 (Ndalimi i diskriminimit) të KEDNJ-së dhe nenin 1 të Protokollit nr. 12 (Ndalimi i përgjithshëm i diskriminimit) të KEDNJ-së, është e konsoliduar bazuar në praktikën relevante të GJEDNJ-së dhe është sqaruar, ndër tjerash, përmes Aktgjykimeve të Gjykatës në rastet (i) [KO01/17](#), parashtrues *Aida Dërguti dhe 23 deputetë të tjerë të Kuvendit*, vlerësimi i kushtetutshmërisë së Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-261 për veteranët e luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Aktgjykim i 28 marsit 2017; (ii) [KO157/18](#), parashtrues *Gjykata Supreme*, vlerësim i kushtetutshmërisë së nenit 14, paragrafit 1.7 të Ligjit nr. 03/L-179 për Kryqin e Kuq të Republikës së Kosovës, Aktgjykim i 13 marsit 2019; (iii) [KO93/21](#), parashtrues *Blerta Deliu-Kodra dhe 12 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës*, vlerësim i kushtetutshmërisë së Rekomandimeve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Nr.08-R-01, të 6 majit 2021, Aktgjykim i 28 dhjetorit 2021; dhe (iv) [KO190/19](#), parashtrues *Gjykata Supreme*, vlerësim i kushtetutshmërisë së nenit 8, paragrafit 2, të Ligjit nr. 04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti lidhur me nenin 5 dhe 6 të Udhëzimit Administrativ (MPMS) nr. 09/2015 për Kategorizimin e Shfrytëzuesve të Pensionit Kontributpagues sipas Strukturës Kualifikuese dhe Kohëzgjatjes së Pagesës së Kontributeve, Aktgjykim i 30 dhjetorit 2022.
333. Përmes këtyre Aktgjykimeve është sqaruar që testi që aplikohet për të konstatuar nëse një akt i nxjerrë nga një autoritet publik është në kundërshtim me të drejtën për barazi para ligjit të garantuar me nenin 24 të Kushtetutës, përfshin fillimisht vlerësimin (i) nëse ka pasur “*dallim në trajtim*” të personave në situata “*analoge ose situata relativisht të ngjashme*” ose dështim për të trajtuar persona ndryshe në situata relativisht të ndryshme; dhe nëse ky është rasti, (ii) vlerësimin nëse një dallim i tillë ose mungesë e dallimit është e justifikuar në mënyrë objektive, përkatësisht nëse kufizimi është “*i përcaktuar në ligj*”, ka ndjekur “*një qëllim legjitim*” dhe masa e ndërmarrë ka qenë “*proporcionale*” me qëllimin që është synuar të realizohet.
334. Në rrethanat e rastit konkret, nuk është kontestuese që anëtarët prokurorë dhe jo-prokurorë të KPK-së janë në “*situata analoge ose situata relativisht të ngjashme*”, sepse (i) të gjithë janë anëtarë të të njëjtit Këshill; (ii) ushtrojnë funksionet e njëjta, siç janë përcaktuar në Kushtetutë dhe ligjin përkatës për KPK-në; dhe (iii) kanë detyrimin të ushtrojnë funksionet e tyre në mënyrë të pavarur, profesionale dhe të paanshme dhe në interes të funksionimit të KPK-së dhe jo autoriteteve që i kanë zgjedhur, pa marrë parasysh që mënyra e zgjedhjes së tyre nuk është e njëjtë. Për më tepër, gjithashtu nuk është kontestuese që në rrethanat e anëtarëve prokurorë dhe jo-prokurorë të Këshillit, ka “*dallim në trajtim*” në kontekst të mjetit juridik në dispozicion për të kontestuar vendimet përkatëse për shkarkim. Grupit të parë, përkatësisht anëtarëve prokurorë, i është dhënë qasje e drejtpërdrejtë në Gjykatën Supreme, e cila është e detyruar të vendos brenda afateve të saktësuar në ligjin e aplikueshëm, ndërsa grupit të dytë, përkatësisht anëtarëve jo-prokurorë, përderisa nuk i është ndaluar e drejta në mjet juridik, ky i fundit në rastin e tyre, është konflikti administrativ i iniciuar në Gjykatë Themelore, pa afat të saktësuar për vendimmarrjen përkatëse. Megjithatë, siç është sqaruar në praktikën gjyqësore të Gjykatës dhe të cituar më lart, fakti që ka një “*dallim në trajtim*” jodetyrimisht rezulton në cenim të nenit 24 të Kushtetutës, sepse paraprakisht, duhet të vlerësohet nëse ky “*dallim në trajtim*” ka “*një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm*” dhe më saktësisht nëse (i) është “*i përcaktuar me ligj*”; (ii) ndjek “*një qëllim legjitim*”; dhe (iii) është “*proporcional*”.

335. Në vlerësimin nëse “*dallimi përkatës në trajtim*” është i “*përcaktuar me ligj*”, Gjykata rikujton se e drejta për mjet juridik drejtpërdrejtë në Gjykatën Supreme i është njohur anëtarëve prokurorë të Këshillit përmes paragrafit 5 të nenit 16 të Ligjit të kontestuar, por një e drejtë e tillë, nuk i është njohur anëtarëve jo-prokurorë të Këshillit, të cilët edhe pse në rrethana “*të ngjashme apo analoge*” me anëtarët prokurorë të KPK-së, duhet të përdorin të drejtën për ankesë përmes legjislacionit tjetër në fuqi, duke ju drejtuar Gjykatës Themelore për të kontestuar vendimet përkatëse për shkarkim. Prandaj, dallimi në trajtim në mes dy kategorive të lartcekura të anëtarëve të KPK-së është “*i përcaktuar me ligj*”, përkatësisht në paragrafin 5 të nenit 16 të Ligji të kontestuar. Për pasojë dhe në vijim, Gjykata duhet të vazhdojë me vlerësimin nëse “*dallimi në trajtim*” i lartcekur dhe i “*përcaktuar me ligj*”, ka ndjekur një “*qëllim legjitim*”, dhe nëse ky është rasti, duhet të vazhdojë me vlerësimin nëse masat e ndërmarra kanë qenë “*proporcionale*” me synimin për të arritur qëllimin.
336. Në kontekst të vlerësimit nëse qëllimi përkatës në “*dallimin në trajtim*” në mes anëtarëve prokurorë dhe jo-prokurorë të KPK-së ndjek “*një qëllim legjitim*”, Gjykata thekson që bazuar në paragrafin 3 të nenit 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore] të Kushtetutës por edhe parimet që burojnë nga praktika gjyqësore e GJEDNJ-së dhe e Gjykatës, përcaktohet që kufizimet e të drejtave dhe lirive të garantuara me Kushtetutë “*nuk mund të bëhen për qëllime të tjera, përveç atyre për të cilat janë përcaktuar.*” Sipas këtij paragrafi, siç është interpretuar përmes praktikës së konsoliduar të Gjykatës dhe të cituar më lart, në parim, qëllimet e një kufizimi duhet të jenë qartësisht të përcaktuara dhe asnjë autoritet publik nuk mund të kufizojë ndonjë të drejtë apo liri mbi bazën e një qëllimi tjetër përtej atij që veçse është përcaktuar në ligjin në të cilin është lejuar/saktësuar kufizimi përkatës. Në parim, dhe në kontekst të rrethanave të rastit konkret, bazuar në këtë praktikë gjyqësore, i takon Ministrisë së Drejtësisë si sponsorisuese e Ligjit të kontestuar dhe Kuvendit që ka miratuar Ligjin e kontestuar, që të tregojnë se ai dallim ishte i justifikuar (shih, ndër tjerash, rastin e GJEDNJ-së, [D.H dhe të tjerët kundër Republikës Çeke](#), nr. 57325/00, Aktgjykim i 13 nëntorit 2007, paragrafi 177; shih gjithashtu rastin e Gjykatës KO190/19, cituar më lart, paragrafët 206 dhe 208 dhe referencat e përdorura aty). Për këtë qëllim, Gjykata rikujton se në përgjigjen e saj të parashtruar në Gjykatë, Ministria e Drejtësisë kishte theksuar se (i) anëtarëve prokurorë ju është mundësuar ankesa drejtpërdrejtë në Gjykatën Supreme duke marrë parasysh unifikimin me sistemin e rregullt disiplinor për prokurorët sipas nenit 15 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore, i cili përcakton se prokurorët ndaj vendimeve disiplinore kanë të drejtë ankese drejtpërdrejtë në Gjykatën Supreme; dhe (ii) Ligji i kontestuar nuk e ka kufizuar mbrojtjen gjyqësore ndaj anëtarëve jo-prokurorë të Këshillit, pasi të njëjtit mund të kontestojnë vendimet për shkarkim në gjykata të rregullta “*me konflikt administrativ apo drejtpërdrejtë në Gjykatën Kushtetuese*”.
337. Megjithatë, as në përgjigjet e pranuar nga Ministria e Drejtësisë e as nga vet Ligji i kontestuar, nuk rezulton të ketë një “*qëllim legjitim*” që arsyeton pamundësinë e anëtarëve jo-prokurorë të Këshillit që t’i drejtohen drejtpërdrejtë Gjykatës Supreme në rast të shkarkimit të tyre, njëjtë sikur kolegët e tyre prokurorë. Në kontekst të përgjigjes së Ministrisë së Drejtësisë, Gjykata thekson që (i) përderisa mjeti juridik i përcaktuar përmes konfliktit administrativ është mjet efektiv juridik dhe për pasojë, (ii) çdo qasje e individëve në Gjykatën Kushtetuese i nënshtrohet detyrimit të shterimi të këtij mjeti juridik, siç është sqaruar në mënyrë të vazhdueshme përmes praktikës gjyqësore të Gjykatës, ekzistenca e këtij mjeti juridik, nuk përbën justifikim legjitim për “*dallimin në trajtim*” në mes të anëtarëve prokurorë dhe jo-prokurorë të KPK-së. Në këtë kontekst, Gjykata rithekson se të gjithë anëtarët e KPK-së, pa dallim nëse janë prokurorë ose jo-prokurorë, ushtrojnë të njëjtat funksione dhe kanë të njëjtat detyrime dhe të drejta gjatë ushtrimit të mandatit të tyre si anëtarë të KPK-së dhe nuk kanë asnjë detyrim ndaj institucioneve që i kanë zgjedhur, por vetëm detyrimin që të ushtrojnë

funkcionin e tyre në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet e aplikueshme të Republikës së Kosovës.

338. Për pasojë, bazuar në të lartcekurat dhe duke marrë parasysh që tashmë Gjykata konstatoi që “*dallimi në trajtim*” në mes të dy kategorive të anëtarëve të Këshillit, përkatësisht atyre prokurorë dhe jo-prokurorë, nuk ndjek një “*qëllim legjitim*” bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së dhe atë të Gjykatës, analiza e proporcionalitetit në mes të mjeteve të përdorura dhe qëllimit që dëshirohet të arrihet, është e panevojshme (shih, ndër tjerash, rastet e Gjykatës [K001/17](#), cituar më lart, paragrafi 99; dhe [K0157/18](#), cituar më lart, paragrafi 114).
339. Përfundimisht, Gjykata konstaton që paragrafi 5 i nenit 16 [pa titull] të Ligjit të kontestuar për ndryshimin dhe plotësimin e nenit 19 (Procedurat disiplinore për anëtarët e Këshillit) të Ligjit bazik, nuk është në përputhshmëri me paragrafin 1 të nenit 24 të Kushtetutës.
- b) Përkitazi me sigurinë juridike në kontekst të mjetit juridik dhe mbrojtjes gjyqësore të të drejtave të prokurorëve ndaj vendimeve të Këshillit*
340. Gjykata gjithashtu rikujton që parashtruesit e kërkesës pretendojnë cenimin e parimeve të sigurisë të juridike, marrë parasysh që neni 18 i Ligjit të kontestuar për plotësimin e Ligjit bazik, përmes të cilit shtohet neni 23/A përkitazi me mbrojtjen gjyqësore, është në kundërshtim me nenin 15 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore dhe se të dy nenet rregullojnë të njëjtat çështje në mënyrë të ndryshme dhe bazuar në afate të ndryshme, përkatësisht kundërthënëse.
341. Në këtë kontekst, Gjykata fillimisht rikujton që e drejta e ankesës së prokurorëve ndaj vendimeve të Këshillit, nuk është e përcaktuar përmes Ligjit bazik, por është e rregulluar në mënyrë të detajuar përmes Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore. Ky i fundit, në nenin 1 (Qëllimi dhe fushëveprimi) saktëson që ligji përkatës përcakton (i) shkeljet disiplinore; (ii) procedurat për fillimin e hetimeve për dyshimet për shkelje disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve; (iii) procedurat disiplinore pranë KGJK-së dhe KPK-së; dhe (iv) sanksionet disiplinore dhe mjetet juridike që lidhen me shkeljet disiplinore pranë Gjykatës Supreme. Për më tepër, në nenin 15 të tij, saktëson, ndër tjerash që (i) palët, përkatësisht prokurorët dhe gjyqtarët, kanë të drejtë të ankohen ndaj vendimeve disiplinore të Këshillit drejtpërdrejt në Gjykatën Supreme, brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimit të vendimit; dhe (ii) Gjykata Supreme, në një trup gjykues të përbërë nga tre (3) anëtarë, të zgjedhur nga Kryetari i Gjykatës Supreme, brenda tridhjetë (30) ditëve, shqyrton dhe vendos lidhur me ankesën.
342. Gjykata rikujton që neni 18 i Ligjit të kontestuar i cili shton nenin 23/A në raport me Ligjin bazik, përcakton që prokurori ka të drejtë të paraqesë ankesë drejtpërdrejtë në Gjykatën Supreme ndaj (i) vendimit të Këshillit për shkarkim; dhe (ii) “*vendimeve lidhur me vlerësimin e performancës së prokurorëve*”, si dhe (iii) “*vendimeve disiplinore, që për pasojë kanë uljen në detyrë të prokurorëve*” dhe përkitazi me të cilat, Gjykata Supreme vendos brenda nëntëdhjetë (90) ditëve nga pranimi i ankesës.
343. Gjykata gjithashtu rikujton që këtë çështje nuk e kanë trajtuar specifikisht dy Opinionet e Komisionit të Venecias lidhur me Ligjin e kontestuar, megjithatë, Opinioni i parë lidhur me Ligjin e kontestuar thekson se “*disa nga ndryshimet janë pozitive. Në këtë aspekt, neni 23A krijon të drejtën për tu ankuar para Gjykatës Supreme ndaj vendimeve për zgjedhje apo ricaktim të prokurorëve*”. Thënë kjo, këto të drejta të prokurorëve për tu ankuar drejtpërdrejtë në Gjykatën Supreme, janë specifikisht të përcaktuara me ligjet respektive ndër vite, përfshirë edhe Ligjin për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

344. Gjykata rikujton që marrë parasysh rregullimin specifik të këtij të fundit, qëllimi i nenit të ri 23/A të Ligjit të kontestuar, është i paqartë. I njëjti, nuk ndërlihet me të drejtat për ankesë të anëtarëve të KPK-së, por të prokurorëve në përgjithësi, të drejta këto të saktësuara me Ligjin për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve. Të vetmet dallime që neni 23/A përcakton, janë (i) ndryshimi i afatit përkatës për vendimmarrjen e Gjykatës Supreme në rast të ankesave përkatëse nga tridhjetë (30) ditë siç është përcaktuar në paragrafin 5 të nenit 15 të Ligjit për Përgjegjësitë Disiplinore, në nëntëdhjetë (90) ditë me kushtin që nuk “*parashihet ndryshe me ligj*”; (ii) përcaktimi i mekanizmit të ankesës në Gjykatë Supreme, lidhur me “*vendimet lidhur me vlerësimin e performancës së prokurorëve*”, kompetencë kjo aktualisht e KPK-së sipas paragrafit 3 të nenit 27 (Vlerësimi i Performancës së Prokurorëve) të Ligjit bazik; dhe (iii) përcaktimi i mekanizmit të ankesës në Gjykatë Supreme lidhur me “*vendimet disiplinore që kanë për pasojë uljen në detyrë të prokurorëve*”, e cila edhe pse nuk është formuluar më të njëjtën gjuhë, përkon me masën disiplinore të përcaktuar në nenin 7 (Sanksionet disiplinore) të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore, përkatësisht “*transferim i përkohshëm ose i përhershëm në një gjykatë apo prokurori tjetër të nivelit më të ulët*”.
345. Në interpretimin e përbashkët të nenit 23/A dhe dispozitave relevante të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore, përkatësisht nenet 7 dhe 15 të tij, por edhe nenit 27 të Ligjit bazik dhe marrë parasysh përcaktimin e nenit 23/A të Ligjit të kontestuar, që afatet e këtij ligji vlejné përpos nëse “*parashihet ndryshe me ligj*”, rezultojnë që (i) afati nëntëdhjetë (90) ditor i përcaktuar në nenin 23/A, vlen vetëm për “*vendimet lidhur me vlerësimin e performancës së prokurorëve*”, siç është përcaktuar në paragrafin 1 të nenit 23/A të Ligjit të kontestuar, ndërsa vendimet tjera disiplinore, i nënshtrohet afateve të ndryshme, përkatësisht kundërthënëse të vendimmarrjes, përkatësisht nëntëdhjetë (90) ditë sipas nenit 23/A të Ligjit të kontestuar dhe tridhjetë (30) ditë sipas nenit 15 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore.
346. Në kontekst të sqarimit të mësipërm, Gjykata rikujton nenin 32 [E drejta për Mjete Juridike] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës. I pari përcakton që “*secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij në mënyrën e përcaktuar me ligj.*”; ndërsa i dyti, që “*Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur.*” Ashtu siç është përcaktuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës dhe e cila bazohet në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, në parim dhe në tërësinë e tyre, neni 54 i Kushtetutës për mbrojtjen gjyqësore të të drejtave, neni 32 i Kushtetutës për të drejtën në mjet juridik dhe neni 13 i KEDNJ-së për të drejtën për zgjidhje efektive, garantojnë: (i) të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose të mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me Kushtetutë ose me ligj; (ii) të drejtën për të përdorur mjet juridik kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat e garantuara në mënyrën e përcaktuar me ligj; (iii) të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë është shkelur; dhe (iv) të drejtën për një zgjidhje efektive në nivel kombëtar nëse është shkelur një e drejtë e garantuar me KEDNJ (shih, në këtë kontekst dhe ndër tjerash, rastin e Gjykatës [KI48/18](#), parashtrues: *Arban Abrashi dhe Lidhja Demokratike e Kosovës*, Aktgjykim i 23 janarit 2019, paragrafi 198).
347. Në kontekst të së drejtës për mjete juridike, Gjykata thekson se parimi i sigurisë juridike, i cili është i mishëruar në të gjitha nenet e KEDNJ-së, kërkon që të drejtat dhe detyrimet të jenë të “*përcaktuara me ligj*”. Megjithatë, “*përcaktueshmëria me ligj*” përveç që kërkon që masa e ndërmarrë duhet të ketë bazë ligjore në legjislacionin shtetëror, kërkon gjithashtu që dispozitat relevante të ligjit të jenë “*të qarta, të qasshme dhe të parashikueshme*” (shih, në këtë kontekst, rastet e GJEDNJ-së, [Beyeler kundër](#)

Italisë, no. 33202/96, Aktgjykim i 5 janarit 2000, paragrafi 109; Hentrich kundër Francës, nr. 1361/88, Aktgjykim i 22 shtatorit 1994, paragrafi 42; dhe Lithgow dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar, nr. 9006/80; 9262/81; 9263/81; 9265/81; 9266/81; 9313/81; 9405/81, Aktgjykim i 8 korrikut 1986, paragrafi 110). Gjykata vëren po ashtu se sipas Listës Kontrolluese të Sundimit të Ligjit të Komisionit të Venecias, “*parashikueshmëria e ligjit*” është pjesë thelbësore e parimit të sigurisë juridike. Në këtë kontekst, “*parashikueshmëria*” nënkupton, mes tjerash, që ligji duhet të formulohet me precizitet dhe qartësi të duhur që t’iu mundësojë subjekteve juridike që të rregullojnë sjelljen e tyre konform ligjit. (shih, Listën Kontrolluese të Sundimit të Ligjit të Komisionit të Venecias, CDL-Ad(2016)007, Strasburg, 18 mars 2016, paragrafët 58 dhe 59).

348. Thënë këtë dhe duke marrë parasysh parimet e lartcekura lidhur me “*parashikueshmërinë*” e ligjit dhe rëndësinë e këtij koncepti për parimin e sigurisë juridike, Gjykata rithekson që leximi i përbashkët i nenit 18 të Ligjit të kontestuar në ndërlidhje me nenet 7 dhe 15 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore dhe nenin 27 të Ligjit bazik, rezulton që në rast të vendimeve/sanksioneve disiplinore të saktësuar në nenin 7 (Sanksionet Disiplinore) të Ligjit për Përgjegjësitë Disiplinore, me përjashtim të propozimit për shkarkim, afati i vendimmarrjes në Gjykatën Supreme, është i qartë dhe i njëjti është tridhjetë (30) ditë, bazuar në paragrafin 5 të nenit 15 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore.
349. Thënë këtë, të dy ligjet, përkatësisht neni 23/A i Ligjit të kontestuar dhe neni 15 i Ligjit për Përgjegjësitë Disiplinore, përcaktojnë dy afate të ndryshme lidhur me vendimet disiplinore, përfshirë propozimet e Këshillit për shkarkimin e prokurorëve, sepse (i) propozimi për shkarkim është masë disiplinore e përcaktuar përmes nenit 7 të Ligjit për Përgjegjësitë Disiplinore dhe për pasojë e ankimueshme bazuar në nenin 15 të Ligjit të lartcekur dhe përkitazi me të cilin Gjykata Supreme është e detyruar të vendos brenda tridhjetë (30) ditësh; ndërsa (ii) “*vendimi i Këshillit për shkarkim*”, siç i referohet neni 23/A i Ligjit të kontestuar, që në fakt duhet të jetë formuluar si propozimi i Këshillit për shkarkim të prokurorëve, sepse Këshilli ka vetëm kompetencën për të propozuar shkarkimin përkatës të prokurorëve sipas Kushtetutës, duke përfshirë sipas paragrafit 18 të nenit 84 të Kushtetutës, përtej afatit tridhjetë (30) ditor të përcaktuar në Ligjin për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, ka përcaktuar edhe afatin (90) ditor për vendimmarrjen e Gjykatës Supreme në kontekst të të njëjtës natyrë të vendimmarrjes; dhe (iii) për më tepër, përderisa neni 23/A ka përcaktuar mundësinë e ankesës në Gjykatë Supreme përkitazi me “*vendimin lidhur me vlerësimin e performancës së prokurorëve*”, neni 27 i Ligjit bazik, e përcakton të njëjtën si kompetencë të KPK-së.
350. Bazuar në parimet e lartcekura përkitazi me parimin e sigurisë juridike dhe rëndësinë që dispozitat relevante të ligjit të jenë “*të qarta, të qasshme dhe të parashikueshme*”, sipas parimeve të përmbledhura nga raportet relevante të Komisionit të Venecias, por edhe praktika gjyqësore GJEDNJ-së, Gjykata vlerëson që formulimi i neni 23/A të Ligjit të kontestuar, rezulton në afate dhe kompetenca kundërthënëse, siç është sqaruar më lart dhe për pasojë, e ndër tjerash, u pamundëson subjekteve juridike, përfshirë Gjykatën Supreme por edhe KPK-në, që të rregullojnë sjelljen e tyre konform ligjit.
351. Përfundimisht dhe për pasojë, Gjykata konstaton që neni 18 i Ligjit të kontestuar përmes të cilit plotësohet, përkatësisht shtohet neni 23/A i Ligjit bazik, nuk është në përputhshmëri me nenin 32 dhe nenin 54 të Kushtetutës.

6. Vlerësimi i kushtetutshmërisë së nenit 20 [pa titull] të Ligjit të kontestuar për ndryshimin dhe plotësimin e nenit 36 (Qëndrimi në detyrë) të Ligjit bazik në lidhje edhe me paragrafin 3 të nenit 11 [pa titull] të Ligjit të kontestuar për ndryshimin dhe plotësimin e nenit 13 (Përfundimi i mandatit) të Ligjit bazik

352. Fillimisht dhe për qëllime të vlerësimit të kushtetutshmërisë së nenit 20 të Ligjit të kontestuar, Gjykata do të paraqesë: (i) thelbin e pretendimeve të parashtruesve të kërkesës dhe komentet mbështetëse të dorëzuara nga palët e interesuara, si dhe thelbin e argumenteve të palës kundërshtare (shih, paragrafët 46-137 të këtij Aktgjykimi për një pasqyrim të hollësishëm të argumenteve dhe kundër-argumenteve përkatëse); dhe (ii) përgjigjen e Gjykatës lidhur me këto pretendime përkitazi me jokushtetutshmërinë e nenit përkatës.

(i) *Thelbi i pretendimeve/argumenteve dhe kundër-argumenteve të parashtruesve dhe palëve të interesuara*

353. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se neni 20 [pa titull] i Ligjit të kontestuar është në kundërshtim me nenet 4, 32, 54 dhe 110 të Kushtetutës, sepse të njëjtit dhe në esencë (i) përmes ndryshimit të strukturës së KPK-së, përfshirë ndërprerjen e mandatit të anëtarëve të KPK-së dhe zëvendësimin e tyre me anëtarë jo-prokurorë të zgjedhur me shumicë të thjeshtë nga Kuvendi, në fakt, ka për qëllim ndikimin në zgjedhjen e Kryeprokurorit të Shtetit për mandatin e ardhshëm shtatëvjeçar; (ii) përmes ndërprerjes arbitrare të mandatit cenohet pavarësia kushtetuese, institucionale e funksionale e KPK-së, e përcaktuar me nenin 110 të Kushtetutës, i cili përcakton se KPK është institucion “plotësisht i pavarur në kryerjen e funksioneve të tij, në pajtim me ligjin”; (iii) ndërprejnë mandatin e anëtarëve të KPK-së në mënyrë arbitrare dhe në tejkalim të të gjitha bazave dhe kriterëve të përcaktuara përmes nenit 13 (Përfundimi i mandatit) të Ligjit bazik, përkatësisht ligjit në fuqi; (iv) është në kundërshtim me Parimet Themelore të OKB-së për Pavarësinë e Gjyqësorit, Rekomandimit të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës CM/Rec (2010) 12, parimeve themelore për pavarësinë e gjyqësorit të miratuar nga Kongresi Shtatë i Kombeve të Bashkuara për Parandalimin e Krimit dhe Trajtimin e Shkelësve të miratuar me rezolutat e Asamblesë së Përgjithshme 40/32, të 29 nëntorit 1985 dhe 40/146, të 13 dhjetorit 1985, si dhe praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, ndër tjerash, në rastet *Baka kundër Hungarisë* dhe *Grzeda kundër Polonisë* dhe Opinioneve të Komisionit të Venecias, duke përfshirë Opinionin nr. 811/2015 lidhur me projekt-ndryshimet e Ligjit për Prokurorë të Gjeorgjisë, por edhe praktikën gjyqësore të Gjykatës, përfshirë në Aktgjykimin KO29/12 dhe KO48/12 lidhur me çështjen e sigurisë së mandateve; (v) është në kundërshtim edhe me vet Opinionin e Komisionit të Venecias për Kosovë, sipas të cilit, “zëvendësimi i anëtarëve aktualë me anëtarë të rinj mund të justifikohet jashtëzakonisht vetëm nëse shpie në një përmirësim të madh të sistemit aktual, (në veçanti, depolitizimin e tij)”, porse sipas parashtruesve të kërkesës “vlerësimet politike apo perceptimet e Qeverisë për punën dhe imazhin e KPK-së, nuk mund të shndërrohen në norma ligjore dhe t’iu ndërpritet pa bazë mandati shumicës së anëtarëve prokurorë aktualë të KPK-së (përfshirë edhe anëtarit joprokuror aktualë), sepse kjo do të përbente një praktikë tepër të rrezikshme për pavarësinë kushtetuese, institucionale dhe funksionale të KPK-së, pasi do t’i shërbente çdo Qeverie dhe shumice të re parlamentare, ndërhyrjen në strukturën, përbërjen dhe vendimmarrjen e këtij institucioni, sipas vlerësimit dhe perceptimit të saj, për KPK-në”; dhe (vi) zbret numrin e anëtarëve prokurorë që zgjedhen nga vet prokurorët, nga nëntë (9) në tre (3) anëtarë, dhe përmes procedurës së shortit të organizuar nga Kryetari i Gjykatës Supreme bashkë me Kryesuesin e Këshillit Gjyqësor dhe Avokatin e Popullit sipas përcaktimeve të Ligjit të kontestuar, ndërprejnë mandatet e fituara pesëvjeçare për të cilin janë zgjedhur, duke u cenuar të njëjtëve edhe të drejtën në mjet juridik dhe mbrojtje gjyqësore të të drejtave, të

garantuara me nenet 32 dhe 54 të Kushtetutës. KPK dhe Oda e Avokatëve, mbështesin pretendimet e parashtruesve të kërkesës.

354. Ministria e Drejtësisë, në anën tjetër, lidhur me pretendimet e lartcekura, ndër tjerash, thekson se (i) mandati i anëtarëve të KPK-së nuk është kategori kushtetuese por ligjore; (ii) se pushteti gjyqësor dallon nga ai prokurorial dhe kjo është përmendur në Aktgjykimin e Gjykatës në rastin KO29/12 dhe KO48/12, të cilit parashtruesit e kërkesës i referohen; (iii) vazhdimi i përbërjes aktuale të KPK-së *“me rrezikun e korporatizimit dhe me një disbalancë të 10 anëtarëve prokurorë dhe vetëm 1 anëtar joprokuror edhe për [katër] 4 vite tjera, do t'i pamundësonte KPK-së të zbatoj kompetencat e veta kushtetuese”*; (iv) bazuar edhe në vlerësimin e Komisionit të Venecias, parimi i *“mbajtjes së mandatit”* nuk është absolut dhe rrjedhimisht ndërprerja e mandatit të anëtarëve të Këshillit mund të arsyetohet nëse *“shpien në përparim të dukshëm të sistemit në përgjithësi”* dhe në këtë kuptim *“nuk ka logjikë që ligji i cili hyn në fuqi tash të pres edhe [katër] 4 vite për zbatim”*; (v) asnjërit nga anëtarët e KPK-së, të cilëve iu ndërprehet mandati sipas shortit, nuk i kufizohet e drejta që të përdorin mjetet juridike lidhur me ndërprerjen e mandatit të tij/saj; dhe në fund (vi) *“ndërprerja e parakohshme të mandatit të disa prej anëtarëve aktualë të KPK-së nuk shkel nenin 110 të Kushtetutës. Përkundrazi vazhdimi i përbërjes aktuale të KPK-së me rrezikun e korporatizimit dhe me një disbalancë të 10 anëtarëve prokurorë dhe vetëm 1 anëtar joprokuror edhe për 4 vite tjera, do t'i pamundësonte KPK-së të zbatoj kompetencat e veta kushtetuese”*.

(ii) *Vlerësimi i Gjykatës*

355. Në kontekst të pretendimeve të parashtruesve të kërkesës dhe argumenteve dhe kundër-argumenteve përkatëse, Gjykata fillimisht thekson se bazuar në nenin 12 (Mandati i anëtarëve të Këshillit) të Ligjit bazik, anëtarët e Këshillit qëndrojnë në detyrë për një mandat pesëvjeçar, pa të drejtë rizgjedhjeje dhe afati i qëndrimit në detyrë i anëtarëve të zgjedhur të Këshillit fillon nga data e zgjedhjes së tyre për anëtar të Këshillit. Në anën tjetër dhe siç është sqaruar edhe në pjesën e parimeve të përgjithshme të këtij Aktgjykimi, bazuar në nenin 13 (Përfundimi i mandatit) të Ligjit bazik, mandati në KPK mund të përfundojë me (i) vdekje; (ii) humbjen e zotësisë për veprim; (iii) dështimin e vazhduar për të marrë pjesë në veprimtaritë e Këshillit më gjatë se tre (3) muaj, pa arsye të vërtetuar; (iv) pushimin e statusit mbi të cilin bazohet emërimi; (v) skadimin e mandatit; (vi) dorëheqje, duke i ofruar Këshillit njoftim paraprak prej tridhjetë (30) ditësh; (vii) arritjen e moshës së pensionimit; dhe (viii) kur është dënuar për veprë penale, me përjashtim të veprave penale të kryera nga pakujdesia. Për më tepër dhe bazuar në të njëjtin nen, Ligji bazik përcakton mundësinë e shkarkimit para skadimit të mandatit në dy rrethana, përkatësisht nëse (i) funksionin e anëtarit të Këshillit nuk e kryen në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin; dhe (ii) ushtron funksionin në kundërshtim me detyrat dhe përgjegjësitë e tij. Për më tepër, dhe përkundër faktit që Ligji i vitit 2019, ndryshonte strukturën e KPK-së në mënyrën e sqaruar tashmë me këtë Aktgjykim, neni 36 (Qëndrimi në detyrë) i tij, saktësonte që anëtarët e zgjedhur të Këshillit, që ushtrojnë këtë funksion në kohën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, mund të qëndrojnë në këtë detyrë deri në mbarim të mandatit të tyre aktual.
356. Gjykata rikujton që fillimisht përmes nenit 4 të draftit të parë të propozuar nga Qeveria për plotësim dhe ndryshim të Ligjit bazik dhe i cili i ishte nënshtruar analizës së parë të Komisionit të Venecias, si rrjedhojë e së cilës Komisioni i Venecias hartoi Opinionin e parë, ishte propozuar plotësim-ndryshimi i nenit 12 të Ligjit bazik, ndryshime këto të cilat, në esencë, nuk e afektonin përmbajtjen e tij. Thënë këtë, (i) neni 14 i draftit të parë të propozuar, propozonte ndryshimin dhe plotësimin e nenit 36 (Qëndrimi në detyrë) të Ligjit bazik, duke përcaktuar që anëtarët e KPK-së, do të vazhdonin ushtrimin e funksioneve në të cilat janë zgjedhur derisa të jenë zëvendësuar sipas dispozitave të

- Ligjit të kontestuar; dhe (ii) neni 15 i draftit të parë të propozuar, shtonte edhe tri nene tjera, nenet 36/A, 36/B dhe 36/C, respektivisht, sipas të cilave, ndër tjerash, procedura e zgjedhjes së anëtarëve të rinj, do të fillonte nga Kuvendi përmes thirrjes për aplikim tridhjetë (30) ditë pas hyrjes së fuqi të ligjit, ndërsa anëtarët prokurorë të zgjedhur nga prokuroritë përkatëse do të zgjedhen vetëm pas zgjedhjes së anëtarëve jo-prokurorë nga Kuvendi dhe se derisa të zgjedhen anëtarët prokurorë, KPK do të funksionojë me katër (4) anëtarët jo-prokurorë të zgjedhur nga Kuvendi.
357. Gjykata thekson që në kontekst të dispozitës së kontestuar, Opinioni i parë i Komisionit të Venecias, adreson edhe përfundimin e parakohshëm të mandatit të anëtarëve si dhe zëvendësimin e anëtarëve ekzistues të KPK-së përmes ndryshimeve dhe plotësimeve të propozuara të projektligjit. Për sa i përket të parës, Opinioni përkatës, në parim, sqaron se (i) ndërprerja e parakohshme e mandatit të një anëtari të një këshilli (kur nuk është rasti i dorëheqjes vullnetare, shfuqizimit të të gjithë institucionit ose për arsye të tjera të ngjashme), duhet të jetë gjithmonë i lidhur me një shkelje të identifikueshme ose dështim në kryerjen e detyrës së tij/saj (shih, Opinionin e parë të Komisionit të Venecias, paragrafi 54); dhe se (ii) anëtarët e KPK-së nuk duhet të “*shkarkohen*” thjesht sepse shumica parlamentare ose kolegët e tyre nuk pajtohen me vendimet që të njëjtit marrin (shih, Opinionin e parë të Komisionit të Venecias, paragrafi 54). Ndërsa, sa i përket zëvendësimit të anëtarëve ekzistues të KPK-së, Opinioni i parë i Komisionit të Venecias, fillimisht thekson se propozimi i Qeverisë që themelimi i KPK-së së propozuar të bëhet në tri faza, e para nga të cilat përcakton që KPK fillimisht do të operojë vetëm me katër (4) prej anëtarëve jo-prokurorë derisa të zgjedhen anëtarët e rinj prokuror, dhe të cilët mund të “*vendosin edhe për zgjedhjen e Kryeprokurorit*”, ndër të tjera, ngre shqetësime, duke theksuar se “*ndryshimet e propozuara bien ndesh me standardet ndërkombëtare dhe evropiane: ato efektivisht largojnë prokurorët nga qeverisja e sistemit në momentin më kritik kur do të zgjedhet edhe Kryeprokurori ashtu edhe anëtarët e rinj prokurorial*” (shih, Opinionin e parë të Komisionit të Venecias, paragrafi 58).
358. Për më tepër, Opinioni i parë gjithashtu trajton propozimin e projektligjit lidhur me përfundimin e parakohshëm të mandateve të anëtarëve aktualë të KPK-së. Në këtë aspekt, Opinioni i parë i Komisionit të Venecias, ndër të tjera, thekson se (i) Kushtetuta nuk përcakton mandatin e anëtarëve të KPK-së, por e autorizon atë të përcaktohet me ligj (shih, Opinionin e parë të Komisionit të Venecias, paragrafi 59); megjithatë (ii) kjo nuk do të thotë që ligjvënësi mund të zvogëlojë kohëzgjatjen e një mandati ose ta ndërpresë atë sipas dëshirës, pasi duhet të respektohet siguria e mandatit, ashtu siç do të ishte “*e pasaktë të lejohej një ripërtëritje e plotë e përbërjes së një këshilli prokurorial pas çdo zgjedhje parlamentare, kur shumica qeverisëse ndryshon*” (shih, Opinionin e parë të Komisionit të Venecias, paragrafi 59).
359. Megjithatë, Opinioni i parë theksoi gjithashtu se parimi i sigurisë së mandatit nuk është absolut, pasi përfundimi i parakohshëm i mandateve, ndonjëherë mund të justifikohet. Duke iu referuar raportit të Komisionit të Venecias për Malin e Zi, Komisioni gjithashtu theksoi se (i) si rregull i përgjithshëm edhe kur reformohet një këshill prokurorial, anëtarët e tij aktualë normalisht duhet të lejohen të përfundojnë mandatin e tyre (shih, Opinionin e parë të Komisionit të Venecias, paragrafi 59); megjithatë (ii) përcaktimi i disa kritereve të reja të papërshtatshmërisë të cilat do të forconin pavarësinë dhe shkëputjen politike të anëtarëve përkatës, mund të justifikojë në mënyrë të argumentueshme zëvendësimin e atyre anëtarëve që nuk korrespondojnë/plotësojnë këto kritere (shih, Opinionin e parë të Komisionit të Venecias, paragrafi 60); në fund, duke vënë në dukje se (iii) “*me fjalë të thjeshta, përfundimi i parakohshëm i mandateve të disa anëtarëve mund të justifikohet nëse çon në një përmirësim të ndjeshëm të sistemit të përgjithshëm*” (shih, Opinionin e parë të Komisionit të Venecias, paragrafi 60).

360. Duke trajtuar më konkretisht propozimin e projektligjit për përfundimin e parakohshëm të mandatit të anëtarëve ekzistues të KPK-së, Komisioni i Venecias, theksoi, në thelb, se (i) në teori, qëllimi i Ministrisë së Drejtësisë për *“të luftuar korporatizmin brenda KPK-së, duke rritur përfundimin e anëtarëve joprokurorë në të mund të arrihet duke shtuar në përbërjen aktuale të KPK-së një numër të caktuar anëtarësh joprokurorë, duke mundësuar kështu që anëtarët aktualë prokurorë të qëndrojnë në KPK deri në skadimin e mandatit të tyre”* (shih, Opinionin e parë të Komisionit të Venecias, paragrafi 61); megjithatë (i) në këtë skenar, *“KPK do të rritej shumë (me më shumë se 20 anëtarë), marrë parasysh numrin relativisht të vogël të prokurorëve në Kosovë”* dhe se *“kjo zgjidhje sigurisht që do të ishte shumë e shtrenjtë, duke pasur parasysh se ndryshimet parashikojnë gjithashtu punësimin me kohë të plotë të të gjithë anëtarëve të KPK-së”* (shih, Opinionin e parë të Komisionit të Venecias, paragrafi 61); prandaj (iii) në vend të përfundimit të njëkohshëm të mandateve të të gjithë anëtarëve, mund të hulumtohen disa modele alternative të ripërtëritjes së përbërjes së KPK-së, duke përfshirë për shembull *“tre nga anëtarët prokurorë të për zgjedhur me short, mund të mbeten në KPK”* pasi kjo të paktën do të respektonte sigurinë e tyre në mandat dhe në të njëjtën kohë, do t'i lejonte KPK-së të fillojë menjëherë funksionimin me përbërjen e re (shih, Opinionin e parë të Komisionit të Venecias, paragrafi 62).
361. Në fund, për sa i përket përfundimit të parakohshëm të mandateve të anëtarëve ekzistues të KPK-së, Komisioni i Venecias përmes Opinionit të tij të parë, në thelb, konstatoi se (i) dispozitat kalimtare që parashikojnë përfundimin e parakohshëm të mandateve të të gjithë anëtarëve aktualë të KPK-së dhe lejimi i KPK-së së ripërtërirë të funksionojë vetëm me anëtarët jo-prokurorë në përbërjen e tij, *“janë të rrezikshme për pavarësinë prokuroriale dhe duhet rishikuar”*, prandaj, *“KPK-ja e re mund të fillojë të funksionojë vetëm kur të zgjedhen të gjithë anëtarët”* (shih, Opinionin e parë të Komisionit të Venecias, paragrafi 72); ndërsa (ii) zëvendësimi i anëtarëve aktualë në detyrë me të rinj mund të justifikohet përjashtimisht vetëm nëse çon në një përmirësim të madh në sistemin aktual, prandaj, *“anëtarët e prokurorisë në detyrë duhet të lejohen të përfundojnë mandatin e tyre”* (shih, Opinionin e parë të Komisionit të Venecias, paragrafi 64). Sipas Opinionit të parë, *“ata mund të largohen para kohe vetëm nëse qeveritë demonstron bindshëm se zëvendësimi i tyre i shërben një interesi jetik publik dhe çon në përmirësimin e dukshëm të sistemit”* (shih, Opinionin e parë të Komisionit të Venecias, paragrafi 64).
362. Thënë këtë, neni 20 i draftit të dytë të propozuar, ndryshon dhe plotëson nenin 36 (Qëndrimi në detyrë) të Ligjit bazik, duke ndërprerë parakohshëm mandatin e një pjesë të anëtarësisë së KPK-së, duke saktësuar, ndër tjerash, që (i) sipas afateve të përcaktuara në këtë nen, procedura e zgjedhjes së anëtarëve të rinj të KPK-së, fillon me Kuvendin dhe Avokatin e Popullit, ndërsa shtatë (7) ditë pas zgjedhjes së anëtarëve joprokurorë, Kryetari i Gjykatës Supreme, Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor dhe Avokati i Popullit, organizojnë procedurën e shortit përmes të cilës përcaktohet se cilët anëtarë të KPK-së vazhdojnë mandatin e tyre të fituar sipas Ligjit bazik; (ii) procedura e shortit do të përcaktojë se cili anëtar i KPK-së nga Prokuroria e Apelit dhe ajo Speciale, do të vazhdojë mandatin dhe cilët nga dy (2) anëtarët e KPK-së nga prokuroritë themelore, do të vazhdojnë mandatet përkatëse; dhe (iii) mandatet e të gjithë anëtarëve të tjerë prokurorë, do të përfundojnë pas procedurës së shortit, ndërsa të anëtarëve aktualë joprokurorë, do të përfundojnë me zgjedhjen e anëtarëve të rinj joprokurorë.
363. Opinioni i dytë i Komisionit të Venecias, shqyrtoi propozimin e rishikuar të projektligjit, përmes të cilit ideja e zëvendësimit të të gjitha mandateve të anëtarëve të KPK-së ishte ndryshuar, duke përcaktuar mundësinë e shortit përmes të cilit tre (3) nga anëtarët aktualë të KPK-së, do të lejoheshin të përfundojnë mandatet ekzistuese. Në këtë drejtim, Opinioni i dytë, ndër tjerash, thekson se (i) drafti i rishikuar lejon që tre (3) nga

- nëntë (9) anëtarët aktualë të KPK-së të mbajnë vendet e tyre, “gjë që është shumë më mirë se një ripërtëritje e plotë e përbërjes së tij” (shih, Opinionin e dytë të Komisionit të Venecias, paragrafi 35); dhe (ii) “edhe pse, si rregull, Komisioni i Venecias nuk është në favor të një përfundimi automatik të parakohshëm të mandateve të anëtarëve të një këshilli prokurorial për shkak të një reforme institucionale, dispozitat e reja kalimtare janë më të respektueshme lidhur me sigurinë e mandatit të anëtarëve të KPK-së ekzistuese në raport me modelin paraprak” (shih, Opinionin e dytë të Komisionit të Venecias, paragrafi 31).
364. Përfundimisht, Opinionin e dytë të Komisionit të Venecias, thekson se dispozitat e reja kalimtare janë “më të respektueshme” për sigurinë e mandateve të anëtarëve të KPK-së ekzistuese sesa modeli i mëparshëm, përkatësisht ai i vlerësuar në Opinionin e parë (shih, Opinionin e dytë të Komisionit të Venecias, paragrafi 31). Më tej, Opinionin e dytë, gjithashtu thekson se (i) “zbatimi i rekomandimeve më specifike të përfshira në këtë Opinion dhe atë të dhjetorit, duhet t’i lihet diskrecionit të Ministrisë dhe Kuvendit, në dialog me akterët vendor, ekspertët dhe partnerët ndërkombëtarë të Kosovës” (shih, Opinionin e dytë të Komisionit të Venecias, paragrafi 37); dhe (ii) “përderisa e kupton urgjencën e reformës, Komisioni megjithatë thërret autoritetet përkatëse që të sigurojnë një përfshirje të vërtetë të prokurorëve të Kosovës në diskutimet për ndryshimet e propozuara në Kuvend” (shih, Opinionin e dytë të Komisionit të Venecias, paragrafi 7).
365. Përtej dy Opinionëve për Kosovën, Komisioni i Venecias, siç është saktësuar në paragrafët 188-200 të këtij Aktgjykimi, çështjen e ndërprerjes së parakohshme të mandateve të anëtarëve të këshillave prokurorial, e ka trajtuar edhe të paktën në pesë (5) Opinionë tjera, tri (3) prej të cilave në rastin e Malit të Zi dhe dy (2) të tjera, në rastet e Moldavisë dhe Serbisë, respektivisht.
366. Në tri (3) Opinionet përkatëse në rastin e Malit të Zi, Komisioni i Venecias, ndër tjerash, kishte theksuar se (i) përderisa, në disa situata të jashtëzakonshme, një ligj mund të ketë një efekt të drejtpërdrejtë në mandatin e një zyrtari, reformat institucionale nuk duhet të nisin me qëllimin e vetëm të zëvendësimit të individëve në pozitat kyçe (shih, Opinionin CDL_AD(2021)012, paragrafi 29); (ii) përderisa është legjitime të zëvendësohen ministrat ose bartësit e tjerë të posteve politike pas zgjedhjeve, në rastet kur një institucion gëzon një lloj autonomie ose, *a fortiori*, përkufizohet si “i pavarur”, zëvendësimi i zyrtarëve kryesorë në një institucion të tillë për shkak të ndryshimit të shumicës politike dhe nën pretekstin e një reforme legislative, bie ndesh me Kushtetutën dhe sundimin e ligjit (shih, Opinionin CDL_AD(2021)012, paragrafi 30); (iii) rastet e sjelljeve joprofesionale në Këshilla të tillë duhet të trajtohen me procedurat përkatëse disiplinore dhe jo të shkarkohen përmes preteksteve ndryshimeve ligjore (shih, Opinionin CDL_AD(2021)012, paragrafi 31); dhe (iv) ripërtëritja e anëtarëve mund të justifikohet me kushtin e ndryshimit të mënyrës së zgjedhjes së tyre nga shumica e thjeshtë në atë të kualifikuar në mënyrë që zvogëlohet rreziku i politizimit të Këshillit apo edhe përmes vendosjes së kriteve të papërshtatshmërisë dhe të cilat do të mund të jenë proporcionale dhe të justifikojnë zbatimin e tyre të menjëhershëm nga rasti në rast për anëtarët aktualë të Këshillit, pa cenuar parimin e besimit në integritetin e mandateve (shih, Opinionin CDL_AD(2021)012, paragrafët 46 dhe 49). Në anën tjetër, në rastin e Opinionit për Moldavinë, në të cilin dhe ndër tjerash, ndërprerja e mandateve ndërlidhej edhe me përcaktimin/uljen e moshës së pensionimit, Komisioni i Venecias, ndër tjerash, kishte theksuar që (i) “nuk duhet të vendoset një kufi moshe me efektin që të ndërprejë mandatet e individëve të caktuar, të zgjedhur sipas rregullave ekzistuese të mëparshme. Komisioni i Venecias kritikoi masa të tilla në një opinion për Poloninë dhe e përsëritë këtë në kontekstin e Republikës së Moldavisë. [...]” (shih, Opinionin CDL_AD(2021)047, paragrafi 56); dhe (ii) “është e vërtetë se siguria e mandatit të anëtarëve të KPSH -së nuk garantohet me Kushtetutë (e cila është e

heshtur lidhur me kohëzgjatjen e mandatit të tyre, kufirin e moshës, etj.). Megjithatë, emërimi si anëtar i një organi kushtetues – i cili, sipas Kushtetutës, është garantuesi kryesor i pavarësisë së sistemit prokurorial, krijon të paktën njëfarë pritshmërie legjitime që mandati të mos ndërpritet në mes pa një arsye të fortë” (shih, Opinionin CDL_AD(2021)047, paragrafi 60). Ndërsa dhe në fund, në Opinionin përkitazi me Serbinë, Komisioni në kontekst të ndërprerjes së mandateve, ndër tjerash, kishte theksuar se (i) “mandati i këtyre anëtarëve duhet të përfundojë vetëm me skadimin e këtij mandati, me daljen në pension, me dorëheqjen ose vdekjen, ose me shkarkimin e tyre për arsye disiplinore (shih, Opinionin CDL_AD(2014)029, paragrafi 38); (ii) “procedura disiplinore mund të zbatohet vetëm në rastet e shkeljeve disiplinore dhe jo për shkak të “mungesës së besimit” [...] dhe duhet të përqendrohet vetëm në çështjen nëse anëtari i KPSH-së nuk ka kryer detyrat e tij ose të saj në përputhje me Kushtetutën dhe ligjin (shih, Opinionin CDL_AD(2014)029, paragrafi 53); dhe (iii) “[...] Anëtarët e këshillave prokurorial janë autonomë (shih, nenin 164 të Kushtetutës) dhe nënshtrimi i tyre ndaj votës së mosbesimit, i bën ata shumë të varur nga dëshirat e prokurorëve dhe në mënyrë efektive, do të thotë që një anëtar i zgjedhur i KPSH-së mund të shkarkohet në çdo moment pa arsye objektive. Komisioni i Venecias rekomandon fuqishëm që një procedurë e tillë të mos parashihet”. (shih, Opinionin CDL_AD(2014)029, paragrafi 56).

367. Bazuar në sqarimet e mësipërme, rezulton se bazuar në emëruesin e përbashkët të Opinioneve të Komisionit të Venecias, duke përfshirë dy Opinionet për Kosovë, në parim, (i) siguria e mandateve duhet të respektohet pa marrë parasysh nëse të njëjtat janë të saktësuar në Kushtetutë apo të përcaktuara në ligj në lidhje me institucione të pavarura kushtetuese; (ii) mandatet e fituara duhet të përfundojnë bazuar në dispozitat përkatëse kushtetuese dhe/ose ligjore sipas të cilave mandatet janë fituar, duke përfshirë edhe përmes procedurave përkatëse disiplinore; (iii) përfundimi i parakohshëm i mandateve përmes ligjeve të reja nuk mund të shërbejë si votë mosbesimi përkitazi me institucione të pavarura sepse përmes precedentëve të tillë, secila shumicë parlamentare do të mund të ndikonte në ndërprerjen e parakohshme të mandateve përkatëse, duke rezultuar edhe në ndikim politik në, ndër tjerash, institucione të pavarura kushtetuese; dhe (iv) mandatet përkatëse jodetyrimit janë absolute dhe të njëjtat, përjashtimisht, mund t'i nënshtrohen ndërprerjes së parakohshme në rrethanat të jashtëzakonshme, duke përfshirë atëherë kur një reformë institucionale është e dizajnuar për përmirësimin e dukshëm të sistemit, përfshirë rastet kur shumicat përmes të cilave zgjedhen anëtarët përkatës, kalojnë nga shumicat e thjeshta në ato të kualifikuara, duke zvogëluar kështu mundësinë e politizimit të këshillave përkatës ose kur përcaktohen kritere të reja të papërshtatshmërisë që forcojnë pavarësinë dhe shkëputjen politike të anëtarëve përkatës.
368. Më tej, dhe përtej standardeve të saktësuar përmes Opinioneve të Komisionit të Venecias, Gjykata do të (i) rikujtojë praktikën e saj gjyqësore përkitazi me sigurinë e ushtrimit të mandateve të fituara; dhe (ii) praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, bazuar në të cilën është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore sipas nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës.
369. Në kontekst të praktikës së saj gjyqësore përkitazi me sigurinë e mandateve, Gjykata rikujton dy Aktgjykime të saj, përkatësisht Aktgjykimin në rastin KO29/12 dhe KO48/12 dhe Aktgjykimin në rastin KO127/21, me parashtrues *Abelard Tahiri dhe 10 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës*, lidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë së Vendimit nr. 08-V-29 të Kuvendit të Republikës së Kosovës të 30 qershorit 2021, për shkarkimin e pesë (5) anëtarëve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Aktgjykimi i Gjykatës në rastin KO127/21).

370. Gjykata rikujton që përmes Aktgjykimit në rastin KO29/12 dhe KO48/12, kishte vlerësuar kushtetutshmërinë e amendamenteve të propozuara kushtetuese dhe të cilat përmes amendamentit nr. 10, lidhur me shpalljen e zgjedhjeve të para presidenciale, kishin propozuar zgjedhjen e Presidentit të Republikës në mënyrë të drejtpërdrejtë nga populli, për dallim nga sistemi ekzistues, në të cilin zgjedhja përkatëse bëhet nga Kuvendi dhe në këtë kontekst, ishte propozuar që zgjedhjet për Presidentin e Republikës, të mbahen brenda gjashtë (6) muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të amendamenteve kushtetuese dhe se mandati i Presidentit ekzistues, të zgjedhur nga Kuvendi, të vazhdojë deri në zgjedhjen dhe dhënien e betimit të Presidentit të ri (shih, rastin e Gjykatës KO29/12 dhe KO48/12, paragrafët 248-271). Gjykata kishte konstatuar se ky amendament i propozuar është në kundërshtim, përkatësisht pakëson të drejtat dhe liritë e përcaktuara në kapitullin II të Kushtetutës, duke theksuar që mandati është i pacenueshëm për të siguruar respektim të parimit të ndarjes së pushteteve dhe për ta ruajtur sigurinë në rendin juridik dhe kushtetues (për arsytim të detajuar shih paragrafët 248-271 të Aktgjykimit KO29/12 dhe KO48/12).
371. Përderisa Aktgjykimi i lartcekur ndërlihet me rrethana të propozimit për ndërprerjen e një mandati kushtetues përmes amendamenteve kushtetuese, në rrethanat e Aktgjykimit në rastin KO127/21, Gjykata kishte vlerësuar kushtetutshmërinë e vendimit përkatës të Kuvendit për ndërprerjen e parakohshme të mandateve të një institucioni të pavarur kushtetues, por mandatet e të cilit ishin të rregulluara me ligj. Edhe në këtë rast, Gjykata kishte konstatuar shkelje kushtetuese dhe ndër tjerash, kishte theksuar që (i) anëtarët e Këshillit përkatës mund të shkarkohen nga Kuvendi bazuar në dispozitat përkatëse të ligjit të aplikueshëm mbi bazën e të cilit janë zgjedhur, përkatësisht Ligjit nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës; dhe se, specifike për rrethanat e rastit, (ii) anëtari i Këshillit nuk mund të shkarkohet për shkak të vendimmarrjes, përkatësisht mënyrës së votimit të tij/saj (shih, rastin e Gjykatës KO127/21, paragrafët 98 dhe 99).
372. Gjykata thekson se përmes këtyre dy Aktgjykimeve të lartcekura, vihet theks në rëndësinë e funksioneve, përkatësisht mandateve kushtetuese dhe/ose ligjore, me theks në institucione të pavarura kushtetuese dhe sigurinë e tyre, sigurisht, për aq sa nuk janë plotësuar kriteret kushtetuese dhe/ose ligjore mbi bazën e të cilave janë fituar, për ndërprerjen e parakohshme të tyre. Në parim, ndërprerja e parakohshme e mandateve përkatëse përmes amendamenteve kushtetuese dhe/ose ligjore, nuk është në përputhje me parimin e sigurisë juridike, përkundër faktit që siguria e mandatit, varësisht nga institucioni përkatës dhe/ose natyra e amendamenteve të propozuara, jodetyrimisht është absolute.
373. Në këtë kontekst, Gjykata, gjithashtu, përtej praktikës së saj gjyqësore, i referohet edhe praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në dy raste, *Baka kundër Hungarisë* nr. 20261/12, Aktgjykimi i 23 qershorit 2016 dhe *Grzeda kundër Polonisë* nr. 43572/18, Aktgjykimi i 15 marsit 2022.
374. Në rastin e parë, përkatësisht, *Baka kundër Hungarisë*, përmes vendimit të 23 qershorit 2016, GJEDNJ gjeti se Hungaria kishte shkelur nenet 6 (E drejta për një proces të rregullt) dhe 10 (Liria e shprehjes) të KEDNJ-së, me rastin e ndërprerjes së mandatit të Kryetarit përkatës të Gjykatës Supreme Hungareze, përmes reformave ligjore dhe të cilat, e kishin afektuar drejtpërdrejtë atë, ndër tjerash, për arsye se (i) sipas Aktgjykimit, i njëjti kishte kritikuar reformat e ndërmarra përkitazi me sistemin e drejtësisë nga Qeveria Hungareze; dhe (ii) nuk ishte përcaktuar një mjet juridik për të kundërshtuar shkarkimin e tij sipas fuqisë së ligjit. Konteksti i rastit përkatës, për dallimin nga rrethanat e rastit konkret, ndërlihet edhe me vlerësimin nëse Qeveria Hungareze, kishte ndërhyrë në lirinë e shprehjes së parashtruesit, përkatësisht ish-

Kryetarit të Gjykatës Supreme, në kundërshtim me garancitë e nenit 10 të KEDNJ-së, duke konstatuar se ky ishte rasti.

375. Thënë këtë, në vlerësimin nëse shkarkimi i ish-Kryetarit të Gjykatës Supreme ndiqte qëllim të ligjshëm/legjitim, GJEDNJ analizoi edhe çështjen e mandateve gjyqësore dhe paprekshmërisë së tyre. GJEDNJ vërejti se sipas ligjit të zbatueshëm për organizimin dhe administrimin e gjykatave, kryetarët e gjykatave, përfshirë Kryetarin e Gjykatës Supreme, shquheshin si “zyrtarë ekzekutivë të gjykatave”. Ligji në fjalë përcaktonte mandat gjashtë (6) vjeçar për kryetarët e gjykatave, si dhe përcaktonte në formë shteruese që, përveç nëse mandati përfundonte si rrjedhojë e skadimit të mandatit gjyqësor të personit në fjalë, bazat për përfundimin e mandatit të kryetarëve të gjykatave, ishin përfundimi me marrëveshje të përbashkët, dorëheqja dhe shkarkimi për shkak të jokompetencës për të kryer funksionet menaxheriale. Në rast të shkarkimit, një kryetar gjykate kishte të drejtën e ankesës para Tribunalit të Shërbimit. Gjykata tutje theksoi se e drejta e parashtruesit për të shërbyer deri në fund të mandatit të tij si Kryetar i Gjykatës Supreme, gjente mbështetje gjithashtu në parimet kushtetuese të pavarësisë gjyqësore dhe mosshkarkimit të gjyqtarëve (shih, rastin e GJEDNJ-së, *Baka kundër Hungarisë*, paragrafët 107 dhe 108).
376. Në këtë kontekst, GJEDNJ vlerësoi se ndryshimi i rregullave për zgjedhjen e Kryetarit të Gjykatës Supreme me qëllim të përforsimit të pavarësisë së personit që mban atë pozitë, mund të ndërlidhet me qëllimin legjitim të ruajtjes së autoritetit dhe paanësisë së gjyqësorit (shih, rastin e GJEDNJ-së, *Baka kundër Hungarisë*, paragrafi 156). Megjithatë, thirrja në pavarësinë e gjyqësorit për të arsyetuar masën e përfundimit të parakohshëm të mandatit të një kryetari gjykate për arsye që nuk kanë qenë të vendosura në ligj paraprakisht dhe që nuk ndërlidhen me baza të mungesës së kompetencës profesionale ose shkeljeve, në rrethanat e rastit konkret, sipas GJEDNJ-së, nuk i shërbeu qëllimit legjitim të ngritjes së pavarësisë së gjyqësorit. Përkundrazi, ndërprerja e parakohshme e mandatit të parashtruesit si Kryetar i Gjykatës Supreme, ishte në mospërputhje me atë qëllim (shih, rastin e GJEDNJ-së, *Baka kundër Hungarisë*, paragrafi 156). Tutje, GJEDNJ gjithashtu hodhi poshtë argumentin e Qeverisë Hungareze se funksioni i parashtruesit si Kryetar i Gjykatës Supreme kishte natyrë më tepër administrative sesa gjyqësore dhe si rrjedhojë, shkarkimi i tij do të duhej të shqyrtohej sipas rregullave të zbatueshme për shkarkimin e të emëruarve politikë dhe jo të gjyqtarëve. GJEDNJ theksoi rëndësinë e parimit të mosshkarkimit të gjyqtarëve, që mbron pavarësinë gjyqësore dhe gjeti se shkarkimi i z. Baka, jo vetëm që nuk i shërbente, por ishte në kundërshtim me qëllimin e ruajtjes së pavarësisë së gjyqësorit (shih, rastin e GJEDNJ-së, *Baka kundër Hungarisë*, paragrafi 172).
377. Për më tepër, GJEDNJ gjithashtu shqyrtoi nëse e drejta e parashtruesit për qasje në gjykatë ishte shkelur meqenëse sipas ligjit të ri, përkatësisht dispozitave kalimtare të tij, atij i ishte mohuar e drejta që i kishte njohur ligji i mëparshëm mbi bazën e të cilit e kishte fituar mandatin, që të paraqiste ankesë kundër shkarkimit para Tribunalit të Shërbimit (shih, rastin e GJEDNJ-së, *Baka kundër Hungarisë*, paragrafi 115). Në rastin në fjalë, ndërprerja e parakohshme e mandatit të parashtruesit si Kryetar i Gjykatës Supreme, nuk i ishte nënshtruar shqyrtimit gjyqësor dhe as nuk kishte mundësi shqyrtimi nga një gjykatë e rregullt ose çfarëdo trupi me kompetenca gjyqësore (shih, rastin e GJEDNJ-së, *Baka kundër Hungarisë*, paragrafi 121). Si rrjedhojë, në mungesë të një mjeti juridik kundër shkarkimit që përndryshe do ta kishte sipas ligjit të mëparshëm, GJEDNJ gjeti shkelje në të drejtën e parashtruesit për qasje në gjykatë, garantuar sipas paragrafit 1 të nenit 6 të KEDNJ-së (shih, rastin e GJEDNJ-së, *Baka kundër Hungarisë*, paragrafi 122).
378. Në rastin e dytë, përkatësisht *Grzeda kundër Polonisë*, Dhoma e Madhe e GJEDNJ-së gjeti se shkarkimi i z. Grzeda, atëkohë gjyqtar në Gjykatën Supreme, nga funksioni si

anëtar i Këshillit Shtetëror Gjyqësor (në tekstin e mëtejshëm: KSHGJ) përpara përfundimit të mandatit të rregullt dhe pamundësia që të ankohej ndaj atij vendimi, përbënte shkelje të së drejtës së parashtruesit për gjykim të drejtë, përkatësisht për qasje në gjykatë. Deri te ndërprerja e parakohshme e mandatit të parashtruesit përkatës kishte ardhur përmes një reforme ligjore, që kishte ndryshuar mënyrën e përzgjedhjes së anëtarëve të KSHGJ-së dhe si rrjedhojë, ishte paraparë të ndërpriteshin parakohshëm mandatet e të gjithë pesëmbëdhjetë (15) anëtarëve të KSHGJ-së në kohën kur ligji përkatës të hynte në fuqi.

379. Përmes këtij rasti, GJEDNJ theksoi rëndësinë e mandatit kushtetues të KSHGJ-së si trup për të mbrojtur pavarësinë gjyqësore dhe analizoi lidhshmërinë e ngushtë në mes të integritetit të emërimeve gjyqësore dhe kërkesave të pavarësisë gjyqësore (shih, rastin e GJEDNJ-së, *Grzęda kundë Polonisë*, paragrafët 269, 345). GJEDNJ, ndër tjerash, kishte theksuar se vlerat e sundimit të ligjit dhe të KEDNJ-së mund të respektohen e të zbatohen nga gjyqtarët, për aq sa ligji i brendshëm nuk u cenon atyre garancitë e KEDNJ-së lidhur me çështjet që prekin drejtpërdrejtë pavarësinë e paanësinë e tyre individuale (shih, rastin e GJEDNJ-së, *Grzęda kundër Polonisë*, paragrafët 264, 302). Si rrjedhojë, GJEDNJ theksoi se çështja e pavarësisë gjyqësore duhet të kuptohet në mënyrë gjithëpërfshirëse, ashtu që si parim, të vlejë jo vetëm për gjyqtarët në ushtrimin e funksionit të tyre gjyqësor, por edhe kur ata ushtrojnë funksione të tjera gjyqësore, siç është anëtarësia në këshilla gjyqësore (shih, rastin e GJEDNJ-së, *Grzęda kundër Polonisë*, paragrafi 303). Për më tepër, GJEDNJ kishte vërejtur po ashtu se në një reformë të ngjashme të vitit 2011 lidhur me po të njëjtin ligj që kësaj radhe kishte ndërprerë parakohshëm mandatin e parashtruesit përkatës, përmes dispozitave tranzitore, ishte ruajtur mandati i anëtarëve të KSHGJ-së. Në të njëjtën frymë, GJEDNJ vërejt se përmes nenit 238 të Kushtetutës së Polonisë të vitit 1997, përmes dispozitave tranzitore, ishte ruajtur mandati i trupave kushtetues dhe individëve anëtarë të tyre, që ishin zgjedhur mbi baza të zbatueshme para hyrjes në fuqi të Kushtetutës. Këta shembuj, sipas GJEDNJ-së, ishin tregues të rëndësisë që ligji vendor i kishte kushtuar sigurisë së mandatit të trupave kushtetues dhe anëtarëve të tyre, përfshirë KSHGJ-në (shih, rastin e GJEDNJ-së, *Grzęda kundër Polonisë*, nr. 43572/18, Aktgjykim i 15 marsit 2022, paragrafi 274).
380. GJEDNJ gjithashtu vërejt se sipas ligjit të brendshëm, KSHGJ ishte trup i mandatuar me Kushtetutë që të mbronte pavarësinë e gjykatave e gjyqtarëve. Prandaj, ushtrimi efektiv i një roli të këtillë esencial, është i mundur vetëm nëse ky trup është mjaftueshëm i pavarur nga pushteti ekzekutiv dhe ai legjislativ (shih, rastin e GJEDNJ-së, *Grzęda kundër Polonisë*, cituar më lart, paragrafi 304). Më tutje, GJEDNJ nuk u bind nga argumentet e Qeverisë së Polonisë se Vendimi i Gjykatës Kushtetuese Polake i 20 qershorit 2017, që e kishte shpallur kushtetues ligjin që parashihte ndërprerjen e mandatit të z. Grzeda, nuk do të mund të zbatohet pa shkurtrimin e mandatit të kompozicionit aktual të KSHGJ-së. GJEDNJ refuzoi gjithashtu argumentin e Qeverisë së Polonisë se një sistem pa shkurtrim të këtillë të mandateve, do të zgjaste tej mase dhe do të komplikonte procesin e reformës. Sipas GJEDNJ-së, qartazi kishte metoda alternative që do të respektonin rregullin e përgjithshëm të ruajtjes së mandatit katërvjeçar të anëtarëve të KSHGJ-së. Alternativë, sipas GJEDNJ-së dhe siç ishte propozuar edhe nga Komisioni i Venecias dhe GRECO, do të ishte nëse anëtarët gjyqtarë do të mbanin pozitat e tyre deri në skadimin e mandateve origjinale, ndërsa anëtarët e rinj të zgjedheshin për periudha më të shkurta. Duke konsideruar ndërprerjen e menjëhershme të mandateve të të gjithë anëtarëve gjyqtarë të KSHGJ-së si masë joproporcionale, GJEDNJ theksoi se ndryshimet do të duhej të ishin shoqëruar me një periudhë të përshtatshme adaptimi ose alternativisht, të vlenin nga fillimi i mandateve të reja (shih, rastin e GJEDNJ-së, *Grzęda kundër Polonisë*, paragrafi 279).

381. Në shqyrtimin e pretendimit të parashtruesit i ishte shkelur e drejta për qasje në gjykatë, GJEDNJ bëri dallimin në mes të rastit në fjalë dhe rastit *Baka*, në të cilin, siç u shtjellua më sipër, ishte gjetur shkelje në të drejtën e parashtruesit të garantuar sipas paragrafit 1 të nenit 6 të KEDNJ-së, për shkak se ligji i ri, për dallim nga ligji i mëparshëm mbi bazën e të cilit parashtruesi e kishte fituar mandatin, nuk përcaktonte mjet juridik kundër shkarkimit (shih, rastin e GJEDNJ-së, *Grzęda kundër Polonisë*, paragrafi 290). Në rastin *Grzęda*, Gjykata e shqyrtoi nëse ndonjëherë parashtruesi përkatës kishte pasur në dispozicion mjet juridik kundër vendimit për shkarkim, pavarësisht ndryshimeve sipas ligjit të ri. Kjo çështje u shqyrtua përmes aplikimit të testit *Eskelinen*, sipas të cilit, për të përjashtuar zbatueshmërinë e nenit 6 të KEDNJ-së, duhet të argumentohet se ligji vendor përjashton në tërësi të drejtën për mjet juridik në llojin e caktuar të kontesteve dhe nëse përjashtimi i tillë, mbështetet në arsye objektive të interesit shtetëror (shih, rastin e GJEDNJ-së, *Grzęda kundër Polonisë*, paragrafi 290). Si përfundim, duke gjetur se neni 6 i KEDNJ-së ishte i zbatueshëm në rastin konkret për shkak se përjashtimi i zbatueshmërisë së tij nuk mund të argumentohet në dritën e interesit shtetëror, Gjykata theksoi se anëtarët e gjyqësorit, ashtu edhe si të gjithë qytetarët tjerë, duhet të jenë të mbrojtur nga arbitrariteti i legjislativit dhe ekzekutivit dhe vetëm mbikëqyrja e ligjshmërisë së një mase të tillë siç është rasti i largimit nga posti të parashtruesit, nga një trup gjyqësor i pavarur, ofron mbrojtje efektive (shih, rastin e GJEDNJ-së, *Grzęda kundër Polonisë*, paragrafët 326 dhe 327). Si rrjedhojë, Gjykata gjithashtu gjeti se mungesa e mjetit juridik ndërhynte me vet thelbin e të drejtës së parashtruesit për qasje në gjykatë (shih, rastin e GJEDNJ-së, *Grzęda kundër Polonisë*, paragrafi 349).
382. Për më tepër dhe në vijim, përtej praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, Gjykata gjithashtu do t'i referohet dy vendimeve të Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Evropian (në tekstin e mëtejme: GJDBE), përkatësisht C-619/18, *Komisioni Evropian kundër Polonisë* (rasti i GJDBE-së C-619/18, *Komisioni kundër Polonisë* [2019] ECR, Aktgjykim i 24 qershorit 2019) dhe C-192/18, *Komisioni Evropian kundër Polonisë* (rasti i GJDBE-së C-192/18, *Komisioni kundër Polonisë* [2019] ECR, Aktgjykim i 5 nëntorit 2019) dhe të cilat ndërliidhen, ndër tjerash, me iniciativa dhe reforma ligjore me pasojën e ndërprerjes së parakohshme të mandateve të gjyqtarëve, kryesisht, si rezultat i uljes/ndryshimit të moshës së pensionimit.
383. Në rastin C-619/18, *Komisioni Evropian kundër Polonisë*, GJDBE, gjeti se Polonia kishte dështuar në përmbushjen e obligimeve të veta sipas të drejtës së Bashkimit Evropian, më saktësisht paragrafit 1 të nenit 19 të Traktatit të Bashkimit Evropian, referuar sundimit të ligjit dhe mbrojtjes efektive juridike në fusha të mbuluara nga e drejta e BE-së, përmes nxjerrjes së një ligji që përcaktonte moshë më të re dhe më të ulët të pensionimit për gjyqtarët aktualë të Gjykatës Supreme, e që si rrjedhojë, rezultonte në përfundimin e parakohshëm të mandatit të tyre dhe si i tillë, ishte në kundërshtim me parimin e moslargimit/mosshkarkimit të gjyqtarëve.
384. Sipas GJDBE-së, dhe ndër tjerash, në mënyrë që të sigurohet pavarësia e paanësia e gjyqtarëve, janë të nevojshme disa garanci të përshtatshme, e ndër to është edhe garancia kundër largimit nga detyra, përkatësisht shkarkimit (shih, rastin e GJDBE-së *Komisioni Evropian kundër Polonisë*, paragrafi 75 dhe referencat e përdorura aty). Sipas këtij parimi, gjyqtarët mund të mbesin në detyrë derisa të kenë arritur moshën e obligueshme për pensionim apo t'ju ketë skaduar mandati, në rast se i njëjti është i kufizuar. Megjithëse ky parim nuk është parim absolut, mund të ketë përjashtime vetëm nëse ato mbështeten në baza legjitime dhe të bindshme dhe në përputhje me parimin e proporcionalitetit. Prandaj, është gjerësisht e pranueshme që gjyqtarët mund të shkarkohen në rast se cilësohen si të papërshtatshëm për të kryer detyrat e tyre, për shkak të jokompetencës ose shkeljes serioze të obligimeve të tyre, me kusht që të jenë

ndjekur procedurat e duhura (shih, rastin e GJDBE-së *Komisioni Evropian kundër Polonisë*, paragrafi 76).

385. Sipas GJDBE-së, zbatimi i ligjit të kontestuar, që parashihte moshë më të re të pensionimit për gjyqtarët e Gjykatës Supreme, do të vlente për të gjithë gjyqtarët aktualë, duke rezultuar kështu në përfundimin e parakohshëm të mandatit të tyre, situatë kjo që ngre shqetësime serioze sa i përket përputhshmërisë me parimin e moslargimit/mosshkarkimit të gjyqtarëve (shih, rastin e GJDBE-së *Komisioni Evropian kundër Polonisë*, paragrafi 78). Zbatimi i një mase të tillë do të ishte i pranueshëm vetëm nëse arsyetohet nga një qëllim legjitim, është proporcional në dritën e atij qëllimi dhe për aq sa nuk ngritë dyshime të arsyeshme në shoqëri sa i përket pandikueshmërisë së gjykatave nga faktorët e jashtëm dhe neutralitetit të tyre përballë interesave para tyre (shih, rastin e GJDBE-së *Komisioni Evropian kundër Polonisë*, paragrafi 79). Gjithashtu, GJDBE kishte theksuar se kjo reformë parasheh gjithashtu kompetencën e Presidentit të Shtetit që të vendosë, në bazë diskriminuese, të zgjasë periudhën tashmë të shkurtuar të mandatit të gjyqtarëve, edhe për gjashtë (6) vjet rresht (shih, rastin e GJDBE-së *Komisioni Evropian kundër Polonisë*, paragrafi 83).
386. Pra, mundësia për zgjatje të mandatit të gjyqtarëve edhe për gjashtë (6) vjet dhe njëkohësisht shkurtimi i mandatit të rregullt për pesë (5) vjet për shkak të moshës më të ulët të pensionimit për gjyqtarët e Gjykatës Supreme, sipas GJDBE-së ngritë dyshime të arsyeshme nëse reforma në fjalë me të vërtetë synon të standardizojë moshën e pensionimit të gjyqtarëve me të gjithë të punësuarit të tjerë dhe nëse përmirëson baraspeshën e moshës në mesin e gjyqtarëve më të moshuar (shih, rastin e GJDBE-së *Komisioni Evropian kundër Polonisë*, paragrafi 84). Kombinimi i këtyre dy masave që ligji i kontestuar përcakton, sipas GJDBE-së, më shumë jep përshtypjen të jetë i prirë nga qëllimi që të përjashtojë një grup të paracaktuar gjyqtarësh të Gjykatës Supreme, duke qenë se Presidenti, pa marrë parasysh zbatimin e masës sipas të cilës ulet mosha e pensionimit për të gjithë gjyqtarët e Gjykatës Supreme që kanë qenë në detyrë kur ligji në fjalë ka hyrë në fuqi, ka diskrecionin të mbajë në detyrë disa nga grupi i po të njëjtëve (shih, rastin e GJDBE-së *Komisioni Evropian kundër Polonisë*, paragrafi 85). Për më tepër, GJDBE ka theksuar se, siç ka gjetur në disa raste, dispozitat e ligjit të brendshëm që në mënyrë të menjëhershme dhe të detyrueshme ulin moshën e pensionimit dhe ndërpresin mandatin e gjyqtarëve, pa parashikuar masa kalimtare që mbrojnë pritjet legjitime të tyre për kohëzgjatje të mandatit, bien në kundërshtim me parimin e proporcionalitetit (shih, rastin e GJDBE-së *Komisioni Evropian kundër Polonisë*, paragrafi 91 dhe referencat e përdorura aty).
387. Në anën tjetër, në rastin C-192/18, *Komisioni Evropian kundër Polonisë*, Vendimi i 5 nëntorit 2019, GJDBE, gjeti se Polonia kishte dështuar në përmbushjen e obligimeve sipas ligjit të Bashkimit Evropian, kur kishte miratuar një ligj që përcaktonte moshë të re të pensionimit për gjyqtarët e Gjykatës Supreme, përkatësisht e ulte atë dhe gjithashtu, mosha të ndryshme të pensionimit për gjyqtarët burra dhe gjyqtaret gra. Sipas këtij ligji, gjyqtarët burra pensionoheshin me të arritur moshën 65 vjeçare, ndërsa gjyqtaret gra kur të mbushnin 60 vjeç, për dallim nga ligji paraprak që kishte përcaktuar si moshë të pensionimit për të dyja gjinitë moshën 67 vjeçare. Ky ligj përcaktonte gjithashtu kompetencën diskrecionale të Ministrit të Drejtësisë për t'ju zgatur moshën e pensionimit gjyqtarëve sipas zgjedhjes së tij, deri në 70 vjeç. Referuar çështjes së parë, pra efektivisht shkurtimit të parakohshëm të mandatit, GJDBE theksoi se siç është tashmë e qartë nga një numër vendimesh të nxjerra, liria e nevojshme për gjyqtarët nga çdo ndikim ose presion i jashtëm, kërkon garanci të përshtatshme për mbrojtjen e atyre individëve që ushtrojnë funksione gjyqësore, siç janë për shembull garancitë që të mos mund të largohen nga detyra në mënyrë të parakohshme (shih, rastin e GJDBE-së *Komisioni Evropian kundër Polonisë*, paragrafi 112 dhe referencat e përdorura aty). GJDBE kishte theksuar gjithashtu që reforma parashihte kompetencë diskrecionale të

Ministrit të Drejtësisë dhe si e tillë, mund të shkaktonte dyshim të bazuar tek qytetarët se sistemi i ri mëtonte t'i mundësonte Ministrit të Drejtësisë që të largonte grup të caktuar të gjyqtarëve, duke përdorur diskrecionin e tij për t'i mbajtur në pozitë gjyqtarët tjerë (shih, rastin e GJDBE-së *Komisioni Evropian kundër Polonisë*, paragrafi 127).

388. Në këtë frymë, sipas GJDBE-së, parimi që gjyqtarët janë të palargueshëm/të pashkarkueshëm do të thotë se gjyqtarët mund të vazhdojnë të mbesin në detyrë, derisa të mos kenë arritur moshën e pensionimit ose derisa t'ju ketë skaduar mandati, në rast se kanë mandat me kohë të caktuar. Përderisa ky parim nuk është plotësisht absolut, mund të ketë përjashtime për aq sa mbështeten në baza legjitime dhe të bindshme dhe që përkojnë me parimin e proporcionalitetit. Si rrjedhojë, është gjerësisht e pranueshme që gjyqtarët mund të shkarkohen nëse konsiderohen të papërshtatshëm për kryerjen e detyrave të tyre, për shkak të mungesës së kompetencës ose shkëljes së rëndë të obligimeve të tyre, me kusht që të jenë ndjekur procedura të përshtatshme (shih, rastin e GJDBE-së *Komisioni Evropian kundër Polonisë*, paragrafi 113, dhe referencat e përdorura aty). Në fund dhe sipas GJDBE-së, marrë parasysh rëndësinë themelore të parimit të moslargimit/mosshkarkimit, përjashtimi nga ky parim është i pranueshëm vetëm nëse arsyetohet nga një qëllim objektiv dhe është proporcional në dritën e atij qëllimi, përderisa dhe aq sa nuk ngriten dyshime të arsyeshme në shoqëri sa i përket pandikueshmërisë së gjykatave nga faktorët e jashtëm dhe neutralitetit të tyre përballë interesave para tyre (shih, rastin e GJDBE-së *Komisioni Evropian kundër Polonisë*, paragrafi 15).
389. Në kontekst të katër (4) aktgjykimeve të referuara më lart, që përfshijnë praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së dhe GJDBE-së, Gjykata fillimisht vëren që për dallim nga rrethanat e rastit konkret, (i) të njëjtat ndërlidhen me gjyqtarë dhe jo me prokurorë dhe në këtë kontekst, megjithatë, rikujton dallimet por edhe ngjashmëritë në ushtrimin e dy funksioneve edhe sipas parimeve të Komisionit të Venecias; (ii) në rastin *Baka kundër Hungarisë*, ku rrethanat e rastit kishin të bëjnë me funksionin shtesë si kryetar gjykate të një gjyqtari, përkatësisht atë të Kryetarit të Gjykatës Supreme, mandati i parashtruesit përkatës ishte ndërprerë me veprimin e ligjit, përmes një reforme ligjore me efekt specifikisht ndaj pozitës që ushtronte ai, ndër tjerash, për shkak të kritikave që i njëjti kishte bërë lidhur me reformat përkatëse në sistemin e drejtësisë; dhe (iii) në rastin *Grzęda kundër Polonisë*, mandati i parashtruesit si anëtar i KSHGJ-së, ishte ndërprerë parakohshëm, me fuqinë e ligjit dhe përmes një reforme ligjore që kishte ndërprerë menjëherë mandatet e të gjithë anëtarëve të KSHGJ-së. Thënë këtë, Gjykata gjithashtu vëren që ngjashëm me rrethanat e rastit konkret, (i) ndërprerja e parakohshme e mandateve në rastet e GJEDNJ-së, ndërlidhjen me funksione administrative të gjyqtarëve përkatës, përkatësisht ushtrimin e funksioneve shtesë në cilësi të Kryetarit të Gjykatës Supreme dhe/ose Këshillit përkatës gjyqësor; dhe (ii) ndërprerja e parakohshme e mandateve në të gjitha rastet pasonte si rezultat i miratimit të ligjeve të reja në emër të reformave në sistemin e drejtësisë.
390. Marrë parasysh edhe ngjashmëritë, dallimet por edhe rrethanat specifike faktike në të cilat aktgjykimet e lartcekura janë nxjerrë, Gjykata thekson se praktika e lartreferuar gjyqësore e GJEDNJ-së dhe GJDBE-së, rezulton në disa parime themelore dhe të cilat, ndër tjerash, përcaktojnë: (i) sigurinë e mandateve kushtetuese dhe ligjore dhe ndërprerjen e parakohshme të tyre vetëm bazuar në dispozitat dhe procedurat përkatëse të saktësuar mbi Kushtetutat dhe/ose ligjet mbi bazën e të cilave janë fituar; (ii) zbatimin e parimit të mosshkarkimit/moslargimit të gjyqtarëve në kontekst të rrethanave të rasteve përkatëse por edhe kur ata ushtrojnë funksione të administrimit të drejtësisë, për shkak të ndërlidhjes së drejtpërdrejtë të këtyre funksioneve me ruajtjen e pavarësisë së sistemit që përfaqësojnë; (iii) rëndësinë e mjeteve efektive juridike për të kontestuar vendimet përkatëse bazuar në të cilat mandatet janë ndërprerë në mënyrë të parakohshme; dhe (iv) mundësinë që mandatet e fituara të

mund të ndërprehen në mënyrë të parakohshme sepse siguria e mandatit jodetyrimisht është absolute, megjithatë çdo iniciativë/reformë ligjore e cila përjashtimisht mund të rezultojë në ndërprerje të parakohshme të mandateve përkatëse, duhet të ndjek bindshëm një qëllim legjitim dhe të jetë proporcionale me qëllimin e ndjekur.

391. Gjykata gjithashtu rikujton që në rastin *Grzęda kundër Polonisë*, GJEDNJ, ndër tjerash, kishte marrë parasysh edhe ndryshimet paraprake ligjore dhe dispozitat përkatëse tranzitore përmes të cilave në mënyrë të vazhdueshme ishte ruajtur mandati i trupave përkatës dhe mandati i anëtarëve të tyre, duke theksuar që një qasje e tillë ishte tregues i rëndësisë që ligji vendor i kishte kushtuar sigurisë së mandateve. Në këtë kontekst, dhe siç është sqaruar edhe në paragrafët 296-297 të këtij Aktgjykimi, Gjykata gjithashtu rikujton që përkundër reformave të vazhdueshme përkitazi me KPK-në ndër vite, përfshirë kur KPK ishte funksionalizuar për herë të parë sipas nenit 110 të Kushtetutës përmes Ligjit të vitit 2010, pas shpalljes së pavarësisë së Republikës së Kosovës dhe hyrjes në fuqi të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, mandatet e anëtarëve të KPK-së, nuk ishin ndërprerë parakohshëm përmes ligjeve të aplikueshme edhe pse ndryshimet përkatëse ligjore, ndër vite, kishin rezultuar në ndryshimin e strukturës së KPK-së, përfshirë në kontekst të raportit në mes anëtarëve prokurorë dhe jo-prokurorë.
392. Më saktësisht dhe së pari, Gjykata thekson që të gjitha ligjet respektive lidhur me KPK-në, kishin ruajtur mandatet e anëtarëve të Këshillit Gjyqësor dhe/ose Prokurorial të fituara paraprakisht. Ky ishte rasti edhe me themelimin e vet Këshillin Prokurorial sipas nenit 110 të Kushtetutës, sepse përmes nenit 53 (Tranzicioni i Këshillit Prokurorial) të Ligjit 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, ishte përcaktuar që prokurorët të cilët janë anëtarë të Këshillit në të njëjtën kohë që themelohet Këshilli Prokurorial, transferohen tek Këshilli Prokurorial dhe mbeten aty deri në skadimin e natyrshëm të mandatit të tyre. Njëjtë ishte përcaktuar edhe përmes Ligjit të parë që themelon KPK-në sipas nenit 110 të Kushtetutës, përkatësisht Ligjit nr. 03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës të vitit 2010, i cili përmes neneve 41 (Vlefshmëria e Veprimeve të Mëparshme të Këshillit themeluar sipas Rregullores Administrative të UNMIK-ut 2005/52 dhe Ligjit mbi Përbërjen e Përkohshme të Këshillit Gjyqësor të Kosovës), 42 (Përbërja fillestare e Këshillit) dhe 43 (Transferimi i kompetencave) të tij, respektivisht, kishte përcaktuar transferimin e kompetencave nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, në Këshillin e ri të themeluar Prokurorial, duke saktësuar që prokurorët të cilët në kohën e themelimit të këtij Këshilli, ishin anëtarë të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, transferohen në Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe mbesin aty deri në skadimin e natyrshëm të mandatit të tyre.
393. Së dyti, mandatet e fituara përmes Ligjit të vitit 2010, ishin ruajtur deri në skadimin e natyrshëm të tyre, përmes paragrafit 3 të nenit 6 [pa titull] të Ligjit të vitit 2015, përkundër faktit që ky i fundit, kishte ndryshuar strukturën e Këshillit Prokurorial jo vetëm duke shtuar numrin e anëtarëve prokurorë në Këshill, por gjithashtu duke e eliminuar përfaqësimin *ex-officio* të Ministrit të Drejtësisë në KPK dhe duke e transferuar administrimin e konkursit për anëtarin e shoqërisë civile nga KPK në Kuvend. Në këtë kontekst, Gjykata vëren se (i) përmes këtij Ligji ishte ndërprerë përfaqësimi *ex officio* i Ministrit të Drejtësisë në KPK-në, por eliminimi i përfaqësimit të Ministrisë së Drejtësisë në KPK ishte propozuar nga vet Ministria e Drejtësisë dhe për pasojë, kjo çështje nuk ishte kontestuar asnjëherë dhe as nuk i ishte nënshtruar vlerësimit gjyqësor dhe/ose kushtetues; dhe (ii) përmes vendimit të vet KPK-së dhe jo me efekt të ligjit, ishte ndërprerë në mënyrë të parakohshme mandati pesëvjeçar i fituar i anëtarit të shoqërisë civile dhe i cili kishte kontestuar këtë vendim edhe në Gjykatë Kushtetuese, e cila e kishte shpallur kërkesën e papranueshme për shkak të mosshterimit të mjeteve juridike (shih, Aktvendimin për papranushmëri në rastin KI145/15, me parashtrues *Florent Muçaj*, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të

- Këshillit Prokurorial të Kosovës, nr. 321/2015 të 5 nëntorit 2015) dhe më pas, kishte vazhduar procedurat në gjykata të rregullta dhe të cilat përmes dy aktgjykimeve [A. nr. 1992/15] dhe [AA.nr.413/2021], të Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe asaj të Apelit, respektivisht, kanë vlerësuar se ndërprerja e parakohshme e mandatit të anëtarit të shoqërisë civile të përfaqësuar në KPK ishte bërë në mënyrë të kundërligjshme nga ana e KPK-së.
394. Së treti dhe në fund, mandatet e fituara përmes Ligjit të vitit 2015, ishin ruajtur deri në skadimin e natyrshëm të tyre, përmes paragrafit 1 të nenit 36 (Qëndrimi në detyrë) të tij, përkundër faktit që i njëjti gjithashtu kishte bërë ndryshime në strukturën e KPK-së, siç është sqaruar në këtë Aktgjykim.
395. Bazuar në të lartcekurat, Gjykata thekson që, përgjatë të gjitha reformave ligjore dhe të cilat e kanë afektuar strukturën e KPK-së që nga themelimi i saj, me efekt të ligjit është ndërprerë vetëm përfaqësimi i Ministrit të Drejtësisë në KPK në vitin 2015, propozim ky i vet Ministrisë përkatëse dhe për pasojë e siç është sqaruar më lart, përfaqësimi dhe/ose mungesa e përfaqësimit *ex-officio* të Ministrit të Drejtësisë në KPK, nuk ishte kontestuar asnjëherë. Thënë këtë, përkundër reformave të vazhdueshme ligjore dhe të cilat e kanë afektuar strukturën e KPK-së, mandatet e fituara bazuar në ligjet paraprake janë ruajtur gjithnjë përmes dispozitave tranzitore të ligjeve të reja, duke përfshirë edhe reformën më të thellë në strukturën e KPK-së, përkatësisht themelimin e saj bazuar në nenin 110 të Kushtetutës, pas hyrjes së të njëjtës në fuqi. Një qasje e tillë e Republikës së Kosovës, ndër vite, siç ka theksuar edhe GJEDNJ në rastin *Grzęda kundër Polonisë*, është tregues i qartë i rëndësisë së shteti i ka akorduar ruajtjes dhe respektimit të sigurisë së mandateve të anëtarëve të një institucioni të pavarur kushtetues.
396. Në kontekst të sqarimeve të mësipërme, Gjykata edhe një herë thekson që neni 20 i Ligjit të kontestuar, ndër tjerash, përcakton procedurën e shortit të udhëhequr nga Kryetari i Gjykatës Supreme, Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor dhe Avokati i Popullit, përmes të cilës përcaktohet se cilët anëtarë të KPK-së vazhdojnë mandatin e tyre të fituar sipas Ligjit bazik; (ii) procedura e shortit do të përcaktojë se cili anëtarë i KPK nga Prokuroria e Apelit dhe ajo Speciale do të vazhdojë mandatin dhe cilët dy (2) anëtarë të KPK-së nga prokuroritë themelore do të vazhdojnë mandatet përkatëse; dhe (iii) mandatet e të gjithë anëtarëve të tjerë prokurorë, do të përfundojnë pas procedurës së shortit, ndërsa të anëtarëve jo-prokurorë aktualë, do të përfundojnë me zgjedhjen e anëtarëve të rinj jo-prokurorë. Siç është sqaruar detajisht përgjatë këtij Aktgjykimi, në të dy opinionet e Komisionit të Venecias, i njëjti ishte shprehur se, në parim, ishte kundër ndërprerjes së parakohshme të mandateve të Këshillit Prokurorial, përkundër faktit që kishte theksuar që një qëndrim i tillë nuk ishte absolut dhe se (i) “*me fjalë të thjeshta, përfundimi i parakohshëm i mandateve të disa anëtarëve mund të justifikohet nëse çon në një përmirësim të ndjeshëm të sistemit të përgjithshëm*”; dhe (ii) “*edhe pse, si rregull, Komisioni i Venecias nuk është në favor të një përfundimi automatik të parakohshëm të mandateve të anëtarëve të një këshilli prokurorial për shkak të një reforme institucionale, dispozitat e reja kalimtare janë më të respektueshme lidhur me sigurinë e mandatit të anëtarëve të KPK-së ekzistuese në raport me modelin paraprak*”, megjithatë, të njëjtat opinione, gjithashtu theksojnë se (i) “*ata mund të largohen para kohe vetëm nëse qeveritë demonstrojnë bindshëm se zëvendësimi i tyre i shërben një interesi jetik publik dhe çon në përmirësimin e përgjithshëm të sistemit*”; dhe se (ii) në parim, “*demonstrimi i bindshëm i përmirësimit të përgjithshëm të sistemit*” dhe reforma përkatëse “*duhet t'i lihet diskrecionit të Ministrisë dhe Kuvendit, në dialog me akterët vendor, ekspertët dhe partnerët ndërkombëtarë të Kosovës*” dhe gjithashtu “*përderisa e kupton urgjencën e reformës, Komisioni megjithatë thërret autoritetet përkatëse që të sigurojnë një përfshirje të vërtetë të prokurorëve të Kosovës në diskutimet për ndryshimet e propozuara në Kuvend*”.

397. Gjykata rikujton gjithashtu, që në dy opinionet për Kosovë, por edhe opinionet e raportet tjerat të Komisionit të Venecias, theksohet vazhdimisht që ndërprerja e parakohshme e mandateve në kontekst të “*përmirësimit të dukshëm të sistemit*” do të mund të ndërlihej me ndryshimet në mënyrën e votimit, përkatësisht kalimit nga votimi i thjeshtë në votë të kualifikuar në Kuvend për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit përkatës dhe/ose vendosjen e kriterëve të reja të papajtushmërisë me funksionin dhe të cilat do të mund të rezultojnë në përmirësimin e dukshëm të funksionit të Këshillit përkatës, përfshirë de-politizimin e tij, dy rrethana këto që nuk ndërlihen me Ligjin e kontestuar. Për më tepër dhe përderisa qasjen që mandatet nuk janë detyruesisht absolute e mban edhe praktika gjyqësore e GJEDNJ-së dhe GJDBE-së, respektivisht, të njëjtat në katër (4) aktgjykimet e lartcekura, kanë konstatuar shkelje të KEDNJ-së dhe të drejtës së BE-së, respektivisht, atëherë kur janë ndërprerë parakohshëm mandatet përkatëse përmes reformave ligjore, duke theksuar, në parim se, siguria e mandatit jodetyruesisht është absolute, megjithatë çdo iniciativë/reformë ligjore e cila mund të rezultojë në ndërprerje të parakohshme të mandateve përkatëse, duhet të ndjek një qëllim legjitim dhe të jetë proporcionale me qëllimin e ndjekur.
398. Në rrethanat e rastit konkret, Gjykata fillimisht thekson që qëllimi i reformës së sistemit prokurorial nga Ministria e Drejtësisë, me theks në zvogëlimin e mundësisë së “*korporatizimit*” në Këshillin Prokurorial dhe rritjen e “*pluralizmit*” në përfaqësimin e të njëjtit është një qëllim legjitim dhe i cili, përkundër mungesës së një emëruesi të saktë të përbashkët në praktikën ndërkombëtare përkitazi me përbërjen e këshillave prokurorial, është në përputhje me standardet e përmbledhura nga Komisioni i Venecias, siç është sqaruar nga i njëjti. Kjo është e rëndësishme pikërisht duke marrë parasysh strukturën hierarkike të sistemeve prokuroriale, dhe mundësinë që në vendimmarrjen e këshillave prokurorial, anëtarët e përzgjedhur nga vet prokuroria, të mund t’i nënshtrohen vullnetit të Kryeprokurorit të Shtetit. Thënë këtë, dhe siç është sqaruar në këtë Aktgjykim, po aq sa mund të jenë legjitime dhe të nevojshme nismat ligjore të dizajnuara për të vendosur balancin e duhur në mes anëtarëve prokurorë dhe jo-prokurorë në këshilla prokurorial, po aq është e rëndësishme që nisma të tilla të jenë proporcionale, duke vënë theks në mënyrë të vazhdueshme që të njëjtat të mos rezultojnë në politizimin e këshillave, duke shtuar mundësitë e ndikimit të pushtetit legjislativ dhe/ose ekzekutiv dhe rrjedhimisht të mos rezultojnë në cenimin e pavarësisë përkatëse dhe të cilin, KPK-së, ia ka akorduar Kushtetuta.
399. Gjykata rikujton që bazuar në paragrafin 1 të nenit 110 të Kushtetutës, KPK është institucion plotësisht i pavarur në kryerjen e funksioneve të tij, në pajtim me ligjin. Gjykata gjithashtu rikujton që po sipas të njëjtit nen, përkatësisht paragrafit 4 të tij, përbërja e KPK-së, si dhe dispozitat për emërimin, shkarkimin, mandatin, strukturën organizative dhe rregullat e procedurës, rregullohen me ligj. Kompetencën për nxjerrjen e këtij të fundit e ka Kuvendi i Republikës bazuar në paragrafin 1 të nenit 65 të Kushtetutës. Thënë këtë, kjo kompetencë nuk mund të ushtrohet në mënyrë që cenon pavarësinë funksionale që Kushtetuta i ka përcaktuar KPK-së bazuar në paragrafin 1 të nenit 110 të Kushtetutës.
400. Gjykata gjithashtu rikujton që një ndër parimet themelore të ruajtjes së pavarësisë së një institucioni të pavarur kushtetues është siguria e mandateve të anëtarëve të tij dhe imuniteti përkatës përkitazi me vendimmarrjen. Që të dy këto parime, siç është sqaruar tashmë përmes këtij Aktgjykimi, janë konfirmuar, ndër vite, përmes praktikës gjyqësore të Gjykatës. Pavarësia e një institucioni kushtetues dhe/ose anëtari të tij, është në mënyrë absolute e cenueshme, nëse një pushtet tjetër, përtej dispozitave kushtetuese dhe atyre ligjore bazuar në të cilat këto institucione janë themeluar dhe mandatet respektive janë fituar, ndërmerr iniciativë ligjore dhe/ose miraton ligj të ri, bazuar në të cilin, ndërpret parakohshëm mandatet përkatëse. Një precedent i tillë, në një sistem demokratik kushtetues, do të ishte i rrezikshëm sepse do t’i mundësonte forcave politike

të përfaqësuara në pushtet ekzekutiv dhe/ose legjislativ që të ndryshojnë strukturën, përfshirë mandatet e anëtarëve të institucioneve të pavarura, varësisht nga bindjet dhe qëllimet politike. Një qasje e tillë nuk përkon me vlerat e një shteti demokratik të bazuar në ndarjen dhe balancin e pushteteve.

401. Për më tepër, çdo përfundim i parakohshëm i mandatit, në përputhje me parimin e sigurisë juridike, në parim, duhet të jetë në përputhje me dispozitat kushtetuese dhe/ose ligjore mbi bazën e të cilave është fituar. Ligji bazik, përkatësisht neni 13 (Përfundimi i mandatit) i tij, saktësisht përcakton bazat mbi të cilat mund të përfundojë një mandat i anëtarit të Këshillit në mënyrë të parakohshme dhe nxjerrja e një ligji të ri nga Kuvendi, nuk është njëra nga këto baza. Për më tepër, çdo ndërprerje e parakohshme e mandatit duhet të shoqërohet me mjetin përkatës efektiv juridik, përmes të cilit mund të kontestohet në procedura gjyqësore procedura e ndjekur përkitazi me përfundimin e parakohshëm të mandatit. Kjo e fundit, është konfirmuar edhe nga praktika gjyqësore e GJEDNJ-së në rastet *Baka kundër Hungarisë* dhe *Grzęda kundër Polonisë*. Përrjashtime nga këto parime, përkatësisht precedentë të tillë, do të cenonin parimin e sigurisë së mandateve dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë edhe pavarësinë dhe paanësinë e anëtarëve të institucioneve përkatëse dhe për pasojë, edhe funksionimin e pavarur të institucionit të cilin e përfaqësojnë, në kundërshtim me parimet kushtetuese në rastin e institucioneve të pavarura kushtetuese, siç është rasti i KPK-së. Fakti që mandatet e anëtarëve të këshillave përkatës, pa marrë parasysh nëse përbërja e tyre është e rregulluar specifikisht me Kushtetutë ose është e deleguar në ligj, nuk janë ndërprerë asnjëherë përmes ligjeve të Kuvendit dhe në rastin e Këshillit Prokurorial, as atëherë kur i është nënshtruar reformës më të thellë të tij, përkatësisht themelimit të tij sipas nenit 110 të Kushtetutës pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, është indikatorë i qartë i rëndësisë së sigurisë së mandateve të institucioneve të pavarura kushtetuese. Një qasje e tillë, siç është sqaruar në këtë Aktgjykim, është në përputhje të plotë me praktikën gjyqësore të Gjykatës, GJEDNJ-së, GJDBE-së por edhe parimeve të shtjelluara nga Komisioni i Venecias.
402. Thënë këtë, Gjykata vëren, që nga këto parime, ka përjashtime dhe të cilat, sipas GJEDNJ-së dhe GJDBE-së, do të ishin të mundshme nëse mbështeten “*në baza legjitime dhe të bindshme dhe në përputhje me parimin e proporcionalitetit*” dhe sipas Opinioneve të Komisionit të Venecias, specifikisht në rastin e Kosovës, (i) “*përfundimi i parakohshëm i mandateve të disa anëtarëve mund të justifikohet nëse çon në një përmirësim të ndjeshëm të sistemit të përgjithshëm*” dhe (ii) “*ata mund të largohen para kohe vetëm nëse qeveritë demonstrojnë bindshëm se zëvendësimi i tyre i shërben një interesi jetik publik dhe çon në përmirësimin e përgjithshëm të sistemit*”. Në të dy rastet, arsye bindëse dhe legjitime që përmirësojnë dukshëm sistemin prokurorial, janë të nevojshme. Siç është sqaruar përmes këtij Aktgjykimi, përmirësimi i strukturës së KPK-së duke e balancuar raportin në mes anëtarëve prokurorë dhe jo-prokurorë dhe duke kontribuar në legjitimitetin demokratik të të njëjtit, gjithnjë me mekanizmat e nevojshëm për të pamundësuar ndikimin politik në të njëjtin, sigurisht ndjek një qëllim të duhur legjitim. Thënë këtë, realizimi i të njëjtit duhet të jetë edhe proporcional, dhe ndër tjerash, siç është sqaruar në *Grzęda kundër Polonisë*, duhet të shqyrtohen të gjitha metodat alternative që do të respektonin rregullin e përgjithshëm të ruajtjes së mandatit të anëtarëve të Këshillit deri në përfundimin e tij, sipas dispozitave të ligjit mbi bazën e të cilit i njëjti është fituar.
403. Në rrethanat e një Ligji, dhe i cili sipas vlerësimit të Gjykatës përmes këtij Aktgjykimi, është kundër-kushtetues në pjesë esenciale të tij, përkatësisht (i) pika 1.3.2 e paragrafit 1 të nenit 6 [pa titull] dhe neni 8 [pa titull], përkatësisht neni 10/A i Ligjit të kontestuar, përmes të cilit ndryshohet dhe plotësohet neni 9 (Përbërja e anëtarëve të Këshillit) i Ligjit bazik, nuk janë në përputhshmëri me paragrafin 1 të nenit 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit], paragrafin 10 të nenit 65 të Kushtetutës dhe nenin 132 [Roli

dhe Kompetencat e Avokatit të Popullit] të Kushtetutës; (ii) paragrafi 2/a i nenit 13 [pa titull] të Ligjit të kontestuar, përmes të cilit ndryshohet dhe plotësohet neni 15 (Kuorumi dhe vendimmarrja) i Ligjit bazik, nuk është në përputhshmëri me paragrafin 1 të nenit 110 dhe paragrafin 1 të nenit 4 të Kushtetutës; (iii) paragrafi 5 të nenit 16 [pa titull] të Ligjit të kontestuar, përmes të cilit ndryshohet dhe plotësohet neni 19 (Procedurat disiplinore për anëtarët e Këshillit) i Ligjit bazik, nuk është në përputhshmëri me nenin 24 të Kushtetutës; dhe (iv) neni 18 i Ligjit të kontestuar përmes së cilit plotësohet, përkatësisht shtohet neni 23/A i Ligjit bazik, nuk është në përputhshmëri me nenin 32 dhe nenin 54 të Kushtetutës, edhe ndërprerja e mandatit të vetëm një pjesë të anëtarëve të Këshillit përmes shortit përkatës dhe në mungesë të plotë të mjetit juridik efektiv që në rastet e lartreferuara të GJEDNJ-së kishte rezultuar në shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së, (i) cenon sigurinë e mandateve të anëtarëve të Këshillit Prokurorial dhe për pasojë, edhe pavarësinë e plotë të Këshillit Prokurorial në ushtrimin e funksioneve të tij në kundërshtim me paragrafin 1 të nenit 110 të Kushtetutës dhe marrë parasysh statusin e Këshillit Prokurorial në rendin juridik të Republikës së Kosovës, siç është sqaruar në këtë Aktgjykim, edhe në kundërshtim me paragrafin 1 të nenin 4 të Kushtetutës; dhe (ii) nuk mund të shërbejë as si arsye bindëse që do të mund t'i shërbente një qëllimi legjitim e proporcional dhe mbi bazën e të cilit do të mund të autorizohet përjashtimisht ndërprerja e mandateve të një institucioni të pavarur kushtetues, duke krijuar kështu një precedent me pasoja në sigurinë dhe pavarësinë e ushtrimit të funksionit të institucioneve të pavarura kushtetuese dhe rrjedhimisht edhe për rendin demokratik dhe sundimin e ligjit në Republikën e Kosovës.

404. Për pasojë dhe përfundimisht, Gjykata konstaton që neni 20 [pa titull] i Ligjit të kontestuar për ndryshimin dhe plotësimin e nenit 36 (Qëndrimi në detyrë) të Ligjit bazik dhe paragrafi 3 i nenit 11 [pa titull] të Ligjit të kontestuar për ndryshimin dhe plotësimin e nenit 13 (Përfundimi i mandatit) të Ligjit bazik, nuk janë në përputhshmëri me paragrafin 1 të nenit 110, paragrafin 1 të nenit 4 dhe nenet 32 e 54 të Kushtetutës.
405. Në fund, Gjykata rikujton që kërkesat e parashtruesve të kërkesës janë parashtruar në Gjykatë bazuar në paragrafin 5 të nenit 113 të Kushtetutës. Kjo kategori e kërkesave ka efekt suspenziv sepse bazuar në nenin 43 (Afati) të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, ligji i tillë mund t'i dërgohet Presidentit të Republikës së Kosovës për shpallje vetëm pas vendimmarrjes së Gjykatës dhe në pajtim me modalitetet e përcaktuara në vendimin final të Gjykatës për rastin e kontestuar.
406. Në praktikën gjyqësore të Gjykatës përkitazi me kategorinë e kërkesave të paragrafit 5 të nenit 113 të Kushtetutës, në rast të konstatimit që dispozita të caktuara të ligjit të kontestuar nuk janë në përputhshmëri me Kushtetutën, Gjykata, (i) ka shpallur të pavlefshme vetëm dispozitat e vlerësuara në kundërshtim me Kushtetutën, ndërsa pjesën tjetër të ligjit e ka dërguar te Presidenti për shpallje në pajtim me modalitetet e Aktgjykimit të Gjykatës, siç është rasti me Aktgjykimet e Gjykatës në rastin KO01/17, me parashtrues *Aida Dërguti dhe 23 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës* lidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit për ndryshim dhe plotësim të Ligjit nr. 04/L-261 për Veteranët e Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës apo edhe rastin KO108/13, me parashtruese *Albulena Haxhiu dhe 12 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës* lidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit nr. 04/L-209 për Amnisti; ose (ii) në rast të vlerësimit që dispozitat e shpallura në kundërshtim me Kushtetutën janë të rëndësishme thelbësore për ligjin në fjalë dhe për pasojë, shpallja apo hyrja në fuqi e tij, do të e bënte të njëjtin të pazbatueshëm, ka shfuqizuar ligjin përkatës në tërësinë e tij, siç është rasti me Aktgjykimin e Gjykatës në rastin KO43/19 (cituar më lart) lidhur me Ligjin për Detyrat, Përgjegjësitë dhe Kompetencat e Delegacionit Shtetëror të Republikës së Kosovës në Procesin e Dialogut me Serbinë.

407. Në rrethanat e rastit konkret, Gjykata ka konstatuar që dispozita esenciale të Ligjit të kontestuar nuk janë në përputhshmëri me Kushtetutën. Për pasojë, dhe duke marrë parasysh që pjesa tjetër e Ligjit të kontestuar do të ishte vështirë e zbatueshme pas shpalljes së dispozitave të lartcekura si të pavlefshme, Gjykata vlerëson se Ligji i kontestuar, duhet të shpallet i pavlefshëm, në tërësinë e tij.

IV. Kërkesa për Masën e Përkohshme

408. Gjykata rikujton se parashtruesit e kërkesave kanë kërkuar nga Gjykata që të vendosë masë të përkohshme, për të pezulluar hyrjen në fuqi dhe zbatimin e Ligjit të kontestuar, deri në vendosjen përfundimtare për kërkesat përkatëse.
409. Gjykata, në këtë kontekst, thekson se paragrafi 2 i nenit 43 (Afati) të Ligjit, përcakton efektin suspenziv të hyrjes në fuqi të ligjeve që kontestohen sipas paragrafit 5 të nenit 113 të Kushtetutës, duke theksuar se *“në rast kur ligji apo vendimi i miratuar nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës kontestohet sipas nenit 113, paragrafi 5 i Kushtetutës, ligji apo vendimi i tillë mund t'i dërgohet Presidentit të Republikës së Kosovës për shpallje në pajtim me modalitetet e përcaktuara në vendimin final të Gjykatës Kushtetuese për rastin e kontestuar”*.
410. Bazuar në dispozitën e lartcekur, Gjykata më 4 korrik 2022, kishte kërkuar nga Kryetari i Kuvendit, Presidentja dhe Sekretari i Kuvendit që të marrin parasysh kërkesat e paragrafit 2 të nenit 43 të Ligjit.
411. Andaj, duke marrë parasysh që bazuar në paragrafin 2 të nenit 43 të Ligjit, Ligji i kontestuar sipas paragrafit 5 të nenit 113 të Kushtetutës nuk mund të dekretohet, të hyjë në fuqi, apo të prodhojë efekte juridike pa nxjerrjen e vendimit nga Gjykata, si dhe në pajtim me nenin 27 (Masat e Përkohshme) të Ligjit dhe me rregullin 57 [Vendimi për masë të përkohshme] të Rregullores së punës, kërkesa për masë të përkohshme, është pa objekt shqyrtimi dhe, si e tillë, refuzohet (shih, *mutatis mutandis*, Aktgjykimin e Gjykatës në rastin KO43/19, cituar më lart, paragrafi 113).

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenet 113 (5) dhe 116 (2) të Kushtetutës, nenet 20, 27 dhe 42 të Ligjit dhe në bazë të rregullave 57, 59 (1) dhe 74 të Rregullores së punës, më 24 mars 2023, njëzëri:

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të pranueshme;
- II. TË KONSTATOJË se pika 1.3.2 e paragrafit 1 të nenit 6 dhe neni 8, përkatësisht neni 10/A i Ligjit të kontestuar nuk janë në përputhshmëri me paragrafin 1 të nenit 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit], paragrafin 10 të nenit 65 [Kompetencat e Kuvendit] dhe nenin 132 [Roli dhe Kompetencat e Avokatit të Popullit] të Kushtetutës;
- III. TË KONSTATOJË se paragrafi 2/a i nenit 13 të Ligjit të kontestuar nuk është në përputhshmëri me paragrafin 1 të nenit 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit] dhe paragrafin 1 të nenit 110 [Këshilli Prokurorial i Kosovës] të Kushtetutës;
- IV. TË KONSTATOJË se paragrafi 5 i nenit 16 të Ligjit të kontestuar nuk është në përputhshmëri me paragrafin 1 të nenit 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës;
- V. TË KONSTATOJË se neni 18, përkatësisht 23/A i Ligjit të kontestuar nuk është në përputhshmëri me nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike] dhe nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës;
- VI. TË KONSTATOJË se paragrafi 3 i nenit 11 dhe neni 20 i Ligjit të kontestuar nuk janë në përputhshmëri me paragrafin 1 të nenit 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit], nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike], nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] dhe paragrafin 1 të nenit 110 [Këshilli Prokurorial i Kosovës] të Kushtetutës;
- VII. TË SHPALLË të pavlefshëm, në tërësinë e tij, Ligjin nr.08/L-136 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës;
- VIII. TË REFUZOJË kërkesën për masën e përkohshme;
- IX. TUA KUMTOJË këtë Aktgjykim palëve;
- X. TË KONSTATOJË që ky Aktgjykim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 20 (5) të Ligjit;

Gjyqtari raportues

Bajram Ljatifi



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Gresa Caka-Nimani

